

Lidhja e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë

LSHPM

AKTIVITETE TË PENSIONISTËVE QË MERITOJNË RESPEKT

70
VJET
1946 – 2016

SHKUP 2016

BOTON:

Lidhja e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë

KËSHILLI I BOTUESIT:

Besnik Pocesta
Saltir Karovski
Mr. Ilija Adamoski
Gjorge Andonov
Dushan Ristoski
Spirko Nikolovski
Dr. Vele Aleksoski
Dr. Krste Angelovski
Baki Bakiu

AUTORË:

Dragi Argirovski
Stanka Trajkova
Kalina Slivovska - Andonova
Mr. Ilija Gligorov
Mendo Dimovski

REDAKTORI KRYESOR:

Dragi Argirovski

REDAKTORË

Baki Bakiu
Kalina Slivovska - Andonova

RECENSUES:

Aleksandar Dimkovski

**PËRGATITJA KOMPJUTERIKE, GRAFIKE
DHE FIGURATIVE:**

Tome Angelovski

PËRKTHEU:

MAK-ALB

SHTYP:

RI-GRAFIKA

PARATHËNIE

VITI I JUBILEUT 70-VJEÇAR DO TË MBAHET MEND

Lidhja e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë në vitin 2016 shënoi një jubile të rrallë: 70-vjetorin e organizimit të pensionistëve në Maqedoni. Gjatë zhvillimit të tij, Asociacioni i pensionistëve u shndërrua në organizatën civile multietnike më të madhe dhe më aktive në Republikën e Maqedonisë dhe në faktor respektabil i shoqërisë, duke regjistruar arritje të rëndësishme në interes të pensionistëve. Rezultate dhe aktivitete veçanërisht impresionuese u arritën dhe zhvilluan gjatë vitit të jubileut, vitit 2016, rezultate dhe aktivitete këto që nuk mund të harrohen, por që do të shënohen me shkronja të mëdha dhe të arta.

Edhe optimistët më të mëdhenj midis nesh nuk do të supozonin se gjatë vitit të jubileut të gjitha detyrat e përcaktuara paraprakisht do të realizoheshin me saktësi, me plan, plotësisht dhe në mënyrë inspiruese. Një gjë të tillë ne arritëm me forca të bashkuara, duke ecur me entuziazëm në rrugën e të vërtetës.

Që në fillimin e vitit LSHPM fitoi dhuratën më të preferuar nga shteti për jubileun 70-vjeçar, fitoi ambientet e reja dhe moderne të punës, që shfrytëzohen pa pagesë. Dhurata e fituar ishte një inkurajim i ri dhe ofroi mundësi më të mira për realizimin e aktiviteteve të përgjithshme. Në muajin mars me gazetën "Nova Makedonija", me një solemnitë shënuam numrin e 50-të të shtojcës së përbashkët "Pikëpamje të pensionistëve", numri i parë i të cilës, në janar të vitit 2005, ishte rrezja e parë e dritës që do të hidhej mbi terrin e atëhershëm informativ lidhur me problematikën e pensionistëve në Republikën e Maqedonisë.

Midis aktiviteteve tona më të theksuara dhe më të mëdha të vitit të jubileut u gjetën sfilatat e 14-ta rajonale të këngës, muzikës dhe lojërave, që u organizuan me sukses nga shoqatat e pensionistëve në Pehçevë, Butel - Skopje, Kriva Palankë, Shtip, Veles, Gazi Babë - Shkup, Manastir dhe Kërçovë. Sfilata e gjashtë në nivel shtetëror u realizua në Shkup, me mbështetjen e Ministrisë së kulturës, e cila si rezultat të cilësisë ose manifestimit më të mirë kulturor të pensionistëve, u shpall nga vetë shteti si ngjarje me interes nacional në fushën e kulturës, ndërsa pensionistët u shpallën rojtarë të besueshëm të pasurisë folklorike në Maqedoni, duke qenë shembull për pensionistët e vendeve të rajonit dhe Evropës. Me dinjitet dhe sukses rezultatet i vërtetuan edhe përfaqësuesit tanë të sivjetshëm të Festivalit ndërkombëtar të moshës së tretë, që u zhvillua në Lubjanë, shoqëritë kulturoro-artistike të Shoqatës së pensionistëve në Manastir dhe Shoqatës së pensionistëve në Demir Hisar. Me rastin e rezultateve të arritura në këtë festival, kryeministri i Sllovenisë, Dr. Miro Cerar, për delegacionin e LSHPM-së organizoi një pranim të veçantë.

Gjatë vitit të jubileut me sukses u organizuan edhe garat rajonale sportive të 21-ta në Çair dhe Gjorçe Petrov në Shkup, Demir Hisar, Dibër, Kavadar, Kumanovë, Llozovë dhe Dellçevë, si dhe Olimpiada republikane e pensionistëve në Radovish, në të cilën morën pjesë një numër rekord garuesish ose mbi 500 garues.

Një numër rekord prej 35.000 pensionistë sivjet morën pjesë edhe në takimet-piknik në Oraavec, Lesnovë, Elenec, Dojran, Pelincë, Pantelej e të tjera dhe gjithashtu u organizuan edhe shumë takime dhe

aktivitete të ngjashme, ekskursione brenda dhe jashtë vendit, aksione humanitare për rajonet e prekura me vërshimet etj.

Me një promovim të veçantë u promovua libri me titullin "Argumentet zbardhin të vërtetën", si një vazhdim i kronikës për moshën e tretë në vendin tonë, që në fakt është një përgjigje e gënjeshtreve dhe manipulimeve të pabaza lidhur me veprimin e Lidhjes dhe zhvillimeve në fushën e problematikës së pensionistëve. Gjatë vitit të jubileut vazhduan lehtësimet lidhur me përmirësimin e standardit të pensionistëve. Deri më sot rreth 38.000 pensionistë kanë fituar rekreacion banje falas, rreth 6.000 të tjerë kanë fituar vikende turistike, mbi dyqind mijë pensionistë kanë fituar udhëtime falas me tren dhe autobus, në mënyrë masive janë shfrytëzuar edhe uljet e çmimeve të biletave për shfaqjet teatrale e të tjera dhe për vizitat e muzeve, u zhvilluan punëtori në kuadër të projektit "Fondi i Sigurimit Shëndetësor i Maqedonisë më afër pensionistëve", zbritën çmimet e shumë barnave, u hapën farmaci të reja mobile, një numër i madh pensionistësh me pensione të ulëta fituan edhe mjekim spitalor falas etj. Me rëndësi akoma më të madhe është pagimi i rregullt i pensioneve gjatë gjithë vitit ose pagimi i tyre gjatë ditëve të para të muajt, ndërsa nga data 1 nëntor 2016 pensionet u rritën për 5 për qind, kështu që pensioni mesatar në Republikën e Maqedonisë kap shumën e 13.745,00 denarëve ose 223,00 euro, duke qenë një nga pensionet më të larta në rajon.

Maksimumi u arrit me organizimin e suksesshëm të Akademisë solemne me rastin e 70-vjetorit të organizimit të pensionistëve në Maqedoni, në të cilën Presidenti i shtetit, Dr. Gjorge Ivanov, LSHPM-në dekoroi me "Kartën e Republikës së Maqedonisë", në formë falënderimi për aktivitetet dhe arritjet në fushën e organizimit të pensionistëve. Ky është dekorimi i parë në historinë shumëvjeçare të Lidhjes dhe për këtë arsye është edhe dekorimi më i dashur. Siç theksoi edhe presidenti Ivanov, kjo mirënjohje shtetërore jepet për të gjithë pensionistët, për kontributin e tyre për bashkësinë gjatë viteve të tyre të punës, por edhe pas daljes në pension. Nga pensionistët me të drejtë pritet të transmetojnë njohuritë, përvojën dhe urtësinë e tyre, pa të cilat nuk mund të funksionojë asnjë shoqëri. Gëzon fakti që i gjithë solemniteti i organizuar në sallën e plotë të Shtëpisë së Armatës së Republikës së Maqedonisë kaloi në një atmosferë jashtëzakonisht të bukur, që do të mbetet në kujtesë.

Të impresionuar nga këto aktivitete, në atmosferë shumë të këndshme dhe dinjitoze, manifestime jubileu u zhvilluan edhe në Manastir, Prilep, Kumanovë, Shtip, Radovish, Veles, Gevgjeli, Solidariteti - Aerodrom, Krushevë, Kriva Palankë, Demir Hisar, Demir Kapi, Shën Nikollë dhe në qytete të tjera.

Njëkohësisht, me rastin e jubileut, delegacione të LSHPM-së u pritën nga Kryetari i Kuvendit të RM-së, z. Trajko Veljanovski dhe nga Kryeministri i RM-së, z. Emil Dimitriev.

Arritjet që meritojnë respekt u prezantuan rregullisht me gazetën tonë të pensionistëve që ndahet falas "Pensionist plus", gazetë kjo e cila në vitin e jubileut shënoi numrin e 100. Gazeta "Pensionist plus" është përmbushje e një vizioni tjetër. Me këtë rast duhet të rikujtojmë numrin e parë të gazetës që u botua më 25 korrik 2008. Në aspektin historik, në atë kohë botimi i një gazete me 16 faqe dhe 6.000 kopje ishte një cilësi e re, një fitore e re për informimin e pensionistëve, por edhe për informimin e opinionit më të gjerë. Koncepti kryesor që u propozua nënkuptonte që pensionistët dhe familjet e tyre, por edhe institucionet shtetërore, të informohen në një mënyrë më efikase, më shpejtë dhe më saktë me vendimet me rëndësi për pensionistët dhe me aktivitetet me rëndësi për jetën dhe veprimin e pensionistëve. Gazeta "Pensionist Plus" filloi të informojë opinionin me zhvillimet me rëndësi në organizatën e pensionistëve, me punën e Fondeve të Sigurimeve Pensionale dhe Sigurimit Shëndetësor dhe me aktivitetet e faktorëve të tjerë relevantë, duke vënë theksin në zgjidhjen ose lehtësimin e problemeve të përditshme të veteranëve të punës.

Në këtë mënyrë me sukses u përhap e vërteta për dhe rreth tyre. Ne u morëm vesh që gjatë informimit të respektohet rreptësisht rregulli i përgjegjësisë lidhur me fjalën e shkruar, duke kontrolluar faktet për interes të së vërtetës. Pothuajse në të njëjtën kohë ne hapëm edhe ueb faqen tonë.

Me aktivitetet tona ne impresionuam pensionistët dhe opinionin në përgjithësi. Me çdo numër të ri dhe nga viti në vit ne mundësuar edhe përmbajtje të reja dhe në hap me kohën mundësuar hapa të rëndësishëm në fushën e informimit. Në vitin 2011 ne hapëm edhe ueb faqe në gjuhën shqipe dhe mundësuar një faqe për pensionistët në gazetën në gjuhën shqipe "Koha". Ne zhvilluam edhe rrjetin e korrespondentëve, i cili është më i mirë se ato të mediave më të njohura në vendin tonë. Në aspektin e cilësisë, përmbajtjeve dhe numrit të lexuesve, gazeta "Pensionist plus" u bë lidere dhe shembull i informimit të pensionistëve në Ballkan, Evropën Juglindore dhe më gjerë.

Informimi i mirë mundësoi të fitohet një pamje reale lidhur me jetën e pensionistëve në Republikën e Maqedonisë dhe dha kontribut për impulse të reja për ditë pensioni më të mira, për kalimin e ditëve të pensionit me shëndet të mirë dhe shumë aktivitete. Botimi i një gazete të pavarur është një arritje shumë e madhe për të cilën duhet pasur kujdes edhe më tej sepse vetëm pensionisti i informuar drejtë dhe në kohë është i mirë për vetveten dhe shoqërinë.

E sipërpërmendura tregon dhe vërteton se Lidhja e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë ecën me krenari dhe pa u ndalur në rrugën e të vërtetës, duke përhapur në mënyrë interaktive energjinë pozitive dhe respektin. Po ashtu LSHPM jep kontribut që shembujt pozitivë të jenë një lloj inkurajimi për pensionistët e tanishëm, por edhe për pensionistët e ardhshëm. Ne duhet të jemi krenarë me rezultatet e arritura, vizionet dhe veprat tona, rritjen e rejtikut të LSHPM, rezultatet e arritura që meritojnë respekt, për të cilat meritë të veçantë ka stafi menaxhues i Lidhjes, Këshilli ekzekutiv, organet punuese, stafet menaxhuese të shoqatave dhe të gjithë pensionistët vullnetarë në të gjithë vendin.

Lidhja e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë funksionon 70 vjet dhe bazohet në shoqërimin, respektin dhe bashkëjetesën.

Tekstet e publikuara, fotografitë autentike dhe analizat e Monografisë për 70-vjetorin e organizimin e pensionistëve në Maqedoni, me titullin "Ditë pensioni që meritojnë respekt", vërtetojnë faktet dhe të dhënat e prezantuara.

Dragi Argirovski
Kryetari i LSHPM

Aleksandar Dimkovski Kryeredaktori i gazetës "Nova Makedonija"

VITE ME PLOTË SHOQËRIM, BASHKËJETESË DHE AKTIVITETE

Me një kënaqësi dhe përgjegjësi të veçantë pranova ofertën për të qenë recensues i Monografisë me titullin "Aktivitete pensioni që meritojnë respekt", që botohet me rastin e 70-vjetorit të organizimit të pensionistëve në Republikën e Maqedonisë. Sfida është akoma më e madhe me vetë faktin që bëhet fjalë për vlerësimin e veprës së organizatës më të madhe në Maqedoni dhe sipas të gjitha gjasave organizata jopartiake me ndikim më të madh, jo qeveritare dhe multietnike, e cila në vitin 2016 shënoi jubileun e saj të madh 7-dekadash.

Si kryeredaktor i të përditshmes në gjuhën maqedonase "Nova Makedonija", i cili drejtpërdrejtë dhe mbi një dekadë bashkëpunon me Lidhjen e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, me publikimin e revistës mujore "Pikëpamje të pensionistëve", por duke ndjekur në aspektin profesional të gjitha aktivitetet e tyre, në fillim mendova se recensionin do të jetë një detyrë rutine. Por, pas rileximit të faqeve të para dhe njohjes me kapitujt dhe përmbajtjet e Monografisë, kuptova se kam marrë përsipër një detyrë të madhe por fisnike, të depërtojë në thelbin e diçkaje që përbën gjurmë dhe vullë historike që nuk do të fshihet me kalimin e kohës lidhur me veprimin e pensionistëve.

Duke lexuar faqet e Monografisë, para jush hapet një horizont me një pasuri të dhënash të paçmueshme. Si një lloj muzeu me artefakte me rëndësi, me këtë vepër janë përfshirë dhe renditur të gjitha ngjarjet me rëndësi, që nga fillimet në vitin 1946, kur janë regjistruar 2600 pensionistë e deri më sot, kur Lidhja e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë ka mbi 250000 anëtarë.

Para se të shtjellojë në detaje çdo kapitull, dua të theksojë se në fakt bëhet fjalë për një monografi profesionale, me të cilën janë realizuar të gjitha parametrat e një vepre të këtij lloji. Në këtë kontekst, unë kam parasysh shfrytëzimin e burimeve relevante dhe të paanshme të të dhënave dhe informatave gjatë përgatitjes së përmbajtjeve, ndërsa çdo temë karakterizohet me origjinalitetin, gjithëpërfshirjen, prezantimin e detajuar dhe të vërtetën. Ndërkaq, cilësia e titujve, rubrikave, nënrubrikave, fotografive dhe ilustrimeve është në një nivel të lartë profesional.

Një numër i madh ngjarjesh historike, ngjarje të harruara dhe të zverdhura të së kaluarës, jetësohen me monografinë para lexuesve. Për këtë arsye, me të drejtë mund të konstatohet se me këtë vepër autorët e saj shkruajnë jo vetëm historinë e tyre të jetës, por edhe gjenezën dhe historinë e organizimit të pensionistëve në Maqedoni. Në këtë mënyrë, gjeneratave të ardhshme u lihet një vepër-pasuri e paçmueshme dhe bazë të dhënash dhe faktesh të pakontestueshme, të mbledhura dhe të sistemuara në një vend.

Në aspektin e strukturës Monografia me titullin "Aktivitete të pensionistëve që meritojnë respekt" është ndarë në 10 kapituj.

Në pjesën e parë, në fillim, është sistemuar ngjarja më e madhe - ndarja e çmimit "Karta e Republikës së Maqedonisë" nga ana e Presidentit të shtetit, Prof. Dr. Gjorge Ivanov. Është shumë logjike dhe e arsyeshme që në fillim të librit të sistemohet dekorimi shtetëror më i lartë, i cili u ndahet pension-

istëve për kontributin e tyre në zhvillimin dhe ndërtimin e vendit tonë, por edhe për aktivitetet, bashkimin e pensionistëve dhe unitetin e tyre, që mund të jenë shembuj për të gjithë popullatën e Maqedonisë.

Me pjesën e dytë janë prezantuar fillimet ose dy dekadat e para të zhvillimit të organizimit të pensionistëve, me pasqyra kronologjike të detajuara të akteve ligjore dhe rregullave me të cilat ka filluar dhe organizuar e drejta e sigurimit pensional dhe social. Kjo pjesë është mbështetur edhe me faksimile dhe ilustrime me të gjitha dokumentet me rëndësi të asaj kohe. Në këtë pjesë do të gjeni edhe të dhënën se në vitin 1952, Qeveria e atëhershme ka marrë vendim për ndarjen e pensioneve sociale për personat e gjallë që kanë marrë pjesë në Kryengritjen e lindenit, që u anëtarësuan në Shoqatën e pensionistëve. Kjo tregon se shumë punë, shumë dokumente dhe shumë materiale arkivi është dashur të mblidhen, të analizohen të dhënat dhe pastaj në një formë të sublimuar të sistemohen në një punim të këtij lloji. Në këtë kontekst Monografia me kapitujt e saj, përveç vlerës letrare dhe dokumentare, përbën edhe një regjistër i veçantë historik me vlerë enciklopedie, që do t'u shërbejë edhe gjeneratave të ardhshme.

Në pjesën e tretë janë paraqitur të gjitha aktivitetet dhe rezultatet më të rëndësishme dhe statusi ligjor, organizimi dhe fushëveprimi i pensionistëve. Solidariteti i pensionistëve ka qenë gjithmonë një karakteristikë pozitive. Besoj se nuk dihet shumë fakti të cilin do ta lexoni në Monografinë se Fondi i vetëm vullnetar i pas-vdekjes për ndihmë është aprovuar që në vitin 1955, fond ky që është plotësuar në vitin 1962.

Me pjesën e katërt trajtohet bashkëpunimi ndërkombëtar i LSHPM-së. Në këtë pjesë, njësoj si në kapitujt e tjerë, do të gjeni të dhëna të veçanta, por edhe fascinuuese. Kjo pjesë jep edhe një paraqitje të detajuar të asociacioneve të pensionistëve të vendeve të tjera, me të cilat bashkëpunon LSHPM. Me të gjitha këto aktivitete LSHPM paraqitet edhe në një rol plotësisht të ri - si një promotor dhe ambasador i suksesshëm i Maqedonisë në rajon, Evropë dhe më gjerë.

Pjesa e pestë i përkushtohet shoqërimit të gjeneratave. Në këtë pjesë duhet theksuar fenomeni i unitetit dhe bashkimit të gjeneratave, që është një karakteristikë e të gjitha manifestimeve që organizohen nga LSHPM. Në një pjesë të madhe të aktiviteteve të organizuara nga ana e LSHPM marrin pjesë përfaqësues të të gjitha gjeneratave. Përfaqësues të të gjitha gjeneratave mund të shihen në piknikët në natyrë, ndërsa në vallet mund të shihen të moshuar, persona të moshës së mesme, të rinj dhe fëmijë. Kur ky uniteti i gjeneratave do të lidhet me bashkëjetesën dhe tolerancën multietnike, një karakteristikë kjo e LSHPM-së, mund të fitohet një koncept i suksesshëm që duhet kopjuar në aspektin e kuptimit të politikës dhe jetesës në përgjithësi.

Pjesa e gjashtë është quajtur: "Rojtarët lojalë dhe në pension të trashëgimisë kulturore të Republikës së Maqedonisë". Edhe kjo është një e vërtetë e madhe. Në erën e globalizimit dhe ndikimeve të jashtme në çdo sferë, por edhe në fushën e kulturës, muzikës dhe artit, pensionistët nuk janë vetëm rojtarë të pasurisë tonë kulturore, por edhe transmetues autentikë për gjeneratat e reja. Sfilatat e këngës, muzikës dhe lojërave janë një manifestim tradicional dhe i mirënjohur që mbështetet edhe nga Ministria e kulturës. Ndërkaq, pensionistët janë aktivë edhe në shumë fusha të tjera, duke inkurajuar dhe duke u kujdesur për krijimtarinë letrare, nëpërmjet ekspozitave të shumta me punime dhe vepra artistike, pjesëmarrje në manifestimet që promovojnë ushqimet tradicionale etj. Të gjitha këto kanë një element të përbashkët - ruajtjen e burimit, patriotizmit, dashurisë për atdheun, identitetin dhe traditës, gjëra këto për të cilat ne s'ka si të mos jemi mirënjohës.

Pjesa e shtatë trajton sportin dhe aktivitetet sportive në moshën e tretë. Me tekstet e zgjedhura të këtij kapitulli mund të shihet se edhe në këtë plan janë arritur rezultate shumë të mira. Olimpiada sportive e pensionistëve në vitin 2015 u mbajt për të 20-ën herë dhe u bë një ngjarje e madhe, duke u nisur nga fakti se sporti në moshë të thyer mundëson kujdesin për funksionet fizike dhe intelektuale të organizmit të njeriut dhe shpirtin e shëndoshë në trupin e shëndetshëm.

Me pjesën e tetë trajtohet segmenti i informimit të pensionistëve, si një nga aktivitetet me prioritet të LSHPM. Fillimet regjistrohen në vitin 1952, kur Shoqata e pensionistëve të Republikës Popullore të Maqedonisë është marrë vesh të ketë faqen e vet në gazetën e atëhershme të pensionistëve serbë, bashkëpunim ky që ka vazhduar për 16 vjet. Më vonë, pensionistët e Maqedonisë kanë hapur gazetën e tyre me titullin "FJALA jonë", e cila për herë të parë është botuar më 31 mars 1967. Në aspektin historik, kur bëhet fjalë për informimin, me rëndësi të madhe është fakti që më 28 janar 2005, me gazetën "Nova Makedonija" publikohet numri i parë i shtojcës së përbashkët "Pikëpamjet e pensionistëve", që në fakt ishte edhe rezja e parë që hodhi dritë mbi terrin e atëhershëm informativ lidhur me problematikën e pensionistëve në Maqedoni. Kjo shtojcë vazhdon të botohet edhe sot dhe gjithnjë e më shumë bëhet më e njohur dhe më e lexuar. Më 25 korrik 2008 filloi të botohet edhe gazeta e LSHPM-së me titullin "Pensionist plus", e cila u bë gazetë lidere dhe shembull i informimit të pensionistëve në Ballkan, Evropën Juglindore e më gjerë. Në këtë kontekst duhet përmendur edhe ueb faqja dhe versioni elektronik i gazetës. E gjithë kjo tregon se pensionistët jo vetëm që janë në hap me teknologjinë, por të njëjtën e përdorin me shkathtësi, ndërsa e gjithë kjo është në funksion të informimit të tyre të drejtë. Në vitin 2011 për pensionistët është mundësuar një faqe në gazetën në gjuhën shqipe "Koha", që përbën një kontribut shtesë drejt tolerancës multietnike, respektimit dhe bashkëjetesës - elemente këto karakteristike për LSHPM-në. Lidhja ka edhe një rrjet të zhvilluar korrespondentësh, siç duan të kenë edhe shumë media të tjera, i cili bashkë me sektorin e informimit dhe ekipin redaktues të LSHPM dallohen për profesionalizmin e madh. Kur bëhet fjalë për informimin, unë do të theksoja moton kryesore të LSHPM-së: Vetëm pensionisti i informuar është i mirë për vetveten, shoqërinë dhe Lidhjen. Kësaj shprehjeje nuk mund t'i shtojmë ose t'i heqim asgjë.

Me pjesën e nëntë të Monografisë janë paraqitur shpërblimet dhe mirënjohjet e ndara me rastin e jubileut 70-vjeçar të organizimit të pensionistëve, ndërsa me kapitullin e dhjetë janë paraqitur 53 shoqatat, anëtare të Lidhjes. E sipërpërmendura tregon qartë se kemi të bëjmë me një organizëm të madh dhe dinamik që pulson në ritmin e përparimit, suksesit dhe aktiviteteve të shumta të Shoqatës në të gjithë vendin.

Monografia me titullin "Aktivitete të pensionistëve që meritojnë respekt" është një vepër me rëndësi dhe e pasur me përmbajtje të shumëllojshme që mundësojnë një pasqyrë të detajuar dhe objektive të organizimit dhe veprimit të pensionistëve dhe rezultateve të arritura gjatë shtatë dekadave të arritura. Kompozicioni dhe struktura e përmbajtjeve është sistemuar logjikisht në pjesë të qarta, të cilat bashkë përbëjnë një tërësi homogjene me një koncept të pasur dhe që bazohet në profesionalizmin. Kapitujt janë përgatitur në aspektin analitik dhe janë të pasur me fakte dhe argumente që tërheqin vëmendjen e lexuesit, ndërsa përveç aspektit informativ ofrojnë edhe edukim dhe gjëra interesante. Megjithatë kjo vepër në një pjesë të madhe trajton të dhëna historike dhe faktografike lidhur me aktivitetet e pensionistëve dhe organizimin e tyre, vetë vepra përmban edhe vizion për të ardhmen. Mund të themi kështu sepse memoria nuk është vetëm regjistrim i kujtimeve lidhur me faza dhe ngjarje të caktuara të historisë, por paraqet edhe bazë për interpretim dhe parashikimin e të ardhmes. Këtë cilësi unë do ta kisha quajtur - vlerë e shtuar e Monografisë ose "bençmark" i qartë që përcakton standardet e larta të veprimit të pensionistëve në të ardhmen në Maqedoni por edhe më gjerë. Njëkohësisht, në kushtet momentale shoqëro-politike vërtetohet se pikërisht koncepti dhe modeli i kuptimit dhe veprimit të LSHPM ka kuptim dhe jep rezultate. Monografia në këtë kontekst është vetëm një indikator shtesë.

PJESA I



"KARTA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË" PËR LSHPM

"KARTA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË" PËR LSHPM

1. AKADEMI SOLEMNE ME RASTIN E JUBILEUT

Më 16 shtator 2016 në Shkup u mbajt një akademi solemne me rastin e shënimit të 70-vjetorit të organizimit të pensionistëve në Maqedoni, në kuadër të të cilës Presidenti i shtetit, ek-selencia e tij, Dr. Gjorge Ivanov, LSHPM-në e deko-

tari i Konfederatës së sindikatave të Shqipërisë, z. Kol Nikollaj, në shoqërinë e zëvendëskryetarit të Konfederatës, znj. Anisa Subashi.

Akademia solemne u mbajt në praninë e 700 pensionistëve dhe të ftuarve, të cilët me respekt,



roi me mirënjohjen "Karta e Republikës së Maqedonisë" për kontributin e pensionistëve në zhvillimin dhe ndërtimin e vendit tonë, por edhe për aktivitetet e tyre, unitetin dhe bashkimin, me të cilat duhet të krenohet dhe të jetë një shembull si asocioni më i madh, shumë aktiv dhe multietnik.

Në Akademi morën pjesë të ftuar nga vendi dhe nga vende të huaja, më saktësisht zëvendëskryeministri plotësues i punës dhe politikës sociale, z. Dime Spasov, kryetari i Lidhjes së Sindikatave të Maqedonisë, z. Zhivko Mitrevski, sekretari i përgjithshëm i Kryqit të Kuq të RM, z. Sait Saiti dhe kryetarët e komunave Gjorçe Petrov, Ilinden dhe Petrovec, z. Sokol Mitrevski, z. Zhika Stojanovski dhe z. Borçe Mitevski, gjenerali Mirçe Gjorgovski nga ARM, ndërsa nga vendet e huaja morën pjesë: zëvendës nënkryetari i Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Sllovenisë, z. Jozhe Zhnidariç, krye-

krenari dhe duartrokite ndoqën fjalimin e kreut të shtetit, Presidentit Dr. Gjorge Ivanov, i cili theksoi si më poshtë vijon:

- Të nderuar pensionistë, të dashur të ftuar, zonja dhe zotërinj,

Një çerek shekull më parë Republika e Maqedonisë shpalli pavarësinë dhe sovranitetin e saj. Kontributin më të madh në këtë drejtim, në këtë zhvillim të rëndësishëm historik, kishin gjeneratat me aftësi pune, të cilat mbi shpatullat e tyre dhe mundin, përvojën dhe njohuritë e tyre dhanë kontribut drejt ndërtimit të shtetit të ri. Një pjesë e madhe e kësaj gjenerate me rëndësi të madhe sot nuk janë më të rinj dhe as të punësuar. Sot jam këtu me ju, në cilësinë e mbështetësit të shënimit të shtatë dekadave të organizimit të pensionistëve në Republikën e Maqedonisë. Në veçanti gëzohem që në Akademinë e sotme do të kem mundësinë që Lid-



hjes së shoqatave të pensionistëve të Republikës së Maqedonisë t'i ndaj Kartën e Republikës së Maqedonisë, në formë mirënjohjeje për të gjitha aktivitetet në fushën e organizimit të pensionistëve.

Jubiletë janë një mundësi e mirë për të sublimuar rezultatet e punës.

Mirëqenia e një shteti mund të shihet me mënyrën e trajtimit të qytetarëve më të rinj dhe qytetarëve më të moshuar. Shteti duhet të vazhdojë me programet dhe projektet me të cilat do t'ju mundësojë të jetoni me dinjitet. Ky jubile është një mundësi për evoluimin e programeve dhe aktiviteteve dhe me një energji të re të vazhdohet drejt avancimit të të drejtave dhe detyrimeve të pensionistëve. Them detyrimeve sepse Ju jeni një pjesë shumë e rëndësishme e shoqërisë.

Dalja në pension nuk do të thotë dalje në pension nga shoqëria, por përkundrazi, pensionistët me aktivitetet e tyre dhe ndihmën në kuadër të familjes dhe shtëpisë, por edhe në bashkësi, nëpërmjet pjesëmarrjes në iniciativat e ndryshme, me përvojën dhe kapacitetet e tyre intelektuale janë faktorë aktivë të rrjedhave shoqërore. E gjithë kjo në një mënyrë adekuate duhet shfrytëzuar maksimalisht dhe duhet verifikuar nga shoqëria jonë.

Lista e aktiviteteve, iniciativave dhe përmbajtjeve të programit, të organizuara, ngritura dhe realizuara nga shoqatat e pensionistëve në çdo pjesë të vendit tonë, është vërtetë impresionuese. Gjithashtu, tipike janë aktivitetet në fushën e kulturës dhe artit dhe sidomos muzikës. Nuk duhen harruar as garat sportive të pensionistëve në nivel lokal, rajonal dhe shtetëror.

Në këtë kontekst dua të përshëndes edhe bashkëpunimin ndërkombëtar të Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Republikës së Maqedonisë. Kur flasim për aktivitetin e Lidhjes nuk duhet anashkaluar aktiviteti në fushën e medias, para së gjithash publikimi i revistës mujore "Pen-

sionist plus", por edhe azhurnimi i rregullt i ueb faqes së lidhjes, që ofrojnë informatat e nevojshme dhe të dobishme.

Të dashur pensionistë,

"Karta e Republikës së Maqedonisë" është edhe një mirënjohje për të gjithë pensionistët për kontributin e dhënë në bashkësi, gjatë kohës së punës, por edhe pas daljes në pension. Mirënjohja e këtillë njëkohësisht është edhe një pritje për të transmetuar njohuritë e mbledhura, përvojën dhe urtësinë, pa të cilat nuk mund të funksionojë asnjë shoqëri. Të na ndihmoni të mos i përsërisim gabimet që janë bërë në të kaluarën. Të rinjve t'u jepni shembull.

Në fund të këtij fjalimi dua t'ju urojë nga zemra që me gëzim dhe shëndet të mirë të shijoni ditët e pensionit, që i keni merituar me punën e mundimshme. Me idenë për mirëqenien e të gjithë qytetarëve tanë dhe për një Maqedoni të fortë dhe me prosperitet, më lejoni që në fund të këtij fjalimi edhe njëherë t'ju urojë jubileun e madh dhe t'ju urojë ditë pensioni të lumtura dhe të plotësura.

Pas fjalimit, Presidenti Ivanov, në një atmosferë solemne i ndau Kartën e Republikës së Maqedonisë Kryetarit të LSHPM-së, z.Dragi Argirovski, i cili duke pranuar mirënjohjen më të madhe që ka fituar LSHPM gjatë 7 dekadave të kaluara dhe duke u falënderuar u shpreh si më poshtë vijon:

- Të nderuar pensioniste dhe pensionistë, të dashur të ftuar, zonja dhe zotërinj.



Në këto momente solemniteti, më lejoni së pari në emër të Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Republikës së Maqedonisë dhe në emrin tim të falënderojë përzemërsisht Presidentin e Republikës së Maqedonisë, ekselencën e tij Dr. Gjorge Ivanov, për dekorimin e Lidhjes, që do të thotë mirënjohje për 250.000 pensionistët - anëtarë të një nga organizatat civile multietnike, joqeveritare dhe apartiake më aktive e Republikës së

Maqedonisë. Dekorimi me "Kartën e Republikës së Maqedonisë" është mirënjohja më e lartë në historinë me shtatë dekada të organizimit të pensionistëve në vendin tonë. Për këtë arsye shpreh një falënderim shumë të madh për Presidentin e Republikës së Maqedonisë dhe komisionin përkatës. Shpreh falënderim të madh për Presidentin tonë të respektuar i cili me këtë Kartë nderon dhe respektin të gjithë pensionistët e vendit tonë.



Gjithashtu falënderojmë për pjesëmarrjen e tyre të gjithë përfaqësuesit qeveritarë, përfaqësuesit e institucioneve shtetërore, drejtuesit e kompanive të rëndësishme me të cilat bashkëpunojmë, të gjithë fituesit e pllakateve dhe mirënjohjeve të jubileut, pjesëmarrësve të programit të Akademisë së sollemne, anëtarëve të gardës së Presidentit, përfaqësuesve të Lidhjeve të pensionistëve të Sllovenisë dhe Shqipërisë, mediave dhe të gjithë Ju që me praninë Tuaj ritët rëndësinë e shënimit të shtatëdhjetë vjetorit të organizimit të pensionistëve në vendin tonë. Kemi të bëjmë me një jubile të rrallë, që meriton një respekt të veçantë edhe nga opinioni më i gjerë.

Shtatëdhjetë vjet më parë, në vitin 1946, në Republikën Popullore të Maqedonisë, kishte vetëm 2.600 pensionistë moshe dhe pensionistë që merrnin pensione familjare dhe invaliditeti, me të cilët filloi edhe organizimi i pensionistëve në Maqedoni. Në vitin 1950 pensionistët u gjetën nën mbrojtjen e sindikatave dhe në këtë rast u formuan edhe komisione për çështjet e sistemit të pensioneve, mbrojtjes shëndetësore, udhëtimeve të privileguara, shfrytëzimit të pushimoreve të sindikatave etj. Në

vitin 1951 u regjistruan 3.700 pensionistë, ndërsa në vitin 1960 ky numër u rrit në 15.300 pensionistë. Dhjetë vjet më vonë ky numër u rrit në 51.500 pensionistë, në vitin 1980 numri i pensionistëve u rrit në 85.000, ndërsa në vitin 1986 u regjistruan 122.800 pensionistë.

Në vitin 1991 në Republikën e pavarur dhe sovranë të Maqedonisë numri i pensionistëve u rrit në 166.200. Po atë vit, LSHPM vendosi të bëhet një

asociacion i pavarur, jo-qeveritar, apartiak dhe multietnik, i cili në vazhdimësi mbron dhe zhvillon të drejtat e pensionistëve të parapara me ligj. Gjatë kohës së tranzicionit në Maqedoni, privatizimi jo i drejtë i kapitalit shoqëror dhe inflacioni i madh ndikuan në dobësimin e madh të stabilitetit të sistemit pensional. Në vitin 1996 numri i të punësuarve u zvogëlua nga 600.000 në 412.000 ose për 188.000, ndërsa numri i pensionistëve u rrit në 220.300 ose për 90.000. Njëkohë-

sisht, raporti i punësuar - pensionist nga 4,6:1 në vitin 1990, u ul në 1,8:1 në vitin 1996. Në prag të mileniumit të ri, në vitin 2000, në Republikën e Maqedonisë u regjistruan 241.000 pensionistë, ndërsa në vitin 2011 u regjistruan rreth 278.000 pensionistë, 235.000 anëtarë të LSHPM-së dhe 35.000 anëtarë të tre lidhjeve të përdoruesve të pensioneve invalidore. Sot, me rritjen e numrit të të punësuarve, raporti i punësuar - pensionist është 2,4: 1, ndërsa LSHPM numëron rreth 250.000 anëtarë. LSHPM me zhvillimin e vazhdueshëm të gjurmëve edhe në zhvillimin e shtetit dhe me 53 shoqatat e pensionistëve të bashkuara vullnetarisht është një përfaqësues i drejtë i lartësisë së tij - pensionistit.

Gjatë këtyre viteve qëllimi kryesor i Lidhjes është mbrojtja dhe zhvillimi i të drejtave të sigurimit pensional dhe invalidor, mbrojtjes shëndetësore, aktiviteteve humanitare, kulturore dhe sportive dhe angazhimi për të mundur kushte jetese me dinjitet dhe standarde për pleqëri aktive dhe me shëndet të mirë. Në këtë kontekst pritet të miratohet edhe Ligji i organizimit të pensionistëve në Maqedonia dhe për të moshuarit, gjë për të cilën stafi drejtues i LSHPM ka përgatitur draftin e ligjit.

Siç e dini, viteve të fundit dhe duke u nisur nga interesi i pensionistëve, Lidhja ka një bashkëpunim shumë të mirë me Ministrinë e punës dhe politikës sociale, Ministrinë e kulturës, Fondin e SPIM, Fondin e sigurimeve shëndetësore, Lidhjen e sindikatave të Maqedonisë dhe me Kryqin e Kuq të Maqedonisë. Falë këtij bashkëpunimi dhe angazhimit serioz, disa vite me radhë pensionet e të gjithë pensionistëve paguhen rregullisht, javën e parë të muajit korrent, ndërsa pensioni më i ulët nga 4.330 denarë në vitin 2006 arriti në 8.241 denarë ose është rritur për 84 për qind, ndërsa pensioni mesatar u rrit nga 7.688 në 13.077 denarë ose u rrit për 70 për qind. Me rritjen e re prej 5 për qind të pensioneve në muajin nëntor, pensioni mesatar do të jetë 223 euro ose më i lartë se pensioni në vendet fqinje, Serbi, Bullgari, Shqipëri dhe Kosovë, vende këto në të cilat janë më të larta edhe shpenzimet e jetës. Për pensionistët e Maqedonisë kjo do të thotë shumë sepse një numër i madh i pensionistëve me pensionet e tyre kujdesen për një ose dy gjenerata. Njëkohësisht, për pensionistët me rëndësi të veçantë është edhe rritja e numrit të punonjësve të gjeneratave të reja sepse në këtë mënyrë më shumë mjete mbeten për një jetë më të mirë të pensionistëve.

Për një standard më të mirë të pensionistëve kontribut kanë edhe disa projekte qeveritare të realizuara me sukses, që janë mbështetur nga LSHPM. Në këtë kontekst dua të përmend përfitimet e disa projekteve. Brenda gjashtë viteve rekreacionin falas shtatë ditësh në banjë e kanë shfrytëzuar 37.000 pensionistë me të ardhura të ulëta, që ndihmon edhe zhvillimin e turizmit të banjave në Republikën e Maqedonisë. Dy viteve të fundit mbi 80.000 pensionistë kanë përdorur transportin hekurudhor falas, ndërsa në Shkup dhe në disa qytete të tjera është mundësuar transporti falas me autobusët urbanë. Me insistimin e Lidhjes një numër i madh pensionistësh me pensione deri në 12.600 denarë fituan të drejtën e mjekimit spitalor falas e të tjera. Gjatë kësaj periudhe shoqatat e pensionistëve, vetë ose në bashkëpunim me vetëqeverisjen lokale, hapën edhe shumë klube pensionistësh, të cilat brenda javës i vizitojnë rreth 150.000 anëtarë për t'u shoqëruar, për të luajtur shah, domino dhe lojëra të tjera dhe për t'u informuar. Gjithashtu, edhe pse janë të pakta, u hapën edhe disa qendra për qëndrim ditor dhe më shumë shtëpi private për akomodimin e të moshuarve dhe njëkohësisht është inkurajuar ndërtimi i shtëpive të reja të pensionistëve, që do të thotë se ky problem ka filluar të lehtësohet.

Disa vite me radhë LSHPM vë theksin edhe në takimet në gjelbërim, për të cilat nga viti në vit ka një interes gjithnjë e më të madh, ndërsa sivjet, me rastin e jubileut, u realizuan një numër rekord vizitash prej 6.000 në Dojran, 7.000 në Elenec e deri në 9.000 në Oraovicë, ndërsa një interes po kaq i madh pritet edhe për takimin e këtij muaji në Lesnovë. Gjatë këtyre takimeve vjen në shprehje respekti i përbashkët dhe përhapja e miqësisë. Në vallen e përbashkët luajnë Maqedonasit, Shqiptarët, Serbët, Turqit, Romët dhe Vllehet, këndohen këngë të përbashkëta me ndjenjën e unitetit dhe bashkimit, si dhe përkatësisë në shtetin maqedonas. Bëhet fjalë për takime që nuk harrohen, që përhapin energji pozitive midis pensionistëve dhe mbeten në kujtesë si shembull për gjeneratat e sotme dhe të ardhshme.

Në rajon dhe më gjerë në vendet e Evropës, njihen manifestimet tona kulturore dhe sportive. LSHPM 14 vjet me radhë organizon sfilata rajonale kënge, muzike dhe lojërash dhe gjashtë vjet organizon sfilatën republikane, të cilën Ministria e kulturës e shpalli si një manifestim me interes nacional për kulturën e vendit tonë. Sfilata e parë rajonale u zhvillua në vitin 2003, në Probishtip, me vetëm 7 shoqata pjesëmarrëse, ndërsa këtë vit u mbajtën 8 sfilata rajonale, me pjesëmarrjen e 50 shoqatave. Në aspektin e folklorit karakteristike ishte sfilata e gjashtë republikane, që u mbajt më 7 qershor në Shkup, e cila deri më tani është sfilata më e mirë. Duhet theksuar se viteve të fundit pensionistët në mënyrë masive marrin pjesë në ngjarjet kulturore, si rezultat të Vendimit të Ministrisë së kulturës që pensionistët të fitojnë bileta me një çmim me zbritje prej 50%.

Me rastin e jubileut u mbajtën edhe 8 gara sportive rajonale të pensionistëve, me pjesëmarrjen e 52 shoqatave dhe mbi 2.000 garuesve në 11 disiplinë. Sa për krahasim, në garat e para në Ohër, në vitin 1996, morën pjesë vetëm 13 shoqata, me gjithsej 45 garues në 3 disiplinë. Një sukses i veçantë u arrit në garat republikane sportive që u mbajtën më 3 shtator të vitit 2016, në fushën sportive të Qendrës rekreative "Shampion" në Radovich, në praninë e rreth 1.200 pjesëmarrës nga të cilat një numër rekord prej 500 personash ishin garues. Këto fakte janë indikatorë të zhvillimit dhe cilësisë së lojërave sportive të pensionistëve në vendin tonë dhe për rëndësinë e tyre në promovimin e shpirtit të shëndoshë në trupin e shëndetshëm.

LSHPM një kohë të gjatë bashkëpunon edhe me Asociacionet e pensionistëve në Serbi, Slloveni

ni, Shqipëri, Kroaci, Bullgari dhe Malin e Zi. Bëhet përpjekje që bashkëpunimi ndërkombëtar i këtij lloji të pasurohet, me qëllim që të shfrytëzohen përvojat evropiane për të mësuar më mirë problemet e pensionistëve dhe arritjet e tyre. Vlen të përhëndet bashkëpunimi ynë me Lidhjen e shoqatave të pensionistëve të Sllovenisë, me ndihmën e të cilit shtatë vite me radhë marrim pjesë në Festivalin ndërkombëtar të moshës së tretë të jetës në Lubjanë. Me ndihmën e madhe financiare të festivalit, në këtë manifestim ndërkombëtar dhe prestigjioz gjatë gjashtë viteve të kaluara morën pjesë Ansamblet e

fakteve. Kjo gjë kontribuon që pensionistët dhe opinioni të informohen në kohë, drejtë dhe saktë dhe me argumente të mësojnë të vërtetën. Me informimin e pasur të këtij lloji, Lidhja e Shoqatave të Pensionistëve të Maqedonisë është e vetmja në Ballkan.

Të gjitha aktivitetet dhe rezultatet e përmendura meritojnë respekt. Kur bëhet fjalë për problematikën e pensionistëve, LSHPM është kategorike se të gjithë faktorët politikë duhet të kenë një qasje pozitive të vetme sepse kemi të bëjmë me çështje me rëndësi për pensionistët, që janë në interes të shtetit. Ne shpresojmë të ecim me sukses në rrugën që kemi zgjedhur, me përvojën, njohurinë dhe urtësinë tonë ose në rrugën në të cilën ecim për shtatë dekada me radhë. Urtësia dhe përvoja janë elemente që i dallojnë të moshuarit, ndërsa fuqia u takon më të rinjve - bashkë mund të arrijmë më shumë.

Të rojë Lidhja e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë! Të rojë Republika e Pavarur e Maqedonisë!



shoqatave të pensionistëve nga Kumanova, Probiшти, Koçani, Tetova, Prilepi, Radovishi dhe Makedonska Kamenica, ndërsa këtë muaj këtë nder do ta kenë Manastiri dhe Demir Hisari. Për pjesëmarrjen cilësore dhe të suksesshme në këtë festival, LSHPM fitoi një mirënjohje në nivel ndërkombëtar.

Një karakteristikë e periudhës së mileniumit të ri është mënjanimi i territ informativ lidhur me problematikën e pensionistëve, me publikimin e revistës "Pikëpamjet e pensionistëve" në vitin 2005, në formën e një shtojce të gazetës "Nova Makedonija", me fillimin e emisioneve në Televizionin e Maqedonisë dhe Radio Shkupi, ndërsa në vitin filloi botimi i gazetës për pensionistët e sotëm dhe të ardhshëm me titullin "Pensionist plus", me një faqe gazete në gjuhën shqipe. Gjithashtu u hap edhe një faqe moderne të LSHPM dhe filluan të botohen tekste për pensionistët, në gazetën në gjuhën shqipe "Koha". Me të gjitha tekstet ose kronikat përdoret metoda e përhapjes së të vërtetës dhe

Në sallë filluan duartrokitjet e përziera me gëzime dhe krenari. Të gjithë ishin të lumtur për mirënjohjen e rëndësishme, por edhe të vetëdijshëm se mirënjohja është edhe një detyrim për të arritur rezultate akoma më të mira dhe për t'u angazhuar akoma më shumë për standarde më të mira dhe ditë pensioni më të plotësuar.

Në kuadër të Akademisë u zhvillua edhe një program kulturor-artistik me pjesëmarrjen e këngëtareve dhe grupeve valltare dhe muzikantëve të shoqatave të pensionistëve të lagjeve: Gazi Babë, Kisella Vodë, Qendër, Solidariteti - Aerodrom, Çair dhe Gjorçe Petrov.

Me rastin e jubileut 70-vjeçar të LSHPM, personazheve të shquara, institucioneve, kryetarëve të komunave, shoqatave të pensionistëve, kryetarëve të shoqatave të pensionistëve dhe aktivistëve të tjerë iu ndanë gjithsej 259 mirënjohje, nga të vilat 97 pllakate dhe 162 fletë-falënderimi.

2. NDARJA E PLLAKATEVE TË PERSONAVE TË SHQYAR DHE INSTITUCIONEVE

2.1 PLLAKATI I LSHPM PËR PRESIDENTIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË DR. GJORGE IVANOV



Presidenti i shtetit, Dr. Gjorge Ivanov, pensionistëve të Maqedonisë - anëtarë të Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, me përkrahjen e tij i respektoi dhe nderoi shumë.

Përkrahjen e parë presidenti i shtetit e ofroi në vitin 2011, kur mbështeti Akademinë solemne me rastin e 65-vjetorit të organizimit të pensionistëve në Maqedoni".

Mbështetjen e dytë presidenti i shtetit e ofroi me rastin e jubileut 70-vjeçar të Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, të cilës i ndau "Kartën e Republikës së Maqedonisë".

Lidhja shprehu falënderimin e saj për Presidentin Gjorge Ivanov, duke i ndarë atij Pllakatin e LSHPM për kontributin e veçantë në zhvillimin e organizimit të pensionistëve në Maqedoni, ky pllakat iu nda Ekselencës së tij personalisht dhe shtetit.

2.2. PLAKATI I LSHPM PËR KUVENDIN E RM

Me rastin e jubileut 70 - vjeçar të LSHPM, Kryetari i Kuvendit të R.M., z. Trajko Veljanovski, pranoi për vizitë Kryetarin e Lidhjes, z. Dragi Argirovski dhe Nënkryetarin e Këshillit Ekzekutiv të LSHPM, z. Saltir Karovski. Me këtë rast Kryetari Argirovski me një solemnitet i ndau pllakatin e LSHPM Kryetarit Veljanovski për kontributin e veçantë të Kuvendit në zhvillimin e organizimit të pensionistëve në Maqedoni. Kryetari Argirovski, gjatë fjalës së tij në takimin me Kryetarin e Kuvendit, theksoi se Lidhja shënon me sukses dhe dinjitet jubileun e

madh me një sërë manifestimesh, ndërsa vuri theksin në vazhdimësinë historike dhe në arritjet e viteve të fundit, kur LSHPM u bë lidere dhe shembull i veprimit të pensionistëve në rajon dhe më gjerë, në vendet e Ballkanit. Duke e falënderuar për mirënjohjen, Kryetari i Kuvendit të R.M., z. Trajko Veljanovski, theksoi rëndësinë e punës së kësaj organizate joqeveritare multietnike me masive dhe shumë aktive dhe të gjithë pensionistëve të vendit tonë u uroi suksese të reja dhe arritje të tjera.



2.3. PLLAKATI I QEVERISË SË RM

Edhe Kryeministri i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, z. Emil Dimitriev, më 25 tetor të vitit





2016 pranoi për vizitë një delegacion të Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, i drejtuar nga Kryetari i LSHPM, z. Dragi Argirovski. Në delegacion morën pjesë Kryetari i Kuvendit, z. Besnik Pocesta, sekretari i Këshillit Ekzekutiv, znj. Stanka Trajkova dhe anëtarët e Këshillit Ekzekutiv, znj. Kalina Slivovska - Andonova dhe z. Gjorgji Serafimov. Kjo vizitë u zhvillua me rastin e ndarjes së pllakatit të Lidhjes Kryeministrit të vendit, me rastin e jubileut të madh 70 vjet të organizimit të pensionistëve në Maqedoni dhe për njohjen me aktivitetet dhe rezultatet e LSHPM gjatë shtatë dekadave të kaluara, duke vënë theksin në dekadën e fundit dhe më aktive, gjatë të cilës LSHPM u bë lidere dhe shembull i një asociacioni i pensionistëve në rajon dhe më gjerë në Ballkan, por edhe një faktor me rëndësi në Maqedoni.

Kryetari i LSHPM, z. Argirovski, fillimisht i ndau Pllakatin Kryeministrit Dimitriev, si rezultat të bashkëpunimit të suksesshëm dhe të frytshëm me Qeverinë e Maqedonisë gjatë këtyre shtatë dekadave. Me këtë rast ai shprehu falënderim të madh për mbështetjen dhe projektet e shumta me të cilat Qeveria dhe institucionet përkatëse që trajtojnë këtë popullatë i realizuan për një jetë më të mirë dhe më cilësore të pensionistëve në Maqedoni. Me Pllakatin, z. Argirovski Kryeministrit i dha edhe librin e tij më të ri me titullin "Argumentet zbardhin të vërtetën", që është shkruar për personat e moshës së tretë dhe është një nga 20 veprat e tij publicistike dhe vepra e shtatë lidhur me pensionistët.

Në një atmosferë të këndshme Kryeministri Dimitriev u njoh me aktivitetet dhe sukseset e Lidhjes gjatë viteve të kaluara, duke vënë theksin në rezultatet e arritura gjatë vitit të jubileut. Ndër të tjera, Kryeministri u njoh me nevojën e ndërtimit të shtëpive të reja për të moshuarit dhe pensionistët në Shkup dhe në qytetet e tjera, me nevojën e përmirësimit të mbrojtjes sociale dhe shëndetësore, nevojën e miratimit të Ligjit për organizimin e pen-

sionistëve në Maqedoni, pagimin e rregullt të pensioneve dhe me konsensusin e të gjithë faktorëve brenda vendit kur bëhet fjalë për të drejtat e popullatës më të numërt dhe me këtë rast theksoi si më poshtë vijon:

- Rruga drejt të cilës ecim është rruga e të vërtetës, nderit dhe bashkëjetesës. Kështu ka qenë deri më sot dhe kështu do të vazhdojmë, ndërsa në



kuadër të Lidhjes dhe në të gjitha 53 shoqatat jemi bashkuar vullnetarisht me të njëjtin qëllim.

Kryeministri Dimitriev shprehu falënderime për respektin e treguar nga më të moshuarit me ndarjen e Pllakatit me rastin e 70-vjetorit të organizimit të pensionistëve në Maqedoni dhe ndër të tjera tha si më poshtë vijon:

- Kam një nder të veçantë që jeni mysafirët e mi. Sukseset dhe rezultatet tuaja më gëzojnë. Nga ju duhet të mësojnë gjeneratat e reja, sidomos në fushën e bashkëjetesës dhe tolerancës etnike. Qeveria si deri më sot, ashtu edhe në të ardhmen, do të mbështes pensionistët dhe do të shqyrtojë të gjitha propozimet tuaja brenda mundësive të veta dhe vërejtjeve që janë në interesin tuaj dhe në interesin e vendit. Kuptohet se gjithmonë mundet dhe duhet të jetë më mirë dhe më shumë. Na kritikojnë se të gjitha projektet dhe përfitimet i mundësojmë për shkak të votave të pensionistëve. Mendimet e këtij lloji nuk do të na defokusojnë të vazh-

dojmë të punojmë si deri më tani. Duhet të jemi të bashkuar dhe të fortë në aspektin ekonomik, të tjerat do të vijnë vetvetiu, megjithëse globalizimi ka ndikimin e vet kudo, si dhe tek ne. Pensionistët janë njerëz të mençur dhe të urtë. Ato gjithmonë janë në anën që u mundëson një jetë më të mirë atyre, por edhe vendit në përgjithësi.

Kryetari i LSHPM, z. Dragi Argirovski, i ndau Pllakat edhe Ministrit të mbrojtjes, z. Zoran Jolevski, me rastin e jubileut 70-vjeçar të organizmit të pensionistëve në Maqedoni dhe me këtë rast shprehu falënderime për mbështetjen që e jep Ministria për Lidhjen dhe shoqatat e pensionistëve.



Gjatë këtij takimi u bisedua edhe për pasurimin e bashkëpunimit në shumë fusha.

2.4. FESTIM DHE NDARJE MIRËNJOHJESH

Pas Akademisë solemne me rastin e shënimit të jubileut 70-vjeçar të organizimit të pensionistëve, festimi dhe ndarja e mirënjohjeve vazhdoi me dinjitet në takimin solem në restorantin "Hanibal", ku Kryetari i LSHPM, z. Dragi Argirovski, Ministrit plotësues të punës dhe politikës sociale, z. Dime Spasov dhe dy të ftuarve dhe përfaqësuesve nga Shqipëria dhe Sllovenia, u ndau Pllakatet e LSHPM, bashkë me mesazhin e vazhdim të mëtejshëm dhe pasurimin e bashkëpunimit me të dy lidhjet. Duke falënderuar për mirënjohjen, z. Jozhe Zhni-



nko Veshoviq dhe Kryetarit të deritanishëm të pensionistëve të Sllovenisë, z. Anton Donko.

Jubileun e madh të gjithë pensionistëve të Republikës së Maqedonisë ua uroi edhe Zëvendësmministri plotësues i punës dhe politikës sociale, z. Dime Spasov, i cili duke pranuar mirënjohjen për kontributin e veçantë në zhvillimin e organizimit të pen-



dariç, në emër të Lidhjes së pensionistëve të Sllovenisë, Kryetarit Dragi Argirovski i dhuroi një pikturë artistike me motive nga Sllovenia. Gjithashtu, falënderim të madh dhe urime për festën shprehu edhe z. Kol Nikollaj, Kryetari i Konfederatës së sindikatave shqiptare, në kuadër të të cilës funksionon edhe Organizata e pensionistëve. Telegramet përshëndetjeje gjatë solemnitetit u lexuan edhe nga Kryetarët e Lidhjeve të shoqatave të pensionistëve nga Serbia dhe Mali i Zi, z. Gjuro Periq dhe z. Bra-



sionistëve në Maqedoni, në emrin e tij dhe në emër të personave të tjerë të shpërblyer, me fjalë të ngrohta shprehu falënderime dhe ndër të tjera tha:

- Unë gjithmonë marr pjesë me kënaqësi në manifestimet dhe aktivitetet e organizuara nga Lid-

hja e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë. Edhe me këtë rast dua të theksojë bashkëpunimin tonë. Ministria edhe në të ardhmen do të inkurajojë projekte dhe programe me interes për pensionistët dhe do të vazhdojë bashkëpunimin. Në emër të të gjithë atyre që fituan mirënjohje shpreh falënderime për kujdesin e treguar nga Lidhja, e cila na ndau mirënjohje për punën e realizuar dhe njëkohësisht nga zemra ju uroj jubileun e madh dhe shpërblimin "Karta e Republikës së Maqedonisë", me të cilën u dekoruat nga Kryetari i vendit, Dr. Gjorge Ivanov. Ju e meritoni këtë shpërblim sepse jeni organizata joqeveritare multietnike me aktive dhe më e madhe. Ju uroj edhe shumë shpërblime të tjera, jubile, shumë shëndet dhe pleqëri të plotësuar dhe aktive, tha Spasov.

Gjatë solemnitetit në restorantin "Hanibal" Pllakate iu ndanë edhe Lidhjes së sindikatave të Maqedonisë, që e pranoi Kryetari i Lidhjes, Dr. Zhivko Mitrevski dhe Kryetarëve të Komunave Ilinden



dhe Petrovec, z. Zhika Stojanovski dhe z. Borçe Mitevski.

Pensionistëve në një mënyrë të veçantë, me pikturën "Lulja e paqes", jubileun ua uroi edhe artisti dhe humanisti i njohur z. Zhivko Popovski - Cve-



tin. Mbrëmja vazhdoi me urime të shumta dhe argëtim.

Me një solemnitet të veçantë, Pllakatet e LSHPM iu ndanë Kryetarit të Shkupit, z. Koce Trajanovski, Kryetarit të Kryqit të Kuq të RM, që e pra-




noi Sekretari i përgjithshëm i Organizatës, Dr. Sait Saiti, Fondit të SPIM, që e pranoi Drejtori i përgjithshëm Shaip Zeneli, Fondit të sigurimeve shëndet-



tësore, që e pranoi Dr. Stefanovski, ndërsa Akademi solemne dhe aktivitete të ngjashme u zhvilluan edhe në shoqatat e pensionistëve në Manastir, Prilep, Kumanovë, Shtip, Solidariteti - Aerodrom, Çair, Strumicë, Strugë, Probishtip, Radovish dhe Konçe, Veles, Ohër dhe Debërcë, Koçan, Make-donska Kamenica, Demir Hisar, Demir Kapi e të tjera.

Fitues të pllakateve janë edhe 23 kryetarë komune të cilat kanë dhënë kontribut të madh në pasurimin e bashkëpunimit të shoqatave të pensionistëve, sidomos për hapjen e klubeve dhe mbështetjen e aktiviteteve të tjera.

PJESA II



DY DEKADAT E PARA TË ZHVILLIMIT

FILLIMET E ORGANIZIMIT TË PENSIONISTËVE NË MAQEDONI

1. FORMIMI I SISTEMIT SOCIAL DHE ZBATIMI I TË DREJTËS SË PENSIONIT NË MAQEDONI

Fillimi i veprimit të organizuar të pensionistëve në Republikën Popullore të Maqedonisë konsiderohet miratimi i tre ligjeve themelore, si më poshtë vijon:

- "Dekreti për njohjen e të drejtës së pensionit", i miratuar më 25.10.1945 dhe i publikuar në "Fletën zyrtare" të Jugosllavisë Federale Demokratike, numër 86, e datës 06.11.1945, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.1946;


- "Ligji i sigurimit social të punëtorëve dhe administratës", i miratuar më 26.07.1946, i publikuar në "Fletën zyrtare" të Republikës Federale Popullore të Jugosllavisë, numër 65, e datës 13.08.1946, zbatimi i të cilit filloi më 01.01.1946;

- "Ligji i daljes në pension dhe njohjes së të drejtës së pensionit të punonjësve të ish bashkësive vetëqeverisëse administrativo-politike në Republikën Popullore të Maqedonisë", i miratuar më 10.09.1946, i publikuar në "Gazetën Zyrtare" të RPM, numër 29, e datës 28.09.1946.

Miratimi i këtyre ligjeve mundësoi që në vitin 1946 të regjistroheshin rreth 2.600 pensionistë dhe të fillojë organizimi i pensionistëve në Maqedoni dhe me këtë rast, në vitin 2016 LSHPM shënoi 70-vjetorin e funksionimit. Pensionistët në fillim kanë marrë pjesë në punën e komisioneve të ndryshme dhe shoqata dhe organizata të tjera shoqëro-politike. Rritja e numrit dhe cilësisë së aktiviteteve të pensionistëve në Maqedoni u mundësua me rritjen e numrit të punëtorëve të dalë në pension dhe si rezultat të arsimimit dhe edukimit të tyre plotësues.

Me dekrete me fuqi ligjore dhe rregulla të tjera të Jugosllavisë Federale Demokratike (JFD), në

vitin 1945 filloi formimi dhe veprimi i "sistemi i sigurimit social", në kushte të reja, kur u hap edhe Enti qendror i sigurimit social, si enti i vetëm i këtij lloji për të gjithë Jugosllavinë. Në Shkup u hap Enti vendor i sigurimit social, me më shumë filiale. Për zgjidhjen e kontesteve lidhur me këto të drejta u hap një Gjykatë për sigurimin social. Atëherë u implementua një normë e vetme kontributi për sigurimin social, në shumë prej 20% të rrogës bruto, e paraparë për sigurimin social në rast sëmundjeje, fatkeqësie dhe sigurimi pensional. Më 25.10.1945 u miratua Dekreti federal me fuqi ligjore: "Dekreti për njohjen e të drejtës së pensionit", i publikuar në "Fletën zyrtare" të Jugosllavisë Federale Demokratike, numër 86, e datës 06.11.1945, i cili ka hyrë në



fuqi më 01.01.1946. Ky Dekret ka rregulluar drejt-përdrejtë pensionimin në nivel federate dhe në nivel republike. Edhe më herët ka pasur rregulla sipas të cilave punëtorët kanë marrë pension, por "de facto" konsiderohet se ky është ligji i parë sistematik i fushës përkatëse. Më 26.07.1946 u miratua "Ligji i sigurimit social të punëtorëve dhe administratës", i publikuar në "Fletën zyrtare" të Republikës Federale Popullore të Jugosllavisë, numër 65, e datës 13.08.1946, zbatimi i të cilit filloi më 01.01.1947. Bëhet fjalë për një ligj sistematik me shumë rëndësi për sigurimin social me të cilin u rregulluan edhe të drejtat e fitimit të pensionit të moshës, familjar dhe invalidor. Zhvillimi i mëtejshëm i të drejtës së punës nëpërmjet sigurimit të punëtorëve u reflektua me ligjin e ri të quajtur "Ligji i sigurimit social të punëtorëve dhe administratës dhe familjeve të tyre", i miratuar më 21.01.1950, i publikuar në "Fletën zyrtare" të RFPJ, me numër 10, e datës 08.02.1950. Me këtë ligj u zgjerua dhe kompletua sigurimi social, si pjesa më e rëndësishme për zgjidhjen e çështjeve të mbrojtjes së punëtorëve dhe administratës. Ky ligj parashihte përlogaritje të re të të gjitha pensioneve sipas rregullave të reja, pa dallim nëse gjatë kohës së punësimit punëtorët kanë qenë të siguruar ose jo. Në këtë mënyrë, u kompletua një sistem i ri i sigurimit social.

Sigurimi pensional dhe invalidor është një degë komplekse e sigurimit social. Ky sigurim regjistron një zhvillim të pandërprerë dhe përshtatje në aspektin humanitar dhe ekonomik. Pensionistët si pjesë e popullatës kanë nevoja të përgjithshme dhe të përbashkëta, njësoj si popullata tjetër, por ato kanë edhe nevoja specifike. Zhvillimi i sistemit pensional në Maqedoni ka pasur disa periudha karakteristike:

- periudha e pas luftës, deri në vitin 1964;
- periudha pas vitit 1964, deri në miratimin e Ligjit të ri të sigurimit pensional dhe invalidor, i publikuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës Socialiste të Maqedonisë" nr. 46, e vitit 1972, rregullat e reja të miratuara gjatë periudhës së viteve 1982-1993;
- periudha nga 01.01.1994 deri më 31.12.2005; dhe periudha e cila në mbështetje të ligjeve të miratuara pas vitit 2000 fillon nga data 01.01.2006. Për çdo vend demokratik është me rëndësi funksionimi i sigurimit (të detyrueshëm) me të gjitha format e sigurimit të punëtorëve. Një lloj shumë i rëndësishëm i sigurimit social është siguri-

mi invalidor (në rast sëmundjeje ose lëndimi) dhe sigurimi pensional (kontribute të paguara, vite stazhi dhe moshë). Çdo sistem pensional duhet të përmirësohet.

Sistemi i sigurimit pensional dhe invalidor nga viti 1945 e këtij zbatohet nëpërmjet institucioneve shtetërore që janë ndryshuar në aspektin e organizimit dhe kanë ndryshuar emrat dhe kompetencat. Në aspektin historik, në Republikën e Maqedonisë sistemi i parë shtetëror i sigurimit social (në kuadër të të cilit gjendet edhe sigurimi pensional) është mundësuar me "Ligjin e sigurimit social të punëtorëve dhe administratës", i cili hyri në fuqi më 01.01.1947. Me këtë ligj organizata e sigurimit u vendos në baza plotësisht të reja, sipas parimit "sigurimi social është shtetëror, gjithëpërfshirës, i plotë dhe i vetëm". Enti shtetëror i sigurimit social ka qenë bartësi i këtij sigurimi, me Drejtorinë në Beograd, me kompetenca për të gjithë vendin, në republikat janë formuar filiale, ndërsa në ndërmarrjet ekspozitura. Në atë kohë akoma kishte dallime midis sigurimit social të punëtorëve dhe administratës. Në fuqi ishin më shumë rregulla të ndryshme për caktimin e pensioneve të administratës, kështu që pensionet e administratorëve nuk i caktonte organi i sigurimit social, por ministri kompetent i resorit. Dekreti për njohjen e të drejtës së pensionit, i miratuar më 25.10.1945, bashkë me Ligjin e sigurimit social të punëtorëve dhe administratës, i datës 26.07.1946 dhe rregullat nënligjore përkatëse, konsiderohen si baza e organizimit të ri pensional.

Numri i pensionistëve në Maqedoni në atë kohë ka qenë i ulët.


Pasqyra e pensionistëve në Maqedoni gjatë periudhës së viteve 1946-1949

Viti	Pension moshe	Pension familjar	Pension invalidor	Totali
1946	792	956	850	2598
1947	1101	1208	1294	3603
1948	1257	1447	1613	4317
1949	1585	1642	1708	4935

2. FORMIMI I SHOQATËS SË PENSIONISTËVE

Pensionistët janë një grup i rëndësishëm i popullatës. Moshë nuk është pengesë për të pasur jetë sociale aktive dhe për të krijuar. Si çdo qytetar tjetër, në mbështetje të ligjit, edhe pensionistët kanë të drejtë të bashkohen në organizata civile. Kjo e drejtë në ish Jugosllavinë fillimet i ka në ligjet e miratuara menjëherë pas Luftës së dytë botërore, kur filloi edhe formimi i shoqatave republikane të pensionistëve në republikat dhe krahinat e Jugosllavisë. Pas formimit, shoqatat republikane të pensionistëve, kanë filluar bashkëpunim, kanë arritur marrëveshje dhe kanë harmonizuar çështjet me rëndësi, kanë shkëmbyer përvoja dhe kanë zhvilluar vizita.

Nga fundi i vitit 1950 u formua Këshilli iniciues i formimit të shoqatës maqedonase. Ky Këshill përgatiti "Rregulla" (Statutin), "Programin" dhe "Planin e financimit". Këshilli iniciues kërkoi leje për formimin dhe regjistrimin përkatës nga ana e organit shtetëror kompetent. Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës Popullore të Maqedonisë më datën 04.11.1950 ka marrë një vendim për formimin dhe funksionimin e "Shoqatës së pensionistëve të Republikës Popullore të Maqedonisë" dhe i njëjti u publikua në "Gazetën Zyrtare të RPM" nr. 13, e datës 18.04.1951, në të cilën u publikua Vendimi për hapjen dhe funksionimin e "Shoqatës së pensionistëve të Republikës Popullore të Maqedonisë".



Më 28.12.1950 u mbajt Kuvendi i themelimit në të cilin u zgjodh Këshilli i parë vendor me për-

bërjen në vazhdim: Gjorgje Ristiç, Kryetar, Pane Fidanovski, Nënkryetar, Stevan Simiq, sekretar, Voislav Nikodijeviq, arkëtar dhe anëtarët: Elisaveta Gjeorgieva, Todor Veleç, Aleksandar Cvetkoviq, Danilo Tomovski, Zdravko Zdravkovski, Muhamed Muderizoviq dhe Novak Bukoviq. Këshilli i parë mbikëqyrës ka qenë me përbërjen në vazhdim: Mihajlo Sanev, Xhemal Katana dhe Milivoje Kajevis. Sipas burimeve sekondare, **Kuvendi i themelimit** u mbajt në qershor të vitit 1951, pak kohë para formimit të Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Jugosllavisë. Në aspektin e financimit, organizimit dhe aksionit, shoqata republikane e pensionistëve u formua si një organizatë e pavarur, e përbërë nga filiale (shoqata) dhe e financuar me pagesat e anëtarësimit të anëtarëve. Detyra e parë e filialeve ka qenë organizimi i pensionistëve në territorin përkatës dhe angazhimin e tyre në të gjitha aktivitetet e shoqërisë, siç kanë qenë në atë kohë aksionet vullnetare të punës dhe pjesëmarrja në funksionimin e organeve të pushtetit popullor në të gjitha nivelet.

Në vitin 1951, Këshilli ekzekutiv vendor i Shoqatës së Pensionistëve të Republikës Popullore të Maqedonisë (SHPRPM), iu drejtua Këshillit qendror të Lidhjes së sindikatave të Jugosllavisë, duke kërkuar përfshirjen si anëtare kolektive në Lidhjen e sindikatave të Jugosllavisë. Bashkëpunimi më i afërt i SHPRPM me sindikatat filloi pas pranimit të lutjes në Kongresin e dytë të Lidhjes së sindikatave të Jugosllavisë, gjithashtu në shtator të vitit 1951.

Gjithashtu u formua edhe "Lidhja e përbashkët e shoqatave të pensionistëve të Jugosllavisë - LSHPJ", në Kongresin e themelimit që u mbajt më 20 dhe 21.06.1951. Në këtë Kongres u zgjodhën organet drejtuese: Këshilli federal dhe Këshilli mbikëqyrës. Në Këshillin federal nga Republika Popullore e Maqedonisë u zgjodhën: Gjorgje Ristiç, Mihajlo Janev, Xhemal Katana, Petar Dimovski dhe Krsto Korunovski, ndërsa zëvendës të tyre u zgjodhën: Pande Fidanovski, Manojlo Janev dhe Blagoj Bocevski. Këshilli federal ka pasur kryesinë e tij, ndërsa në detyrën e Kryetarit të parë u zgjodh Gjuro Gashparac. Në detyrën e nënkryetarit u zgjodhën Gjorgje Ristiç dhe Lazar Matkoviq. Të ardhurat e buxhetit të LSHPJ u caktuan sipas kuotës së pagimit të çdo shoqate republikane, proporcionalisht me numrin e pensionistëve.

Kryesia e parë e LSHPJ

Za Predsjednika izabran je Gašparac Đuro, za potpredsjednike: Matković Lazar, predsjednik Zemaljskog odbora UPNRB i H i Ristić Đorđe, predsjednik Zemaljskog odbora UPNRM, za Sekretara Kličin Predrag, predsjednik UP Autonomne Pokrajine Vojvodine.



Predsjedništvo Saveza Udruženja pensionera Jugoslavije (s lijeva na desno) 1. Ristić, predsjednik ZONRH, 2. A. Petrović, potpredsjednik ZONRH, 3. M. Šauer, tajnik ZONRH, 4. Predrag Kličin, predsjednik PO i sekretar Saveza UPNRM, 5. R. Matković, predsjednik ZONRH, 6. Đorđe Stefanović, član ZONRH, 7. Đuro Gašparac, predsjednik ZUPNRM i predsjednik Saveza, 8. Ivan Veklijan, tajnik UPNRM, 9. Novica Schulović, predsjednik ZONRH Crne Gore, 10. Andrej Šantić, predsjednik društva Upokojenaca LRS, 11. Valentin Bidoce, pravi referent društva Upokojenaca LRS.

Bashkëpunimi i shoqatave republikane të pensionistëve me sindikatat u rregullua pas Plenumit të trembëdhjetë të Këshillit qendror të Lidhjes së sindikatave të Jugosllavisë, në nëntor të vitit **1950**. Atëherë u rekomandua që shoqatat e pensionistëve të republikave të pranohen në përbërjen e Lidhjes së sindikatave të Jugosllavisë, pa pasur për detyrë të paguajnë anëtarësim.

Sipas raportit, në korrik të vitit 1952, SHPRPM ka pasur 28 filiale, me rreth 6.500 pensionistë. Qeveria ka marrë një vendim për ndarjen e pensioneve sociale të personave të gjallë që kanë marrë pjesë në Kryengritjen e Ilindenit, që u pranuan në SHPRPM. Pas regjistrimit dhe mbajtjes së Kuvendit të themelimit të SHPRPM filluan mendimet për hapjen e një gazete informative. Për arsye se nuk ka pasur mundësi për të botuar një gazetë, Shoqata maqedonase arriti marrëveshje të botoj tekste në një nga faqet e gazetës së pensionistëve serb.

Ndërkohë, Qeveria federale miratoi një Dekret për organizimin e enteve të sigurimit social në nivel qyteti, rajoni dhe republike, në kuvendet e të cilave janë zgjedhur edhe pensionistë. Në filialet u formuan "Arka ndihme", ndërsa nga buxheti i SHPRPM filluan të bëhen pagesa për ndihmë pas vdekjes dhe ndihmë për mjekim në banja - klimatik. Sipas ndryshimeve të ndarjes territoriale, Shoqata në aspektin e organizimit u përshtat me decentral-

izimin. Bashkë me riorganizimin e organeve të pushtetit qendror, filluan të bëhen riorganizime edhe brenda organeve drejtuese të Shoqatës dhe filloi të bëhet riorganizimi vetëqeverisës. Kuvendi i dytë vjetor i Këshillit vendor të SHPRPM i mbajt më 15.04.1953, pasi u mbajtën paraprakisht Kuvendet zgjedhore vjetore në filialet e pensionistëve. Në këtë Kuvend të ftuar ishin Kryetari dhe Sekretari i LSHPJ dhe një përfaqësues i Shoqatës së pensionistëve të RP të Serbisë. Në atë kohë SHPRPM ka pasur 30 filiale komunale me 8.038 anëtarë dhe një numër të madh pensionistësh që nuk ishin anëtarësuar. Të njëjtin vit në Beograd, më 5 nëntor, u mbajt Kongresi i dytë i Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Jugosllavisë, me delegatë nga të gjitha shoqatat republikane. Në Kongres u sqarua si u realizua dispozita e Ligjit me rëndësi të sigurimit social të pensionistëve nga buxheti i shtetit, në rast vdekjeje të të siguruarit, të paguhen dy pensione, ndërsa në rast vdekjeje të një anëtarit të familjes së tij, për të cilin është kujdesur, të paguhet një pension. Në Kuvendin e tretë vjetor të Këshillit vendor, më 28.06.1954, u zgjodh Këshilli ekzekutiv i SHPRPM, Këshilli mbikëqyrës dhe delegatët e LSHPJ, Më 02.08.1954 me një solemnitë u hap Shtëpia kulturore-arsimore e pensionistëve në rajonin e parë dhe të dytë të Shkupit.

Një Rregullore e re për Fondin e vetëm vullnetar të pas vdekjes të SHPRPM dhe Udhëzim për punën e Fondit të vetëm vullnetar të pas vdekjes të SHPRPM u miratuan në vitin 1955. Të njëjtin vit u njoftua se u kompletua formimi i Shoqatës së invalidëve të punës, ndërsa në përbërjen e SHPRPM edhe më tej mbetën seksione të pensionistëve invalidorë. Organizatat e pensionistëve në mënyrë aktive filluan të bashkëpunojnë me Lidhjen e luftëtarëve dhe të ndihmojnë njëra-tjetrën. Zhvillimi i shoqërisë ndikoi edhe mbi zhvillimin e Shoqatës. Në Kuvendin e pestë vjetor të Këshillit republikan të SHPRPM, që u mbajt më 28.06.1956, me delegatë të 32 filialeve (me 11.500 pensionistë anëtarë) u miratuan Rregullat e reja (Statuti) dhe që atëherë u shfuqizuan Rregullat e SHPRPM të miratuara në Kuvendin e themelimit, më 28.12.1950. Gjithashtu, u miratua edhe Rregullore për gjykatat. Gjatë funksionimit 7-vjeçar Organizata e pensionistëve arriti rezultate të rëndësishme, stabilitet dhe siguri përvojë për mbrojtjen e interesave të pensionistëve. Të njëjtin vit Lidhja e sindikatave të Jugosllavisë ka insistuar për decentralizim dhe ndryshime në shoqatat republikane të pensionistëve, me qëllim

që të forcoheshin dhe pavarësoheshin organizatat komunale, nëpërmjet ndryshimeve të statutit dhe transferimit të kompetencave drejtuese në nivel komunal. Kjo mund të konsiderohet si faza e parë e organizimit dhe regjistrimit të shoqatave pensionale komunale si subjekte juridike të pavarura, deri në miratimin e statuteve të reja dhe ligjit të ri të shoqatave.

**Numri i pensionistëve të filialeve
në dhjetor të vitit 1959.**

	FILIALET	Numri i anëtarëve pensionistë më 30.12.1959
1	Berovo	85
2	Manastir	1192
3	Brezovë	69
4	Brod	54
5	Gjevgjeli	243
6	Gostivar	323
7	Dibër	142
8	Dellçevë	57
9	Demir Kapi	38
10	Gjorçe Petrov - Shkup	127
11	Idadija - Shkup	1304
12	Kavadar	210
13	Kala - Shkup	971
14	Kisela Vodë - Shkup	994
15	Kërçovë	348
16	Koçan	225
17	Kratovë	68
18	Kriva Pallankë	160
19	Krushevë	118
20	Kumanovë	858
21	Negotinë	57
22	Ohër	711
23	Prilep	638
24	Radovish	88
25	Resnjë	142
26	Rostushë	103
27	Shën Nikollë	45
28	Strugë	377
29	Strumicë	397
30	Tetovë	350
31	Titov Veles	610
32	Shtip	273
	Gjithsej në RPM	11.377

Me "Rregullat" e reja është paraparë si në vazhdim: "Shoqata e pensionistëve e Republikës Popullore të Maqedonisë është organizatë shoqë-


rore vullnetare. Shoqata është një subjekt juridik. Shoqata është pjesë e organizatës së Lidhjes së sindikatave të Jugosllavisë, e cila miraton Statutin e saj dhe drejton punën e saj sipas vendimeve të organeve të saj. SHPRPM është njësi organizative më vete, me vendimmarrje individuale për çështjet e organizimit, financimit dhe çështjet e tjera. Anëtar i SHPRPM mund të jetë çdo pensionist moshe, personal, invalidor, familjar dhe personat që kanë marrë pjesë në Kryengritjen e Ilindenit, që jetojnë në territorin e Republikës Popullore të Maqedonisë. Filiali është organizata bazë e Shoqatës të pensionistëve të RP të Maqedonisë. Filiali i përfshin të gjithë pensionistët e moshës - pensional, invalidor dhe familjar të rajonit të një vendi ose qarku. Çdo filial i ri regjistrohet në Këshillin republikan. Vendimi për formimin e filialeve të reja e merr Këshilli republikan i Shoqatës. Filiali ka Këshillin ekzekutiv me kryetar, nënkryetar, sekretar dhe arkëtar dhe Këshillin mbikëqyrës, që mbledhen çdo vit në Kuvendin e rregullt të filialit".

Më 13.09.1960 u mbajt Kuvendi i dhjetë i rregullt vjetor. Gjithashtu u mbajt seanca e parë solemne e Shoqatës të pensionistëve të Republikës Popullore të Maqedonisë, me një festim me rastin e jubileut 10-vjeçar të themelimit. Nga viti 1961 e më vonë u rregullua që "Kuvendi zgjedhor republikan të mbahet çdo të tretin vit". Në vitin 1962 u intensifikuan aktivitetet e sigurimit të shtëpive dhe klubeve kulturoro-arsimore, ndërsa në Shkup edhe shtëpi pensionistësh me banesa, klub dhe ambiente afariste.

Në vitin 1963 Shoqata ka pasur 17.278 anëtarë, të organizuar në 36 shoqata komunale, ndërsa Republika ka pasur akoma pensionistë të pa anëtarësuar. Në atë kohë nga buxheti i përgjithshëm për pensione ndahej shuma prej 4%, shumë kjo që derdhej në Fondin republikan për ndërtim objektësh, ndërsa më vonë, në një llogari të veçantë për ndërtim objektësh në kuadër të Entit republikan të sigurimit social. Pas miratimit të Kushtetutës së re në vitin 1963, Shoqata në dokumentet përkatëse filloi të regjistrohet me emrin e ri, fillimisht të mbaj emrin "Shoqata e pensionistëve të Republikës Socialiste të Maqedonisë". Pak kohë më vonë u miratuan edhe Rregullat e reja me ndryshimin: "Lidhja e shoqatave të pensionistëve dhe invalidëve të punës të Republikës Socialiste të Maqedonisë - LSHPIPRSM". Pas tërmetit shkatërrues në Shkup, zyrat e Këshillit republikan të

Lidhjes u zhvendos në objektin "Shtëpia e punës", në katin e gjashtë, në dhomën me nr. 185.

Në janar të vitit 1966 u zgjodh Këshilli i ri republikan dhe u bënë ndryshime të rëndësishme në strukturën organizative. Në detyrën e kryetarit të ri të LSHPIPRSM u zgjodh z. Pero Stojanovski. U organizua edhe Seanca e dytë solemne me rastin e 15-vjetorit të themelimit të Shoqatës së pensionistëve të Republikës Socialiste të Maqedonisë. Të njëjtin vit u mor vendim që shoqatat më të dobëta të bashkohen me shoqatat më të fuqishme. Më vonë u bashkuan shoqatat më poshtë: f. Brezovë u bashkua me Demir Hisarin, Demir Kapija me Negotinën, Gjorçe Petrov me Idadija - Shkup, Lazaropole me Gostivarin, Pehçeva me Berovën dhe Rostusha me Gostivarin. Në vend të shoqatave të mbyllura, në vendet më sipër filluan të funksionojnë përfaqësi, të cilat në Shoqatat me të cilat u bashkuan kishin delegatët e tyre. Gjithashtu u formua edhe shoqata komunale në Vinicë. Bashkësia republikane e sigurimit social mori vendim që mjetet e ndërtimit të objekteve të ndahen në një fond të veçantë për kredi për ndërtimin dhe adaptimin e shtëpive dhe banesave të pensionistëve dhe invalidëve, që u takonin shoqatave, ndërsa në vend të kartës së privilegjuar "K-15" për transportin e pensionistëve, shoqatat filluan të fitojnë 1,5% të buxhetit për pensione dhe në këtë mënyrë siguroheshin mjete financiare për ndërtimin e Shtëpisë së mjekimit dhe rekreacionit në Banjën e Katllanovës. Në vitin 1967, në Kuvendin e çrregullt të Këshillit



republikan të Lidhjes së shoqatës së pensionistëve dhe invalidëve të punës të RSM, u miratua Statuti i ri i LSHPIPRSM dhe në këtë mënyrë u pezullua bashkëpunimi me gazetën serbe të pensionistëve. Pensionistët e Maqedonisë ndërkohë formuan redaksinë e tyre të re dhe filluan të botojnë gazetën

e tyre, në formën e një shtojce të gazetës ditore "Veçer".

Më 19.02.1967 u miratua Statuti i ri i "Lidhjes së shoqatës së pensionistëve dhe invalidëve të punës të Republikës Socialiste të Maqedonisë". Atëherë u miratua edhe Rregullorja e punës materiale dhe financiare, si dhe Rregullorja e Fondit të vetëm të ndihmës së përbashkët pranë Këshillit republikan të LSHPIPRSM. Gjatë kësaj periudhe u siguruan lidhje më të mira dhe bashkëpunim më i mirë midis Lidhjes së pensionistëve të Maqedonisë dhe Lidhjeve të pensionistëve të Kroacisë, Sllovenisë, Bosnjës e Hercegovinës dhe Malit të Zi.

Numri i pensionistëve dhe invalidëve të punës me gjendjen e datës 01.10.1967 në Republikën Popullore të Maqedonisë ka qenë 41.581 pensionistë, nga të cilët në Lidhjen ishin anëtarësuar 35.196 pensionistë, që do të thotë se 6.385 (15,35%) nuk kanë qenë anëtarë të organizatës. Në vitin 1967 është kërkuar që në organet e vetëqeverisjes të Bashkësisë së sigurimit social dhe Fondit të sigurimit invalidor dhe pensional të ketë përfaqësues të të siguruarve, me të drejtë të ndikojnë mbi përmbajtjen dhe vendimmarrjen.

Në vitin 1968 Këshilli i sindikatave dërgoi një shkresë në të gjitha këshillat sindikale komunale, që kryesitë e tyre të përfshinin përfaqësues të pensionistëve. Me rastin e 65-vjetorit të Kryengritjes së Ilindenit, në gazetën e pensionistëve u publikuan emrat dhe vendbanimet e të gjithë pjesëmarrësve të gjallë të kryengritjes, anëtarë të Lidhjes.

Me rastin e jubileut "20 vjet nga themelimi i SHPRPM" u mbajt një seancë solemne më 30.06.1970, ndërsa për këtë qëllim u përgatit një logo e veçantë dhe u ndanë mirënjohjet "FLETËKUJTIMI" për pensionistët që morën pjesë në themelimin e Shoqatës republikane ose Shoqatave komunale.



Në atë kohë, Enti i sigurimit social mori vendim për lirim të kategorive të caktuara të pensionistëve nga shpenzimet e mjekimit (pjesëmarrje kjo e detyrueshme). Gjithashtu, ky lehtësim u kërkuar edhe për pensionistët e tjerë.

Në vitin 1970 u formua Shoqata e pensionistëve të OPB, me seli në Shkup, ndërsa në qytetet e tjera pensionistët janë anëtarësuar në seksionet në kuadër të shoqatave komunale të pensionistëve. Atëherë u formua "Këshilli i qytetit i pensionistëve të Shkupit", si një trup koordinues i shoqatave "Idadija", "Kala", "Kisela Voda" dhe "Shoqata e punëtorëve të pensionuar të organeve të OPB". Pas një funksionimi dyvjeçar me sukses të Këshillit të qytetit, Lidhja e qytetit e pensionistëve dhe invalidëve të punës në pension të rajonit të Shkupit, me mbështetjen e Kryetares, znj. Trajanka Koleva, më 10 maj 1972 ka mbajtur konferencën e parë zgjedhore.

Emri i shoqatës maqedonase të pensionistëve u miratua edhe me ndryshimet e rregullave ligjor,

por ndryshimet vazhdojnë kontinuitetin e shoqatës së parë. Emri i organizatës së pensionistëve të Maqedonisë nga viti 1950 deri në vitin 2016 është ndryshuar si më poshtë vijon:

- "Shoqata e pensionistëve të Republikës Popullore të Maqedonisë" (regjistrimi i parë në MPB e RM është bërë më 04.11.1950 dhe është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës Popullore të Maqedonisë" nr. 13, më 18.04.1951);

- "Shoqata e pensionistëve të Republikës Socialiste të Maqedonisë" (viti 1963);

- "Lidhja e shoqatave të pensionistëve dhe invalidëve të punës në pension të Republikës Socialiste të Maqedonisë - LSHPIPRSM" (22.01.1966);

- "Lidhja e pensionistëve të Maqedonisë - LPM" (29.05.1975);

- "Lidhja e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë - LSHPM" (21.12.1998);

- "Lidhja e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë - LSHPM" (22.12.2015).

Emrat e kryetarëve të organizatës së pensionistëve gjatë periudhës së viteve 1950-2016*

K R Y E T A R Ë T



Gjorgje Ristić



Pero Stojanovski



Krste Krstevski



Naqo-Koço Meshkovski



Pero Lazarevski



Stojçe Nikollovski



Petar Kabranov



Vite Isjanovski




Dushko Shurbanovski



Dragi Argirovski

* Vërejtje: Për shkak të mungesës së dokumenteve origjinale të zgjedhjeve të mbajtura gjatë periudhës së viteve 1978-1986 mund të kemi paraqitur të dhëna jo të plota

PJESA III




AKTIVITETET DHE REZULTATET ME RËNDËSI

AKTIVITETET DHE REZULTATET ME RËNDËSI

1. STATUSI LIGJOR, ORGANIZIMI DHE FUSHËVEPRIMI

Statuti i ri i Lidhjes së shoqatave të pensionistëve dhe invalidëve të punës të Republikës Socialiste të Maqedonisë u miratua në Kuvendin e çrregullt të Këshillit Republikan të Lidhjes, që u mbajt më 19.02.1967 dhe i njëjti u plotësua në Kuvendin e rregullt të këtij këshilli, që u mbajt më 01.07.1970.



Në përputhje me qëllimet dhe detyrat, Lidhja u organizua me funksionimin e organeve më poshtë:

- Këshilli republikan - Plenumi i Lidhjes së shoqatës së pensionistëve dhe invalidëve të punës, si një trup drejtues i organizatës në përgjithësi, në territorin e RSM;
- Shoqatat komunale, më saktësisht shoqatat e pensionistëve dhe invalidëve të punës si organizatë kryesore e Lidhjes, në territorin e një komune dhe
- Organizatat vendore për të cilat do të ketë nevojë.

Këshilli republikan dhe shoqata komunale janë subjekte juridike dhe përgjigjen vetë për dety-

rimet e tyre ndaj palëve të treta. Ato përfaqësohen nga Kryetari ose zëvendësi i caktuar prej tij.

Vlen të theksohet se Lidhja e shoqatave të pensionistëve dhe invalidëve të punës të RSM ka qenë anëtare kolektive e organizatës së Lidhjes së sindikatave të RSM.

Këshilli republikan i Lidhjes së atëhershme ka pasur për qëllim të zbatojë politikën e vetme dhe të bëjë përpjekje që shoqatat të kenë qëndrime të unifikuara lidhur me çështjet parimore dhe praktike me interes të përbashkët për pensionistët dhe invalidët e punës, ndërsa organizatat e tyre në aspektin e organizimit të përfshinin të gjithë pensionistët, ato të moshës, familjarë dhe invalidët e punës dhe bartësit e tjerë të të drejtës së pensionit, si dhe të zhvillonin dhe ndihmonin aktivitetet kulturore-artistike të anëtarëve të njësive organizative të Lidhjes. Në këtë kontekst, Këshilli republikan i Lidhjes ka koordinuar dhe harmonizuar funksionimin e shoqatave në territorin e RSM dhe i ka përfaqësuar para organeve shtetërore.

Për sa i përket anëtarësimit në Lidhjen, i njëjti ka qenë në bazë vullnetare dhe anëtar mund të bëhej çdo person që ka marrë pension moshe, familjar, invalidor, personat me pension të veçantë dhe personat e tjerë me të drejtë pensioni që kanë jetuar në territorin e RSM. Një rrethanë me rëndësi ka qenë detyrimi për të pranuar Statutin e Lidhjes dhe respektimi i dispozitave të Statutit. Të miturit që kanë marrë pension familjar kanë pasur të drejtë anëtarësimi në Shoqatë vetëm nëpërmjet kujdestarit ligjor.

Anëtarësimi është realizuar nëpërmjet shoqatës komunale ose shoqatës në territorin e komunes, në të cilën anëtari përkatës ka pasur adresë

banimi. Në rast se në një komunë nuk ka pasur shoqatë, pensionistët janë anëtarësuar në një nga shoqatat më të afërta komunale. Gjatë anëtarësimit, anëtari ka paguar një shumë konkrete dhe shumë anëtarësimi dhe ka fituar kartë anëtarësimi. Barazia ka qenë e pranishme nëpërmjet faktit që anëtarët e Lidhjes kanë pasur të drejta dhe detyrime të njëjta. Të drejtat materiale të anëtarëve të Lidhjes, që kanë rrjedhur nga anëtarësimi i tyre, mund të realizoheshin gjashtë muaj pas anëtarësimit të pandërprerë. Të gjithë anëtarët e shoqatës kanë pasur të drejta të barabarta në përputhje të Statutit. Çdo anëtar ka pasur të drejtë zgjedhjeje, aktive dhe pasive, të shfrytëzojë ndihmë monetare në mbështetje të akteve të shoqatës, të përdor bibliotekat dhe libraritë dhe pajisjet e tjera kulturore dhe argëtuese të shoqatës. Një dispozitë statutare me rëndësi ka qenë detyrimi i anëtarëve për të ruajtur renomenë e pensionistëve, për të penguar çdo dukuri negative që mund të dëmtojë interesat e bashkësisë ose shoqatës. Anëtari ka pasur për detyrë që me pjesëmarrjen e tij dhe përpjekjet të ndihmojë shoqatën në realizimin e qëllimeve dhe detyrave të saj, të realizojë dhe respektojë vendimet e saj dhe të paguajë rregullisht shumën e anëtarësimit. Shuma e anëtarësimit ka qenë e njëjtë për të gjithë anëtarët e Lidhjes dhe është caktuar nga ana e Kuvendit të Lidhjes ose Këshilli republikan - Plenumi, sipas shumës mujore të të ardhurave të pensionistëve dhe është caktuar në mënyrë progresive. Anëtarësimi në një shoqatë mund të ndërpritej në disa forma, si më poshtë vijon: në rast se anëtari do të deklarohej me shkrim se heq dorë nga anëtarësimi në Shoqatë, në rastet e riaktivizimit, humbjes së të drejtës së pensionit, refuzimit për të paguar shumën e anëtarësimit të paktën një vit, ndërsa Këshilli ekzekutiv i shoqatës nuk ka arsyetuar mospagesën, me përjashtimin nga shoqata dhe me vdekjen e personit. Me fshirjen e anëtarit nga evidencat e anëtarësimit ai ka humbur të drejtat në mbështetje të Statutit dhe të drejtën e rimbursimit të shumave që i ka paguar paraprakisht. Përjashtimi i anëtarit nga shoqata mund të bëhej edhe në rastet në vazhdim: në rast se anëtari në çfarëdo lloj mënyre me punën e tij ose me fjalë dhe vepra ka dëmtuar renomenë dhe ka penguar punën e shoqatës komunale ose Lidhjes në përgjithësi. Propozim për ngritjen e procedurës së përjashtimit të anëtarit nga shoqata ka pasur të drejtë të jap çdo anëtar ose organ në mbështetje të provave. Vendimin e përjashtimit e

mernte Këshilli ekzekutiv, i cili për këtë qëllim ka formuar komisione të veçanta që kanë pasur për detyrë vërtetimin e gjendjes faktike. Për vendimin e përjashtimit ka pasur një procedurë me dy nivele. Anëtari i përjashtuar ka pasur të drejtë të anëtarësohet përsëri në shoqatë në rastet e mënjanim të rrethanave për të cilat është përjashtuar.

Lidhja ka pasur organet në vazhdim:

1. Kuvendi,
2. Këshilli republikan,
3. Kryesia e Këshillit republikan dhe
4. Këshilli mbikëqyrës.


Këshilli republikan - Plenumi për çështjet organizative, financiare dhe çështjet e tjera ka marrë vendime vetë, në përputhje me dispozitat e Statutit dhe Rregullores mbi punën financiare - materiale të Lidhjes. Fushëveprimi i Këshillit republikan - Plenumit shtrihej në territorin e Republikës Socialiste të Maqedonisë. Këshilli republikan - Plenumi kishte statusin e subjektit juridik dhe të njëjtin e përfaqësonte kryetari, ndërsa në mungesë të tij e përfaqësonte nënkryetari i Këshillit republikan ose personi i caktuar nga ana e Kryesisë. Kuvendi nga delegatët dhe anëtarët zgjidhte Këshillin republikan - Plenumin, ndërsa ky organ ka zgjedhur Kryesinë me 9 deri në 15 anëtarë. Kryesia ka zgjedhur kryetarin, nënkryetarin, sekretarin dhe arkëtarin. Këshilli republikan - Plenumi ka mbajtur seanca sipas nevojës ose të paktën një herë në vit. Seancat e Këshillit republikan i ka caktuar Kryesia.

Për sa u përket detyrave të Këshillit republikan, lirisht mund të themi se ato kanë qenë të shumta. Këshilli ka pasur për detyrë të ndihmojë, harmonizojë dhe bashkojë veprimtarinë e të gjitha njësive organizative të Lidhjes për një realizim sa më të suksesshëm të detyrave të Lidhjes, të administronte pasurinë e Këshillit republikan dhe pasurinë e fondeve të përbashkëta, të ndihmonte anëtarësinë lidhur me realizimin e të drejtave të tyre, të parapara me ligjet e sigurimit pensional dhe invalidor dhe të jepte propozime për organet kompetente, si dhe të mundësonte bashkëpunim me Entin republikan të RSM. Gjithashtu, Këshilli është kujdesur për pozicionin material dhe social të anëtarëve të Lidhjes, duke gjetur forma bashkëpunimi përkatëse. Këshilli ka zhvilluar dhe ndihmuar aktivitetet kulturoro-politike të anëtarëve të njësive organizative të Lidhjes, ka bashkëpunuar me orga-

nizatat sindikale dhe organizatat e tjera shoqërore. Këshilli ka trajtuar çështjet me interes për pensionistët dhe çështjet e tjera shoqërore, është kujdesur për zhvillimin e dashurisë midis anëtarëve ose pensionistëve të RSM dhe republikave vëllazërore, ka bërë përpjekje për ndërtimin e shtëpive kulturore-arsimore dhe për argëtimin e pensionistëve, ndërsa për realizimin e detyrave të caktuara ka formuar edhe komisione përkatëse. Si një organ i veçantë në kuadër të Lidhjes ka funksionuar Këshilli mbikëqyrës, të cilin e përbënin 3 deri në 5 anëtarë, që janë zgjedhur në Kuvendin vjetor të Lidhjes dhe kanë pasur për detyrë në çdo kohë dhe në rast nevojë të bëjnë kontrolle financiare-materiale të funksionimit të Këshillit republikan të Lidhjes ose të paktën një herë në gjashtë muaj. Ky organ për punën e tij ka dorëzuar raporte për gjendjen financiare dhe materiale në Kryesinë dhe Këshillin republikan - Plenumin dhe në Kuvendin vjetor.

Në Kuvendin e çrregullt të Lidhjes së pensionistëve të Maqedonisë, që u mbajt më 29 maj 1975, u miratua Statuti i ri dhe emri i ri "Lidhja e pension-

ka funksionuar selia e komunës dhe Lidhja e pensionistëve të Maqedonisë me seli në Shkup, e përfaqësuar nga Këshilli republikan. Edhe këtë herë Lidhja dhe organizatat komunale kishin statusin e subjekteve juridike, por një status të tillë nuk kishin organizatat vendore që kanë funksionuar në bazë të kompetencave dhe udhëzimeve të organizatave të tyre komunale. Anëtarësimi në Lidhjen ka mbetur vullnetar dhe pensionisti ka pasur të drejtë të anëtarësohet vetëm në një nga organizatat komunale. Ndërkaq u forcua korniza ligjore e përfashtimit të anëtarëve nga organizata dhe në rast se përfashtimi ka qenë tendencioz. Organizata ka marrë përsipër të nis procedurë kundër parashtruesit të dhënave të këtij lloji. Shuma e regjistrimit dhe anëtarësimit dhe përqindja e kuotës, të cilën organizatat komunale ia kanë dhënë Lidhjes, caktoheshin nga Kuvendi i Lidhjes, pas marrjes së një vendimi nga organizatat komunale. Organet e organizatave vendore kanë qenë kuvend për të gjithë pensionistët e organizatës vendore dhe këshillit vendor, ndërsa organizata komunale ka pasur organet në vazhdim:



- a) Kuvendin;
- b) Këshillin ekzekutiv;
- v) Këshillin mbikëqyrës;
- g) Komisionet.

Mandati i të gjithë organeve ka vazhduar katër vjet. Komisionet, si organe ndihmëse, janë paraparë me Statutin si komisione për çështje organizative, statutare dhe kadrovike, ndjekjen e sistemit të sigurimit pensional dhe invalidor dhe gjendjes materiale të pensionistëve, çështjet e banimit, pushimit dhe rekreacionit të pensionistëve, jetën kulturore-argëtuese dhe kujdesin dhe ndihmën sociale për pensionistët. Mund të vërehet se me këtë Statut është paraparë se organe të Lidhjes kanë qenë:

- 1) Kuvendi;
- 2) Këshilli republikan; dhe
- 3) Këshilli mbikëqyrës.

istëve të Maqedonisë". Lidhja edhe më tej definohej si organizata e vetme vullnetare, shoqërore-humanitare e personave që kanë marrë pension në territorin e Republikës Socialiste të Maqedonisë. Lidhja e pensionistëve të Maqedonisë edhe më tej vazhdoi të veprojë në kuadër të Lidhjes së sindikatave të Maqedonisë, si anëtare kolektive e Lidhjes. Për sa i përket organizimit, me Statutin e ri, në vend të parë janë pozicionuar organizatat vendore që janë formuar në rajonin e një ose më shumë bashkësive vendore, ku kanë jetuar mbi 50 pensionistë, organizatat komunale të Lidhjes në territorin e komunës, me seli në vendin në të cilin

Këshilli republikan, si organ ekzekutiv, i ka pasur pothuajse të gjitha komisionet si në organizatat komunale dhe në kuadër të Lidhjes ka funksionuar edhe komisioni i çështjeve të pensionistëve të luftës, çështjeve të pensionistëve të OPB dhe komisioni për zhvillimin e konceptit të mbrojtjes

popullore. Me këtë Statut akoma ekziston një lidhje vertikale e fortë midis organizatave komunale dhe Lidhjes, me bazën ligjore të Këshillit republikan të Lidhjes, i cili ka pasur mundësi të pezullojë organizatën komunale në bazë të mendimit të siguruar paraprakisht nga ana e organizatave shoqëroro-politike të komunës nëse punon në kundërshtim me dispozitat e Statutit të Lidhjes dhe në rastet kur me veprimet e veta prish renomenë e Lidhjes dhe bashkësisë shoqërore. Me dispozitat e këtij Statuti, Lidhja e punëtorëve të pensionuar të OVR - RSM është në përbërje të Lidhjes, me një status ligjor të veçantë, por me të njëjtat të drejta dhe detyrime si organizatat e tjera të pensionistëve. Në fund, kur bëhet fjalë për Statutin e Lidhjes, të miratuar në vitin 1975, në këtë statut implementohet një dispozitë me të cilën përcaktohet se në Shkup është duke u formuar Këshilli i qytetit të Lidhjes së shoqatave të pensionistëve, me detyrën e tij për ta koordinuar dhe bashkuar punën e shoqatave të qytetit dhe ta prezantojë të njëjtën para organeve shoqëroro-politike dhe organeve dhe organizatave të tjera të qytetit.

Me Statutin e vitit 1982 Lidhja ka vazhduar të funksionojë si një anëtare kolektive e Lidhjes së sindikatave të Maqedonisë. Me këtë Statut dhe me statutet e mëparshme, si rezultat të lidhjes vertikale të Lidhjes me organizatat komunale, ishin paraparë dispozita për organizatat komunale dhe Lidhjen. Sipas këtij Statuti, në shoqatat komunale ka funksionuar Konferenca e shoqatave, të cilën e kanë formuar të gjithë përdoruesit e pensioneve në rajonin në të cilin ka vepruar shoqata dhe ajo ka zgjedhur Kryesinë dhe Këshillin e kontrollit shoqëror. Në këtë Statut mund të gjenden edhe lidhjet komunale të pensionistëve, në kuadër të të cilave organi më i lartë ka qenë Konferenca që përbëhej nga delegatët e bashkësive vendore. Organe të Lidhjes kanë qenë:

- 1) Konferenca
- 2) Këshilli i kontrollit shoqëror.

Me Statutin për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Lidhjes së pensionistëve të Maqedonisë i vitit 1984 vërehet se në territorin e Maqedonisë, si organizata të përdoruesve të pensionit ekzistojnë:

1. Organizata vendore e Lidhjes së pensionistëve nga rajonet e një ose më shumë bashkësive vendore;

2. Lidhjet komunale të pensionistëve dhe invalidëve të punës të Qytetit të Shkupit;

3. Lidhja e pensionistëve të Maqedonisë në të cilën janë bashkuar lidhjet komunale të pensionistëve dhe Lidhja qytetare e pensionistëve të Qytetit të Shkupit.

Më datën 26 maj 1987 u mbajt takimi i kryetarëve të shoqatave, në të cilin është debatuar për masat restriktive të paralajmëruara lidhur me uljen e pensioneve. Në vitin 1990, në Kuvendin zgjedhor vjetor të Lidhjes së pensionistëve të Jugosllavisë në detyrën e kryetarit të Kryesisë së Lidhjes u zgjodh Mr. Vite Isjanovski. Në këtë takim u diskutua çështja e mbajtësit të të drejtës së pronësisë të shumë objekteve të pensionistëve.

Në vitin 1991, me pavarësimin e Republikës së Maqedonisë, LPM doli nga Lidhja e pensionistëve të Jugosllavisë. Me Statutin e Lidhjes së pensionistëve të Maqedonisë, që u miratua nga Këshilli republikan në seancën e mbajtur më 5 korrik 1991, mund të shihet autonomia më e theksuar e veprimit të LPM sepse me dispozitat fillestare është paraparë që Lidhja, si një organizatë shoqërore është e pavarur në aspektin e organizimit dhe realizimit të qëllimeve dhe aktiviteteve, ndërsa si organe janë definuar Këshilli republikan dhe Këshilli mbikëqyrës. Këshilli republikan ka pasur Këshill ekzekutiv të zgjedhur nga delegatët e përbërjes së vetë Këshillit. Këshilli ekzekutiv ka mbajtur seanca sipas nevojës, por të paktën katër seanca brenda vitit. Procesverbalet e Këshillit ekzekutiv u janë dorëzuar anëtarëve të Këshillit ekzekutiv të lidhjeve komunale të pensionistëve dhe Lidhjes së qytetit të pensionistëve të qytetit të Shkupit.

Statuti i ri i Lidhjes së pensionistëve të Maqedonisë është miratuar në seancën e mbajtur më 27.10.1994 dhe është me shumë rëndësi për organizimin e pensionistëve sepse Lidhja nuk ka mbetur në përbërje të Lidhjes së Sindikatave të Maqedonisë dhe nuk ka qenë më një organ kolektiv i Lidhjes së sindikatave. Lidhja, si një organizatë shoqërore, ka qenë e pavarur në aspektin e organizimit dhe realizimit të qëllimeve dhe aktiviteteve të saj. Struktura organizative ka mbetur e njëjtë, ndërsa me këtë Statut është paraparë që organizimi i organizatave të bëhet vetëm sipas parimeve territoriale. Struktura organizative ka mbetur e njëjtë, ndërsa konferencat e organizatave vendore u zëvendësuan me Kuvendin, si organi më i lartë në të cilin kanë marrë pjesë të gjithë pensio-

nistët e anëtarësuar që kanë jetuar në rajonin përkatës. Ky statut përputhet edhe me Ligjin e ri të sigurimit pensional dhe invalidor të Republikës autonome dhe të pavarur të Maqedonisë. Në Lidhjen janë anëtarësuar përdoruesit e pensioneve (të moshës, invalidor, familjarë, të luftës dhe bujqësorë) sepse me Ligjin e sigurimit pensional dhe invalidor janë përfshirë të gjithë kategoritë e të siguruarve dhe janë shfuqizuar ligjet e veçanta që kanë rregulluar problematikën e pensionistëve.

Me këtë statut më shumë hapësirë i është lënë Lidhjes së qytetit të pensionistëve, ndërsa organe të Lidhjes kanë qenë:

- 1. Këshilli i qytetit i pensionistëve dhe**
- 2. Këshilli mbikëqyrës.**

Këshillin e qytetit të shoqatave të pensionistëve dhe invalidëve të punës të Qytetit të Shkupit e përbënin anëtarët e zgjedhur të shoqatave komunale dhe pensionistë të tjerë anëtarë të Lidhjes që i ka zgjedhur Këshilli i qytetit me propozimin e Komisionit të kandidimit. Këshilli i qytetit ka pasur edhe Këshill ekzekutiv me anëtarë të zgjedhur nga përbërja e vetë, me mandat 4-vjeçar. Edhe më tej organe të Lidhjes kanë qenë Këshilli republikan, Këshilli mbikëqyrës dhe Këshilli ekzekutiv, i cili është zgjedhur nga Këshilli republikan. Gjithashtu, edhe me këtë Statut u formua baza me të cilën Lidhja fitoi të drejtën që me një Rregullore të veçantë të rregullojë funksionimin materialo - financiar. Me pjesën më të madhe të statuteve të Lidhjes është paraparë se urdhërdhënësi i realizimit të planit financiar të Lidhjes është kryetari i Këshillit ekzekutiv, ndërsa në mungesë të tij, nënkryetari dhe sekretari. Edhe në atë kohë është theksuar përcaktimi i organizimit apartiak, me qëndrimin e vetëm se Partia e pensionistëve do të ishte jo popullore dhe e padobishme për pensionistët e Maqedonisë.


Risia më e rëndësishme e organizimit të pensionistëve ishte miratimi i Statutit në seancën e Kuvendit, e mbajtur më 30.11.1998, në kuadër të të cilës u caktua emri i ri i organizatës së pensionistëve - Lidhja e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë. Nevoja e miratimit të Statutit të ri dhe të harmonizuar buronte nga neni 37 i Ligjit të shoqatave dhe fondacioneve (Gazeta Zyrtare e RM nr. 31/98) sipas të cilit organizatat dhe shoqatat shoqërore të qytetarëve kanë pasur për detyrë programet dhe statutet e tyre t'i harmonizojnë me dis-

pozitat e ligjit përkatës brenda gjashtë muajve nga dita e hyrjes së ligjit në fuqi. Më konkretisht, baza ligjore e miratimit të këtij Statuti del nga neni 5 i Ligjit të shoqatave civile dhe fondacioneve sepse ka pasur ndikim të madh në dispozitat e Statutit të atëhershëm. Me vetë ligjin e organizatave civile janë paraparë organet e shoqatës dhe kompetencat e tyre, caktimi i seancave të organeve të shoqatës dhe shumica e nevojshme e anëtarëve të organeve për të marrë vendime ligjore. Ligji rregullon edhe çështjen e shuarjes së shoqërisë dhe çështjen e pasurisë, si dhe mënyrën e sigurimit dhe përdorimit të mjeteve të shoqatës. Me këtë ligj është paraparë se organizatat mund të bashkohen në Lidhje ose forma të tjera organizimi dhe për këtë arsye ky Statut është një akt i organizatave të bashkuara të pensionistëve, më saktësisht Lidhja e pensionistëve i bashkon dhe përfaqëson interesat dhe të drejtat e të gjithë përdoruesve të pensioneve në nivel vendi. Shoqatat vullnetarisht bashkohen dhe formojnë Lidhje, duke i formuar organet e Lidhjes me delegatët e tyre, duke marrë pjesë në punën e tyre dhe në këtë mënyrë duke realizuar drejtpërdrejtë interesat e përdoruesve të pensioneve ose anëtarëve të shoqatave. Ligji në fjalë përcakton karakterin dhe kompetencat e LSHPM, ndërsa organet e Lidhjes janë:

- 1. Kuvendi (reprezentues i përgjithshëm i të gjithë pensionistëve në Maqedoni)**
- 2. Këshilli ekzekutiv dhe**
- 3. Këshilli mbikëqyrës.**



Premisa ligjore kryesore e pavarësisë së veprimit të shoqatës gjeti vendin e vet në Statutin e Lidhjes. Më konkretisht, shoqatat në mënyrë autonome rregullojnë mënyrën e organizimit të brendshëm, themelimin e degëve si qeliza kryesore të organizatës etj.

Organizimi i pensionistëve, i shprehur nëpërmjet një forme më të lartë të organizimit në Lidhje me 52 anëtarë, është një subjekt respektimi kur bëhet fjalë për të drejtat dhe interesat e pensionistëve dhe të drejtën e tyre të pensionit. Statuti i vitit 1998, si akti më i lartë, analizohet vazhdimisht me qëllim që ai të jetë akt që do të jetë sa më demokratik. Në këtë kontekst, në vitin 2011 u përgatit dhe miratua Statuti i ri i LSHPM. Të njëjtin vit, pas një pushimi disavjeçar, anëtare e LSHPM përsëri u bë Shoqata e pensionistëve të Manastirit, me rreth 17.000 anëtarë, ndërsa nga fundi i vitit 2014, në



mbështetje të Statutit, nga Lidhja dolën katër shoqata të pensionistëve me invaliditet nga Prilepi, Ohri, Kavadarci dhe Velesi, me rreth 4.000 anëtarë, të cilët u anëtarësuan në Lidhjen e pensionistëve me invaliditet e Maqedonisë.

Në vitin 2015 u ndryshua dhe plotësua Statuti i LSHPM. Arsyet kryesore të ndryshimeve kanë



qenë harmonizimi më i mirë me Ligjin e shoqatave dhe fondacioneve, Ligjin e sigurimit pensional dhe invalidor, tejkalimi i akumulacionit të funksioneve,

definimi i bazës ligjore të miratimit të akteve për rregullimin e çështjeve materialo-financiare dhe definimi i një zgjidhjeje më të qartë se shoqatat me bashkimin në LSHPM nuk e humbasin pavarësinë dhe autonominë e tyre. Me këtë statut zgjidhet dhe tejkalohet çështja e akumulacionit të funksioneve dhe përfaqësuesit e zgjedhur në organet e Lidhjes ushtrojnë vetëm nga një funksion. Sipas zgjidhjes së vjetër ligjore "Kryetari i Kuvendit të LSHPM ka ushtruar edhe detyrën e Kryetarit të Këshillit ekzekutiv", ndërsa me statutin e ri u ndryshua dispozita përkatëse dhe u mundësua emërimi i Kryetarit të Kuvendit, si një funksion i veçantë dhe Kryetarit të Këshillit ekzekutiv, i cili njëkohësisht ushtron edhe detyrën e Kryetarit të Lidhjes. Me zgjidhjet e mëvonshme, të parapara me Statutin, avancohet vendimi i pensionistëve se shoqatat e pensionistëve nuk duhet të propozojnë anëtarë për Kuvendin e Lidhjes vetëm sipas funksionit, por edhe nga baza më e gjerë e delegatëve të shoqatës. Me këtë statut në nivelin e dispozitës statutare janë edhe zgjidhjet që kanë të bëjnë me Organizatën e regjistruar të fondit solidar dhe anëtarësimit, më saktësisht detyrat e Organizatës së regjistruar i realizon

LSHPM, me pëlqimin paraprak të lidhjeve të tjera të pensionistëve të RM. Organizata e regjistruar ka Këshillin që miratoi Rregulloren me të cilën rregullohet kërkesa e kësaj organizate, që merret me zgjidhjen e të gjitha çështjeve të Fondit solidar dhe anëtarësimit. Kryetari i parë i Këshillit të Organizatës së regjistruar ishte Dushko Shurbanovski, ndërsa pas tij, të njëjtën detyrë e ushtruan Metodija Toshevski dhe Saltir Karovski.


tën detyrë e ushtruan Metodija Toshevski dhe Saltir Karovski.

2. FONDI I SOLIDARITETIT

Solidariteti ka qenë gjithmonë një nga karakteristikat pozitive të pensionistëve. Dihet që Fondi i vetëm vullnetar i pas vdekjes është formuar që në vitin 1955 dhe më vonë është plotësuar në vitin 1962. Në vitin 1967 në mbështetje të Re-

gullores në përbërje të Këshillit republikan të Lidhjes së shoqatave të pensionistëve dhe invalidëve të punës të RSM ka funksionuar Fondi i vetëm i ndihmës së përbashkët, që u formua me mjetet të veçanta të anëtarëve dhe kishte për qëllim

ofrimin e ndihmës në rast vdekjeje të një anëtarit të Fondit, për anëtarët e familjes së tij. Fondi ka qenë një institucion vullnetar. Ai ka ushtruar aktivitetin në të gjithë territorin e vendit. Vlen të theksohet se Fondi ka pasur statusin e një subjekti juridik, ndërsa aktiviteti i tij është zhvilluar nëpërmjet Këshillit republikan të Lidhjes, drejtpërdrejtë dhe nëpërmjet shoqatave komunale. Anëtarësimi në fond bëhej



me ndihmën e shoqatave komunale të pensionistëve dhe invalidëve të punës, sipas kushteve të parapara me këtë rregullore. Anëtar i Fondit ka mundur të bëhet çdo pensionist, anëtar i një shoqate komunale të Lidhjes së shoqatave të pensionistëve dhe invalidëve të punës të RSM, i cili ka pranuar rregullat e Fondit. Me anëtarësimin në Fondin pensionistët njëkohësisht ka siguruar ndihmën për vetveten dhe për anëtarët e familjes së tij, në shumë prej 50% të shumës së paraparë për anëtarët e Fondit. Megjithatë, në rastet kur anëtar i Fondit ka dashur të sigurojë të drejta të njëjta edhe për bashkëshortin ose bashkëshorten, një gjë të tillë ka mundur të arrijë me anëtarësimin dhe me detyrimin për të paguar për bashkëshortin ose bashkëshorten të njëjtën shumë anëtarësimi. Anëtar i Fondit ka pasur detyrat në vazhdim: të paguajë rregullisht shumën e anëtarësimit, të bëjë përpjekje për rritjen e numrit të anëtarëve dhe forcimin e Fondit dhe të realizojë detyrat e tjera të parapara me Rregulloren.

Ky Fond ka funksionuar deri në vitin 1986 kur institucionet kompetente filluan të mbulojnë mjetet e varrimit të pensionistëve, që rezultoi me stagnimin e Fondit të solidaritetit. Megjithatë, me pavarësimin e Republikës së Maqedonisë, inflacionin dhe problemet e tjera të tranzicionit, shuma që ndahej nga ana e institucioneve shtetërore në rastet e vdekjes së pensionistëve u bë shumë e vogël. Për këtë arsye Lidhja e pensionistëve të Maqedonisë filloi të analizojë mënyrën e mbledhjes më të sigurt

të mjeteve përkatëse. Në vitin 1993 u lidh një marrëveshje me "Kjubi Makedonija" për pagimin e mjeteve të Fondit të solidaritetit për varrim, por 12 shoqata të pensionistëve formuan fonde të veçanta dhe në këtë mënyrë i siguruan edhe bashkëshortët ose bashkëshortet që nuk kanë qenë pensionistë. Më vonë këtë shembull e pranuan edhe shoqata të tjera të pensionistëve dhe formuan fonde të veçanta të këtij lloji. Në vitin 1998 FSPIM këtyre shoqatave filloi të mos u paguajë më mjetet e Fondit të solidaritetit, që rezultoi me një proces gjyqësor, ndërsa me kërkesë të LSHPM dhe angazhimin e Prof. Dr. Asen Grupçe, Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë, me një aktvendim të veçantë ka mbyllur këtë kontest në favor të pensionistëve, të cilët u bashkuan në mbrojtje të fondeve të solidaritetit.

Në aspektin historik, varianti më i sigurt i mbledhjes së këtyre mjeteve ka qenë varianti i mbledhjes së tyre nëpërmjet FSPIM nga një organ që ka bërë përlllogaritjen dhe pagimin e pensionit të çdo pensionisti. Megjithatë, si një pengesë u paraqit mungesa e një baze ligjore për realizimin e kësaj pune nga ana e Fondit. Në zgjidhjen e kësaj çështjeje dhe realizimin e këtij opsiioni një kontribut shumë të madh ka dhënë z. Kiro Zrmanovski, drej-



tori i atëhershëm i FSPIM. Për realizimin e kësaj iniciative u përgatitën më shumë informata dhe më vonë, këtë çështje humane e pranoi Fondi i atëhershëm pensional i cili ka kërkuar qartë nga lidhjet e pensionistëve që mjetet të jenë pasuri personale e pensionistëve dhe në kompetencë të Lidhjeve. Çështjet ligjore të këtij lloji me problematikën e Fondit të solidaritetit u rregulluan nga organet e Lidhjes, ndërsa Fondi i SPIM ka pasur për detyrë të veprojë sipas tyre. Mjetet e Fondit të solidaritetit janë transferuar në llogaritë e Shoqatave, të cilat në mbështetje të vendimeve të tyre ua kanë paguar anëtarëve të familjeve. Megjithatë, në funksionimin e Fondit të solidaritetit dhe lidhur me shumën e

anëtarësimit u paraqitën probleme në aspektin e transferimit të anëtarëve nga një shoqatë në një tjetër, formimit të shoqatave paralele, shumave të ndryshme të pagesave në rastet e vdekjes, transferimit të mjeteve të Fondit në llogaritë e organizatave të invalidëve, në të cilat kryesisht janë anëtarësuar invalidë të punës me aftësi pune të dobësuar, probleme këto si rezultat të të cilave Shoqatat e invalidëve filluan të fitojnë vetëm 50% të mjeteve të anëtarësimit dhe në këtë mënyrë në llogaritë përkatëse nuk kishte mjete të mjaftueshme për pagimin e shpenzimeve të varrimit, ndërsa shumat përkatëse familjeve u janë paguar me këste ose vonesa disamujshme. Të pakënaqura me zhvillimet e tilla, Shoqatat e pensionistëve me invaliditet nga Velesi, Kavadari, Prilepi dhe Ohri kërkuar anëtarësim dhe u pranuan në LSHPM. Për lehtësimin e funksionimit të FSPIM, Kuvendi i LSHPM mori një vendim sipas të cilit një shoqatë e re mund të formohej në rast se në kuadër të Komunes kishte të paktën 500 anëtarë - pensionistë. Në këtë mënyrë u caktuan kriteret më të rrepta dhe nuk pranoheshin më shoqata paralele për të mos u rritur numri i tyre dhe të mos vështirësohej funksionimi i FSPIM, në aspektin e mbajtjes së mjeteve të Fondeve të solidaritetit dhe shumës së anëtarësimit. Çështja e Fondit të solidaritetit u ngrit në nivel ligji dhe u rregullua me Ligjin e sigurimit pensional dhe invalidor. Me këtë ligj, me kreun 10 u definua Fondi i solidaritetit - ndihma e pas vdekjes dhe shuma e anëtarësimit (nenet 115-117) dhe u definua se pensionist që merr pension me pëlqimin e tij mund t'i mbahet një pjesë e pensionit për të siguruar mjetet e nevojshme për pagimin e ndihmës së pas vdekjes për anëtarët e familjes së tij dhe për shumën e anëtarësimit. Me vetë faktin që bëhet fjalë për mjete të pensionistëve, ligjdhënësi çështjet lidhur me Fondin e solidaritetit i rregulloi me Akt dhe të njëjtat i vërteton Organizata e regjistruar e Lidhjeve të shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë. Me MARËVESHJEN nr. 165, e datës 17.12.2008, e lidhur midis katër lidhjeve (LSHPM, Lidhja nacionale e invalidëve të punës të Republikës së Maqedonisë, Lidhja e shoqatave të pensionistëve me invaliditet të Republikës së Maqedonisë, Lidhja e shoqatave të invalidëve të punës - përdorues të pensionit invalidor të RM) caktohet Organizata e regjistruar që formon Këshill, në të cilin marrin pjesë 7 anëtarë, 4 nga të cilat zgjidhen nga ana e LSHPM dhe nga një anëtar zgjedhin lidhjet e tjera. Këshilli miraton rregullore mbi punën e tij, me të cilën caktohet mënyra e funksionimit, shuma që mbahet për ndihmën e

pas vdekjes dhe shumën e anëtarësimit, shumën që paguhet për ndihmën e pas vdekjes, mënyrën dhe procedurën e pagimit të ndihmës së pasvdekjes, mënyrën e ndarjes së shumës së anëtarësimit për Lidhjet dhe mënyrën e kontrollimit të pagesës së këtyre mjeteve. Sipas Ligjit të sigurimeve pensionale dhe invalidore, pagimin e ndihmës së pas vdekjes me mjetet e Fondit të solidaritetit e bën Shërbimi profesional nëpërmjet filialeve të tij. Sipas këtij ligji, mjetet e anëtarësimit Fondi i derdh në llogarinë e caktuar nga ana e Organizatës së regjistruar, që përbëhet nga Lidhjet e shoqatave të pensionistëve. Raportet më të afërta midis FSPIM dhe LSHPM janë paraparë me marrëveshje, ndërsa viteve të fundit Fondi dhe LSHPM kanë lidhur kontratë bashkëpunimi lidhur me shkëmbimin e dokumenteve dhe të dhënave të evidencave zyrtare, regjistrave dhe përmbledhjeve të të dhënave personale dhe në këtë mënyrë Fondi LSHPM-së i dorëzon të dhëna lidhur me shumën e anëtarësimit, e cila në mbështetje të akteve të Këshillit më vonë në llogaritë e shoqatave të LSHPM dhe lidhjeve të tjera. Në mbështetje të relacioneve të bashkëpunimit të Këshillit drejtues të Fondit të SPIM, dy herë në vit përgatiten dhe shqyrtohen informacione lidhur me ndihmën e pas vdekjes dhe shumën e anëtarësimit.

Sipas mjeteve të derdhura dhe të paguara për Fondin e solidaritetit për pensionistët e vdekur, gjatë periudhës janar-dhjetor 2016 dhe në bazë të Vendimit nr. 02-02/847 i Këshillit të organizatës së regjistruar të Lidhjeve të pensionistëve të Maqedonisë, për Fondin e solidaritetit janë mbajtur nga 120,00 denarë, ndërsa shuma e anëtarësimit në Shoqatë ka qenë 30,00 denarë ose gjithsej janë mbajtur nga 150 denarë. Ndihma e pas vdekjes kap shumën e 30.000,00 denarëve, sipas vendimit të Këshillit të Organizatës së regjistruar.

Mjetet për Fondin e solidaritetit - ndihmën e pas vdekjes, Fondi i ka paguar në një llogari të veçantë në kuadër të llogarisë së buxhetit, në formën e "Mjeteve për fondin e solidaritetit - ndihma e pas vdekjes për pensionistët". Gjatë periudhës janar - nëntor 2016, për Fondin e solidaritetit - ndihmën e pas vdekjes janë llogaritur dhe mbajtur gjithsej 381.148.800 denarë nga 286.173 pensionistët, të cilët kanë paguar shumën përkatëse dhe mjetet janë dorëzuar sipas muajve bënë llogarinë e veçantë për këtë qëllim.

Numri i personave që kanë marrë pension dhe mjeteve të llogaritura për Fondin e solidaritetit për periudhën janar - nëntor 2016 janë paraqitur në tabelën më poshtë:

Muaji	Përdorues pensioni të cilët paguajnë mjete për Fondin e solidaritetit	Mjetet për Fondin e solidaritetit (në denarë)
Janar	284.231	34.367.640
Shkurt	283.737	34.326.840
Mars	284.792	34.534.440
Prill	285.139	34.451.880
Maj	285.716	34.595.160
Qershor	286.346	34.669.440
Korrik	286.680	34.677.840
Gusht	286.956	34.722.240
Shtator	287.514	34.833.960
Tetor	287.933	34.862.280
Nëntor	288.861	35.107.080
Totali		381.148.800

paguar mjete për ndihmën e pas vdekjes për pensionistët në shumë prej 381.090.000 denarë. Gjendja e llogarisë më datën 31.11.2016 ka qenë 97.344 denarë.

Si rezultat të kësaj gjendjeje të Fondit të solidaritetit, Fondi i sigurimeve pensionale dhe invalide të Maqedonisë nuk është në gjendje të paguajë rregullisht shumën e pas vdekjes për pensionistët e vdekur dhe në këtë mënyrë pagesat shtyhen për muajt e ardhshëm, pas pagimit të pensione dhe transferimit të mjeteve që mbahen në xhirollogarinë e Fondit, mjeteve për Fondin e solidaritetit në Buxhetin e Ministrisë së financave për t'u derdhur në Fondin e solidaritetit.

Mjetet e paguara nga Fondi i solidaritet - ndihma pas vdekjes dhe numri i pensionistëve të vdekur për periudhën janar - nëntor të vitit 2015/2016 janë paraqitur me tabelën në vazhdim:

Nr. rend	Muaji	Të vdekur	Mjetet e paguara	Të vdekur	Mjetet e paguara	Diferenca
0	1	2	3	4	5	(5-3)
1.	Janar	1.229	36.870.000	1.146	34.380.000	-2.490.000
2.	Shkurt	1.120	33.600.000	1.144	34.320.000	720.000
3.	Mars	1.122	33.660.000	1.151	34.530.000	870.000
4.	Prill	1.123	33.690.000	1.149	34.470.000	780.000
5.	Maj	1.134	34.020.000	1.153	34.590.000	570.000
6.	Qershor	1.137	34.110.000	1.156	34.680.000	570.000
7.	Korrik	1.136	34.080.000	1.156	34.680.000	600.000
8.	Gusht	1.137	34.110.000	1.157	34.710.000	600.000
9.	Shtator	1.139	34.170.000	1.161	34.830.000	660.000
10.	Tetor	1.142	34.260.000	1.162	34.860.000	600.000
11.	Nëntor	1.145	34.350.000	1.168	35.040.000	690.000
	Totali	12.564	376.920.000	12.703	381.090.000	4.170.000

Gjatë periudhës janar - nëntor 2016 në Fondin janë paguar 381.090.000 denarë në formën e mjeteve të ndihmës së pas vdekjes për 12.703 pensionistë të vdekur dhe sa për krahasim, të njëjtën periudhë të vitit 2015 janë paguar 376.920.000 denarë për 12.564 pensionistë të vdekur, ndërsa në vitin 2016, numri është rritur për 139 dhe janë paguar më shumë mjete ose gjithsej 4.170.000 denarë më shumë. Sipas të dhënave më sipër, mund të konstatohet se gjatë periudhës janar - nëntor 2016, në formën e mjeteve të mbajtura për Fondin e solidaritetit janë mbledhur gjithsej 381.148.800 denarë, të cilat bashkë me mjetet e transferuara për vitin 2015, në shumë prej 29.744 dhe pagesa për Fondin e solidaritetit në shumë prej 8.800 denarë arrijnë në gjithsej 381.187.344 denarë. Të njëjtën periudhë janë

Duhet marrë parasysh se mjetet e pagimit të ndihmës së pas vdekjes për pensionistët e vdekur, numri i të cilëve në nivel mujor është rreth 1.154 përdorues, arrin rreth 34.620.000 denarë, ndërsa mesatarja e shumës mujore të mjeteve të parapara për Fondin e solidaritetit arrin rreth 34.649.891 denarë. Këto mjete sivjet nuk mjaftuan për mbulimin e pagesave të ndihmës së pas vdekjes për pensionistët e vdekur sepse sivjet numri i pensionistëve të vdekur që u takon ndihma e pas vdekjes ka qenë më i madh në raport me vitin e kaluar ose më i madh për 139 pensionistë.

Mund të konstatohet se Fondi në nivel mujor mesatarisht bën pagesa sipas 1.154 kërkesave, shumë kjo e barabartë me shumën mujore mesatare që mbahet për Fondin e solidaritetit. Megji-

thatë, deri në fund të muajit dhe pas pagimit të të gjitha mjeteve mujore, pa u paguar mbeten rreth 500 kërkesa që duhen paguar pas pagimit të pen-

sioneve të muajit korrent dhe transferimit të mjeteve që mbahen për Fondin e solidaritetit në llogarinë e Fondit.

3. INFORMATA PËR MËNYRËN E NDARJES SË MJETEVE TË ANËTARËSIMIT

Me informatën lidhur me shumën e anëtarësimit në Shoqatat e pensionistëve deri në nëntor të vitit 2016 theksohet se në mbështetje të nenit 115 të Ligjit të sigurimit pensional dhe invalidor, Fondi i sigurimit pensional dhe invalidor i Maqedonisë pensionistëve, me pëlqimin e tyre, u mban një pjesë të pensionit për të siguruar mjetet e nevojshme për pagimin e ndihmës së pas vdekjes për anëtarët e familjeve të pensionistëve dhe për shumën e anëtarësimit në shoqatat e pensionistëve.

Shuma e ndihmës së pas vdekjes dhe shuma e anëtarësimit merret nga pensioni i pensionistit, me përjashtim të pensionit familjar të fëmijës që fitohet për shkollimin e tij. Në mbështetje të nenit 116, paragrafi 2 i të njëjtit ligj, shuma e ndihmës së pas vdekjes dhe shuma e anëtarësimit me një vendim caktohen nga Organizata e regjistruar e Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë.

Sipas Vendimit të Këshillit të Organizatës së Regjistruar, në vitin 2011 për shumën e anëtarësimit janë mbajtur nga 30,00 denarë dhe këtë shumë Fondi e derdh në llogarinë që e cakton organizata e regjistruar, pas pagimit të pensioneve të muajit korrent, ndërsa ndarjen sipas lidhjeve të pensionistëve e bën LSHPM. Në vitin 2016, për anëtarësim në shoqatat e pensionistëve, me gjendjen e muajit nëntor të të njëjtit vit, janë derdhur gjithsej 95.362.500 milionë denarë. Numri i personave që paguajnë anëtarësim dhe mjetet e përlllogaritura për periudhën janar - nëntor 2016 janë paraqitur me tabelën më poshtë:

Numrit të përgjithshëm të pensionistëve, i cili në nëntor të vitit 2016 ka qenë 305.883 (pensionistë pune, lufte dhe bujqësie), 289.340 pensionistëve u janë mbajtur shumat e anëtarësimit në shumë të përgjithshme prej 8.778.930 denarë dhe shumat përkatëse janë derdhur në llogarinë e veçantë të Lidhjeve të Organizatës së regjistruar të pensionistëve të Maqedonisë dhe shuma përkatëse u ndahet 4 Lidhjeve, si më poshtë vijon:

1. Për LSHPM = 7.786.732 ose 88.70% prej të cilave:

- Për LSHPM = 651.878 ose 8.37%
- Për shoqatat e pensionistëve - anëtare të LSHPM = 7.134.854 ose 91.63%

2. Për Lidhjen e Shoqatave të Invalidëve të Punës Përdoruesit e Pensioneve Invalidore = 503.887 ose 5.74%

3. Për Lidhjen nacionale të invalidëve të punës = 310.979 ose 3.54% dhe për

4. Lidhjen e shoqatave të pensionistëve invalidë të Maqedonisë = 177.332 ose 2.02%.

Nga numri i përgjithshëm i përdoruesve të pensionit, të cilët nuk paguajnë shumën e anëtarësimit, deri në nëntor të vitit 2016, 2.916 përdorues janë fëmijë që shkollohen deri në moshën 26-vjeçe.


Nr.	Muaji	Numri i përdoruesve të pensionit	Shuma e anëtarësimit	Mjetet
1.	Janar	283.361	30	8.570.430,00
2.	Shkurt	284.416	30	8.622.330,00
3.	Mars	284.762	30	8.601.660,00
4.	Prill	285.339	30	8.637.540,00
5.	Maj	285.972	30	8.656.140,00
6.	Qershor	286.306	30	8.658.240,00
7.	Korrik	286.584	30	8.669.460,00
8.	Gusht	278.144	30	8.697.420,00
9.	Shtator	287.565	30	8.704.530,00
10.	Tetor	288.496	30	8.765.820,00
11.	Nëntor	289.340	30	8.778.930,00
	Totali			95.362.500,00

4. PUNËTORI PËR KONTABILISTËT E SHOQATAVE ANËTARE TË LSHPM

Me qëllim që puna financiare e Shoqatave anëtare të Lidhjes të realizohet sipas Ligjit të punës financiare të organizatave jofitimprurëse dhe planeve financiare të shoqatave, Lidhja organizon punëtorin për kontabilistët e shoqatave anëtare të LSHPM dhe publikon Manual për të njëjtën problematikë. Lidhja derri më tani ka organizuar 4 punëtorin të këtij lloji.

Me organizimin e Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, më 29 janar, në restorantin "Panini" në Liqenin e Velesit, u zhvillua një punëtori lidhur me përgatitjen e raporteve financiare dhe llogarive vjetore të Shoqatave të pensionistëve dhe Lidhjes, në të cilën morën pjesë kontabilistët dhe kryetarët e Shoqatave të pensionistëve anëtare të LSHPM, Kryetari i LSHPM, z. Dragi Argirovski, Nënkryetari i Kuvendit, z. Besnik Pocesta, Nënkryetari i Këshillit ekzekutiv, z. Salltir Karovski, përpiluesi i materialit, z. Dimitar Todevski dhe Kryetari i Këshillit mbikëqyrës të LSHPM, z. Mitre Stojanovski.

Punëtorinë e hapi Kryetari i LSHPM, z. Dragi Argirovski, duke theksuar rëndësinë e edukimit të kryetarëve dhe kontabilistëve lidhur me punën e drejtë financiare, që u tregua si shumë i dobishëm dhe u vërtetua me praktikën e katër viteve të kaluara. Falë kujdesit të këtij lloji për funksionim ligjor, në kuadër të Lidhjes gjatë periudhës së kaluar nuk janë konstatuar dobësi ose gjendje negative nga ana e organeve të inspektimit dhe mbikëqyrjes.



Autori i manualit për përgatitjen e raporteve financiare - llogarive vjetore të vitit 2015, z. Dimitar Todevski, shtjelloi çështjet lidhur me këtë problematikë dhe theksoi problemet që mund të shfaqen në raste të ndryshme dhe të shkaktojnë reperkusione në rast se nuk do të veprohet sipas rregullativës përkatëse dhe sidomos sipas Rregullores për kontabilitetin e organizatave jofitimprurëse. Me punëtorinë përkatëse u sqaruan të gjitha dilemat lidhur me përgatitjen e raporteve financiare dhe llogarive përfundimtare të shoqatave të pensionistëve dhe LSHPM-së, ndërsa të gjitha detajet dhe specifikat në raste të ndryshme dhe me shembuj janë pjesë e materialeve të manualit që iu nda kontabilistëve.

5. AKTIVITETET MË TË RËNDËSISHME DHE SHËNIMI I JUBILEVE

Lidhja e pensionistëve të Maqedonisë bën përpjekje intensive për të qenë sa më afër anëtarëve, të forcohet dhe zhvillohet për t'u shërbyer dhe për të mbrojtur interesat e pensionistëve, me sigurimin e një veprimi të organizuar, modern, më të frytshëm dhe më të dobishëm. Duke marrë parasysh aktivitetet ambicioze të programit është vendosur që të gjitha organizatat komunale të pensionistëve dhe Këshilli ekzekutiv i Lidhjes së Pensionistëve të Maqedonisë të kenë orar pune të detyrueshëm, më saktësisht Kryesia të punojë 4 orë,

në vend të praktikës së mëparshme të organizimit të takimeve të përkohshme ose periodike në ambientet punuese. Në këtë mënyrë u mundësua vazhdimësi në punën dhe prania e rregullt e drejtuesve dhe në këtë mënyrë pensionistët mund të informohen më mirë, të kërkojnë mendime, këshilla ose përgjigje të pyetjeve që u interesojnë ose më të gjera.

Në vitin 1986, me rastin e 40-vjetorit të miratimit të Ligjit të parë të sigurimit pensional dhe invaditor në Maqedoni, u morr një vendim dhe më da-

tën **20.11.1986** u mbajt një solemnitë për shënimin e këtij përvjetori. Ky solemnitë ishte edhe promovimi i parë i madh publik i Lidhjes së pensionistëve të Maqedonisë. Në seancën përkatëse u dorëzua një referat me programin e deklaruar të veprimit në shoqëri nëpërmjet Lidhjes së sindikatave dhe nëpërmjet aktiviteteve individuale. Në seancën solemne morën pjesë anëtarët e Këshillit republikan, nga 2 anëtarë të organizatave komunale, 5 anëtarë të organizatave të Qytetit të Shkupit dhe shumë të ftuar të tjerë. Fjalime rasti mbajtën Kryetari i atëhershëm i Lidhjes së sindikatave të Maqedonisë, z. Tome Georgievski dhe Kryetari i Lidhjes së pensionistëve të Jugosllavisë. Referatin me titullin "Jeta dhe puna 40-vjeçe e pensionistëve të Maqedonisë" e dorëzoi Kryetari i Këshillit republikan të Lidhjes së pensionistëve të Maqedonisë, z. Vite Isjanovski.



Në fund të ditës së punës, në mënyrë unanime u miratua programi i ri i punës, me të cilin në veçanti u definuan elementet më poshtë:

Çdo vit, më datë 20 shtator, të shënohet përvjetori i formimit të Lidhjes së pensionistëve të Maqedonisë, me takime solemne, referate, aktivitete të ndryshme kulturore dhe sportive etj.;

Në çdo 10 vjet të shënohet funksionimi dhe puna e Lidhjes së pensionistëve të Maqedonisë;

Me rastin e 40-vjetorit të organizimit të pensionistëve në Lidhjen e pensionistëve të Maqedonisë, me një solemnitë të ndahen një numër i madh mirënjohjesh.

Më **20 shtator 1996**, me rastin e 50-vjetorit të organizimit të pensionistëve të Maqedonisë, në

Shtëpinë e ARM në Shkup u mbajt një manifestim solemn. Në seancën solemne morën pjesë anë-



tarët e Këshillit republikan dhe nga 5 anëtarë të çdo organizate komunale të pensionistëve. Në këtë solemnitë mori pjesë edhe Kryetari i Republikës, z. Kiro Gligorov me bashkëshorten e tij, Kryetari i Kuvendit të RM, z. Tito Petkovski, me një grup deputetësh, Kryeministri i RM, z. Branko Crvenkovski me shumë ministra të Kabinetit të tij dhe të ftuar të tjerë.

Referatin e rastit me titullin "Jeta dhe puna 50-vjeçe e pensionistëve të Maqedonisë" e dorëzoi Kryetari i Lidhjes së pensionistëve të Maqedonisë, Mr. Vite Isjanovski. Opinioni i Republikës së Maqedonisë pati rastin të dëgjojë hapur rezultatet e Lidhjes së pensionistëve të Maqedonisë, të arritura me punën 50-vjeçare. Manifestimi përkatës ishte një lloj dialogu publik lidhur me çështjet e hapura që i prekin pensionistët si pjesë integrale e popullatës në Maqedoni. Me këtë rast shtypi ditore dhe televizionet botuan dhe transmetuan kronika lidhur me manifestimin në fjalë. Pensionistët këtë përvjetor e shënuan edhe me një sërë aktiviteteve të tjera. Programet e punës kishin ambicie të reja, përmbajtje të reja për angazhim më të madh dhe për realizimin e qëllimeve evropiane të organizimit të pensionistëve, që të mundësohet një jetesë sipas standardeve të tyre dhe të plotësohet koha e pensionistëve me aktivitete të shumta dhe të menduara mirë. Pensionistët me manifestimin përkatës

dërguan një mesazh të përgjithshëm me masë realiteti dhe respekt të përbashkët, të gatshëm për të mbajtur përgjegjësinë e nevojshme për një standard jete më të mirë dhe jetë më të lumtur. Për përmbledhjen e rezultateve të seancës solemne u botua publikimi me titullin "50 vitet e Lidhjes së pensionistëve të Maqedonisë 1946 - 1996", i cili u përkthye edhe në gjuhën angleze për prezantimin e funksionimit dhe punës së Lidhjes së pensionistëve të Maqedonisë, në vendet fqinje, në vendet anëtare të Bashkimit Evropian dhe më gjerë.

Në zgjedhjet e mbajtura më **12 dhjetor 2002**, në detyrën e Kryetarit të LSHPM u zgjodh z. Dushko Shurbanovski, në detyrën e Nënkrjetarit të Këshillit ekzekutiv u zgjodh z. Andon Markovski dhe në detyrën e Sekretarit të Këshillit ekzekutiv u zgjodh z. Çedo Georgievski.

Në Seancën e tretë të Kuvendit të LSHPM, më **29 prill 2003**, u miratua protokoli i bashkëpunimit me Fondin e SPIM lidhur me servisimin e mjeteve të anëtarësimit në shumë prej 20,00 denarë dhe për Fondin e solidaritetit shumë për varrim prej 120 denarë.

Në vitin **2006** për arsye objektive dhe subjektive, në një mënyrë modeste u shënua 60-vjetori i organizimit të pensionistëve në Maqedoni.

Në seancën zgjedhore të Kuvendit të LSHPM më **20 dhjetor 2006**, z. Dushko Shurbanovski përsëri u zgjodh në detyrën e Kryetarit, z. Andon Markovski i zgjodh në detyrën e Nënkrjetarit të Këshillit ekzekutiv dhe z. Çedo Georgievski në detyrën e Sekretarit të Këshillit ekzekutiv.

Pas dy vitesh z. Andon Markovski dhe dorëheqje për arsye personale, ndërsa në detyrën e Nënkrjetarit të Këshillit ekzekutiv u zgjodh z. Çedo Georgievski.

Në seancën e pestë të Kuvendit të LSHPM, më **16 mars 2009**, në detyrën e sekretarit të ri të Këshillit ekzekutiv u zgjodh z. Dragi Argirovski.

Në zgjedhjet e rregullta, në Seancën e Kuvendit që u mbajt më **31 mars 2011**, në detyrën e Kryetarit të ri të LSHPM u zgjodh z. Dragi Argirovski, në detyrën e Nënkrjetarit të Kuvendit u zgjodh z. Besnik Pocesta, në detyrën e Nënkrjetarit të Këshillit ekzekutiv u zgjodh z. Metodija Toshevski dhe në detyrën e Sekretarit të Këshillit ekzekutiv u zgjodh znj. Stanka Trajkova.



Pas një mandati të suksesshëm katërvjeçar, Kuvendi i LSHPM në seancën e mbajtur më 24 mars 2015 në detyrën e Kryetarit rizgjodhi z. Dragi Argirovski, në detyrën e Kryetarit të Kuvendit rizgjodhi z. Besnik Pocesta, në detyrën e Nënkrjetarit të Këshillit ekzekutiv rizgjodhi z. Metodija Toshevski dhe në detyrën e Sekretarit të Këshillit ekzekutiv rizgjodhi znj. Stanka Trajkova. Në dhjetor të të njëjtit vit Këshilli ekzekutiv në detyrën e Nënkrjetarit zgjidhi z. Saltir Karovski, në vend të z. Metodija Toshevski.



Më **20 shtator 2011** me një solemnitete u shënua jubileu 65-vjeçar i organizimit të pensionistëve në Maqedoni, bashkë me 20-vjetorin e shpalljes së pavarësisë së Republikës së Maqedonisë. Me këtë rast dhe nën patronazhin e Kryetarit të shtetit, Dr. Gjorge Ivanov, në Shtëpinë e ARM në Shkup u mbajt një Akademi solemne. Pensionistëve të pranishëm dhe të ftuarve vendas dhe të huaj iu drejtua

an dhe i përshëndetën Kryetari i Republikës së Maqedonisë, Dr. Gjorge Ivanov dhe Ministri i punës dhe politikës sociale, z. Spiro Ristovski. Kryetari i LSHPM, z. Dragi Argirovski, para leximit të referatit solemn i përshëndeti të pranishmit, midis të cilëve u gjetën edhe të ftuar të huaj, me të cilët LSHPM ka bashkëpunim të mirë: Vladimir Nozhariq, zëvendëskryetar i Lidhjes së pensionistëve të Kroacisë, Rajko Jariq, sekretari i Lidhjes së pensionistëve të Serbisë, Andrej Jus, Drejtori i Institutit evropian "Hevrekka" nga Lubjana dhe Marjan Shiftar, përfaqësues i Festivalit të moshës së tretë me seli në Lubjanë, ambasadori shumëvjeçar i Republikës së Sllovenisë në vendin tonë dhe të ftuarit e shumë institucioneve që kanë lidhje me këtë grup-moshë, siç janë FSPIM, FSSHM, kryetarët e komunave e të tjerë. Të ftuarve të huaj dhe doajenëve të organizimit të pensionistëve të Maqedonisë, z. Dushko Shurbanovski, z. Andon Markovski dhe z. Besnik Pocesta, me një solemnitet iu ndanë mirënjohje përkatëse.

Më **1 nëntor 2011** për herë të parë jashtë Shkupit, në Krushevën legjendare, u mbajtën tre takime konstruktive të Kuvendit të LSHPM dhe

punën e organeve të caktuara shtetërore, në këshillat dhe komisionet përkatëse. Me sukses janë menaxhuar më shumë aktivitete që lehtësojnë plakjen, relaksojnë, pasurojnë shpirtërisht, ruajnë dhe forcojnë shëndetin, që para së gjithash janë në formë sportive, rekreative, kulturore dhe argëtuese. LSHPM bën përpjekje për të siguruar inkluzion maksimal dhe përfshirje të anëtarësisë në aktivitetet e ndryshme. Gjatë kësaj periudhe organizimi i pensionistëve regjistron zhvillim. Në LSHPM u përgatit Ligji i organizimit të pensionistëve sepse organizimi i pensionistëve ka shumë specifika sepse në të marrin pjesë 53 shoqata me 252.000 pensionistë anëtarë.

Zhvillim të madh dhe riafirmacion ka pësuar edhe zhvillimi i aktiviteteve sociale-humanitare dhe në këtë kontekst viti 2012 u shpall "**Viti i solidaritetit**" që dha rezultate. Ndërkaq, pas shumë vitesh funksionimi në kushte organizimi më të ndryshme të shoqatave, në vitin 2014 u miratua edhe Rregullorja e kriterëve të vetme të punës materialo-financiare të shoqatave të pensionistëve dhe LSHPM, me të cilën për të gjitha shoqatat janë paraparë kriterë të vetme me limite për përdorimin e mjeteve



Këshillit ekzekutiv, Kryetarëve të shoqatave dhe aktiveve të pensionistëve, në të cilat u vlerësuan pozitivisht aktivitetet e deritanishme dhe u dhanë drejtime për dinamikën e re të funksionimit të përgjithshëm.

Ky vit, në historinë e LSHPM dhe shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë do të regjistrohet si një vit shumë i rëndësishëm dhe i frytshëm, Megjithatë, akoma nuk janë shterur të gjitha instrumentet e ndikimit dhe veprimit nëpërmjet Kryesisë së LSHPM, e cila jep iniciativa, sugjerime dhe propozime për rregullativën ligjore në interes të pensionistëve dhe është e gatshme të marr pjesë në

që mblidhen në formën e shumës së anëtarësimi. Në drejtim të zhvillimit të komponentës sociale u miratua edhe projekti i Kartës sociale të pensionistëve, që u realizua në SHP "Gjorçe Petrov", ndërsa në vazhdim e sipër është implementimi i këtij dokumenti social në një nga shoqatat më të mëdha në Shkup, SHP Kisella Voda.

Një nga aktivitetet me shumë rëndësi të kësaj periudhe ishte edhe **Projekti i rregullimit të dokumentacionit të arkivit të LSHPM** për një periudhë më të gjatë. Vlen të theksohet edhe miratimi i **Rregullores së arbitrazhit**, që ka për qëllim në mënyrë paqësore dhe me ndihmën e Komisionit të

arbitrazhit të zgjidhen kontestet midis shoqatave, me qëllim që të pengohet shpenzimi i pabazë i mjeteve të pensionistëve, të siguruara me pagesat e anëtarësimit. Këshilli ekzekutiv përgatiti edhe Listën e arbitrave të cilët për kontestet konkrete mund të zgjidhen nga ana e shoqatave të pensionistëve.

LSHPM në vazhdimësi modernizon punën e saj dhe në këtë mënyrë u ndihmon shoqatave të pensionistëve si anëtare të saj. Më konkretisht, për përdorimin e të dhënave personale për nevojat e pensionistëve është përgatitur **Rregullorja e masave teknike dhe organizative të mbrojtjes së të dhënave personale në nivelin elementar**, kompatibel për LSHPM dhe shoqatat që kanë për detyrë të zbatojnë Rregulloren.

Me kërkesë të kryetarëve të shoqatave LSHPM përgatiti edhe Projektin - Puna vullnetare në kushtet moderne të funksionimit të shoqatave të pensionistëve. Projekti promovon zhvillimin e aktiviteteve vullnetare, në formën e ndihmës së pensionistëve gjatë furnizimit të produkteve, pagimit të faturave, vizitës së institucioneve shëndetësore, me mundësi që vetë shoqatat të zhvillojnë, plotësojnë dhe implementojnë projektin sipas mundësive të tyre materiale.

Më **16 shtator 2016** jubileu 70-vjeçar i organizimit të pensionistëve në Maqedoni u shënua me një Akademi solemne, në sallën e plotë të Shtëpisë



së ARM. Me këtë rast, Kryetari i Republikës së Maqedonisë, Dr. Gjorge Ivanov, LSHPM-së në mënyrë solemne i ndau mirënjohjen shtetërore "Karta e Republikës së Maqedonisë". Para pensionistëve dhe shumë të ftuarve në akademinë solemne mbajtën fjalime Kryetari i Republikës së Maqedonisë, Dr. Gjorge Ivanov dhe Kryetari i LSHPM, z. Dragi Argirovski. Aktivitete solemne u zhvilluan edhe gjatë gjithë vitit 2016, në LSHPM dhe në të gjitha shoqatat anëtare të Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë.

PASQYRË

Numri i pensionistë sipas shoqatave në muajin dhjetor të vitit 2016

SHP Berovë	2.257
SHP Manastir	17.714
SHP Bogdancë	1.464
SHP Vallandovë	1.839
SHP Vevčanë	403
SHP Veles	8.880
SHP Vinicë	2.611
SHP Gjevgjeli	3.885
SHP Gostivar	6.581
SHP Dibër dhe Qendër Zhupë	2.111
SHP Dellçevë	3.175
SHP Demir Kapi	711
SHP Demir Hisar	1.590
SHP Dojran	590
SHP - Ilinden Shkup	2.016
SHP Kavadar	5.860
SHP Krçovë	4.479
SHP Koçanë	6.457
SHP Kratovë	1.825
SHP Kriva Pallankë	3.099
SHP Krushevë	1.605
SHP Kumanovë	13.895
SHP Llozovë	435
SHP Makedonski Brod	1.297
SHP Makedonska Kamenica	1.290
SHP Negotinë	3.059
SHP Novo Sellë	1.386
SHP Ohri dhe Debërca	9.763
SHP Pehçevë	1.009
SHP Prilep	13.581
SHP Probishtip	1.951
SHP Zletovë	454
SHP Radovish dhe Konçe	3.922
SHP Resnjë	2.809
SHP Shën Nikollë	2.880
SHP Strugë	4.109
SHP Labunishtë	665
SHP Strumicë	10.349
SHP Tetovë	12.262
SHP Shtip dhe Karbincë	8.432
SHP Solidariteti - Aerodrom-Shkup	11.515
SHP Butell - Shkup	5.533
SHP Gazi Babë - Shkup	11.956
SHP Gjorçe Petrov - Shkup	6.516
SHP Karposh - Shkup	5.160
SHP Taftalixhe - Shkup	6.704
SHP Kisella Voda - Shkup	12.954
SHP Saraj - Shkup	1.901
SHP Qendër - Shkup	9.785
SHP Çair - Shkup	7.845
SHP Shuto Orizari - Shkup	1.318
Shoqata e pensionistëve të luftës - Shkup	1.281
SHP OPB të RM	1.633
TOTALI	256.801

6. BASHKËPUNIM ME ORGANET DHE INSTITUCIONET SHTETËRORE NË INTERES TË PENSIONISTËVE

Për organizatën e pensionistëve në Maqedoni, nga formimi deri në ditën e sotme, është i rëndësishëm bashkëpunimi me organet dhe institucionet shtetërore me përkushtimin për zgjidhjen e problemeve dhe për standard më të mirë të pensionistëve. Me pavarësinë e Republikës së Maqedonisë LSHPM (Lidhja e shoqatave të pensionistëve në Maqedoni) ka bashkëpunuar me të gjitha qeveritë në vendin tonë me këmbëngulje që pensionet të shpërndahen rregullisht, të harmonizohen dhe rriten, por edhe të krijohen kushte të reja për një jetë sa më të denjë të kësaj popullate të shumtë.

● Në **tetor të vitit 1996** Presidenti i Republikës së Maqedonisë Kiro Gligorov e priti delegacionin e LPM (Lidhja e pensionistëve në Maqedoni), i



kryesuar nga presidenti Vite Isjanovski, ku u bë fjalë për shumë pyetje aktuale nga jetesa e pensionistëve në shtetin tonë dhe në veçanti për zvogëlimin e pensioneve në vitin 1993 për 8 për qind. Delegacioni ishte pritur dhe nga kryeministri Branko Crvenkovski dhe nga kryetari i parlamentit maqedonas Tito Petkovski.

● Në **28 janar të vitit 2005** kryetari i Qeverisë të Republikës së Maqedonisë Vllado Buckovski priti një delegacion të LSHPM të kryesuar nga presidenti Dushko Shurbanovski. Takimi ishte iniciuar me qëllim kryeministri të njihet me pozitën e pensionistëve maqedonas dhe me problemet që hasen ata. Në mënyrë të veçantë ishte theksuar nevoja të vazhdohet me pagesën e diferencës nga 8 për qind që në vitin 1999, me vendim të veçantë ishte futur në bazat e përdoruesve të pensioneve të cilët këtë të drejtë e kanë përfutur përpara vitit 1993 dhe duke u bazuar në këtë në vitin 2000 filloi pagesa. Në këtë takim me kryeministrin u pajtuan të respek-

tohet marrëveshja e LSHPM dhe Fondit të SPIM (sigurimi pensional dhe ivalidor i Maqedonisë) për pagesën e pensioneve dhe fondit të solidaritetit.

● Në **10 qershor të vitit 2006** kryetari i atëherëshëm i qeverisë Vllado Buçkovski dhe kryetari i LSHPM Dushko Shurbanovski nënshkruan Memorandum për mirëkuptim për përmirësimin e kushteve dhe standardin e pensionistëve.

Dhe në shkurt në të njëjtin vit delegacioni i LSHPM u prit nga presidenti i Parlamentit të RM Ljupco Jordanovski, ku kryetari Shurbanovski informoi për iniciativën për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sigurimin pensional dhe ivalidor.

● Në **15 shkurt të vitit 2007** kryetari i ri i qeverisë të Republikës së Maqedonisë Nikolla Grueski e priti delegacionin e LSHPM, në krye me kryetarin Dushko Shurbanovski, ku u fol për rritjen e pensioneve dhe për ndryshimin e harmonizimit i cili ishte 40 për qind nga rritja e shpenzimeve të jetesës dhe 20 për qind nga rritja e pagave. Për këtë problematikë u fol dhe në 2 prill të vitit 2007 kur delegacioni i LSHPM u prit nga kryetari i parlamentit të RM Ljupço Georgievski.

● Në **9 maj të vitit 2008** LSHPM nënshkroi Memorandum për bashkëpunim me BNJVL (Bashkësia e njërive të vetëqeverisjes lokale) me të cilin filloi dhe bashkëpunimi më intensiv midis shoqatave të pensionistëve dhe qeverive lokale për hapjen e klubeve për pensionistë dhe aktivitete të tjera të përbashkëta. Falë gjithë kësaj sot në Maqedoni ka mbi 350 klube për pensionistë.

● Në **20 mars të vitit 2009** Presidenti i Republikës së Maqedonisë Branko Crvenskovski në Demir Hisar kishte takim me kryetarin e LSHPM Dushko Shurbanovski dhe me sekretarin e ri të LSHPM Dragi Argirovski, në të cilin pjesëmarrje morën dhe pensionistët nga rajoni jugperëndimor, ku presidenti Crvenkovski theksoi që në veçanti e gëzon ajo që pensionistët në vendin tonë janë aktivë dhe angazhohen për të drejtat e tyre, duke bërë presion për rritjen e pensioneve dhe tejkalimin e varfërisë dhe për kujdes shëndetësor më të mirë dhe paralelisht me këtë janë dhe organizatorë të aktiviteteve kulturore dhe sportive dhe të shoqërimeve dhe takimeve të paharrueshme. Problemet e jetës së pensionistëve duhet të zgjidhen sepse Republika e Maqedonisë dhe sipas kushtetutës është shtet

social dhe ajo duhet të kujdeset njëloj për të gjitha strukturat e qytetarëve dhe në veçanti për ata që të gjithë jetën e tyre kanë kontribuar në ndërtimin e vendit tonë, siç janë anëtarët e LSHPM.

● Në 26 gusht të vitit 2012 kryetari i qeverisë së RM Nikolla Gruevski, i shoqëruar nga ministri për punë sociale dhe politikë Spiro Ristovski dhe ministri i shëndetësisë Nikolla Todorov realizuan takim pune në ambientet e LSHPM, me udhëheqjen e Lidhjes, në krye me kryetarin Dragi Argirovski. Kjo ndodh për herë të



parë në historinë shumëvjeçare të LSHPM që t'i vizitojë një kryeministër, ku ishte informuar për arritjet, problemet dhe planifikimin e aktiviteteve të organizatës më masive, apolitike, multietnike. Kryeministri Nikolla Gruevski në veçanti ishte i kënaqur nga atë që pensionistët bëjnë për veten dhe plakjen aktive të tyre. Ishte propozuar të gjithë pensionistët me të ardhura deri në pension mesatar të përfitojnë kujdes shëndetësor falas.

● Në 26 shtator të vitit 2012 kryeministri Nikolla Gruevski priti delegacion të LSHPM i cili kësaj radhe ishte i kryesuar nga kryetari Dragi Argirovski. Në seancë ishin të pranishëm zëvendëskryeministri dhe ministri i financave Zoran Stavreski dhe ministri për punë sociale dhe politikë Spiro Ristovski. Në takim kryeministri Nikolla Gruevski deklaroi që 270.000 pensionistë me pensionin e marsit, në vitin 2013, do të përfitojnë dhe rritje për 7 për qind ose 5 për qind rritje nga buxheti dhe 2 për qind harmonizim.

- Nga ky vendim i qeverisë ne jemi të kënaqur dhe këtë do ta përshëndesin të gjithë pensionistët sepse dihet se si është kriza ekonomike në Evropë,

pë, për këtë indeksimi në shumë shtete është ndërprerë dhe në disa vende pensionet ulen, kurse ne rregullisht i marrim në javën e parë të muajit, theksoi kryetari Argirovski dhe shtoi që në këtë mënyrë deri diku zbutet varfëria që sjell çdo krizë në ekonomi.

● Për të theksuar është që në vitin 2012 për arritjet në LSHPM Redaksia dhe lexuesit e gazetës "Nova Makedonija" kryetarin e LSHPM Dragi Argirovski e shpallën për personalitet të vitit.



● Në vitin 2013 ai fitoi dhe çmimin më të lartë të shtetit "11 Tetori" (11 tetor) për vepër të jetës në fushën e gazetarisë dhe publicistikës.



● Në 6 mars të viti 2013 dhe në 4 tetor të vitit 2015 zëvendëskryeministri Zoran Stavrevski

dhe ministri për punë dhe politikë sociale Dime Spasov e vizituan LSHPM ku me udhëheqjen këmbëmbas mendime për rritjen e pensioneve, për projektin rekreacion në llixa falas për përdoruesit e pensionit, për inkurajimin e ndërtimit të shtëpive për pensionistë dhe pleq, si dhe për projektet për fundjavë turistike falas, si dhe transport hekurudhor falas.

● Në 25 tetor të vitit 2016 kryetari i qeverisë të RM Emil Dimitriev priti një delegacion të LSHPM që kryesohej nga kryetari Dragi Argirovski. Arsyeja për këtë takim ishte dorëzimi i Pllaketës nga LSHPM për qeverinë e Republikës së Maqedonisë me rastin e përvjetorit të madh, 70 vjet organizim të pensionistëve. Kryeministri Emil Dimitriev theksoni

që e gëzojnë sukseset dhe rezultatet e arritura dhe që nga pensionistët duhet të mësojnë dhe gjeneratat e reja, në veçanti në fushën e bashkëjetesës dhe tolerancës multietnike.

● Me rastin e përvjetorit kryetari i Parlamentit të RM Trajko Veljanovski priti një delegacion të LSHPM, ndërsa kryetari Dragi Argirovski në mënyrë formale ja dorëzoi Pllaketën e LSHPM për kontribut të Parlamentit maqedonas në zhvillimin e organizimit të pensionistëve në Maqedoni. Duke u falënderuar për mirënjohjen, Veljanovski e theksoi rëndësinë e punës së LSHPM si organizata joqeveritare multietnike me masive dhe aktive dhe i uroi suksese dhe arritje të reja të gjithë pensionistëve në vendin tonë.

7. BASHKËPUNIM I LSHPM ME FONDIN PËR SIGURIM PENSIONAL DHE INVALIDOR TË MAQEDONISË

Në aspektin historik, Lidhja gjithmonë ka bashkëpunuar me fondin për sigurim pensional dhe invalidor të Maqedonisë. Në fillimet e largëta të organizimit të pensionistëve Fondi kishte në dispozicion më shumë mjete financiare në llogarinë e tij. Ajo në të kaluarën veçonte mjete financiare të cilat shkonin në Fond për ndërtesa banimi (shtëpi për pensionistë, shtëpi pushimi, klube). Në organet më të larta të fondit gjithmonë shtriheshin edhe temat të lidhura me pensionistët. Rishikoheshin propozime të projekteve ligjore, pyetje për harmonizimin e pensioneve, statusi material i pensionistëve me pensione të ulëta, ku kërkohej dhe miratim nga shoqata e pensionistëve. Në seancat e organeve të Fondit të atëhershëm rregullisht kishte përfaqësues të Lidhjes. Kur ishte e nevojshme në seancat e bordit Republikan të Lidhjes ishin prezent ekspertët më të lartë nga Fondi për të dhënë përgjigje profesionale për të gjitha pyetjet që i bënin pensionistët. Fondi Lidhjen tonë e ndihmonte dhe me përkrahje administrative në kryerjen e aktivitetit të tij si forma më e lartë e shoqatës qytetare. Për të theksuar është dhe që në bordin udhëheqës të organeve të mëparshme të Fondit kishte anëtarë pensionistë dhe patjetër anëtarë të

Lidhjes. Gjithashtu vihet re fakti që kryetarë të Komisionit për vendimmarrje në shkallë të dytë për çështjet nga sigurimi pensional dhe invalidor ishin përfaqësues të Lidhjes (Andon Markovski, Lazar Labachevski), të cilët me profesionalizëm dhe në kohë e kryenin punën e tyre me qëllim pensionistët sa më shpejt të marrin vendim për ankesën e aplikuar. Në një periudhë ai bashkëpunim ishte ngrirë që përsëri të kuptohet që është i pakalueshëm dhe i nevojshëm. Në vitet e fundit bashkëpunimi midis Fondit dhe Lidhjes mund të themi që është



në nivel për të pasur zili. Domethënë, në vitin 2013, për anëtar të bordit drejtues ishte zgjedhur kryetari i LSHPM Dragi Argirovski, me të cilën pasurohet angazhimi në të gjitha segmentet dhe pyetjet për pensionistët, kurse bashkëpunimi më i madh realizohet në pjesën e fondit të solidaritetit dhe anëtarësimit. Në të njëjtin vit FSPIM miratoi dhe Protokoll për bashkëpunim me LSHPM për servisimin e mjeteve financiare për anëtarësim dhe fondit të solidaritetit. Për kënaqësi të përgjithshme të gjitha

pyetjet nga fondi i solidaritetit zgjidhen së bashku. Gjithashtu, në këtë periudhë janë realizuar disa takime me kryesinë LSHPM dhe Fondi i SPIM në lidhje me këmbimin e të dhënave, mbështetje dhe zbatimin e projekteve me interes për pensionistët (pagesa në kohë e pensioneve, përputhja e pensioneve, rekreacioni klimatik-Ilxha, informimi i pensionistëve etj). Në rishikimin që e përgatiti FSPIM për lëvizjen e pensionit mesatar dhe harmonizim në 20 vitet e kaluara është e dukshme rritja.

PENSIONET MESATARE GJATË PERIUDHËS SË VITEVE 1997-2016

Totali i pensionit mesatar sipas vitit			Grupi i tretë i pensioneve me të ulëta (nga viti 1997)	Shuma më e lartë e pensioneve	Gjithsej harmonizimi
Viti	Pensioni mesatar (Në denarë)	komenti			
1997	5.778		3.238	20.570	1,10%
1998	5.760	nuk ka harmonizim	3.238	20.570	nuk ka harmonizim
1999	6.251		3.301	20.969	1,94%
2000	6.431		3.362	21.362	1,88%
2001	6.535		3.422	23.632	1,79%
2002	6.955		3.647	25.026	6,57%
2003	7.346		3.856	26.460	5,73%
2004	7.428		3.903	26.780	1,21%
2005	7.463		3.919	26.887	0,40%
2006	7.684	gjithsej pensioni mesatar nga pensioni familjar, invalidor dhe i pleqërisë	4.024	27.605	2,67%
2007	7.848	- // -	4.092	28.071	1,69%
2008	9.541	- // -	5.262	32.075	21,66%
2009	10.057	- // -	5.556	33.868	5,59%
2010	10.273	- // -	5.634	34.343	1,40%
2011	10.628	- // -	5.796	35.328	2,87%
2012	11.038	gjithsej pensioni mesatar nga pensioni familjar, invalidor, i moshës, bujqësor dhe i luftës	5.895	35.933	1,71%
2013	11.845	- // -	6.562	37.173	+ 5% harm. plotësues Gjithsej 7%
2014	12.487	- // -	7.162	37.773	fiks 600 Den.
2015	13.095	- // -	7.783	38.394	fiks 621 den.
2016	13.754	- // -	8.437	47.128	fiks 654 den.

Për të siguruarit të cilët nuk u kaluan në financimin kapital të detyruar të sigurimit pensional pensioni më i lartë nuk mund të jetë më shumë se 80% deri në vitin 2015, jo më shumë se përqindjet e konstatuara me nenin 52, paragrafi (1) nga ky Ligj, nga paga mesatare neto e paguar në vend në vitin e paraprak, e rritur për 2,7 herë.

Në bazë të nenit 230 nga LSPI (Ligji për sigurim pensional dhe invaliditetit), FZ (Fletorja zyrtare) nr.98/2012 nga 01.08.2012, pensioni më i lartë në vitin 2016 është 47.128 denarë ose paga minimale e realizuar në vitin 2015 është 21.906 denarë, e shumëzuar me 2,7 herë, e shumëzuar me 79.68 shkalla e këmbimit dhe është fituar pensioni më i lartë për përfituesit të cilët e realizuan të drejtën në vitin 2016. Numri i përfituesve të pensionit për këtë shumë pensioni për dhjetorin e 2016 është 43 përfitues.

Situata e përfituesve të pensionit sipas llojit, sipas të drejtës të arritur dhe pensionit mesatar për dhjetorin e viti 2016

Dhjetor vit. 2016	Përfitues sipas drejtës së punës	Përfitues sipas të drejtës ushtarake	Përfitues sipas të drejtës bujqësore	Nr.i përgjithshëm i përfituesve
Lloji i pensionit				
Pension familjar	76.790	850	258	77.898
Pension invaliditeti	38.343	190	0	38.533
Pension i pleqërisë	190.633	447	99	191.179
Gjithsej:	305.766	1.487	357	307.610

Lloji i pensionit	Pension mesatar
Pension Familjar	11.052,00
Pension invaliditeti	12.449,00
Pension mplakje	15.062,00
Pension bujqësor	6.849,00
Pension ushtarak	20.851,00
Gjithsej:	13.754,00

Mesatarja e përgjithshme e pensioneve të paguara për muajin dhjetor të vitit 2016 13.754,00



Grafiku 1. Struktura e pensionistëve sipas vlerës të pensionit për dhjetorin e vitit 2016



Rekreacionin klimatik falas - në llixha për shtatë vjet, që nga viti 2010 deri në 2016, e shfrytëzuan gjithsej 37.020 përfitues të pensioneve dhe për dy vjet në fundjavë falas pushuan 4.740 pensionistë.

I pranishëm është dhe bashkëpunimi për përmirësimin e kushteve në shtëpitë e pensionistëve, me të cilat menaxhon FSPIM dhe më të cilën vër-

tetohet që kujdesi i Fondit për realizimin e të drejtave të përfituesve të pensioneve nuk përfundon. Në Republikën e Maqedonisë gjithsej ka 37 shtëpi për pensionistë nga të cilat FSPIM menaxhon me 13 dhe 24 të tjerat janë të shoqatave të pensionistëve. Fondi disponon me rreth 340 apartamente në 11 qytete. Për përmirësimin e kushteve për akomodim kohët e fundit u bë sanimi i shtëpive për pensionistë në Shkup, Aerodrom, Avtokomandë, Gjorce Petrov dhe Çair, si dhe në disa shtëpi për pensionist me kapacitet më të vogël, në qytete të tjera në vendin tonë. Gjithsesi LSHPM për shkak të mungesës së shtretërve për akomodimin në këto shtëpi, për një kohë të gjatë insiston që ky problem të zgjidhet me ndërtimin e shtëpive shtetërore të



reja për pensionistë në Shkup, Koçani, Shtip, Ohër, Tetovë, Kavadar dhe në qytete të tjera. Gëzon fakti që në kornizën e strategjisë kombëtare për persona të moshuar për vitet 2010 - 2020 përgatitet projekti i ardhshëm për ndërtim në tre faza të shtëpisë së re shtetërore në Shkup, me 510 shtretër për pensionistë dhe persona të moshuar me të ardhura më të vogla.

Në Koçani është përgatitur projekti i ardhshëm për shtëpi pensionistësh bashkëkohore, kurse në Shtip është duke u ndërtuar.

Për të theksuar është që vitin e kaluar FSPIM bashkë me LSHPM nënshkruan marrëveshje për bashkëpunim me kompaninë e sigurimit Sava, për përfitime nga siguri i pensionistëve dhe familjet e tyre.

Me rastin e 70 vjet organizim të pensionistëve, në 18 shkurt të vitit 2016, LSHPM për herë të parë në historinë shumëvjeçare, nëpërmjet FSPIM, e mori nga shteti dhuratën më të dëshiruar-zyra të reja .Gjithë kjo kontribuon për formimin e organizatës të pensionistëve moderne dhe evropiane në Republikën e Maqedonisë.

8. BASHKËPUNIM I LSHPM ME FONDIN PËR SIGURIMIN SHËNDETËSOR TË MAQEDONISË

Fondi i sigurimeve shëndetësore të Maqedonisë (FSSHM) është themeluar me ligjin për sigurimin shëndetësor, si institucion financiar i pavarur me të drejta dhe detyra për zbatimin e sigurimit shëndetësor të detyruar, nga viti 2000. Fondi kryen aktivitet publik. Me punën e fondit menaxhon bordi drejtues, në të cilin ka dhe përfaqësues të pensionistëve. FSSHM përpaket pensionistët në mënyrën më të mirë të realizojë të drejtën e mjekimit me siguri shëndetësor të detyrueshëm dhe për shërbim shëndetësor me cilësor. FSSHM mundëson shfrytëzimi efikas të mjeteve financiare dhe resurseve të disponueshme, stabilitet financiar dhe efikasitet. Së bashku me punonjësit e tjerë të sistemit shëndetësor kryhen në mënyrë masive skринing vizita preventive, kurse me organizatat joqeveritare organizohen fushata për promovimin e shëndetit nëpërmjet ndërgjegjësimit publik për zakonet e mira dhe tregohet për të dëmshmet.

Në FSSHM praktikohen takime vjetore të organeve udhëheqëse të FSSHM me përfaqësues nga LHPM ku bisedohet për përcaktimin e nevojave dhe kërkesave të pensionistëve si dhe për përmirësimin e shërbimeve që janë nën juridiksionin e FSSHM. Me interes të veçantë për pensionistët është furnizimi me medikamente, projekti "Kartë elektronike shëndetësore", punishtet edukative "Fondi më afër pensionistëve" dhe informimi i rregullt i pensionistëve për të gjitha risitë dhe përfitimet nga siguri shëndetësor. Risi specifike janë përfitimet nga ambulancat dhe farmacitë në vendet rurale dhe farmacitë e lëvizshme. Trendi i uljes së çmimeve të medikamenteve rezultoi me rritjen e numrit të medikamenteve të cilat sigurohen për personat e siguruar. Ekziston tendenca që edhe



më tej të rritet numri i mjekimeve që janë pa pagesë shtesë. Është rregulluar për sëmundjet kronike të jepen receta për gjashtë muaj dhe përfitime të tjera.

Në shenjë mirënjohje për kontributin e madh në fushën e sigurimit të shërbimeve shëndetësore



për pensionistët dhe me rastin e festimit të 70-vjetorit të organizimit të pensionistëve në Maqedoni, në 16.9.2016, Fondit të sigurimit shëndetësor i është dorëzuar Plaketë nga LSHPM.

9. BASHKËPUNIMI I LSHPM ME LIDHJAN E SINDIKATEVE TË MAQEDONISË, LIDHJEN E VETERANËVE DHE KRYQIN E KUQ TË MAQEDONISË

Shoqata e pensionistëve ka bashkëpunim të frytshëm disa dhjetëvjeçarë me Shoqatën e sindikatave dhe Shoqatën e veteranëve, si dhe me kryqin e Kuq të Maqedonisë. Që në fillimet e organizimit të pensionistëve në vendin tonë shoqatat e pensionistëve bëheshin si pjesë e sindikatave të vetme, kurse bashkëpunimi shumë vite realizohej për pyetje me interes të përbashkët.

Mbas shpalljes të pavarësisë së Republikës së Maqedonisë, Shoqata e pensionistëve filloi të veprojë në mënyrë më të pavarur, por mbeti shumë vite të përdorë zyrat me qira të LSM (Lidhja e sindikatave të Maqedonisë).

Kohëve të fundit bashkëpunimi u intensifikua pas nënshkrimit të memorandumit për bashkëpunim midis LSHPM dhe LSM. Ndërkaq, Kryetari i LSM Dr. Zhivko Mitrevski e theksoi nevojën për ba-

Lidhur me të sipërpërmendurën LSHPM ka nënshkruar një Memorandum bashkëpunimi me Lidhjen e veteranëve të Maqedonisë.

Edhe lëvizja e organizatës ndërkombëtare e Kryqit të Kuq në Maqedoni ka traditë të gjatë me aktivitete në favor të popullsisë dhe pensionistëve. Theksohet se vullnetarë të Kryqit të Kuq kanë qenë shumë qytetarë të moshave të ndryshme, duke përfshirë dhe një numër i madh pensionistësh, të cilët edhe sot e kësaj dite nuk heqin dorë nga pjesëmarrja vullnetare në aksionet e Kryqit të Kuq. Në periudhën pas luftës, kur kishte familje të ndara dhe një numër i madh invalidësh, shumë njerëz të varfër dhe të sëmurë të të gjithë grup-moshave, Kryqi i Kuq i Maqedonisë që nga formimi i tij në mars të vitit 1945 u përfshi në ofrimin e ndihmës së të gjithëve, deri tek të cilët mund të arrinin vullnetarët e tij. Janë realizuar shumë aktivitete dhe deri në ditët e sotme kanë ndihmuar mijëra persona në Maqedoni. Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë (KKRM) është organizatë vullnetare, masive, e pavarur, joqeveritare, jopartiake dhe organizatë e pavarur humanitare e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë. Si organizatë kryesuese humanitare KKRM kujdeset dhe për pleqtë e paaftë dhe të varfër. Kryqi i Kuq organizon vizita në shtëpitë kolektive dhe individuale të të moshuarve, manifestime publike për rritjen e ndërgjegjësimin për nevojat e të moshuarve dhe organizon aktivitete donacionesh për ndihmë materiale për çështjet sociale. Për pensionistët një numër i madh i vullnetarëve realizojnë vizita mjekësore, i vizitojnë dhe bisedojnë me to. Bëhet fjalë për një mbështetje psikologjike, u sjellin dhurata dhe u japin shërbime të tjera të nevojshme, bëjnë furnizim me medikamente, artikuj për bane-sat, realizojnë aksione për matjen e tensionit të gjakut, marrjen e gjakut për analiza laboratorike dhe realizojnë aktivitete të ngjashme. Me personat e moshuar dhe të paaftë vullnetarët e Kryqit të Kuq kontaktojnë rregullisht dhe i ndihmojnë të njëjtat. Në Shkup, nën kujdestarinë e Kryqit të Kuq, ekzistojnë qendra dhe klube për qëndrim ditor të personave të moshuar në Maxhari, Saraj dhe në Shtëpinë " .

Në vitin 1974, në kuadër të bashkëpunimit



shkëpunim të përbashkët më aktiv dhe shkëmbim të eksperiencës sepse pensionistët si veteranë të punës, janë pjesë e popullatës punëtore dhe kanë probleme të ngjashme me anëtarët e sindikatës. Përpjekjet e Sindikatës për zmadhimin e pagave dhe punësimit është në favor të pensionistëve, sepse në këtë mënyrë mundësohen burime të sigurta për pensionistët. Madje, veteranët e punës meritojnë të kenë kushte më të mira jetese.

Bashkëpunim të dukshëm pensionistët realizojnë me Lidhjen e veteranëve të Maqedonisë si domos për ruajtjen e traditës, duke vizituar së bashku vendet historike, festimin e ngjarjeve historike dhe të ngjashme. Në shumë shoqata të pensionistëve në mënyrë aktive punojnë seksione historike.



midis LPM dhe KKR, u caktua organizimi i "Javës së kujdesit për personat e moshuar", e cila zbatohet deri në ditët e sotme. Duhet theksuar se, javën në fjalë, e përbëjnë aktivitete që kanë të bëjnë me ofrimin e ndihmës për të moshuarit. Tradicionalisht në këtë javë kanë marrë pjesë organizatat e Kryqit të Kuq, kompanitë me përgjegjësi sociale, Institucionet qeveritare dhe shoqatat e pensionistëve.

Në programet e punës së LSHPM, nëpërmjet organeve dhe komisioneve të saj, si dhe në shoqatat e pensionistëve, vazhdimisht ka qenë e planifikuar dhe realisht është vendosur bashkëpunim me KKR. Në organet kryesuese të Kryqit të Kuq në të kaluarën janë përfshirë dhe përfaqësues të pensionistëve. Me qëllim të zyrtarizimit të bashkëpunimit midis LSHPM dhe Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë në vitin 2008 u nënshkrua një Memorandum. Me këtë memorandum rregulloheshin raportet dhe detyrimet e ndërsjella për një bashkëpunim të mëtijshëm me të suksesshëm. Implementimi i Memorandumit kontribuon për rritjen e kujdesit ndaj personave të moshuar.

Shoqatat e pensionistëve për një periudhë të gjatë kohore kanë bashkëpunim të shkëlqyer me organizatat komunale të Kryqit të Kuq. Disa shoqata të pensionistëve kanë klube të veçanta ose organizata themelore të pensionistëve, si një anëtar kolektiv të Kryqit të Kuq, në të cilën ata realizojnë aktivitete vullnetare pavarësisht nëse aktivitetet në fjalë kanë të bëjnë me pensionistët ose për grupe të tjera të popullsisë. LSHPM dhe shoqatat marrin pjesë me një ndihmë financiare modeste, por e mirëseardhur në aktivitetet e Kryqit të Kuq, të destinuara për sanimin e fatkeqësive ose katastrofave më të mëdha, siç janë tërmetet, vërshimet, rrëshqitjet e tokës dhe situata të tilla të ngjashme.

Shoqatat e pensionistëve në bashkëpunim me Kryqin e Kuq organizojnë ligjërata edukative nga fushat shëndetësore dhe sociale, aksione të përbashkëta për vizita mjekësore preventive dhe këshilla, matjen e tensionit të gjakut, sheqerit, kolesterolit në gjak etj.

Ka pensionistë të cilët edhe tani anëtarësohen në Kryqin e Kuq dhe përfshihen si vullnetarë në shumë aktivitete të tij. Humanizmi i njerëzimit është i rëndësishëm. Dhurimi i gjakut tënd, pjesë nga lëngu i shtrenjtë nënkupton të shpëtosh jetë. Dhuruesit e gjakut që kanë dhuruar gjak më së shumti mund të gjenden në radhët e pensionistëve. Ata kanë filluar që në rininë e tyre dhe nuk kanë ndalur. Të kujdesesh për atë ndjenjë është më shumë se humane, është e madhërishtme dhe meriton admirim të singertë. Ndonjëherë shembullin e dhurimit të gjakut e ndjekin edhe të afërmit dhe njerëzit përreth. Për këta njerëz human, në shenjë falënderimi, Kryqi i Kuq ka organizuar shpërblime jubilarë dhe takime për të shënuar ditën.

Me rastin e shënimit të 70-vjetorit të organizimit të pensionistëve në Maqedoni, delegacioni i LSHPM më datën 18.10.2016, vizituan Kryqin e Kuq e Republikës së Maqedonisë, të cilin e priti Sekretari i Përgjithshëm Sait Saiti. Në këtë takim Kry-



etari Dragi Argirovski në mënyrë ceremoniale ja dorëzoi Pllaketën e LSHPM me rastin e jubileut dhe shprehi një falënderim të madh për bashkëpunimin shumëvjeçar, për përkrahjen dhe ndihmën në interes të pensionistëve dhe qytetarëve të Maqedonisë. Sekretari i Përgjithshëm i Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë, Dr. Sait Saiti, i falënderoi për këtë gjest të bukur dhe shprehu urimet për jubileun e madh të LSHPM, për të gjitha aktivitetet e kaluara, por edhe për aktivitetet që do dalin nga bashkëpunimi i përbashkët në të ardhmen.

PJESA IV



BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR I LSHPM

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR I LSHPM

1. BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR I LSHPM GJATË PERIUDHËS SË VITEVE 1946-1989

Kryesia e pensionistëve të Maqedonisë, që në momentet e formimit të saj është interesuar për zhvillimet e ngjarjeve në shoqatat e pensionistëve në republikat e tjera të ish Jugosllavisë, si dhe në shtetet e tjera.

Që atëherë, ishte vendosur praktika që në organizimin e kuvendeve vjetore të lidhjeve republike të merrnin pjesë mysafirë të lidhjeve të shoqatave të tjera republikane. Sipas dokumentacionit, bashkëpunimi i parë zyrtar, bilateral, si dhe shkëmbimi i eksperiencave dhe konsultimeve filloi me takimin e caktuar tek pensionistët maqedonas nga ana e kryesisë së Lidhjes së pensionistëve të Republikës së Serbisë, në vitin 1967.

quajtur "bashkëpunim ndërkufitar" në të cilin u vëllazëruan disa shoqata komunale të të dy shteteve. Që atëherë pensionistët e të gjitha shoqatave filluan me organizimin e ekskursioneve në republikat fqinje, si dhe shtetet përreth. Si rezultat të bashkëpunimit të mirë, LP e RS të Serbisë, i ndanë certifikata mirënjohjeje në shenjë falënderimi Lidhjes së pensionistëve dhe invalidëve të pensionuar të punës të Republikës Socialiste



Më vonë janë vendosur lidhje më të forta dhe bashkëpunim midis Lidhjes së pensionistëve të Maqedonisë me Lidhjet e pensionistëve të Kroacisë, Sllovenisë, Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Malit të Zi.

Në 1971 zyrtarë të këtyre shoqatave të pensionistëve nga Serbia dhe Vojvodina qëndruan në Maqedoni dhe njëkohësisht kanë pasur takime intensive, bisedime dhe shkëmbim eksperiencash me pensionistët maqedonas. Vizitën ja kthyen në Beograd dhe Novi Sad krerët e Shoqatës së pensionistëve të Maqedonisë, në muajin tetor të të njëjtit vit. Ndërkohe nisi të zhvillohet edhe i ashtu-



të Maqedonisë, më datën 3 dhjetor të vitit 1973.

Ne mesin e vitit 1972 në Beograd ishte nënshkruar Akti i vëllazërimit midis Lidhjes të shoqatave të pensionistëve dhe invalidëve të pensionuar të punës e Maqedonisë dhe Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Serbisë.

Menjëherë pas binjakëzimit midis Lidhjeve të pensionistëve nga Maqedonia dhe Serbia vijuan binjakëzimet midis Shoqatave të pensionistëve nga të dy republikat, si në vazhdim: SHP Kisella Vodë me SHP Priepole, SHP Shtip me SHP Zemun, SHP Titov Veles me SHP Beogradi i Ri, SHP e OPR Shkup me SHP Lazarevac, SHP Prilep me SHP Kraguevac, SHP Kumanovë me SHP Vranje, SHP Idadija me SHP Novi Sad, SHP Kale me SHP Nishi dhe binjakëzime të tjera.

Në shenjë falënderimi SHP e RS të Serbisë, më datën 24 dhjetor 1980, Lidhjes të pensionistëve të RS të Maqedonisë i ndau certifikatë falënderimi dhe Monografi për periudhën e viteve 1946-1979.

Në festimin e organizuar me rastin e 35-vjetorin nga formimi i Lidhjes të shoqatave të pensionistëve të Sllovenisë, në shenjë falënderimi dhe mirënjohjeje për punën me sukses të deriatëhershme dhe bashkëpunimin në favor të pensionistëve, si dhe shoqatave të tyre, Lidhjes të pensionistëve të Maqedonisë, i është



ndarë një SIMBOL FLORIRI nga Lidhja e shoqatave të pensionistëve të Sllovenisë, në Lubjanë, në muajin dhjetor të vitit 1981.

Pasurimi i bashkëpunimit ndërkombëtar rriti reputacionin e Lidhjes të pensionistëve të Maqedonisë dhe mundësoi përfitime të dyanshme, zhvillim dhe forcim të aktiviteteve në favor të pensionistëve dhe organizatës. Në vitet shtatëdhjetë dhe tetëdhjetë të shekullit të 20-të ka qenë i intensifikuar bashkëpunimi me kryesinë e pensionistëve Sllovenë dhe Kroatë, një bashkëpunim ky që u bë tradicional dhe afatgjatë.



2. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR I LSHPM 1990 - 2016

Po Pas pavarësimit të shtetit bashkëpunimi ndërkombëtar me organizata homologe të pensionistëve nga vendet e rajonit, por edhe më gjerë në Evropë, filloi të zhvillohet në shkallë të lartë. Konform synimeve dhe detyrave të përcaktuara në Statusin dhe në programet e punës vijoi në kontinuitet bashkëpunimi bilateral me pensionistët e republikave ish jugosllave. Më parë, deri në vitin 1990, ata funksiononin sipas normativave ligjore të njëjta dhe në shumë situata të ngjashme, ndërkohe që periudha e adaptimit sipas kushteve të reja solli edhe përvoja të tjera dhe që këtë është i kuptueshëm edhe shkaku dhe interesi për shkëmbimin e tyre të ndërsjellë, por po ashtu u shqyrtuan edhe përvojat nga vendet e Bashkimit Evropian. Sipas të dhënave që i prezantoi kryetari i atëhershëm Vite Isjanovski, ishte vendosur bashkëpunimi me organizatat e pensionistëve të ish republikave jugosllave përveç se me BH, si edhe kishin bashkëpunuar edhe me Shqipërinë, Italinë dhe Suedinë. Organizatat e pensionistëve nga vendet e tjera ishin interesuar së tepërmi për përvojat maqedonase dhe për funksionimin e fondit të solidaritetit të pasvdekjes.

Në atë kohë ishin realizuar disa takime të rëndësishme me udhëheqësinë sllovene të pensionistëve. Udhëheqësia maqedonase ishte e interesuar për të ditur më shumë rreth përvojave të anëtarësimit të Sllovenisë në BE, ndërsa pala sllovene ishte e interesuar për përparimin e reformave në sistemin pensional maqedonas dhe që të ndihmonte për përafrimin e mëtejshëm të tyre drejt praktikave dhe legjislacionit evropian.

Pensionistët kroatë, si organizatorë të simpoziumit ndërkombëtar, me mbështetjen e Federatës së pensionistëve nga Italia, i mundësuan udhëheqësinë maqedonase të pensionistëve që të marrë pjesë dhe të krijojnë kontakte më të afërta me Konfederatën e pensionistëve të Bashkimit Evropian (FERPA). Delegacioni i SPM mori pjesë edhe tek Kongresi i pensionistëve italianë. Ndërsa në takimin kthyes ishte prezent edhe delegacioni italian në Maqedoni që i ofroi asistencë financiare pensionistëve maqedonas në kohën e krizës së refugjatëve që ndodhi gjatë luftës në Kosovë, në vitin 2000.

Delegacioni maqedonas u takua e bisedoi edhe me pensionistët serbë në Beograd.

Pensionistët malazezë organizuan edhe një qëndrim dhjetëditor të kryetarit të SPM në Igalo, ku edhe u realizuan disa takime të rëndësishme të përbashkëta. Delegacioni ishte edhe në Suedi, ku u njoh me sistemin e atjeshëm të inkluzionit social të pensionistëve. Delegacioni i pensionistëve maqedonas mori pjesë edhe në Takimin mediteranes të pensionistëve në Algjeri, ku u prezantuan situata dhe reformat e sistemit pensional.

Federata e pensionistëve francezë dhe Organizata e romëve në R. Maqedonisë, organizuan edhe një simpozium për zhvillimin dhe orientimin e organizatave pensionale drejt rrugës së anëtarësimit në BE.



Në vitin 1999 zëvendëskryetari i SPM, Andon Markovski, ishte në studime në SHBA. Ai realizoi disa takime dhe biseda me drejtues të organizatave pensionale, mes të cilave edhe me organizatën më të madhe në Uashington. U organizua edhe një trajnim dyditor për kuadrot që duhet të drejtojnë organizatat joqeveritare.

Delegacioni maqedonas mori pjesë edhe në Kongresin mbarëbotëror të pensionistëve në Bullgari, në vitin 2002, ku më pas ato vizituan Maqedoninë. Në vitin 2002, me iniciativën e organizatave të pensionistëve bullgarë u organizua Konferenca ballkanike e pensionistëve në Sofje, me konkluzionin që në kuadër të bashkëpunimit të përbashkët të zhvillohej Festivali ballkanik folklorik me grupe këngëtarësh dhe të shkëmbehen vizita të delegacioneve nga të gjitha shtetet ballkanike, për shkak të zhvillimit të bashkëpunimit edhe në planin kulturor. Sipas informacioneve nga delegacioni ynë nga Konferenca pati edhe një përjetim të pakëndshëm për shkak të obstruksioneve kundrejt delegacionit maqedonas, me konotacione politike.

Më 11 shtator të vitit 2004 në Strugë u zhvillua takimi i përfaqësuesve të organizatave të pensionistëve: Sindikata e pensionistëve të Shqipë-



risë, me kryetar profesor Dr.Isak Gorica; Lidhja e bashkuar e pensionistëve të Bullgarisë, me kryetar Sava Garbuzanov; Lidhja demokrate e pensionistëve të Bullgarisë, me kryetar Georgi Merxanov; Lidhja e shoqatave të pensionistëve të Malit të Zi, me kryetar Dr.Quba Sekuliq; Lidhja e pensionistëve të shërbimeve publike të Republikës së Turqisë, me kryetar Irfan Jengjiingjui, si organizatorë Lidhja e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, përfaqësuar me kryetarin Dushko Çurbanovski. Ishin të ftuar, por nuk erdhën edhe përfaqësues të pensionistëve nga: Bosnja dhe Hercegovina, Serbia, Sllovenia, Greqia dhe Rumania. Në takim u shkëmbyen informacione për përvojat e organizimit të pensionistëve, për sistemet pensionale, financimin e aktivitetit të asociacionit pensional, për mënyrën e harmonizimit të pensioneve me shpenzimet e jetesës, për mbrojtjen shëndetësore të pensionistëve, për shpenzimet mortore e të tjera. Unanimisht u mbështet ideja që të organizohen gara sportive të pensionistëve dhe që të punohet për të krijuar edhe Asosacionin ballkanik të shoqatave të pensionistëve. Për përgatitjen e një kuvendi themelues u zgjodh edhe Këshilli iniciues, ndërsa si kryetar u zgjodh Dushko Çurbanovski. Megjithatë për shkak të shkaqeve të ndryshme objektive dhe subjektive kjo iniciativë nuk u realizua.

Më 1 Tetor të vitit 2005, kryetari i LSHPM Dushko Çurbanovski, me delegacion, mori pjesë në punimet e Kongresit të 18-të të Asociacionit Evropian për mbrojtjen e të moshuarve (EURAGE) në Lubjana, Slloveni. Ku mbajti edhe një referat dhe prezantoi monografinë "50 vjet organizim i pensionistëve në Maqedoni", si edhe buletinet për lojërat sportive dhe paradën folklorike të LSHPM. U dakorduan edhe për Kongresin e radhës në vitin 2008 në Madrid, që LSHPM të pranohet zyrtarisht

si anëtare e këtij asociacioni, megjithatë për shkak të problemeve financiare nuk u realizua.

Komisioni për bashkëpunimin pranë Këshillit ekzekutiv të LSHPM gjatë vitit 2006 hartoi programin e bashkëpunimit me asociacionet ndërkombëtare të pensionistëve, me asociacionet në shtete të caktuara, me theks tek organizatat e vendeve fqinjë, duke insistuar që të intensifikohen kontaktet e shoqatave të pensionistëve të rajoneve kufitare me shoqatat e shteteve fqinje. LSHPM shfaqti interes edhe për komunikimin dhe bashkëpunimin me organizatat ndërkombëtare dhe fondacionet: "Shoqëri e hapur", USAID, Agjencia evropiane e rikonstruktimit, MCMS dhe me BNJVL, me idenë që të ketë edhe përfaqësues të LSHPM në këto subjekte.

Në LSHPM, në dhjetor të vitit 2006, në një ceremoni solemne, kryetarit të nderit të pensionistëve maqedonas m-r Vite Isjanovski iu akordua mirënjohja Anëtar nderi i "Konfederatës së sindikatës së pensionistëve nga Pogradeci, R Shqipëri", për bashkëpunimin shumëvjeçar. Mirënjohja në Shkup u soll nga delegacioni i SHP SHP Tetovë, e cila vizitoi Konfederatën e sindikatës së pensionistëve të Pogradecit, në kuadër të bashkëpunimit të ndërsjellët, ku u diskutua edhe për idenë e shkëmbimit në organizimin e pushimeve për pensionistët.

Gjatë zhvillimit të garave republikane sportive të pensionistëve në shtator të vitit 2007, në Krani, qëndroi edhe një delegacion i udhëhequr nga Nazim Daljani, kryetar i Konfederatës së sindikatës së pensionistëve nga Pogradeci, R Shqipëri. Aty u shkëmbyen edhe përvojat e punës.

Në 7 prill të vitit 2010, në Shkup, qëndroi një delegacion nga Lidhja e shoqatave të pensionistët invalidë të punës të Republikës së Kosovës. Në takim me LSHPM ata u interesuan për përvojat e organizimit të pensionistëve në vendin tonë dhe për solidaritetin mes gjeneratave.

Në takimin e LSHPM në Shkup më 20 prill të vitit 2010, qëndroi një delegacion i Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Sllovenisë (ZDUS). Qëllimi i takimit ishte vendosja dhe thellimi i bashkëpunimit mes ZDUS dhe LSHPM. Më tej u ftua LSHPM që të marrë pjesë në Festivalin e moshës së tretë në Lubjana, Slloveni.

Më 16 tetor të vitit 2010 në Pogradec, në takimin e Konfederatës së sindikatave të pensionistëve mori pjesë edhe një delegacion i LSHPM.

Për rëndësinë dhe pritjet e bashkëpunimit ndër-fqinjësor të pensionistëve foli Dushko Çurbanovski, kryetar i LSHPM. Ndërsa për bashkëpunimin e suksesshëm kryetarit nga Pogradeci, Nazif Dajlani, nga SHP Ohër, iu akordua edhe Urdhri



Anëtar nderi i Shoqatës, ndërsa nga SHP Dibër Dokumenti për shpalljen anëtar nderi të shoqatës dibrane.

Bashkëpunimi ndërkombëtar është i rëndësishëm për angazhimin e pensionistëve. Në Programin e punës së LSHPM për vitin 2011 dhe vitin 2012 u potencua zhvillimi i bashkëpunimit ndërkombëtar me lidhje dhe shoqata nga vendet: Serbia, Bullgaria, Shqipëri dhe Kosova, Sllovenia dhe Kroacia, si edhe për rritjen e shkëmbimit të përvojave me vendet e Bashkimit Evropian.

Në kuadër të programit të Evropës për qytetarët, më 23 shkurt të vitit 2011 në Zagreb, Kroaci, u zhvillua një tryezë e rumbullakët për projektin "Për bashkëjetesë tolerante shoqërore të të gjitha gjeneratave", në të cilën folën përfaqësues nga asociacionet e pensionistëve nga Sllovenia, Italia, Maqedonia dhe Kroacia.

Më 27 prill të vitit 2011, në Zagreb, u shënuar 65 vjetori i themelimit dhe veprimit të Maticës së pensionistëve të Kroacisë - MUH. Në këtë përvojë mori pjesë edhe kryetari i LSHPM Dragi Argirovski, ku edhe u nënshkruan Marrëveshja e bashkëpunimit mes LSHPM dhe MUH.

Më 20 shtator të vitit 2011, me rastin e jubileut të 65-të të organizimit pensional në Maqedoni, në Shkup, Vladimir Nozharish, zëvendëskryetar i Maticës së pensionistëve të Kroacisë, sekretarit të Lidhjes së pensionistëve të Serbisë Rajko Jarish, Andrej Jus, drejtor i Institutit evropian "Eureka" nga Lubjana dhe Marjan Çiftar nga Festivali i mos-

hës së tretë në Lubjana, kryetari i LSHPM Dragi Argirovski i akordoi mirënjohje për bashkëpunimin e frytshëm mes LSHPM dhe organizatave të tyre, me dëshirë dhe shpresë që në të ardhmen të përmirësohet më shumë dhe të jetë më e frytshme.

Në 19 qershor të vitit 2012 Ministria e punës dhe politikës sociale, në bashkëpunim edhe me Ministrinë e punës dhe politikës sociale dhe mbrojtjen e konsumatorëve e Republikës së Austrisë dhe Fakulteti Filozofik - Instituti i Punës sociale "Nënë Tereza" - Shkup, organizuan Konferencën ndërkombëtare me temë "Plakja aktive dhe solidariteti ndër gjeneratash". Në kuadër të sesionit tematik u prezantua edhe një referat nga Dragi Argirovski dhe Ilija Gligorov, përfaqësues të LSHPM.

Delegacioni i LSHPM, më 21 qershor të vitit 2012 qëndroi në Tiranë, me ftesë nga Konfederata e sindikatave të Shqipërisë. Kryetari Dragi Argirovski, nënkryetari i Kuvendit të LSHPM Besnik Pocesta dhe kryetari i Shoqatës së pensionistëve nga Ohri dhe Dibra Gjorgji Tërpeski, u pritën nga kryetari i Konfederatës së sindikatave nga Shqipëria Kol Nikolaj. Në takim u potencua nevoja për pasurimin e bashkëpunimit të ndërsjellë në interes të pensionistëve të të dyja vendeve. Kryetari Argirovski tregoi për iniciativën e LSHPM për zhvillimin e një olimpiade sportive të pensionistëve dhe për paradën ballkanike të këngëve, muzikës dhe valleve.



Më 15 qershor të vitit 2012 u realizua edhe një takim mes kryetarit të LSHPM Dragi Argirovski, profesorit të historisë Lionel Dibëre dhe pensionistes Xhanin Disel, që kanë qenë aktivistë të asociacioneve franceze "Veteranët e Luftës së madhe" dhe "Përmendoret franceze dhe ruajtja e vendeve ku kanë rënë dëshmorët". Të ftuarit nga Franca shprehën falënderimin për kujdesin dhe respektin

kundrejt varrezave të ushtarëve francezë që gjenden në disa vende në Maqedoni. Ato janë më pak se askush fajtorë për luftën në territore të huaja dhe në shtete të huaja.

Delegacioni me tre anëtarë, i drejtuar nga Oleg Serozin, shef i Sektorit të bashkëpunimit teknik pranë Sekretariatit për punë sociale dhe zhvillim i Njesisë së punëve ekonomike dhe sociale në Sekretariatit e OKB (UNDESA), i shoqëruar nga Sonja Tanevska, ndihmës përfaqësuese e Fondit për popullsinë e KB ON (UNFPA) dhe Dushan Tomshiq, përfaqësues i Ministrisë së punës dhe politikës sociale, më 29 maj të vitit 2014 vizituan LSHPM me qëllim që të njihen nga afër me misionin e Lidhjes. Në mënyrë të veçantë u diskutua mbi iniciativën e hartimit të kartës sociale të pensionistëve. Takimi u mbyll me marrëveshjen për tu takuar sërish dhe ndërmarrjen e masave konkrete dhe ndihmës nga Fondi për popullsinë i KB, i dedikuar për veprimtari të këtilla. Kryetari i LSHPM Dragi Argirovski, në shtator të vitit 2014 vizitoi Lidhjen e pensionistëve të Serbisë, ku u takuan me kryetarin dhe sekretarin e tyre. Më tej ata shkëmbyen përvoja për punën dhe shanset për përmirësimin e bashkëpunimit mes të dy lidhjeve. U konstatua se shoqatat komunale dhe qytetare të pensionistëve nga Serbia dhe Maqedonia - Nish, Vranjë, Leskovac, Kumanovë, Ohër dhe Manastir mbajnë lidhje shumë intensive.

Në tetor të vitit 2014 nën organizimin e "Arbaiter Samaritarien Bond" nga Gjermania, në Ohër u mbajt seminari me temë "Forcimi i kapaciteteve të organizatave civile", në të cilën morën pjesë edhe përfaqësues nga Shqipëria dhe nga LSHPM. U theksua nevoja për vendosjen e "Shërbimit vullnetar pensional" sipas shembullit të BE, ku pjesëmarrja e pensionistëve në mbështetjen e shoqërisë nxitet dhe ka një rëndësi të posaçme për zhvillimin e saj.

Më 11 mars të vitit 2015, takim me udhëheqësinë e LSHPM kishin përfaqësues të asociacioneve më të mëdha të pensionistëve nga Suedia që kanë me nga mbi 450.000, Milan Stojcevski, kryetar i organizatës komunale "Shën Kiril" në Geteborg dhe Jani Dimovski. Të ftuarit nga Suedia informuan se gjatë të tërë vitit hartuan një projekt për bashkëpunimin dhe vizitat turistike të pensionistëve suedeze në Maqedoni. U disku-



tua edhe që pensionistët suedezë të vijnë në Maqedoni, duke filluar nga muaji maj i vitit 2015.



Në takim është folur edhe që një delegacion i lartë i pensionistëve suedezë ta vizitojë Maqedoninë dhe ky të jetë hapi i parë zyrtar i bashkëpunimit, por ende nuk është realizuar.

Në vitin 2015 delegacioni nga Shqipëria, i udhëhequr nga kryetari i Konfederatës së sindikatave nga Shqipëria Kol Nikolaj, i shoqëruar edhe nga kryetari i Konfederatës së sindikatave të pen-



sionistëve nga Pogradeci, Nazim Daljani, u takuan me udhëheqësinë e LSHPM. Ata diskutuan për rezultatet dhe aktivitetet e LSHPM, që janë shembull për mjedisin. Delegacioni nga Shqipëria mori pjesë në takimin multi-etnik të pensionistëve nga Tetova.

Në mesin e vitit 2015, në Shkup u realizua takimi ndërkombëtar bilateral me pensionistët nga Sllovenia për shkëmbimin e përvojave dhe marrëveshjen e aktiviteteve për vitin 2015. Delegacioni nga Lidhja e shoqatave të pensionistëve nga Sllovenia e drejtuar nga nënkryetari i atëhershëm Anton Donko, bisedoi për bashkëpunimin e suk-

sesshëm shumëvjeçar dhe mbështetjen, por edhe për projektet e ardhshme të përbashkëta. Po ashtu iu diskutua edhe për zbatimin e projekteve të për-



bashkëta me financimin e Bashkimit Evropian për përmirësimin e standardit dhe kushteve të jetës së pensionistëve.

Në numrin e muajit mars të vitit 2016, në rivistën "Maqedonia" nga Toronto, Kanada, gazetë e maqedonasve, ishte publikuar një shkrim për



shënimin e jubileut të 70-të të organizimit pensional në Maqedoni dhe aktiviteteve të zhvilluara me atë rast.



Nga LSHPM u realizua edhe një korrespondencë me kryeredaktorin e gazetës "Maqedonia", Sonja Lozanovska, si edhe me kryeredaktorin e gazetës sonë "Pensionist plus", Kalina S. Andonova, si edhe u dakordua për një bashkëpunim mes të dy organeve të shtypit për tema që

do të jenë me interes të pensionistëve maqedonas dhe më gjerë.

Më 16 shtator të vitit 2016, me rastin e jubileut të 70-të organizimi i pensionistëve në Maqedoni, me Vendim të Këshillit Ekzekutiv të LSHPM akordoi pllakate për individë dhe organizata nga jashtë vendit, me të cilat ka realizuar bashkëpunime dhe

që kanë kontribuar në punën e LSHPM. Pllakatet iu akorduan: Andrej Jus nga "Eureka" Lubjana, Anton Donko nga LSHP nga Sllovenia, Marjan Çiftar nga LSHP e Sllovenisë, Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Sllovenisë na Konfederatës së sindikatave të Shqipërisë, Kol Nikolajt, kryetar i KSSH, dhe Nazif Daljanit, kryetar i KS Pogradec, Shqipëri.

3. FESTIVALI I MOSHËS SË TRETË **f3žO**

Me rekomandimin e OKB, është caktuar "Dita kushtuar kujdesit për të moshuarit", i cili shënohet çdo vit më 1 tetor. Në Republikën e Sllovenisë, duke filluar nga viti 2001 në atë ditë zhvillohet një Festival.

Në festivalin e 10-të jubilar për moshën e tretë, në vitin 2010 në Lubjanë, për herë të parë morën



pjesë pensionistët nga Maqedonia, me një delegacion nga krerët e LSHPM dhe SHKA "Gjoko Simonovski" nga SHP Kumanovë. Në pjesën artistike të hapjes së festivalit për herë të parë interpretoi ansamblet i një shteti tjetër dhe pikërisht nga Maqedonia, SHKA "Gjoko Simonovski" nga

Kumanova. Në tryezën e rrumbullakët në kuadër të Festivalit u mbajt referati me temë "drejt kohës së re të jetesës së pensionistëve dhe plakjes me dinjitet" nga Dragi Argirovski, shef i delegacionit maqedonas. U arrit në konkluzion dhe propozim që festivale të këtij lloji në të ardhmen të zhvillohen edhe në vende të tjera të Ballkanit. Në manifestimin e panairit të Festivalit pensionistët maqedonas kishin edhe një stendë informative.

Vitin e ardhshëm, nga 27 deri më 30 shtator të vitit 2011, në Lubjanë, Slloveni, në Festivalin e 11-të të moshës së tretë mori pjesë një delegacion nga LSHPM dhe një grup gjajdexhinjsh i SHKA



"Pensionistët e lumtur" nga SHP - Probishtip. Me atë rast ambasadori i Maqedonisë në Slloveni, Igor Popov. Organizoi një pritje. Në kuadër të leksioneve profesionale të Festivalit, d-r Ilija Gligorov prezantoi temën "Vullnetarizmi i mbështet gjeneratat".

Në vitin **2012**, që i kushtojë plakjes aktive dhe bashkëpunimit mes gjeneratave dhe bashkëjetesës në Lubjanë, nga 1 deri më 3 tetor në Festivalin e **12-të** të moshës së tretë, tradicionalisht për herë të tretë morën pjesë pensionistët nga Maqedonia. Me delegacionin e LSHPM ishte edhe Shoqata artistike



kulturore e pensionistëve nga SHP Koçani. Përfaqësuesi i LSHPM d-r Ilija Gligorov në pjesën konferenciare - edukative prezantoi referatin me titull "Ndikimi i mediave mbi përfshirjen sociale të pensionistëve" me autorë Dragi Argirovski dhe Ilija Gligorov, për çka edhe morën certifikata.

Në vitin **2013** në Festivalin e **13-të** në Lubjanë mori pjesë një delegacion i LSHPM dhe pensionistët nga SHP Tetovë me dy ansamble. Ata u prezantuan me këngë dhe tradita maqedonase dhe



shqiptare, ndërsa Gojko Eftovski u prezantuan me një referat me titull "Realizmi i detyrave programore të pensionistëve në mjedisin ndëretnik".

Në festivalin **14-të të moshës së tretë**, në vitin **2014**, morën pjesë dy shoqata kulturore - artistike "Pensionisti" dhe "Penka Koteska" nga SHP Prilep, së bashku me një delegacion të LSHPM.



Atëherë u lexuan edhe referatet nga: Dragi Argirovski dhe d-r Ilija Gligorov, me temë "Lidhja e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë si stimulues i vlerave familjare", si edhe "Organizimi i pensionistëve në Republikën e Maqedonisë", prezantuar nga m-r Ilija Adamoski. Me rastin e pjesëmarrjes pesëvjeçare të rregullt dhe shumë afirmative të pensionistëve të LSHPM, në pjesën solemne të Festivalit u akordua

edhe Mirënjohja për LSHPM, si një mirënjohje e parë e rëndësishme ndërkombëtare. Në ceremoninë në sallën e madhe në Shtëpinë Cankarev mirënjohja u akordua nga ministria e Punës, familjes, çështjeve sociale dhe mundësive të barabarta e Qeverisë së Sllovenisë Anja Kopac Mrak, që e mori kryetari Dragi Argirovski.

Në vitin **2015**, në Festival u prezantuan pensionistët nga SHP Radovish dhe Konçe, si edhe nga SHP Makedonska Kamenica, me të cilat mori pjesë edhe një delegacion nga LSHPM. Prezantim në



Konferencën ndërkombëtare në kuadër të Festivalit kishte Dragi Argirovski, me temë "Si të plakemi në formë aktive". Më 1 tetor, në kuadër të Festivalit në Lubjanë u mbajt një mbledhje në të cilën morën pjesë: Andon Donko, kryetar i ZDUS, kryetari i LSHPM, Dragi Argirovski, Andrej Jus nga ZDUS, kryetari i Lidhjes së pensionistëve nga Bullgaria, Cvetan Minkov, nënkryetari i Lidhjes së pensionistëve nga Serbia, Vasilije Belobërković si edhe kryetari i Lidhjes së pensionistëve të Malit të Zi, Branko Veshović, ku edhe u fol për bashkëpunim bilateral. Në takim kryetari i LSHPM, Dragi Argirovski, u shpall si doajen dhe lider i organizimit të pensionistëve të Ballkanit.

Në kuadër të Festivalit të moshës së tretë, në Lubjanë, në vitin **2016**, Lidhja e shoqatave të pensionistëve të Sllovenisë mbajti një Akademi solemne dhe festë për 70-të vjetorin e formimit të Lidhjes.



Në Festival dhe në ceremoninë e tij morën pjesë: kori "Sirma Vojvoda" i SHP Manastir dhe Shoqata kulturore artistike me grupin e valleve të Demir Hisarit, së bashku me një delegacion të LSHPM, që u prit edhe nga kryeministri i R Sllovenisë, d-r Miro Cerar.

4. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR I SHOQATAVE TË PENSIONISTËVE ANËTARE TË LSHPM

Bashkëpunimi ndërkombëtar i shoqatave të pensionistëve, anëtare të LSHPM, kryesisht është zhvilluar përmes vizitave të ndërsjella në ceremoni, festa, pritje, festivale dhe manifestime e gara sportive, aksione humanitare, donacione, seminare e të tjera. Teksti është një informacion i përmblodhur, i shkurtër për bashkëpunimin ndërkombëtar të shumicës së shoqatave.

Duke filluar nga viti 1966, me ndryshimet e atëhershme shoqërore erdhën edhe ndryshimet në programet e punës së shoqatave të pensionistëve. U planifikuan forma të ndryshme të bashkëpunimit

ndërkombëtar, të cilat në fillim ishin mes shoqatave të ish republikave jugoslllovene dhe më vonë edhe me shoqata dhe organizata nga shtete e tjera evropiane. Të dhëna për këtë bashkëpunim më së shumti janë publikuar në monografitë e botuara nga shoqata të caktuara si, i edhe në shkrime të tjera. Për SHP Prilep ka të dhëna se për një kohë më të gjatë ka bashkëpunuar dhe ka ruajtur lidhje miqësore edhe me SHP Kraguevac. Më 11 tetor të vitit 1969 këto shoqata nënshkruan edhe Konventën për vëllazërim.

Delegacioni i SHP Prilep vizitoi provincën belge Flemish Brabant, ku edhe arritën deri në shkëmbimin e përvojave.

Takimet, bisedat dhe shoqërimi janë forma të shkëlqyera për krijimin e urave të bashkëpunimit de miqësisë mes shoqatave për vite të tëra. Delegacionet dhe grupet e pensionistëve nga shoqatat e LSHPM në vitet e kaluara kanë realizuar shumë vizita të ndërsjella ndërkombëtare dhe bashkëpunim me shoqatat e shteteve fqinje.

Me organizatat e pensionistëve nga Republika e Bullgarisë kanë bashkëpunuar shoqata maqedonase të pensionistëve nga: Berova, Gazi Baba, Delçeva, Ohri, Debërca, Radovishi, Kumanova, Probishtipi dhe të tjera.

Me organizatat e pensionistëve nga Republika e Shqipërisë kanë bashkëpunuar shoqatat e pensionistëve të: Dibrës dhe Qendër Zhupa, Ohri dhe Debërca, Kavadari, Gostivari, Çairi, Saraji, Buteli, Kumanova dhe të tjera.

Me organizatat e pensionistëve të Republikës së Serbisë kanë bashkëpunuar shoqatat e pensionistëve nga: Kumanova, Ma-



nastiri, Buteli, Pensionistët e luftës Shkup, OVR Shkup, Kavadari, Gazi Baba, Kriva Pallanka, Ohri dhe Debërca, si edhe Probishtipi.

Me organizatat e pensionistëve nga Republika e Kroacisë kanë bashkëpunuar shoqatat maqedonase të pensi-

onistëve nga: Manastiri, Koçani dhe të tjera.

SHP Probishtip ka vendosur bashkëpunim me individë, grupe dhe shoqata nga Holanda, Belgjika, Gjermania, Japonia, Kosova dhe Sllovenia.

SHP Berovë ka bashkëpunuar dhe ka pasur të ftuar nga shoqatat nga Holanda dhe Grupi "Village Harmony" nga SHBA.

SHP Koçani ka bashkëpunuar me pensionistët nga Serbia dhe shtet të tjera.

SHP Kumanovë ka vendosur bashkëpunim me organizata pensionistësh në Shqipëri, Serbi, Bullgari, Kosovë, Kroaci dhe Rumani. Kori i SHP Kumanovë në Takimit e 11-ta kulturore ndërkombëtare



të pensionistëve në Sofje ka marrë Mirënjohje ndërkombëtare dhe STATUJË, mirënjohjen më të lartë për interpretim cilësor. Bashkëpunimi ndërkombëtar pensionistëve nga Kumanova është shprehur me zhvillimin e Festivalit ndërkombëtar të koreve, më 12 qershor të vitit 2016. SHP Kumanovë për vite me radhë ka organizuar Takimet ndërkombëtare të pensionistëve "Eko Heping" në Pelince.

SHP Gjorçe Petrov me grupin e valleve ka marrë pjesë në Festivalin e 21-të internacional folklorik në Pragë, R. Çekisë. Për interpretimin e suksesshëm në Festival ka marrë edhe Mirënjohje dhe Certifikatë ndërkombëtare.



5. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR I LSHP TË QYTETIT TË SHKUPIT

Në maj të vitit 1975 në një mbledhim ceremonial të madh në Zagreb u nënshkrua edhe Marrëveshja për vëllazërimin e shoqatave të pensionistëve të qytetit Shkup, Beograd, Titograd, Sarajevë, Lubjanë, Zagreb, Novi Sad dhe Prishtinë (shoqatat e pensionistëve ose lidhjet e nga qytetet kryesore të republikave të atëhershme dhe krahinave të Jugosllavisë). Nga ky mbledhim është bërë edhe një album i posaçëm i madh me fotografi që ruhet në Lidhjen e Qytetit të pensionistëve në Shkup.

Delegacioni nga Lidhja e shoqatave të pensionistëve të qytetit të Shkupit në vitin 2014 qëndroi në Beograd, Serbia, në një vizitë në Shoqatën e pensionistëve të Beogradit. Delegacioni përbëhej nga përfaqësues të shoqatave të pensionistëve nga: Qendra, Aerodrom, Çair, Saraj, Ilinden, Gjorçe Petrov, Shuto Orizari, Butel dhe SHVP. Qëllimi i vizitës ishte shkëmbimi i përvojave rreth punës së shoqatave të qytetit të Shkupit dhe të Beogradit. Gjatë kthimit delegacioni kishte takim edhe me drejtuesit e SHP Jagodina.



Më 22, 23 dhe 24 nëntor të vitit 2015 delegacioni i përbërë nga kryetarët e dhjetëra shoqatave, anëtare tek Lidhja e shoqatave të qytetit të Shkupit, ishin në një vizitë treditore tek Konfederata e sindikatave në Shqipëri. Ata kanë biseduar me kryetarin tek Konfederata e sindikatave në Shqipëri dhe me bashkëpunëtorët e tij. Më pas janë shkëmbyer edhe përvojat nga puna e të dy asociacioneve multietnike.

Më 30 dhe 31 tetor dhe më 1 nëntor të vitit 2016, një delegacion i SSHP të qytetit të Shkupit me 12 pensionistë nga të gjitha shoqatat e Shkupit qëndroi në Sarajevë, BH. Ata kishin takime, biseda dhe shkëmbim të mendimeve dhe përvojave me drejtuesit nga Lidhja e shoqatave të pensionistëve të kantonit Sarajevë.



PJESA V



SHOQËRIMI MES GJENERATAVE DHE BASHKËJETESA

SHOQËRIMI MES GJENERATAVE DHE BASHKËJETESA

1. SHOQËRIMI MES GJENERATAVE

Bashkimi Evropian e shpalli vitin 2012 si vitin e bashkëpunimit ndër gjeneratash dhe solidaritetit dhe në kuadër të organizimit të pensionistëve ajo u shënua me shumë aktivitete.

Shoqërimi mes gjeneratash është shumë i rëndësishëm për njerëzit e moshës së tretë të jetës, pasi që kur jemi bashkë me të rinjtë kthehemi në kohën kur kemi qenë të rinj, po ashtu me rininë gjithmonë është e lidhur edhe optimizmi dhe gegizmi, si edhe pjekuria dhe përvoja e të moshuarve gjithmonë është e lidhur me energjinë e të rinjve dhe jep rezultate të mira. Shoqërimi me të rinjtë praktikohet në më shumë shoqata.



Në shumë aktivitete janë prezent edhe përfaqësues të të gjitha gjeneratave. Në piknikët në bar, në valle ka të moshuar dhe të moshës së mesme, të rinj e fëmijë. Në shumë manifestime dhe festa janë prezent edhe gjyshet e gjyshërit si edhe nipërit e mbesat e tyre. Si shembull për këtë janë takimet - piknik në Oreovicë, Elenec, Lesnovë, Dojran...

Më 2 gusht - linden, në Bogomillë, komuna e Çashkës, Shoqata e pensionistëve - Veles inauguroi Shtëpinë e rinovuar rekreative për pensionistët



dhe të rinjtë "Petar Pop Arsov". Objekti i shkatërruar u mor nga shoqata për përdorim nga komuna e Çashkës, e rinovoi dhe në të mund të akomodohen shumë vizitorë që duan që të shijojnë bukuritë e Azotit. Ceremonia u hap nga aktorja Vesna Dimitrieva Bobeski, ndërsa të ftuarve iu drejtua kryetari i SHP Veles Dr.Vele Aleksoski:

- Shtëpia rekreative i dedikohet pensionistëve dhe të rinjve. Pse edhe për rininë? Pasi që edhe ato një ditë do të jenë pensionistë, ndërsa ne, që jemi aktualisht pensionistë kemi strategji për bashkëpunimin mes gjeneratave. Tek objekti i kësaj shtëpie gjenden dhjetëra dhoma me nga 3-4 shtretër dhe sallë sportive polivalente, në të cilën para së gjithash do të zhvillohen treningë përgatitore për: futboll, hendboll, basketboll, tenis, volejbol, ping-pong dhe të tjera. Kemi në dispozicion edhe terrene sportive për futboll në fusha të mëdha. - Goranço Panovski, kryetar i komunës Çashka shprehu kënaqësinë për hapjen e Shtëpisë rekreative për pensionistët dhe të rinjtë, si edhe për bashkë-



punimin shumë të mirë me Shoqatën e pensionistëve në Veles, e cila edhe më tej do të vijojë. Duke e përshëndetur mbledhimin kryetari i LSHPM Dragi Argirovski, potencoi:

- Kjo është Shtëpia e dytë e këtillë në Maqedoni, pas asaj në Shkup. Edhe krahas zbatimit praktik, është e rëndësishme që të shfrytëzohen edhe bukuritë natyrore me mundësi për shëtitje dhe argëtim në ajër të pastër. Dhe akoma më e rëndësishme është që kjo shtëpi, me ndryshime të vogla administrative, përkatësisht shfrytëzimin e tipit të partneritetit publik-privat shumë shpejt mund të kthehet dhe të adoptohet në një Shtëpi për qëndrimin e të moshuarve dhe atyre të pafuqishëm.

Nga qyteti i Vardarit është shembulli kur më 9 mars disa djem dhe vajza nga SHMP "Kole Nedelkovski" së bashku me profesorët e tyre ishin të ftuar të Aktivit në pensionistëve të SHP Veles. Hynë në sallën e Shtëpisë me buqetë me lule dhe i uruan festën e 8 marsit. Një ditë më vonë, shoqata u vizitua edhe nga nxënës të klasës së parë të SHMP "Koço Racin". Ata erdhën për të dhënë një lajm të bukur.

- Ne çdo ditë kur shkojmë dhe kthehemi nga shkolla shikojmë disa pensionistë që mezi i ngjisin shkallët e Shtëpisë. Disa ecin me paterica, të tjerë me karroca i fusin të afërmit e tyre, kështu që vendosëm që të përpiqemi së bashku me ju dhe me Kryqin e Kuq të R Maqedonisë që të ndërtojmë një tra adekuat për të gjithë ata nuk mund të ngjiten nëpër shkallë.

Kur e dëgjuan këtë pensionistët prezent iu rrodhën lot jo nga keqardhja, apo gëzimi, por nga kujdesi, shqetësimi dhe dashuria që e treguan të rinjtë ndaj tyre. Në takim kryetari i shoqatës Vele Aleksoski, duke i falënderuar u shpreh: - Është shumë pak që të themi se ju jemi mirënjohës kjo është një punë e madhe. Edhe sikur kjo ide të mbetet thjesht një ide flet mjaftueshëm se ka di-kush që kujdeset për ne. Ne gëzohemi për planet e

përbashkëta dhe projektet me të rinjtë. Ja pra që tani angazhohemi që t'ju ndihmojmë që të realizohet ideja juaj, por do të kishim dëshirë që të jeni të ftuarit tanë dhe bashkëpunëtorë edhe në fusha të tjera, për shembull të merrni pjesë në takime kulturore poetike të përbashkëta, të merremi bashkë me sport, të këndojmë e kërcëjmë. Ju ftojme që të jeni të ftuarit tanë në shtëpitë rekreative që filluam t'i ndërtojmë në shumë vende të mrekullueshme. Ja në lagjen Otovica në projektin që do të fillojë të realizohet do të ketë një mjedis edhe për ju. Do të ketë një sallë edhe për ping-pong dhe një vend për t'u shoqëruar dhe për të bërë takime.

Këtu është edhe shembulli i SHP Ohër dhe Debërca dhe shkollës fillore "Hristo Uzunov", që më 20 nëntor të vitit 2015 organizuan Takimin e pestë mes gjeneratave të pensionistëve të Degës vendore "Gorna vlashka maalla" dhe nxënësve të shkollës. Manifestimi tradicional është projekt i Bashkimit Evropian dhe realizohet nga SHP Ohër dhe Debërcë - anëtare e LSHPM. Pas takimit të



përbashkët me pensionistët dhe nxënësit dhe bisedës rreth pensionimit dhe cilat janë aktivitetet dhe të mirat e pensionistëve u prezantua një manifestim i pasur kulturor-artistik. Takimi mes gjeneratash u pasurua edhe me interpretimin e grupit të pensionistëve "Dallgë" dhe të shoqërisë dramatike - recituese "Razvigorçe."

Për organizimin e suksesshëm, kontributin dhe pjesëmarrjen në Takimin mes gjeneratave, që u shënuar edhe me një jubile të vogël - pesë vjetrin e themelimit, kryetari i SHP Ohër dhe Debërca Gjorgji Trpçeski drejtorit të SHF "Hristo Uzunov" Mr.Toni Simonoskit i akordoi një Falënderim.

Për t'u cekur janë edhe aktivitetet e SHP Pro-bishtip, në kuadër të "Javës së kujdesit për të moshuarit", në bashkëpunim edhe me Kryqin e Kuq.

Nga qyteti i minatorëve u zhvilluan një sërë aktivitetesh në të cilat u përfshinë edhe Shtëpia e shëndetit "Nada Mihajlova", kopshti i fëmijëve "Goce Delçev" dhe SGMP "Vëllezërit Milladinovci", ku secili në mënyrën e vet u kujdes që të sillte një pikë gëzimi në jetën e të moshuarve. Ekipi i përbërë nga doktor dhe infermiere dhe vullnetarë nga Kryqi i Kuq vizitoi 30 të moshuar dhe persona të



pafuqishëm në disa fshatra në komunë dhe kryen vizita të plota mjekësore, matjen e tensionit, sheqerit në gjak, ndërsa nga Kryqi i Kuq iu ndanë edhe paketa me rroba të trasha.

Një ditë në kuadër të javës iu përkushtua ligjëratave edukative nga sfera e shëndetit, zbatuar nga doktorët vullnetarë të kryqit të Kuq në Probishtip Dr. Marijka Andonovska dhe Dr. Tatjana Anastasovska. Ata folën për ftohjen dhe sëmundjet virale, karakteristike të stinës së dimrit, për mënyrën e njohjes së tyre dhe mjekimin e duhur, ushqimin adekuat dhe aktivitetin fizik në moshën e tretë. Pas shumë pyetjeve drejtuar nga të pranishmit dhe përgjigjeve të plota u vijua me matjen e tensionit, sheqerit në gjak dhe dhënien e këshillave individuale mjekësore.

Aktivitetet finale në kuadër të "Javës për kujdesin e të moshuarve" ishin interesante dhe motive, pasi që banorët e shtëpisë së pensionistëve u vizituan edhe nga fëmijët e kopshtit "Goce Delçev" "Sërnički". Fëmijët për prezencën e tyre i falënderoi kryetari i SHP Probishtip Gruica Manasijev, ndërsa pensionistëve i dëshiroi shumë shëndet dhe ditë pensioniste të lumtura dhe pa shqetësime, me dëshirë që kështu të takohen edhe për vite me radhë. Në emër të Kryqit të Kuq pensionistëve iu drejtua sekretari Mitko Georgievski, i cili po ashtu iu dëshiroi shumë shëndet dhe çaste të këndshme në këtë shtëpi të përbashkët, ku edhe i kalojnë ditët duke u shoqëruar si një familje e vetme.

Shënojmë edhe një shembull nga Ohri. Me rastin e 66-të vjetorit të formimit të SHP Ohër dhe Debërca dhe festës së patronazhit "Shën Kirili dhe Metodija" të Shkollës fillore "Bashkim-Vëllazërim", si edhe jubileun e madh - 70-të vjetorin e organizimit pensionist në Maqedoni, në Ohër u organizua Takimi i parë mes gjeneratash si një formë e re e bashkëpunimit multi-etnik mes pensionistëve dhe nxënësve. Takimi filloi me shoqërimi të përbashkët me nxënësve të udhëheqësisë të pensionistëve në të cilën përfaqësuesit e gjeneratës më të re u interesuan për rolin dhe kontributin e qytetarëve

të rritur në familje dhe shoqëri. Pjesa kulturore-argëtuese e manifestimit u zhvillua paralel në tre gjuhë, ndërsa filloi me interpretimin e korit të shkollës me tre kompozime në gjuhët maqedonisht, shqip dhe turqisht.

Të ftuarve të pranishëm, pensionistëve, prindërve dhe nxënësve në takim, iu drejtua me një përshëndetje drejtori i shkollës, Muamer Doko, dhe kryetari i SHP Ohër dhe Debërca Gjorgji Tërçeski, të cilët besojnë se ky takim do të bëhet tradicional, duke treguar me vepra sesi duhet të kultivohet bashkëjetesa dhe bashkëpunimi ndër gjeneratash.

Në emër të LSHPM të pranishmit i përshëndeti nënkryetari i Kuvendit të LSHPM Besnik Pocesta.

Zëvendëskryetari i komunës Ohër, Angel Janev, duke i përshëndetur të pranishmit ceku se pensionistët janë shembulli sesi në këtë frymë duhet që të edukohen të rinjtë, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre fetare, racore dhe etnike. Fundi i këtij takimi u zbuloi me seksionin dramatik-recitues të shoqatës në bashkëpunim edhe me nxënësit, të cilët realizuan një recital kushtuar Ohrit, jetës në shkollë dhe pensionistëve, përcjellë përmes humorit dhe shakave. Takimi i parë i përbashkët mes gjeneratash dhe multi-etnik mes pensionistëve dhe nxënësve u mbyll me interpretimin e SHKA "Dallga" nga SHP Ohër dhe Debërca, të cilët interpretuan disa këngë të vjetra qytetare ohridase.

Misioni i shoqërimit ndër gjeneratash u shënuar edhe në SHP Struga, ku u hap edhe një shkollë për shahistë.



- Që kur dola në pension menjëherë u bëra pjesë e aktiviteteve të SHP Strugë dhe së bashku me kryetarin Milorad Tërposki, një adhurues i madh i shahut formuam një shkollë dedikuar shahistëve të rinj, e cila funksionon në klubin e pensionistëve. Pasi që u paraqitën shumë fëmijë i ndamë në dy grupe, ndërsa shoqata e pensionistëve na siguroi ambientin e duhur, ngrohjen dhe pajisjet për shah. Po ashtu, mjeshtri ndërkombëtar i shahut për femra Gabriela Koskoska, me origjinë nga Struga, na dhuroi pesë komplete shahu dhe pesë kuti për nevojat e shkollës dhe të shoqatës.

- Shkolla gratis e shahut i dedikohet filloristëve nga Struga dhe përbën një sfidë të vërtetë për të gjithë adhuruesit e kësaj loje, të cilët dëshirojnë që të ecin në gjurmët e shahistëve të famshëm të këtij qyteti, - u shpreh me kënaqësi kryetari Milorad Trposki.

Për t'u shënuar është edhe seminari katër ditor i vullnetarëve të rinj nga komuna Veles dhe anëtarëve të SHP Veles "Humanizmi para së gjithash". Shoqata e pensionistëve nga Veles, së bashku me vullnetarët e rinj dhe në organizimin e komunës Veles mbajtën edhe një seminar katër ditor



për shoqërim të përbashkët, me temë "Si t'ju ndihmojmë personave të moshuar dhe të pafuqishëm". Në "takime" u fol se në cilën formë mund të merret dhe jepet ndihma. Në marrëveshjen e nënshkruar nga Shoqata dhe komuna Veles u arritën përfundime mes të cilave më kryesore ishin: ndihma për personat të cilët nuk kanë para të mjaftueshme për t'u mjekuar, ndihmë në rast zjarri në shtëpi, rasteve të fatkeqësive, ndihmë nga të rinjtë në raste të garave të ndryshme, si ngjarjeve sportive, pjesëmarrje në gara botërore e të tjera, publikim i librave, e kështu me radhë.

Këto katër ditë kaluan shpejt, shoqërimi i përbashkët mes të moshuarve dhe të rinjve gjithsesi që ishte interesant.

Kultivimi i bashkëpunimit dhe solidaritetit mes gjeneratash është prezent edhe në SHP Prilep, përmes projektit "Super Mario" që funksionon sipas standardeve evropiane. Janë të përfshirë në të 13 vullnetarë që kujdesen për rreth 100 të moshuar, për të cilët nuk ka se kush të përkujdeset, ose që të afërmit dhe familjarët e tyre nuk gjenden në Pri-



lep dhe nuk kanë mundësi që t'i vizitojnë shpesh. Vullnetarët i vizitojnë të moshuarit disa herë në javë, iu blejnë produkte ushqimore, ilaçe, ia paguajnë faturat, i rregullojnë shtëpinë, por edhe thjesht, shoqërohen dhe bisedojnë me ta.

- Planifikojmë që vitin e ardhshëm ky projekt të zgjerohet - potencoi Marjan Risteski, kryetar i komunës së Prilepit, gjatë nënshkrimit të marrëveshjes së tyre.

Shembuj të ngjashëm ka edhe në komuna të tjera në vendin tonë, por që gjithsesi duhet të jenë më të shumta në numër.

2. TOLERANCA MULTIETNIKE DHE BASHKËJETESA

L SHPM, si një asociacion joqeveritar, apolitik dhe multietnik i jep një theks të veçantë zhvillimit të bashkëjetesës mes anëtarëve të saj

dhe më gjerë. Kjo është e dukshme edhe në takimet mes pensionistëve dhe shoqërimet e tyre. Bashkëjetesa e njerëzve që i takojnë moshës së tretë

të jetës është prezent në çdo paradë këngësh, muzike dhe vallesh. Edhe në nivel rajonal, por edhe republikan. Në parada gjithmonë vjen në shprehje diversiteti, edhe tek këngët, edhe tek vallet ajo ishte sintetizuar në një fjalë, në një mendim: bashkëjetesë për të gjithë ata që jetojnë në këto treva, pa dallim gjuhe dhe besimi, pasi të gjithë kemi një dëshirë: prosperiteti në vendit tonë dhe jetë të lumtur për gjeneratat që vijnë. Me këngë dhe pensionistët tregojnë sesi duhet atdheu, si ruhet identiteti, si ndërtohet bashkëjetesa, si respektohet tradita dhe zakonet e tjetrit dhe se për këtë rrugë dhe mënyra të tjera nuk ka! Bashkëjetesa është prezent edhe tek ngjarjet sportive, rajonale dhe republikane dhe të garave mes shoqatave. Të gjithë bëjnë tifozllëk dhe i gëzohen rezultateve pa dallim feje dhe nacionaliteti. Bashkëjetesa është një pasuri e paçmuar, dhe kjo gjë vërehet edhe tek takimet në klubet e pensionistëve, ekskursione dhe shoqërime të tjera, si është edhe manifestimi humanitar "Ëmbëlsirat e gjyshes", e të tjera të ngjashme.

Në prill të vitit 2005 nën organizimin e Shoqatës së pensionistëve të Tetovës u realizua projekti i OBSE për integrimin më të madh të pensionistëve nga të gjitha nacionalitetet të rajonit të Pollogut dhe nga pjesë të tjera nga Republika e Maqedonisë. Rreth 500 pensioniste maqedonase, shqiptare, turke, rome, serbe, vllahe dhe malazeze nga qytete si Manastir, Gostivar, Kumanovë, Prilep, Kavadar, Veles, Shtip, Dibër dhe qytete të tjera nga vendi ynë u shoqëruan së bashku dhe treguan në praktikë sesi duhet të kultivohen lidhjet ndëretnike dhe se në Tetovë, pas konfliktit nuk ka rrezik që të jetë një destinacion për t'i vizituar. Një vit më pas, në maj të vitit 2006 një takim i ngjashëm u zhvillua tek kompleksi i manastirit "Shën Atanasij" në fsh. Les-hok në Tetovë.

Në 28 maj të vitit 2011 një takim i ngjashëm multietnik u mbajt në bregun e Liqenit të Mavrovës, nën organizimin e SHP Gostivar, ku morën pjesë mbi 1.700 pensionistë nga të gjitha anët e vendit.

Në shtator të vitit 2014 dhe 2015 në kompleksin sportiv rekreativ në Saraj, Shkup, u mbajt pikniku - takim multietnik, që duhet që të shndërrohet në një traditë, dhe që organizohet nga LQP e qytetit Shkup.

Në të dy takimet morën pjesë mbi 2.000 pensionistë nga më shumë shoqata të vendit ku u fol ,



u këndua në shenjë të burimeve të unitetit dhe bashkëjetesës.

Po ashtu këto elementë dominuan edhe në takimet-piknik në Oreovicë, Elenec - Cera, në Dojran, Pelince, Dragobrashte, e kudo. Nga shoqërimi dhe bashkëjetesa në Lidhjen e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë mund të marrin mësim edhe gjeneratat e tanishme të të rinjve, por edhe të atyre që do të vijnë. Kështu ndodhi edhe në mbledhjet multietnike të cilat për herë 21-të organizohen çdo vit në SHP Tetovë, si edhe në takimet tradicionale multietnike në Gostivar, ku marrin pjesë me nga 600 pensionistë nga e tërë Maqedonia. Këndohet në gjuhët maqedonisht, shqip, serbisht, turqisht, vllahe, rome, boshnjake, e të tjera.

Në takimet në Likovë, Kumanovë shkëmbehen përvoja dhe ndërtohen ura miqësie dhe bashkëjetese. Shembuj ka shumë. Prandaj në Lidhje ne



ecim në harmoni dhe së bashku duke arritur suksese dhe rezultate.

Dhe pensionistët e tregojnë se gjithmonë dhe kudo vetëm të bashkuar dhe në harmoni mund të ekzistojmë. Uniteti është fuqia dhe mbështetja jonë. Kështu ka qenë dhe kështu do të jetë! Kështu na mëson pjekuria jonë dhe përvoja e mbledhur në vite.

PJESA VI



PENSIONISTËT GARDIANË BESNIKË TË THESARIT KULTUROR TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

PENSIONISTËT GARDIANË BESNIKË TË THESARIT KULTUROR TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

1. KËNGËT, VALLET DHE ZAKONET - TIPARE IDENTITARE TË TË GJITHË ATYRE QË JETOJNË NË KËTË VEND

Jeta kulturore - artistike nën organizimin e pensionistëve është praktikuar që në formimin e saj si një trajtë e demonstrimit të afiniteteve të individëve kundrejt një arti të caktuar, me të cilin janë marrë në mënyrë profesionale dhe amatore më parë ata. Pensionimi ka qenë i mirëseardhur për të riafirmuar aktivitetet e tilla me të cilat kalohet koha e lirë, por njëherazi janë krijuar kushte për të jetuar dhe për t'u relaksuar në formë aktive në moshën e tretë të jetës. Me kalimin e kohës u rrit edhe ideja për tu shoqëruar për shkak të një demonstrimi më masiv dhe të organizuar të vlerave kulturore, kështu që nën organizimin e pensionistëve aty-këtu në Maqedoni filluan që të çelen shoqëri dhe ansamble kulturore-artistike, të cilat edhe sot e kësaj dite mbijetojnë dhe funksionojnë me sukses.

Aktivitetet kulturore-artistike në shoqatat e pensionistëve janë bërë pjesë e rutinës ditore, ndërsa organizatorë të tyre janë pensionistët entuziastë, mes të cilëve edhe individë janë afirmuar si muzikologë,



këngëtarë, valltarë të mirë dhe forma të tjera nga sfera e kulturës, që kanë qenë të përgatitur për masivizimin dhe interpretimin e organizuar në suaza të shoqata të tyre dhe më gjerë në LSHPM. Kështu, thjesht lindi ideja për organizimin e paradës së parë të ansambleve folklorike, grupeve të këngëtarëve dhe instrumentistëve, që u realizua nga Komisioni i jetës kulturore-argëtuese pranë Këshillit ekzekutiv të LSHPM, i përbërë nga: Dushko Pereski - kryetar dhe anëtarët: Milevka Zdravkovska, Pavle Spasev, Fruska Kostadinovska dhe Liljana Fishiq.

Në maj të vitit 2003 Komisioni mori një iniciativë për të zhvilluar Paradën e aktiviteteve artistike-kulturore të shoqatave të pensionistëve të Republikës së Maqedonisë. U vendos që të dërgohet një pyetësor anketues tek të gjitha shoqëritë e pensionistëve që të parashtrojnë të dhëna për formimin e seksioneve të aktiviteteve kulturore-artistike. Kjo gjë u realizua vetëm nga 9 shoqata pensionistësh: SHP Probishtip, SHP Gjevgjeli, SHP Prilep, SHP Kavadar, SHP Lozovë, SHP Berovë, SHP Koçan, SHP Gazi Baba Shkup dhe SHP Kumanovë.

1.1. PARADA E PARË E ANSAMBLEVE FOLKLORIKE, GRUPEVE TË KËNGËTARËVE DHE INSTRUMENTISTËVE TË PENSIONISTËVE

Probishtip, 12 nëntor i vitit 2003

Parada e parë e ansambleve folklorike, grupeve të këngëtarëve dhe instrumentistëve të pensionistëve u mbajt më **12 nëntor të vitit 2003** në Shtëpinë e Kulturës në **Probishtip**, ku ekzistonte edhe një shoqatë kulturore-artistike, e cila për një kohë të gjatë kujdesej për folklorin dhe merrte pjesë në gara folklorike sipas ceremonive të ndryshme që organizoheshin dhe festivaleve. Shoqata amë e pensionistëve

nga Probishtipi ishte organizator i këtij manifestimi kulturor. Parada u organizua me 196 pjesëmarrës nga shoqatat e regjistruara dhe përfaqësues thuajse nga të gjitha shoqatat e pensionistëve dhe të ftuar, banorë vendas, me rreth mbi 300 pjesëmarrës.

Në paradën e parë të ansambleve folklorike këngëtarët, grupet dhe instrumentistë të pranishmëve iu drejtua fillimisht kryetari i Komisionit të jetës kulturore-argëtuese pranë LSHPM **Dushan Pereski**, i cili



u zotua se ky manifestim do të shndërrohej në tradicional.

Fjalë përshëndetëse u mbajt nga kryetari i komunës Probishtip, **Stefan Stojanov**, dhe nga kryetari i SHP Probishtip, **Todor Aksentiev**. Duke e hapur manifestimin kryetari i LSHPM, **Dushko Çurbanovski**, shprehu dëshirën që në këtë manifestim të merrnin pjesë edhe më shumë shoqëri.

Shoqata e pensionistëve pjesëmarrës në paradë u prezantua me këngë burimore popullore dhe qytetare të vjetra, si edhe me valle që u shoqëruan nga grupet muzikore dhe nga instrumente popullore burimore. Ky manifestim kishte një rëndësi të posaçme në nxitjen e aktiviteteve kulturore të shoqatës.

Mes manifestimeve shoqëruese të Paradës së parë të folklorit burimor ishte edhe ekspozita me ekspozate - piktura nga kolonia e Lesnovës, e cila shkaktoi interesim të madh dhe vëmendje tek pjesëmarrësit dhe të ftuarit. Gjatë qëndrimit së bashku në hotelin "San Niko" kryetari i LSHPM, **Dushko Çurbanovski**, në shenjë mirënjohje për të gjitha shoqatat - pjesëmarrësve i ndau diploma.

1.2. PARADA E DYTË E ANSAMBLEVE FOLKLORIKE, GRUPEVE TË KËNGËTARËVE DHE INSTRUMENTISTËVE TË PENSIONISTËVE

Shtip, Veles i Kumanovë, shtator - tetor viti 2004

Në vitin 2004 u organizuan paradat e dyta rajonale në Shtip, Veles dhe Kumanovë. Më **17 shtator të vitit 2004** në Qendrën rajonale **Shtip** u takuan pjesëmarrësit e paradës nga shoqatat e pensionistëve nga: Koçan, Novo Sellë, Llozovë, Berovë, Strumicë, Vinicë, Radovish, Shën Nikollë, Dellçevë dhe Shtip, si organizator.



shoqatat nga: Karposh, Gazi Baba dhe Qendër - Shkup, si edhe Probishtip, Gostivar, Kratovë dhe Kumanovë.

Më dy tetor të vitit **2004 Velesi** ishte organizator i pjesëmarrësve të paradës së shoqatave të pensionistëve nga: Prilep, Bogdanci, Vallandovë, Gjevgjeli, Negotinë, Veles dhe Kavadar.

Në **Kumanovë**, në paradën folklorike të pensionistëve, më **23 tetor të vitit 2004** morën pjesë

Paradat në Shtip, Veles dhe Kumanovë u hapën nga kryetari i LSHPM, **Dushko Çurbanovski**, ndërsa foli edhe kryetari i Komisionit pranë LSHPM, **Dushko Pereski**. Parada në Shtip u përshëndet nga kryetari i komunës, **Dimitar Eftimov**, ndërsa në Veles nga kryetari i komunës, **Ace Kocevski**.

Në të tre manifestimet rajonale në suaza të Paradës së tretë të pensionistëve të ansambleve folklorike, grupeve të këngëtarëve dhe instrumentistëve në qytetet e përmendura performuan 510 pjesë-marrës nga 24 shoqëri të pensionistëve nga Republika, përpara më shumë se 2.200 vizitorëve. Pensionistët e hareshëm u prezantuan me përzgjedhjen e bërë prej tyre të këngëve dhe valleve nga thesari pasur i krijimtarisë maqedonase folklorike, por përveç se në maqedonisht këndohej edhe në gjuhët shqip dhe turqisht. Në paradë u tregua se moshja e tretë mund të jetë interesante dhe e mbushur plot me ngjarje që e zbukurojnë pleqërinë dhe krijojnë momente të lumtura. Po ashtu u tregua se ky manifestim i nxit shoqëritë në ideimin e jetës kulturore, formimin e ansambleve të reja folklori e dhe seksioneve muzikore, që u vërejt edhe nga numri i trefishuar i pjesëmarrësve në raport me një vit më parë.

Në marginat e Paradës së dytë folklorike të pensionistëve në rajonin e tretë në Kumanovë u realizua edhe një manifestim shtesë - Ekspozitë me krijime nga vendasit e cila ngjalli interes të veçantë dhe vëmendjen e vizitorëve.

1.3. PARADA E TRETË E ANSAMBLEVE FOLKLORIKE, GRUPEVE TË KËNGËTARËVE DHE INSTRUMENTISTËVE TË PENSIONISTËVE Tetovë, Negotinë dhe Koçan, qershor - korrik, viti 2005

I nxitur nga suksesi i paradave folklorike në vitin 2004, Këshilli ekzekutiv i LSHPM vendosi që të zhvillohen paradat e ansambleve folklorike, grupeve të këngëtarëve dhe instrumentistëve të pensionistëve në tre rajonet e përcaktuara në Tetovë, Negotinë dhe Koçan.

Prezantimi folklorik në Tetovë u mbajt në Shtëpinë e kulturës, më 16 qershor të vitit 2005, me



pjesëmarrjen e shoqatave të pensionistëve nga: Gostivar, Kumanovë, Tetovë dhe Gazi Baba, Karposh, Kisella Vodë, Qendër dhe Çair, Shkup. Në paradë morën pjesë 180 pjesëmarrës të drejtpërdrejtë, përpara 450 spektatorëve. Në hapjen solemne të manifestimit muzikor, në emër të organizatorëve përshëndetën **Slavko Lazarevski**, kryetar në Shoqatën e pensionistëve të Tetovës dhe **Nervet Jashari**, kryetar i Kuvendit të kësaj shoqate. Ata theksuan se në këtë qytet prej shumë shekujsh kultivohet tradita folklorike, dhe sidomos muzika e kavallit, curleve dhe daulleve.

Të pranishmit i përshëndeti kryetari i Komisionit pranë LSHPM **Dushan Pereski**, ndërsa për përcaktimet programore dhe rëndësinë e paradave foli kryetari i LSHPM **Dushko Çurbanovski**, që u zotua në pasurimin e mëtejshëm të aktiviteteve vetjake kulturore të pensionistëve. Falënderime iu ndanë pjesëmarrësve në Paradë nga Andon Markovski, nënkryetar i LSHPM.

Në Negotinë interpretoi shoqëria e pensionistëve nga Bogdanci, Vallandovë, Veles, Gjevgjeli, Kavadar - të të moshuarve dhe Kavadar - invalidë, Negotinë, Lozovë, Ohër dhe Prilep. U zhvillua në Shtëpinë e kulturës, më 17 qershor të vitit 2005, me interpretimin e 200 artistëve përpara 400 spektatorëve. Ata u prezantuan me këngë burimore, kryesisht qytetare, të shoqëruar edhe nga orkestra dhe instrumentistë-solo.

Në emër të organizatorit të pranishmit dhe të ftuarit i përshëndeti kryetari i SHP Negotinë **Kosta Çupov**, ndërsa i përshëndeti shkurt kryetari i Komisionit pranë Lidhjes, **Dushan Pereski**.

Fjalë e rastit u mbajt nga kryetari i LSHPM, **Dushko Çurbanovski**, që theksoi angazhimin dhe

përkushtimin e përfaqësuesve në përgatitjet e manifestimit të kësaj Parade. Të gjitha shoqëritë pjesëmarrëse në Paradën në Negotinë iu ndanë falënderime, në emër të LSHPM ia akordoi sekretari Çedo Georgievski.

Në 2 qershor të vitit 2005 në Shtëpinë e kulturës në **Koçan** interpretuan 310 pjesëmarrës nga shoqëritë nga: Berova, Vinica, Dellçeva, Ziletova, Kratova, Koçan, Kriva Pallanka, Makedonska Kamenica, Novo Sello, Probishtip, Radovish, Shën Nikolla, Strumica dhe Shtip, përpara 500 spektatorëve.

Një mirëseardhje të ngrohtë të ftuarve i uroi edhe **Ivan Jordanov**, kryetar i SHP Koçan, ndërsa para-
da u përshëndet edhe nga anëtari i Këshillit të Komunës **Petar Efremov**. Po ashtu, ashtu si edhe në para-
dat e tjera, të pranishmëve iu drejtuan kryetari i komisionit **Dushan Pereski** dhe kryetari i LSHPM **Dushko Çurbanovski**, që duke e shpallur paradën të hapur ceku se me cilësi dhe përmbajtjen e tyre këto manifestime sigurojnë që tradita të marrë me shumë intensitet. Në shenjë mirënjohje për pjesëmarrjen në këtë paradë përfaqësuesve të shoqërisë iu ndanë mirënjohje nga nënkryetari i SHP Koçan Stojçe Trajanov.

Në të tre paradat rajonale në vitin 2005 morën pjesë në total 32 shoqëri të pensionistëve përpara 1.300 spektatorëve.

PARADA E PARË FOKLORIKE REPUBLIKANE E PENSIONISTËVE

Shkup, 7 tetor i vitit 2005

Suksesi i paradave rajonale të pensionistëve në vitin 2005 pa dyshim që e vërteton më së miri
parada e parë folklorike republikane e pensionistëve që u mbajt në Sallën universale në Shkup
me 7 tetor të vitit 2005. Në të morën pjesë një numër impresiv pjesëmarrësish (300), përpara një pub-
liku prej 1.000 spektatorëve. Përzgjedhja e pjesëmarrësve, me ndihmën e komisionit JKZ, e bëri juria pro-
fesionale e drejtuar nga profesor d-r Gjorgji Gjorgjiev, i cili i përcolli paradat rajonale dhe i selektoi për-
faqësuesit më të mirë nga shoqëritë e pensionistëve. Në paradë morën pjesë grupe vokale-instru-
mentiste, solistë dhe valltarë nga shoqëritë e pensi-
onistëve nga: Go-
stivar, Gjevgjeli,
komunat e Shku-
pit Gazi Baba,
Qendër dhe Kise-
lla Vodë, nga Pri-
lep, Probishtip,



Negotino, Kavadari, Vinica, Koçan, Tetovë, Berova, Dellçeva dhe Kumanovë.

I pari në këtë paradë republikane foli kryetari i komisionit JKZ **Dushan Pereski**, që theksoi se u
plotësua dëshira e shfaqur që në paradën e parë rajonale folklorike në Probishtip, në vitin 2003, që të
mbahet edhe një Paradë folklorike republikane. Për rëndësinë e paradës foli edhe kryetari i LSHPM
Dushko Çurbanovski, duke i dashuruar këtij manifestimi kulturore-argëtues të marrë formën e një fes-
tivali këngësh dhe vallesh për pensionistët në Maqedoni, por edhe më gjerë.

Parada e parë republikane e pensionistëve tregoi se për valle, muzikë të mirë dhe këngë nuk kanë
rëndësi vitet, por se nevojitet talent, veshë dhe frymëzim.

Shoqëritë të pensionistëve që morën pjesë në paradë iu ndanë dhurata nga Çedo Georgievski,

sekretar pranë LSHPM, ndërsa shoqërimi vazhdoi edhe në restorantin në Shkup Opatija.

Si një manifestim shumë i rëndësishëm kulturor para shkaktoi interes të madh edhe tek mediat e shkruara dhe elektronike në Maqedoni dhe më gjerë.

1.4. PARADA E KATËRT RAJONALE E ANSAMBLEVE FOLKLORIKE, GRUPEVE TË KËNGËTARËVE DHE INSTRUMENTISTËVE Qershor - shtator i vitit 2006

Zhvillimi i paradave rajonale dhe ndër rajonale folklorike të pensionistëve në vitin 2006 përkoi me shënimin e 60- vjetorit të organizimit pensional në Maqedoni. Që është edhe një nxitje dhe impuls i ri për këtë manifestim kulturor të pensionistëve, për të fituar akoma edhe më shumë rëndësi dhe të ngrihet në një stad më të lartë. Këshilli ekzekutiv i LSHPM vendosi të organizohen tre para rajonale dhe dy ndër rajonale të këngëve, valleve dhe muzikës, në mënyrë që të ruhet kontinuiteti i kultivimit dhe zhvillimit të traditave kulturore në Maqedoni. Në realizimin e këtij vendimi ndihmoi edhe iniciativa për të formuar Këshillin organizativ.

Më 15 qershor të vitit 2006, në zemër të Ovçepoles - **Shën Nikollë**, u mbajt para folklorike rajonale e pensionistëve e shoqërive të pensionistëve nga kjo zonë. Në këtë manifestim morën pjesë shoqëri kulturore-artistike, ansamble folklorike dhe grupe këngëtarësh, instrumentistë dhe solistë nga shoqëritë e pensionistëve nga: Berovë, Strumica, Probishtip, Kratovë, Shtip, Koçan, Vinica, Radovish, Dellçevë, Zletovë, Novo Sellë, Llozovë dhe Shën Nikollë.

Të pranishmit në fillim i përshëndeti me ngrohtësi dhe i uroi mirëseardhje kryetari i komunës **Slobodan Danevski** dhe kryetari i SHP Shën Nikollë, **Mirko Danailov**.

- Filluam me modesti në Probishtip, ndërsa tani numërojmë 32 seksione ose shoqëri që punojnë në përbërje të shoqatave të pensionistëve. Rezultatet nuk janë vetëm numra, por edhe me cilësi që çdo vit ka një tendencë në rritje, - tha sekretari i KE pranë LSHPM **Çedo Georgievski** në hapje të paradës.

Në paradë morën pjesë 215 interpretues, që performuan përpara rreth 490 spektatorëve.

Parada rajonale e rajonit të nën Vardarit u mbajt në **21. 6. 2006, Veles** në Kinemanë e qytetit, me pjesëmarrjen e shoqatave nga: Bogdanci, Vallandovë, Veles, Gjevgjeli, Kavadar, Negotinë, Ohër, Prilep dhe qytetit organizator. Në këtë takim kishte 149 pjesëmarrës të drejtpërdrejtë që performuan përpara 400 spektatorëve.

Para fillimit të programit folën kryetari i SHP Veles **Momçilo Markovski**, kryetari i komunës **Ace Kocovski** dhe kryetari i LSHPM **Dushko Çurbanovski**.

Më **28.6.2006 në Gostivar**, në Shtëpinë e kulturës, në paradën rajonale u takuan pjesëmarrës të shoqatave të pensionistëve nga: Gazi Baba, Karposh, Kisella Vodë i Qendër - Shkup, Gostivar, Tetovë dhe Kumanovë me 142 pjesëmarrës të drejtpërdrejtë para 320 spektatorëve. Para fillimit të paradës folën kryetari i SHP Gostivar **Andrea Ognjanoski** dhe kryetari i LSHPM **Dushko Çurbanovski**.

Parada e parë ndër rajonale e vitit 2006 u mbajt në **22 shtator në Strumicë**, në Qendrën e kulturës "Anton Panov". Në manifestimin morën pjesë shoqata të pensionistëve nga: Berovë, Vinica, Dellçevë, Zletovë, Koçan, Kratovë, Llozovë, Novo Sellë, Probishtip, Radovish, Shën Nikollë, Strumicë dhe Shtip. Interpretues kishte mbi 298, ndërsa spektatorë rreth 450. Në hapje folën kryetari i KE të Kuvendit të SHP Strumicë, **Toma Spasov**, kryetari i Këshillit të komunës **Zoran Ristov** dhe kryetari i LSHPM **Dushko Çurbanovski**.

Pas përfundimit të programit nënkryetari i KE të Kuvendit të LSHPM Andon Markovski, iu ndau mirënjohje të veçanta përfaqësuesve të shoqatave që morën pjesë.

Parada e dytë ndër rajonale në vitin 2006 u mbajt në **Prilep** më **29 shtator**, me pjesëmarrjen e 15 shoqërive nga: Bogdanci, Vallandovë, Veles, Gazi Baba, Gjevgjeli, Gostivar, Kavadar, Kisella Vodë, Kumanovë, Negotino, Ohër, Prilep i Qendër i SHKA "Sirma Vojvoda" nga Manastir, me rreth 320 interpretues dhe mbi 550 spektatorë në Shtëpinë e kulturës "Marko Cepenkov". Në hapje folën kryetari i shoqatës së pensionistëve të Prilepit **Pando Baçanoski** dhe kryetari i LSHPM **Dushko Çurbanovski**.

Mirënjohje shoqërive pjesëmarrëse iu ndau Dushan Pereski, kryetar i Komisionit të JKZ pranë LSHPM.



Në të pesta paradat (rajonale dhe ndër rajonale) morën pjesë 28 shoqata të pensionistëve me 1.124 interpretues para më shumë se 2.200 spektatorëve. Në këto takime u paraqitën edhe shoqëri të reja pjesëmarrëse me grupe të veta dhe individë.

Në parada u kënduan këngë edhe në gjuhët shqip e turqisht. Shoqërimet ishin një gëzim i vërtetë për pjesëmarrësit

dhe të ftuarit e pranishëm. Shoqatat mikpritëse u treguan nikoqirë të mirë, ndërsa organizimi nga an e LSHPM ishte sipas Vendimit të KE.

1.5. PARADA E PESTË RAJONALE E ANSAMBLEVE FOKLORIKE, GRUPEVE TË KËNGËTARËVE DHE INSTRUMENTISTËVE Qershor - shtator 2007

Aktivitetet e planifikuara nga sfera e kulturës në vitin 2007 në kuadër të LSHPM konsistuan në organizimin dhe realizmin e paradave folklorike të pensionistëve në të cilat shoqatat - pjesëmarrëse u paraqitën me këngë burimore dhe qytetare të vjetra, pikë muzikore dhe valle popullore, me solistët e vet përfaqësues, duete dhe grupe më të mëdha, kore dhe orkestra, si edhe grupe valltarësh. Lidhja e shoqatave të pensionistëve nga Maqedonia vendosi që të zhvillohen katër parada rajonale: për shoqatat nga pjesa **jugperëndimore në Ohër**, për **rajonin veriperëndimor në Kumanovë**, për **rajonin juglindor në Vallandovë** dhe **verilindorin në Shtip**. Në vitin 2007 godina u organizuan vetëm parada rajonale të pensionistëve (pa ndër rajonale, përkatësisht paradë republikane), me qëllim që të shmanget përsëritja e programeve dhe dyfishimi i shpenzimeve.

Në **Ohër, me 22 qershor** në Shtëpinë e kulturës "Grigor Përliçev", me programin e vet interpretuan shoqata nga: Prilepi (me dy SHKA pensionistësh), Kërçovë, Krushevë dhe Ohër. Po ashtu performoi edhe shoqata e vëllazëruar e pensionistëve Ohër - "Stara Zagora", Republika Bullgarisë. Në total morën pjesë 90 interpretues para 500 spektatorëve. Këndohej në gjuhët maqedonase, vllahe dhe bullgare. Këngët ishin burimore dhe qytetare të vjetra. Interpretuhej edhe në instrumente bashkëkohore, por edhe në ato tipike, popullore, gajde, curle dhe daulle.

Në takim folën kryetari i komunës na Ohër, **Aleksandar Petrevski**, kryetari i KE të SHP Ohër Dhe Dëbërca **Gjorgji Tërçeski**, kryetari i BNPS nga Stara Zagora **Ivan Caprazov**, kryetari i Kuvendit të LSHPM **Dushko Çurbanovski**, i cili e shpalli të hapur paradën, ndërsa sekretari i KE të LSHPM Çedo Georgievski i ndau mirënjohje pjesëmarrësve. Manifestimit i paraprinte edhe një defile nga vetë Shtëpia e kulturës.

Në **Kumanovë, më 29 qershor** në Qendrën e kulturës "Trajko Prokopiev", në paradën rajonale u paraqitën me programin e tyre shoqata të pensionistëve nga: Gazi Baba, Gjoççe Petrov, Kisella Voda, Kratovë, Tetovë dhe Kumanovë, me gjithsej 251 performues para 800 spektatorëve. Më parë, për shkak të motit të nxehtë u mbajt një defile e shkurtër përpara shtëpisë. Programi ishte i shumëllojshëm: krahas këngëve burimore dhe qytetare të vjetra dhe muzikës popullore burimore e interpretuar nga solistë, duete dhe grupe këngëtarësh, kishte edhe grupe instrumentistësh, kore dhe grupe valltarësh dhe kostume kombëtare nga këto treva. Në këtë manifestim si e ftuar mori pjesë edhe Nadezhda Kasabova, kryetare e pensionistëve nga Sofja, Republika Bullgarisë, që shprehu dëshirën që të interpretojë edhe këngën maqedonase "Tokë maqedonase".



Parada u përshëndet edhe nga kryetari i shoqatës mikpritëse Kumanovë, **Spirko Nikolovski**, kryetari i komunës Kumanovë, d-r Zoran Damjanovski dhe nga sekretari i KE të LSHPM **Çedo Georgievski**, që e shpalli të hapur paradën, ndërsa Dushan Pereski iu ndau pjesëmarrësve mirënjohje. Paradës i paraprinte edhe një ekspozitë me punime dore të realizuara nga shoqata kumanovare e pensionistëve.

Më 6 korrik 2007 në **Vallandovë** në "Skenën e hapur verore", ku u mbajt festivali muzikës popullore Vallandovë, u zhvillua edhe parada folklorike e shoqatave të pensionistëve të rajonit. Ditën tjetër u mundësua edhe një defile në pjesën e qytetit rreth Qendrës dhe skenës. Me programet e tyre u prezantuan shoqatat nga: Bogdanci, Veles, Gjevgjeli, Kavadari, Negotinë dhe Vallandovë me gjithsej 122 interpretues para 350 spektatorëve. Të ftuarit dhe të pranishmit i përshëndetën kryetari i SHP Vallandovë **Leonid Mancev**, kryetari i komunës **Nikolçe Çurlinov**, kryetari i LSHPM **Dushko Çurbanovski**, që e shpalli paradën të hapur, ndërsa mirënjohje pjesëmarrësve i ndau nënkryetari i KE të LSHPM Andon Markovski. Në paradë dominuan grupet e këngëtarëve dhe koret e këngëve qytetare të vjetra dhe veshjeve qytetare të vjetra.

Në **Shtip**, më **27 shtator** në Shtëpinë e kulturës "Aco Shopov" në paradën rajonale morën pjesë një numër i madh shoqëri nga Berovë, Vinica, Dellçevë, Ziletovë, Koçan, Makedonska Kamenica, Probishtip, Radovish, Shën Nikollë, Strumica dhe Shtip, me 153 pjesëmarrës përballë më shumë se 400 spektatorëve. Parada u përshëndet edhe nga kryetari i SHP Shtip, **Mihajlo Krale**v dhe sekretari i KE së LSHPM **Çedo Georgievski**, që njëherazi e shpalli të hapur manifestimin, ndërsa kryetari i komisionit të JKZ Dushan Pereski ndau mirënjohje.

Programi ishte i shumëllojshëm, me interpretime të këngëve tradicionale dhe qytetare të vjetra, me instrumente burimore, me koreografi të shumëllojshme dhe kostume kombëtare të ndryshme. Në paradë kishte edhe një defile të shkurtër (për shkak të shiut).

Në të katër prezantimet revyale rajonet më të rëndësishme morën pjesë me 28 shoqata të pensionistëve me 616 interpretues, para më shumë se 2.000 spektatorëve. Nuk u realizuan pritjet se numri i shoqatave - pjesëmarrës do të rritet. Po ashtu nuk kishte inovacione të dukshme, kryesisht kishte përsëritje nga një vit më parë. Risia e vetme ishte ajo që u këndua edhe në gjuhë vllahe, krahias asaj maqedonishte dhe shqiptare, ndërsa në gjuhën bullgare si i ftuar këndoi shoqata nga Stara Zagora.

1.6. PARADA E GJASHTË E KËNGËVE, MUZIKËS DHE VALLEVE

Qershor - tetor 2008

Këshilli ekzekutiv LSHPM vendoi në vitin 2008 që të organizohen pesë parada rajonale me këngë, muzikë dhe valle. Për përmbushjen e programit morën pjesë 500 interpretues nga 30 shoqata të pensionistëve, ndërsa LSHPM për mbajtjen me sukses të paradave në rajone siguroi mjetet e duhura materiale dhe financiare.

Më **27 qershor të vitit 2008** në **Radovish** performuan shoqata të pensionistëve nga: Probishtip, Kratovë, Llozovë, Ziletovë, Shtip dhe qyteti mikpritës Radovish. Pas defilesh së pjesëmarrësve nëpër qytet, takimi u hap nga kryetari i SHP Radovish dhe Konçe **Jovan Eftimov**, që iu dëshiroi mirëseardhje dhe sukses pjesëmarrësve. Me fjalën e nderit takimin e përshëndeti kryetari i komunës Radovish **Dr. Robert Velkov**, ndërsa parada u shpall e hapur nga **Çedo Georgievski**, sekretar i KE të LSHPM. Për pjesëmarrje të suksesshme në paradë përfaqësuesve të shoqatave iu nda mirënjohje nga Andon Markovski, nënkryetar i KE të LSHPM.

Në **28 qershor** të vitit **2008** në Shtëpinë e kulturës në **Kërçovë** morën pjesë SHKA "Pensionist" dhe SHKA "Penka Koteska" nga SHP Prilep, si edhe grupe këngëtarësh dhe solistësh të shoqatave të pensionistëve Ohër, Kërçovë dhe Krushevë dhe poetja Spasa Jankulovska nga Demir Hisar. Mirëseardhje pjesëmarrësve i dëshiroi kryetari i SHP Kërçovë Stojan **Stankovski**. Me fjalë rasti iu drejtua kryetari i LSHPM **Dushko Çurbanovski**, i cili e shpalli të hapur manifestimin, ndërsa falënderime pjesëmarrësve iu ndanë nga kryetari i komisionit të JKZ pranë LSHPM Dushan Pereski.

Në **11 korrik të vitit 2008 në Gjevgjeli**, në shtëpinë e pensionistëve përballë një publiku të shumtë në numër performuan përfaqësues të shoqatave të pensionistëve nga: Strumica, Bogdanci, Vallandovë, Veles, Kavadar, Negotino dhe Gjevgjeli. Fillimi i paradës ishte me interpretimin e përfaqësuesve të rinj të ansamblit të njohur "Bojmija", si simbol i lidhjes mes rinisë dhe përvojës. Mirëseardhje të ftuarve iu uroi kryetari i shoqatës mikpritëse Gjevgjeli, **Dragica Jovanoviq**. Në emër të LSHPM para u hap nga sekretari i KE, **Çedo Georgievski**, dhe në fund kryetari i KJKZ Dushan Pereski iu ndau falënderime pjesëmarrësve. Me interpretimet e tyre thuajse të gjitha shoqatat patën një performancë mbresëlënëse, ndërsa parada u mbyll me këngë melodioze kushtuar të drejtave të njeriut.



Në **10 tetor 2008 në Koçan** në Qendrën e kulturës "Beli mugri" me grupet e tyre të këngëtarëve, këngëtarët solo, muzikantët dhe valltarët performuan shoqata të pensionistëve nga Berovë, Vinicë dhe Koçan. Në paradë fillimisht foli kryetari i shoqatës nga Koçani **Gjorgji Serafimov**. Në emër të vetëqeverisjes lokale të komunës Koçan foli **Venço Bojkov**, ndërsa parada u shpall e hapur nga **Çedo Georgievski**, sekretar i KE pranë LSHPM, ndërsa mirënjohjet iu ndanë pjesëmarrësve nga Miroslava Petrovska, anëtare e KE pranë LSHPM dhe nga Komisioni i JKZ. Me muzikë, valle u krijua një atmosferë e këndshme shoqërie në restorantin "Sliv" në Vinicë.

Më **15 tetor 2008 në Shkup** si mikpritës ishte **SHP Gazi Baba**. Në paradën në restorantin "Hanibal" morën pjesë shoqata të pensionistëve: Gazi Baba, Gostivar, Gjorçe Petrov, Karposh, Kisella Voda, Kumanovë, Saraj, Tetovë dhe Çair. Pjesëmarrësit dhe të ftuarit i përshëndeti në fillim dhe i uroi sukses dhe mirëseardhje kryetari i komisionit të JKZ pranë LSHPM, njëherazi edhe kryetar i SHP Gazi Baba **Dushan Pereski**.

Takimi i pensionistëve u përshëndet nga **Koce Trajanovski**, kryetar i komunës Gazi Baba dhe kryetar i BNJVL që ceku se do të angazhohet konform Memorandumit të nënshkruar me të gjithë kryetarët e komunave nga Shkupi që më shumë të bashkëpunojnë me shoqatat shkupjane të pensionistëve.

Parada u shpall e hapur nga **Çedo Georgievski**, sekretar i KE pranë LSHPM, ku u ndal tek tradita gjashtë vjeçare e zhvillimit të këtij manifestimi kulturor të pensionistëve. Në emër të LSHPM Dushan Pereski iu ndau mirënjohje pjesëmarrësve në paradë.

1.7. PARADA E SHTATË E KËNGËVE, MUZIKËS DHE VALLEVE

Korrik - shtator 2009

Në bashkëpunim me kryetarët e shoqatave të pensionistëve u caktuan pesë qendra rajonale për zhvillimin e paradave dhe ato në: Probishtip, Tetovë, Krushevë, Kavadar dhe Berovë.

Më **30 qershor** Parada rajonale u mbajt në **Probishtip**, ku performuan shoqata të pensionistëve nga: Radovish, Shtip, Probishtip, Kumanovë, Shën Nikollë, Kriva Pallanka, Zletovë dhe Kratovë. Të

pranishmëve i pari iu drejtua kryetari i SHP Probishtip **Todor Aksentiev**, ndërsa i uroi mirëseardhje në emër të qytetit mikpritës kryetari i komunës **Toni Tonevski**. Me fjalë rasti takimin e hapi nënkryetari i KE të LSHPM **Çedo Georgievski**, ndërsa mbyllja e paradës u parapri me ndarjen e mirënjohjeve pjesëmarrësve nga Dushan Pereski, kryetar i KJKZ.

Në **3 korrik, në Tetovë**, na Paradën rajonale të këngëve, muzikës dhe valleve, me grupe këngëtarësh, solistë, duete dhe instrumentistë performuan shoqatat shkupjane të pensionistëve: Kisella Voda, Gazi Baba, Qendër, Çair, Gjorçe Petrov, Saraj dhe Shuto Orizari, si edhe Gostivar dhe Tetovë. Në Qendrën e kulturës në qytetin nën Sharr, mirëseardhje iu uroi të gjithë të pranishmëve kryetari i kuvendit të SHP Tetovë **Nervet Jashari**, në emër të kryetarit të komunës të ftuarit u përshëndetën nga këshilltari **Kurtish Kurtishi**, ndërsa parada u shpall e hapur nga **Dragi Argirovski**, sekretar i KE pranë LSHPM. Duke pasur parasysh programin e pasur multi-etnik të folklorit burimor dhe qytetar të vjetër, Argirovski tha se shoqërimi kulturor i pensionistëve kontribuon në pasurimin e thesarit tonë folklorik, si edhe për ta ruajtur nga harresa folklorin, traditat dhe identitetin tonë.

Parada u zhvillua në shenjë të programit multi-etnik me folklor burimor dhe qytetar të vjetër, në gjuhët: maqedonisht, shqip, turqisht, gjuha rome dhe serbe. Mirënjohjet iu ndanë pjesëmarrësve nga nënkryetari i KE të LSHPM Georgievski.

Më **5 korrik, në Krushevë** në Paradën rajonale të këngëve, muzikës dhe valleve performuan shoqata të pensionistëve nga: Prilep (me dy SHKA), Ohër, Kërçovë, Krushevë, Demir Hisar, Dibër dhe Makedonski Brod. Në takimin folklorik folën kryetari i shoqatës mikpritëse **Kërsto Stojanovski**, kryetari i komunës së Krushevës, **Vasilço Damceski**, dhe kryetari i LSHPM, **Dushko Çurbanovski**. Në program, krahas gjuhës maqedonase u kënduan edhe në shqip, vllahisht dhe serbisht. Pjesëmarrësve të paradës iu ndanë mirënjohje nga Dragi Argirovski, sekretar i KE pranë LSHPM.

Më **17 shtator, në Kavadar**, Parada rajonale e këngëve, muzikës dhe valleve u mbajt në shenjë të Ditës së pensionistëve. Me grupet e tyre të këngëtarëve dhe ansambleve performuan shoqatat e pensionistëve nga: Velesi, Kavadari, Negotina, Vallandova, Bogdanci, Gjevgjelia dhe Strumica. Në emër të mikpritësit pjesëmarrësit dhe të ftuarit i përshëndeti **Ilija Pemov**, kryetar i KE të SHP Kavadari, ndërsa mirëseardhje të përzemërt të pranishmit i uroi edhe kryetari i komunës së qytetit mikpritës **Aleksandar Panov**. Fjalë rasti mbajti edhe sekretari i KE të LSHPM **Dragi Argirovski**, a mirënjohje të pranishmëve iu ndau Dushan Pereski, kryetar i Komisioni i JKZ. Sipas programit me krijimet e tyre morën pjesë edhe nxënës nga dy shkolla nga Kavadari.

Në **ditën e pensionistëve - 20 shtator**, SHP Berovë ishte mikpritës në Paradën rajonale këngëve, muzikës dhe valleve. Ceremoninë e hapi kryetari i komunës **Dragan Naxhinski**, ndërsa manifestimi u shpall i hapur nga **Çedo Georgievski**, nënkryetar i KE të LSHPM. Në paradë me një repertor të pasur dhe në ambient të stolisur me kostume Osogovase u prezantuan ansamblet, grupet e këngëtarëve, solistëve dhe instrumentistëve të shoqatave të pensionistëve nga: Koçan, Vinica, Makedonska Ka-

menica, Berovë dhe Pehçevë. Mirënjohjet për pjesëmarrjen u ndanë për pjesëmarrësit nga kryetari i shoqatës Dragi Argirovski, sekretar i KE pranë LSHPM.

Për t'u cekur është se në **Paradën e shtatë të këngëve, muzikës dhe valleve - 2009**, që u mbajt në rajone në qytet të caktuara morën pjesë gjithsej 37 shoqata të pensionistëve, që është shumë më tepër sesa një vit më parë, megjithatë nuk kishte justifikime të mëdha për shoqëritë Dellçevë, Karposh,



Resen, Strugë dhe disa të tjerë që nuk morën pjesë. Në paradat rajonale kishte në total 250 pjesëmarrës të drejtpërdrejtë, që performuan para 2.500 spektatorëve. Pjesëmarrje të veçantë kishin edhe kryetarët e komunave si edhe përfaqësues të tjerë të vetëqeverisjes lokale.

1.8. PARADA E TETË E KËNGËVE, MUZIKËS DHE VALLEVE

Qershor - tetor 2010

Lidhja e shoqatave të pensionistëve Maqedoni për herë të tetë me sukses i organizoi paradat rajonale folklorike që u bënë traditë e jetës kulturore të pensionistëve. Është vërejtur përparim në masivizimin e prezantimeve, ashtu që 2 shoqëri u shtuan numrit të pjesëmarrësve, në raport me një vit më parë, nga 37 në 39, ndërsa u përmirësuan së tepërmi edhe cilësia dhe kontributi për ruajtjen e pasurisë kulturore. Edhe këto parada u organizuan në 5 rajone, në qytetet: Shën Nikollë, Prilep, Vinica, Gjorçe Petrov dhe Strumica.

Në **Shën Nikollë** Parada e këngëve, muzikës dhe valleve u mbajt në Shtëpinë e kulturës "Kërste Misirkov". Në këtë prezantim tradicional performuan shoqata të pensionistëve nga Kumanova, Kriva Palanka, Kratovë, Probishtip, Zilletovë, Shtip, Radovish dhe qyteti mikpritës. Fjalë rasti mbajtën **Mirko Danailov**, kryetar i SHP Shën Nikollë dhe kryetari i komunës **Vasko Peshev**, ndërsa parada u shpall e hapur nga **Çedo Georgievski**, nënkryetar i KE të LSHPM. Performanca e suksesshme e shoqërive u përshëndet nga kryetari i komisionit të JKZ **Dushan Pereski**, i cili i ndau mirënjohjet.

Më **13 korrik** në Qendrën e kulturës në **Prilep** u mbajt parada e pensionistëve, e këngëve muzikës dhe valleve nga rajoni jugperëndimor ku morën pjesë shoqata nga: Ohër, Krushevë, Demir Hisar, Makedonski Brod, Kërçovë, Dibër, qyteti mikpritës i SHP Shtip, si i ftuar. Performuan solistë, duete, poetë, grupe këngëtarësh me melos maqedonas, shqiptar dhe vllah, si edhe dy SHKA nga Prilepi, me një përshirje të madhe të këngëve burimore popullore me motive patriotike. Ashtu si edhe në paradën e 7 edhe e 8-ta në këtë rajon nuk performuan shoqatat nga Resen dhe Struga. Pjesëmarrësit dhe të ftuarit në sallën e tejmbushur (rreth 650) i përshëndeti kryetari i SHP Prilep **Kiril Gjorgjiioski**, ndërsa për ecurinë e këtij manifestimi folklorik foli edhe **Dragi Argirovski**, sekretar i KE pranë LSHPM. Dushan Pereski, kryetar i KJKZ pranë LSHPM, iu ndau mirënjohje pjesëmarrësve.

Më **4 shtator** në **Vinice**, në Shtëpinë e kulturës shfaqje të suksesshme kishin edhe grupet e këngëtarëve, ansamblet, duetet, solistët dhe poetët nga shoqatat e pensionistëve nga: Koçan, Berovë, Makedonska Kamenica, Pehçevë dhe qyteti mikpritës, ndërsa për dy vjet me radhë nuk morën pjesë SHP Dellçevë. Të pranishmit në paradë i përshëndeti **Mladen Petrov**, kryetar i SHP Vinica dhe kryetari i komunës **Emil Donçev**, ndërsa me fjalë rasti iu drejtua **Dushko Çurbanovski**, kryetar i LSHPM. Mirënjohjet pjesëmarrësve iu ndanë nga Çedo Georgievski, nënkryetar i KE të LSHPM.

Më **22 shtator** në restorantin në **Liçenin e Treskës në Shkup**, u mbajt Parada e planifikuar rajonale e këngëve, muzikës dhe valleve, në të cilën me programe të përshtatshme performuan shoqatat e pensionistëve nga: Tetovë, Gostivar dhe shoqatat nga Shkupi të pensionistëve- Kisella Voda, Gazi Baba, Karposh, Qendër, Çair dhe Butel, Saraj, Shuto Orizari dhe mikpritësi Gjorçe Petrov.

Për rëndësinë e këtij manifestimi kulturor folën **Metodija Novkovski**, kryetar i KE të SHP Gjorçe Petrov, **Dushko Çurbanovski**, kryetar i LSHPM dhe kryetari i komunës **Sokol Mitrovski**, që e shpalli të hapur paradën. Mirënjohje iu ndanë pjesëmarrësve nga Dragi Argirovski, sekretar i KE pranë LSHPM.

Kushtet në restorant ndikuan negativisht që të vijë në shprehje cilësia e kësaj parade, pra edhe u imponua ideja që manifestimet të zhvillohen në skena të hapura, ose edhe në salla adekuate të pajisura me mjete për këtë qëllim.

Paradat e teta folklorike të këngëve, muzikës dhe valleve në **vitin 2010** u mbyllën me takimet e pesta të shoqërive më **7 tetor në Strumicë**. Në Shtëpinë e kulturës kryesisht me grupet e këngëtarëve dhe orkestrave performuan përfaqësuesit e shoqatave nga: Veles, Vallandovë, Bogdanci, Gjevgjeli, Dojran, Negotino, Kavadar me pensionistët e moshuar dhe invalidë nga qyteti mikpritës, ndërsa grupi i këngëtarëve i SHP Gazi Baba morën pjesë si të ftuar. U dëgjuan shumë këngë të vjetra qytetare të suksesshme dhe serenada.



Në hapjen e paradës folën **Dance Daskalovska**, kryetar i KE të SHP Strumica dhe kryetari i komunës **Zoran Zaev**, ndërsa në emër të organizatorit - LSHPM, **Dushko Çurbanovski**, kryetar i Lidhjes. Në fund me fjalë rasti u ndanë edhe mirënjohjet pjesëmarrësve nga **Çedo Georgievski**, nënkryetar i KE të LSHPM. Ashtu si edhe ato të tjerat, edhe ky takim u mbyll me shoqërim të përbashkët, me këngë dhe valle, me shkëmbimin e përvojave, me shtrirjen e miqësive dhe të ngjashme.

Këshilli ekzekutiv LSHPM vendosi që në Festivalin ndërkombëtar i moshës së tretë të jetës në Lubjanë - Slloveni, të përfaqësohet me Lidhjen dhe Republika e Maqedonisë nga Shoqata e pensionistëve nga Kumanova. Me prezantimin e SHP Kumanovë, me ansamblin "Gjoko Simonovski", LSHPM dhe krijimtaria kulturore që e kultivojnë pensionistët nga Maqedonia filloi që të afirmohet në formë të rëndësishme edhe në plan ndërkombëtar.

1.9. PARADA E NËNTË E KËNGËVE, MUZIKËS DHE VALLEVE

Qershor - shtator 2011 godina

Në vitin 2011 sipas Programit të punës së LSHPM dhe shënimit të 65-vjetorit të organizimit të pensionistëve në Maqedoni, që të nëntë paradat rajonale të pensionistëve, të këngëve, muzikës dhe valleve, në Shkup mikpritës Shoqata e pensionistëve të luftës, Vallandovë, Kriva Pallanka, Kërçovë dhe Makedonska Kamenica.

Në **Shkup**, më **18 qershor 2011** në Shtëpinë e ARM u mbajt parada rajonale e këngëve, muzikës dhe valleve, ku me përfaqësues të tyre performuan shoqata të pensionistëve: Gazi Baba, Kisella Voda, Solidarnost - Aerodrom, Karposh, Taftalixhe, Qendër, Butel dhe Çair, Pensionistët e luftës, Gjorçe Petrov, Shuto Orizari dhe Saraj nga Shkup, i shoqatave të pensionistëve nga Gostivar dhe Tetovë. Pjesëmarrësit dhe të ftuarit fillimisht i përshëndeti mikpritësi, kryetari i SHVP **Dragan Bozarevski**, ndërsa një fjalim impresiv mbajti edhe kryetari i LSHPM **Dragi Argirovski**, për rëndësinë e manifestimeve. Krahas të tjerave, ai ceku se në këto parada folklorike LSHPM insiston që të ruhet krijimtaria burimore dhe të zhvillohen vlerat kulturore tek maqedonasit, shqiptarët, turqit, serbët, vllahët, romët dhe të gjithë të tjerët që jetojnë në Maqedoni, dhe më pas e shpalli të hapur paradën.

Mirënjohje pjesëmarrësve iu ndau nënkryetari i Kuvendit të LSHPM Besnik Pocesta.

Më **15 qershor, Vallandovë** - qyteti i shëgëve, fiqve dhe këngëve, ishte mikpritës i Paradës së nëntë të këngëve, muzikës dhe valleve. Skena e Festivalit të Vallandovës mbledhi shoqatat e pensionistëve nga zona e nën Vardarit që ta demonstrojnë përgatitjen e tyre për interpretimin. Pjesëmarrës nga: Strumica, Dojran, Bogdanci, Kavadari (pensionistë të moshuar dhe invalidë), Negotinë, Veles, Gjevgjeli dhe Vallandovë, fillimisht i përshëndeti dhe i uroi mirëseardhjen kryetari i SHP Vallandovë, **Leonid Mançev**. Po ashtu, në emër të qytetit mikpritës, të pranishmit i përshëndeti kryetari i komunës **Nikolce Çurlinov**, ndërsa në emër të organizatorit LSHPM, me një fjalë rasti iu drejtua edhe sekretari i KE **Stanka Trajkova**, që edhe e shpalli të hapur paradën. Në kuadër të bashkëpunimit ndër komunal në paradë per-

formuan edhe përfaqësues të shoqatave të pensionistëve nga Manastiri dhe Prilepi.

Më **30 qershor**, në **Kriva Pallanka**, në sallën e kinemasë së Qendrës së Kulturës u mbajt parada rajonale e këngëve, muzikës dhe valleve. Në manifestimin morën pjesë 9 shoqëri, që ishin nga : Kriva Palanka (mikpritësi), Ziletovë, Probishtip, Llozovë, Radovish dhe Konçe, Shtip dhe Karbinci, Kratovë, Shën Nikollë dhe Kumanovë. Parada u hap me një defile të pjesëmarrësve nëpër qytet, ndërsa mirëseardhje i uroi të gjithëve kryetari i shoqatës mikpritëse **Slavko Stojanovski**. Fjalë rasti mbajtën nënkryetari i KE të LSHPM **Metodija Toshevski** dhe kryetari i komunës Kriva Pallanka **Arsenço Aleksovski**. Mirënjohje pjesëmarrësve iu ndau Arsen Ilievski, anëtar i Komisionit dhe informimit në LSHPM.

Parada rajonale e këngëve, muzikës dhe valleve në rajonin jugperëndimor u mbajt në **3 shtator 2011** në Qendrën e Kulturës në **Kërçovë**. Performuan shoqata të pensionistëve nga: Kërçovë, Krushevë, Makedonski Brod, Prilep, Dibër, Ohër dhe Debërca, Demir Hisar dhe Gostivar, si i ftuar. Fillimisht pjesëmarrësit dhe të ftuarit i përshëndeti **Lubomir Lukaroski**, kryetar i shoqatës mikpritëse, ndërsa fjalë rasti mbajtën kryetari i komunës Kërçovë **Blagoja Despotoski** që të gjithëve ia uroi jubileun e dyfishtë, 21 vjetorin e pavarësisht të RM dhe 65 vjetorin e organizimit të pensionistëve në Maqedoni. Në takim në gjuhët maqedonisht dhe shqip foli edhe **Besnik Pocesta**, nënkryetar i Kuvendit të LSHPM, që theksoi rëndësinë e karakter-



it multi-etnik të paradës. Pjesëmarrësit me prezantimet e tyre shumë autentike treguan zakonet dhe traditat burimore të tyre, si shenjë e identitetit dhe të pasurisë kulturore. Mirënjohjet u ndanë nga nënkryetari i KE të LSHPM Metodija Toshevski.

Parada rajonale e këngëve, muzikës dhe valleve në rajonin lindor u mbajt në **4 shtator** në sallën e kinemasë së **Makedonska Kamenica**. Në këtë manifestim kulturor të pensionistëve morën pjesë shoqatave nga: Koçan, Berovë, Vinica, Pehçevo, Dellçevë dhe Makedonska Kamenica. Pjesëmarrës dhe të ftuarit fillimisht i përshëndeti kryetari i shoqatës mikpritëse **Vidan Konevski**, ndërsa me fjalë rasti iu drejtua edhe kryetari i komunës **Darko Mitevski**. Kryetari i LSHPM **Dragi Argirovski**, duke e shpallur të hapur paradën iu drejtua të pranishmëve duke folur për rëndësinë e këtij manifestimi dhe vlerësoi përparimin tek organizmi dhe pasurimi i përmbajtjeve, ku edhe ceku se në të 5-të rajonet morën pjesë 43 shoqata të pensionistëve, që është pesë herë më shumë nga parada e parë që u mbajt në vitin 2003 në Probishtip.

Mirënjohje të pranishmëve iu ndau Stanka Trajkova, sekretar i KE pranë LSHPM.

Duke parë suksesin e të nëntë paradeve të pensionistëve të këngëve, muzikës dhe valleve, u përcaktua që SHP Probishtip të marrë pjesë në Festivalin ndërkombëtar të moshës së tretë të jetës në Lubjana - Slloveni, që mbahet më 1 tetor, me rastin e Ditës së të moshuarve. Në këtë manifestim të rëndësishëm të SHP Probishtip perfomoi edhe SHKA "Pensionistët e hareshëm".

1.10. PARADA E DHJETË E KËNGËVE, MUZIKËS DHE VALLEVE

Qershor - shtator 2012

LSHPM në vitin 2012 solli risi në organizmin dhe mbajtjen e paradeve folklorike të pensionistëve. Fillimisht filloi me riorganizmin e Komisionit të JKZ në përbërjen e të cilit hynë: Milevka Zdravkovska (kryetar), Leonid Mançev, Nurie Kadriu, Vidan Konevski, Slavica Lambasha, Vanja Markovska, Borivoje Bojaxhiev, Ilija Gjorgev dhe Cvetanka Angelkovska. U bënë edhe ndryshime të rëndësishme dhe në

rigrupimin e shoqatave nëpër rajone dhe në vend të 5, ashtu si vitet e tjera, u ndanë 6 rajone, ndërsa i kushtoi rëndësi edhe rregullimit më adekuat të kriterëve të prezantimit dhe pjesëmarrjen nëpër parada. Po ashtu, si selektor i SHP për pjesëmarrje në Paradën republikane u zgjodh regjisori Tihomir Bačovski. Njëkohësisht drejtuesit e LSHPM në këtë vit filluan intensivisht që të bashkëpunojnë edhe me Ministrinë e kulturës së RM, si edhe me vetëqeverisjen lokale nëpër të gjithë Republikën, dhe në një korrelacion të tillë të lidhjeve sponsorë të Paradave të dhjeta jubilarë të këngëve, muzikës dhe valleve ishin Ministria e kulturës dhe qyteti i Shkupit.

Paradat rajonale të këngëve, muzikës dhe valleve në **vitin 2012** filluan më **6 qershor** në **Probishtip**, në qytetin ku në vitin 2003 u mbajt edhe Parada e parë folklorike. Dhjetëvjetori jubilar i paradave mori një rëndësi më të madhe me shpalljen e vitit 2012-ta, si vit të solidaritetit dhe bashkëpunimit ndër gjen-eratah dhe me këtë moto u mbajtën edhe parada republikane. Me një simbolikë të tillë filloi parada rajonale në Probishtip, me prezantimin e nxënësve - violinistë nga shkolla fillore e muzikës, të cilët interpretuan edhe kompozime të njohura. Në takim fjalë rasti mbajtën kryetari i SHP Probishtip **Gruica Manasiev**, kryetari i Këshillit të komunës **Ranko Davitkov** dhe kryetari i LSHPM **Dragi Argirovski**, që ceku rëndësinë e paradave në vite dhe kontributin e këtij manifestimi në ruajtjen dhe rinovimin e trashëgimisë kulturore, si një dëshmitar i mbijetesës. Pastaj në skenë u shfaqën shoqëritë pjesëmarrëse nga: Shtip dhe Karbinci, Llozovë, Probishtip, Shën Nikollë, Ziletovë, Radovish dhe Konçe, si dhe Strumica. Mirënjohje për suksesin iu ndau Aleksandar Zahariev, anëtar i KE pranë LSHPM.

Më **8 qershor** parada rajonale u mbajt në **Kavadari**, dhe në të performuan shoqata të pensionistëve nga: Negotino, Nov Dojran, Kavadari, Vallandovë, Bogdanci, Veles, Gjevgjeli dhe Pensionistët invalidë nga qyteti mikpritës. Në ceremoninë e hapjes në Shtëpinë e kulturës në Kavadar folën: **Risto Angjushev**, kryetar i KE të SHP Kavadari, kryetari i komunës **Aleksandar Panov** dhe **Dragi Argirovski**, kryetar i LSHPM, ndërsa mirënjohjet u ndanë nga Milevka Zdravkovska, kryetar i Komisioni të JKZ pri LSHPM.

Më **16 qershor** në Qendrën e kulturës në **Kumanovë** Parada rajonale e këngëve, muzikës dhe valleve kaloi me rregullin dhe organizmin më të mirë. U prezantuan shoqata të pensionistëve nga: Kumanovë, Kriva Pallanka, Kratovë, Qendër, Gazi Baba, Kisella Vodë, Pensionistët e luftës dhe Solidariteti - Aerodrom. Takimi u hap me fjalën rasti nga kryetari i SHP Kumanovë **Spirko Nikolovski**, kryetari i komunës Kumanovë **Zoran Damjanovski** dhe sekretari i KE të LSHPM **Stanka Trajkova**, që e hapi paradën, ndërsa mirënjohje i ndau pjesëmarrësve Done Todorovski, anëtar i KE të LSHPM.

Më **27 qershor** në Qendrën e kulturës në **Tetovë** u mbajt parada me pjesëmarrës nga rajoni i 5-të, në të cilën me program të shumëllojshëm dhe interesant u prezantuan shoqata nga: Çair dhe Butel, Gjorçe Petrov, Gostivar, Karposh, Saraj, Shuto Orizari, Taftalixhe dhe Tetovë. Në emër të mikpritësit takimin e përshëndeti **Gojko Eftovski**, kryetar i Kuvendit dhe **Shaban Azizi**, kryetar i KE të SHP Tetovë, që foli në gjuhën shqipe, ndërsa parada u shpall e hapur nga nënkryetari i Kuvendit të LSHPM Besnik Pocesta, ndërsa mirënjohjet iu ndanë pjesëmarrësve nga Vanja Markovska, anëtar i Komisionit të JKZ.



Më **1 shtator**, në Qendrën e kulturës në **Koçan**, mirësearchje pjesëmarrësve të shoqatave të pensionistëve nga: Berovë, Vinica, Makedonska Kamenica, Pehçevo, Koçan dhe Dellçevë, fillimisht i uroi kryetari i shoqatës mikpritëse **Gjorgji Serafimov**, ndërsa takimi u përshëndet edhe nga kryetari i Këshillit të komunës **Spirko Georgiev**. Në emër të organiza-

torit, LSHPM, fjalë rasti mbajti edhe sekretari i LSHPM **Stanka Trajkova**, që njëherazi e shpalli të hapur paradën. Pjesëmarrësve iu ndanë mirënjohje për pjesëmarrjen.

Parada rajonale e këngëve, muzikës dhe valleve për pjesëmarrësi e rajonit jugperëndimor u mbajt me **2 shtator në Manastir, shoqata që sërish u bë anëtare e Lidhjes**. Në manifestimin më të madh të pensionistëve në qytetin e konsujve performuan shoqatat e pensionistëve nga: Ohër dhe Debërca, Prilep, Makedonski Brod, Demir Hisar, Manastir, Kërçovë, Krushevë dhe Dibër. Pjesëmarrësit dhe të pranishmit fillimisht i përshëndeti **Tome Ilioski**, kryetar i KE të SHP Manastir, ndërsa në hapjen solemne të takimit folën kryetari i komunës Manastir **Vladimir Taleski** dhe kryetari i LSHPM **Dragi Argirovski**. Takimi u mbyll në shoqëri të përbashkët në restorantin "Imperator", ndërsa mirënjohje pjesëmarrësve, në emër të organizatorit LSHPM, iu ndau Ilija Adamoski, anëtar i KE të LSHPM.

PARADA E DYTË REPUBLIKANE E KËNGËVE, MUZIKËS DHE VALLEVE

Shkup, 25 shtator 2012

Më 25 shtator 2012 në Sallën universale në **Shkup**, u mbajt Parada e dytë republikane e këngëve, muzikës dhe valleve. Selektori Tihomir Bačovski me ndihmën e Këshillit organizativ dhe Komisionit të JKZ për paradën republikane zgjodhi 33 prezantues më të mirë të shoqatave të pensionistëve pjesëmarrëse në paradat rajonale që performuan përballë më shumë se 1.500 spektatorëve. Për herë të parë në një manifestim të tillë ishin prezent dhe folën edhe ministrja e kulturës **Elizabeta Kančeska-Milevska** dhe kryetari i komunës Shkup



dhe kryetar i BNJVL **Koce Trajanovski**, ndërsa mes të pranishmëve ishin edhe ministri i punës dhe politikës sociale **Spiro Ristovski** dhe kryetari i SSM **Zhivko Mitrevski**. Fjalë rasti impesive mbajtën edhe kryetari i LSHPM **Dragi Argi-**

rovski, i cili ceku në më shumë aspekte rëndësinë e paradave republikane dhe rajonale. Mikpritës i suksesshëm i paradës ishte Lidhja e shoqatave të pensionistëve të qytetit Shkup, me në krye me kryetarin **Kërste Angelovski**, ndërsa sponsor shtesë ishte edhe kompania "Tineks". Për suksesin e shfaqjes së shoqatave iu dhanë falënderimi, ndërsa shoqërimi ishte në hotelin "NEW STAR" në Vizbeg me bendin "Drim tim", ku performoi edhe këngëtarja e njohur **Irena Spasovska**. Pjesëmarrësit më të mirë në Paradën e dytë republikane të këngëve, muzikës dhe valleve - SHP Koçan, mori pjesë në Festivalin e moshës së tretë të jetës në Lubjana - Slloveni që e prezantoi në formën më të mirë të mundshme Lidhja e shoqatave të pensionistët Maqedoni dhe Republika Maqedonisë.

1.11. PARADA E NJËMBËDHJETË E KËNGËVE, MUZIKËS DHE VALLEVE

Maj - qershor 2013

Parada e njëmbëdhjetë rajonale dhe e treta republikane e muzikës, këngëve dhe valleve në vitin 2013 u organizuan sipas vendimit dhe orientimeve të Këshillit ekzekutiv të LSHPM. Si mikpritës dhe bashkë organizatorë të LSHPM ishin shoqatat e pensionistëve: Gostivar, Ohër dhe Debërca, Dellçevë, Radovish dhe Konçe, Kisella Vodë dhe Veles.

Më **9 maj** në paradën e mbajtur në **Gostivar** performuan shoqatat e pensionistëve nga: Gjoçe Petrov, Karposh, Saraj, Taftalixë, Tetovë, Çair, Butel, Shuto Orizari dhe Gostivar. Të pranishmëve fillimisht iu drejtua kryetari i shoqatës mikpritëse **Nijazi Xhelili**, ndërsa në emër të LSHPM takimi u përshëndet nga **Besnik Pocesta**, nënkryetar i Kuvendit të Lidhjes. Mirënjohje të pranishmëve iu ndau Vangelica Markovska.

Më **11 maj** në Qendrën e kulturës në **Ohër** ishte Qendër ku u mbajt Parada e këngëve, muzikës dhe valleve e shoqatave të pensionistëve nga ai rajon. Performuan shoqata nga: Ohër dhe Debërca, Prilep, Manastir, Krushevë, Kërçovë, Dibër, Demir Hisar, Struga, Makedonski Brod dhe si i ftuar Ansambli folklorik i SHP Vranjë. Në takim folën kryetari i KE të SHP Ohër i Debërca **Gjorgji Trpçeski**, kryetari i LSHPM **Dragi Argirovski** dhe kryetari i Këshillit të komunës **Gordana Konjanoska**, që e hapi edhe paradën. Pas prezantimit me sukses pjesëmarrësve të shoqatave me prezantime këngësh burimore, folklorike dhe qytetare të vjetra iu ndanë mirënjohje nga Cvetanka Angelkovska, anëtare e Komisionit të JKZ.

Në paradën e këngëve, muzikës dhe valleve në **Dellçevë**, më **12 maj**, morën pjesë gjashtë shoqata të pensionistëve nga rajoni lindor: Dellçevë-mikpritës, Berovë, Pehçevo, Koçan, Vinica dhe Makedonska Kamenica. Mirëseardhje i uroi pjesëmarrësve dhe të ftuarve kryetari i SHP Dellçevë **Slavčo Dimitrovski**, ndërsa fjalë rastit u mbajt nga nënkryetari i KE të LSHPM **Metodija Toshevski**. Parada filloi me defilenë nëpër qytet që kaloi në një organizim të mirë dhe performacë të shkëlqyer të pjesëmarrësve që iu ndanë mirënjohje nga Milevka Zdravkovska, kryetar i Komisionit i JKZ pranë LSHPM.

Më **16 maj**, Parada rajonale e këngëve, muzikës dhe valleve në **Radovish** u mbajt në Qendrën e kulturës "Aco Karamanov" dhe filloi me defilenë nëpër rrugët e qytetit. Krahas kryetarit të SHP Radovish dhe Konçe **Jordan Kostadinov**, në paradë folën edhe të dy kryetarët e të dy shoqatave **Sashko Nikolov** dhe **Blagoj Jovanov**, ndërsa fjalë rasti në emër të LSHPM mbajti **Stanka Trajkova**, sekretar i KE, që hapi edhe manifestimin. Prezantimi i pjesëmarrësve të shoqatave të pensionistëve nga: Shtip, Llozovë, Radovish dhe Konçe, Probishtip, Strumica, Novo Sellë, Shën Nikollë dhe Ziletovë, u përshëndet me duartrokitje të bujshme nga publiku i shumë në numër. Falënderime u ndanë pjesëmarrësve nga Borivoj Bojaxhiev, anëtar i Komisionit i JKZ pranë LSHPM.



Më **17 maj** në Shtëpinë e ARM në **Shkup**, SHP Kisella Vodë në rolin e mikpritësit i priti dhe përshëndeti pjesëmarrësit në paradën e këngëve, valleve dhe muzikës së shoqatave të pensionistëve nga: Gazi Baba, Solidariteti - Aerodrom, Kumanovë, Pensionistët e luftës, Kratovë, Kriva Palanka, Qendër dhe Kisella Voda. Pjesëmarrësve dhe të ftuarve iu drejtuan: **Blagoje Arsiq**, kryetar i KE të SHP Kisella Vodë, **Dragi Argirovski**, kryetar i LSHPM dhe kryetari i komunës Kisella Vodë, **Biljana Belicanec**

- **Aleksiq**. Interpretuesit u prezantuan në program me klorit të pasur folklorik, me këngë, valle dhe muzikë, zakone dhe prezantime të tjera nga krijimtaria e pasur kulturore e kësaj zone. Mirënjohje të pranishmëve iu ndau, Nurie Kadriu, anëtare e Komisionit të JKZ pranë LSHPM.

Parada rajonale e këngëve, muzikës dhe valleve ne vitin **2013** u mbajt në **18 maj në Veles**, ndër-
sa mikpritës ishte shoqata amë. Performuan pjesëmarrës të shoqatave të pensionistëve: Bogdanci,
Negotino, Nov Dojran, Kavadari - pensionistët e moshuar dhe invalidë, Gjevgjeli dhe Vallandovë. Folën
kryetari i SHP Veles **Lubomir Gjeorgjiev**, kryetari nga këshilli i komunës **Aleksandar Kolev** dhe sekre-
tari i KE të LSHPM **Stanka Trajkova**, që njëherazi e shpalli të hapur paradën. Pjesëmarrësve iu ndau
falënderime në emër të organizatorit, LSHPM, Milevka Zdravkovska, kryetare e Komisionit të JKZ. Pjesa
finale ishte shoqërimi i përbashkët në liqenin e Velesit.

PARADA E TRETË REPUBLIKANE E KËNGËVE, MUZIKËS DHE VALLEVE

Shkup, 4 qershor 2013

Më 4 qershor 2013, në Sallën universale në Shkup nën mbështetjen e Ministrisë së Kulturës dhe
Qyteti Shkup u mbajt Parada e tretë republikane që tashmë është edhe tradicionale. Duke u
bazuar në përvojat e viteve më parë, parada republikane ishte organizuar mirë dhe u bë shumë interesa-
nte për mediat në vend. Këshilli organizativ dhe Komisioni i JKZ me ndihmën e selektorit, regjisorit me
përvojë në TV Tomçe Stojkov, bënë përzgjedhjen e pjesëmarrësve më të mirë nga paradat rajonale dhe



në skenën e këtij manifestimi final kultur-
or u shfaqën përfaqësues nga 30 shoqa-
ta të pensionistëve. Takimi u mbajt në
shenjë të shënimit të 50-vjetorit të tër-
metit katastrofal në Shkup.

Në fillim kryetari i LSHPM **Dragi Ar-
girovski** përshëndeti pjesëmarrësit dhe
të ftuarit, mes të cilëve ishin edhe
kryetari i SSM Zhivko Mitrevski dhe drej-
tori i sallës universale Vera Boshovska,
që folën për rëndësinë e këtij manifestimi
pensionistësh multikulturor dhe multiet-
nik dhe kontributin në ruajtjen dhe kultivi-

min e pasurisë folklorike dhe tra-
ditave në Maqedoni.

Për këtë dimension të para-
dave foli edhe ministrja e kultu-
rës **Elizabeta Kançeska - Milev-
ska** me theks të posaçëm tek
misioni i përçimit të këtij amaneti
tek gjeneratat e reja. Duke pasur
parasysh të gjitha aspektet e
kontributit të paradave të këngë-
ve, muzikës dhe valleve, Minis-
tria e kulturës së RM i shpalli ato
manifestime kulturore me interes shtetëror.



Parada u ndoq nga më shumë se 1.500 persona, kryesisht pensionistë, por kishte edhe nga gjen-
erata më të reja dhe tek të gjithë të pranishmit la një impresiono të thellë. Sipas jurisë profesionale
prezantimin më të mirë e kishte SHP Tetovë, që u përcaktua që të merrte pjesë në Festivalin ndërkom-
bëtar të moshës së tretë të jetës në Lubjana - Slloveni, ku përfaqësuesit tanë nga qyteti nën Sharr per-
formuan me dy grupe folklorike dhe programe në gjuhët maqedonisht dhe shqip.

1.12. PARADA E DYMBËDHJETË E KËNGËVE, MUZIKËS DHE VALLEVE

Maj - qershor 2014

Manifestimi tradicional kulturor i pensionistëve në Maqedoni që u mbajt në nivel republikan dhe rajonal u shënua si i 12-ti me radhë dhe filloi më 3 maj 2014. Zhvillimi i paradave, organizimi dhe kontinuiteti u bë me mbështetje financiare të LSHPM, dhe po këto u shpallën në këtë vit si manifestime me interes shtetëror të kulturës së Republikës së Maqedonisë paradat e dymbëdhjeta të këngëve, muzikës dhe valleve u mbajtën në 6 qendra rajonale në:

Berovë - 3 maj 2014 - Performuan pjesëmarrës të shoqatave të pensionistëve nga: Vinica, Dellçevë, Koçan, Makedonska Kamenica, Pehçevo dhe Berovë. Folën kryetari i shoqatës mikpritëse **Lupço Gotovski**, kryetari i komunës **Dragi Naxhinski** dhe në emër të LSHPM, nënkryetari i KE të LSHPM **Metodija Toshevski**. Pjesëmarrësve iu ndanë falënderime nga Gjorgji Serafimov, anëtar i KE të LSHPM.

Shën Nikollë - 9 maj 2014 - Performuan si pjesëmarrës shoqëritë nga: Probishtip, Llozovë, Novo Sellë, Shtip dhe Karbici, Strumica, Ziletovë, Radovish dhe Shën Nikollë. Folën kryetari i SHP Shën Nikollë **Nikola Atanasov**, kryetari i LSHPM **Dragi Argirovski** dhe kryetari i komunës së Shën Nikollës **Nikole Zoran Tasev**. Pjesëmarrësve i ndau mirënjohje Milevka Zdravkovska, kryetar i Komisioni i JKZ.

Struga - 11 maj 2014 - Folën kryetari i SHP Struga **Liman Pollozhani**, nënkryetari i Kuvendit të LSHPM **Besnik Pocesta** dhe kryetari i komunës së Strugës **Zijadin Sela**. Pjesëmarrësve iu ndanë mirënjohje nga Cvetanka Angelkovska, anëtare Komisioni i JKZ pranë LSHPM.

Negotinë - 15 maj 2014 - Folën i SHP Negotinë **Petar Zaharçev**, sekretari i KE të LSHPM **Stanka Trajkova** dhe kryetari i komunës Negotinë **Vanço Apostolov**. Pjesëmarrësve iu ndanë mirënjohje nga Milevka Zdravkovska, kryetar i Komisioni i JKZ pranë LSHPM.

Solidariteti - Aerodrom - 20 maj - Folën kryetari i SHP Solidariteti - Aerodrom **Dimitrija Bogatinoski**, kryetari i LSHPM

Dragi Argirovski dhe kryetari i komunës Aerodrom **Ivica Konevski**. Pjesëmarrësve i ndau mirënjohje në emër të LSHPM Vangelica Markovska, anëtare nga Komisioni i JKZ.

Gjorçe Petrov - 28 maj 2014 - Folën kryetari i SHP Gjorçe Petrov **Metodija Novkovski**, nënkryetari i Kuvendit të LSHPM **Besnik Pocesta** dhe kryetari i



komunës Gjorçe Petrov, **Sokol Mitrovski**. Pjesëmarrësve i ndau mirënjohje Rufat Ramadani, anëtar i KE të LSHPM.

PARADA E KATËRT REPUBLIKANE E KËNGËVE, MUZIKËS DHE VALLEVE

Shkup, 10 qershor 2014

ReParada u mbajt në 10 qershor 2014 në Sallën universale në Shkup me mbështetjen e Ministri-së së Kulturës dhe Qytetit Shkup. Me përfaqësues të tyre morën pjesë 35 shoqata të pensionistëve. Para 1.500 spektatorëve folën : kryetari i LSHPM **Dragi Argirovski**, kryetari i komunës Shkup dhe kryetar i BNJVL **Koce Trajanovski** dhe ministrja e kulturës Elizabeta Kançeska - Milevska, që theksoi se



parada e këngës, muzikës dhe valleve është një projekt me interes nacional që në përgjithësi e pasuron jetën kulturore publike në Maqedoni dhe për këtë arsye Ministria e Kulturës edhe më tej do ta mbështesë këtë manifestim të rëndësishëm. Pjesëmarrësve i ndau mirënjohje kryetari i LSHPM Dragi Argirovski dhe kryetari i Lidhjes së qytetit të SHP Kërste Angelovski, si mikpritës i paradës, gjatë qëndrimit

shoqërues në hotel "NEW STAR".

Si përfaqësues i LSHPM nga Maqedonia në Festivalin e moshës së tretë të jetës në Lubjana - Slloveni u zgjodh SHP Prilep, që u prezantua me 2 SHKA - "Pensionisti" dhe "Penka Koteska" me program të pasur kulturor nga ana prilepase, por edhe më gjerë nga Maqedonia.



1.13. PARADA E TREMBËDHJETË E KËNGËVE, MUZIKËS DHE VALLEVE

Maj - qershor 2015

LSHPM në vitin 2015 mori masa dhe aktivitete për zhvillimin e mëtejshëm dhe përmirësimin e jetës kulturore -argëtuese të pensionistëve në vend. Për realizmin më të mirë të aktiviteteve kulturore të shoqatave të pensionistëve, kryesisht përmes paradave të këngëve, muzikës dhe valleve, u bënë disa ndryshime dhe plotësime në Rregulloren e paradave, me çka u bë zgjerimi i rajoneve - nga gjashtë në tetë. Këshilli ekzekutiv i LSHPM në seancën e dytë dhe me përbërjen e re më 15 prill 2015 bëri rizgjedhjen e **Komisionit të jetës kulturore-zbavitëse** (KJKZ) pranë LSHPM, kështu që në përbërjen e re u zgjodhën: Mendo Dimovski (kryetar), Milevka Zdravkovska, Cvetanka Angelkovska, Vangelica Markovska, Slavica Lambasha, Nurie Kadriu, Vangja Peneva, Boris Grkovski dhe Leonid Mançev.

Ashtu si edhe një vit më parë, edhe në vitin 2015, paradat u mbajtën nën mbështetjen e Ministrisë së Kulturës së Republikës së Maqedonisë, ku morën pjesë 43 shoqata të pensionistëve nga 8 rajone:

Ohër i Debërca - 23 maj 2015 - Morën pjesë shoqatave të pensionistëve nga Struga, Kërçovë, Gostivar, Dibër dhe Qendër Zhupa, Makedonski Brod dhe Ohër e Debërca. Mirëseardhje i uroi kryetari i KE të SHP Ohër dhe Debërca **Gjorgji Trpçeski**, ndërsa për rëndësinë e Paradës foli kryetari i LSHPM **Dragi Argirovski**. Pjesëmarrësit dhe manifestimin i përshëndeti duke hapur ceremoninë nënkryetari i komunës Ohër **Angel Janev**. Pjesëmarrësve i ndau mirënjohje në emër të organizatorit LSHPM **Dushan Risteski**, anëtar i KE të LSHPM.

Demir Hisar - 24 maj 2015 - Në Shtëpinë e kulturës "Ilinden" në Demir Hisar pjesëmarrësit nga shoqatat e pensionistëve nga Prilep, Manastir dhe Krushevë, fillimisht i përshëndeti kryetari i shoqatës mikpritëse **Pere Petreski**, ndërsa fjalë rasti mbajtën kryetari i LSHPM **Dragi Argirovski** dhe kryetari i komunës Demir Hisar **Lupço Blazhevski**. Pjesëmarrësve i ndau mirënjohje Cvetanka Angelkovska,

anëtare Komisioni i JKZ pranë LSHPM.

Pensionistët e luftës - Shkup 26 maj 2015 - Në shtëpinë e ARM Shkup performuan një pjesë nga shoqëritë e rajonit të Shkupit : SHP Pensionistët e luftës si mikpritës, Kisella Vodë, Saraj dhe Gazi Baba. Mirëseardhje pjesëmarrësve i uroi Kryetari i SHPV **Gjorgji Zarinski**, ndërsa në emër të Gjeneral Shtabit të ARM të pranishmit i përshëndeti koloneli **Borko Simoski**. Fjalë rasti u mbajt nga kryetari i Kuvendit të LSHPM **Besnik Pocesta**, që hapi edhe manifestimin . Mirënjohje të pranishmëve iu ndau Mendo Dimovski, kryetar i Komisioni i JKZ.

Gjevgjeli - 27 maj 2015 - Pjesëmarrësit e shoqatave të pensionistëve nga rajoni i nën Vardarit : Bogdanci, Kavadari, Negotino, Veles i Gjevgjeli, performuan në Teatrin Popullor, ku në fillim i përshëndeti kryetarja e KE e SHP Gjevgjeli, **Lena Semenakova**, ndërsa mirëseardhje i uroi të pranishmëve kryetari i komunës Gjevgjeli, **Ivan Frangov**. Parada u hap nga kryetari i LSHPM **Dragi Argirovski**, që ceku kontributin në kultivimin dhe pasurimin e krijimtarisë kulturore dhe traditave. Mirënjohje të pranishmëve iu ndau Mendo Dimovski, kryetar i Komisioni i JKZ.

Karposh - 28 maj 2015 - Parada u mbajt në Teatrin e Dramës në komunën Karposh, ku morën pjesë shoqëritë nga: Karposh, Taftalixhe, Butel, Tetovë, Gjorçe Petrov dhe Shuto Orizari. Të ftuarit dhe pjesëmarrësit fillimisht i përshëndeti **Jovan Ginovski**, kryetar i Kuvendit të SHP Karposh, ndërsa në



emër të organizatorit - LSHPM, folën në gjuhët maqedonisht dhe shqip kryetari i Kuvendit të Lidhjes, **Besnik Pocesta**. Pjesëmarrësve i ndau mirënjohje **Vangelica Markovska**, anëtare Komisioni të JKZ.

Kumanovë - 1 qershor 2015 - Pjesëmarrësit në Paradën rajonale në Kumanovë nga shoqatat e pensionistëve: Kumanovë, Kratovë, Kriva Pallanka i SHP Qendër, Çair i

Solidariteti - Aerodrom - Shkup, manifestimi folklorik e filluan me defile nëpër qytet, ndërsa performuan në Qendrën e kulturës "Trajko Prokopiev". Të pranishmit fillimisht i përshëndeti kryetari i Shoqatës mikpritëse **Spirko Nikollovski**, ndërsa në emër të organizatorit, LSHPM, parada u hap nga sekretari i KE **Stanka Trajkova**. Mirënjohje të pranishmëve iu ndau Mendo Dimovski, kryetar Komisioni i JKZ pranë LSHPM.

Strumicë - 2 qershor 2015 - Në Shtëpinë e kulturës në Strumica performuan shoqatat e pensionistëve nga: Probishtip, Shtip dhe Karbinci, Shën Nikollë, Zletovë, Radovish dhe Konçe, Novo Sellë dhe Llozovë. Të pranishmëve iu drejtua: kryetarja e KE së SHP Strumica **Dançe Daskalovska**, kryetari i këshillit të komunës Strumicë **Josif Hristov** dhe **Stanka Trajkova**, sekretar i KE pranë LSHPM, që hapi paradën. Pjesëmarrësve i ndau mirënjohje **Milevka Zdravkovska**, anëtare e Komisionit të JKZ.

Vinica - 3 qershor 2015 - Pjesëmarrës shoqëritë: Vinica, Koçan, Makedonska Kamenica, Dellçevë, Berovë dhe Pehçevo. Parada filloi me një defile në qytet, ndërsa performuan në sallën e sportit të gjimnazit "Vanço Përke" në Vinicë. Në manifestimin e pensionistëve folën: kryetari i KE të SHP Vinica **Dragan Petkov**, kryetari i komunës na Vinica **Emil Donçev** dhe sekretari i KE të LSHPM **Stanka Trajkova**. Pjesëmarrësve i ndau mirënjohje **Gjorgji Serafimov**, anëtar i KE të LSHPM.

PARADA E PESTË REPUBLIKANE E KËNGËVE, MUZIKËS DHE VALLEVE

Shkup, 9 qershor 2015

Manifestimi më i madh kulturor i pensionistëve në vitin 2015 u mbajt në 9 qershor në sallën e Operës dhe Baletit në Shkup. Më këtë prezantim folklorik performuan përfaqësues nga 25 shoqata të pensionistëve, ku më të mirët u zgjodhën nga Komisioni i JKZ pranë LSHPM dhe selektori Tomçe Stojkov. Para më shumë se 900 spektatorëve pjesëmarrës u prezantuan si gardianë të vërtetë të krijimtarisë kulturore dhe traditave si ravijëzues të identitetit tonë dhe mbijetesës mijëra shekullorë. Për më shumë se dy orë u dëgjuan tingujt e këndshëm dhe refrenet e këngëve popullore, këngëve të vjetra qytetare dhe evërgrineve që u gërshetuan ngjyrat e veshjeve popullore burimore, këndohej dhe kërcëhej në gjuhët maqedonisht, shqip, turqisht, vllahe, serbe..., shkrihej gjithçka valle pas valle, këngë pas kënge, zakon pas zakoni dhe traditave dhe ndërtohej mozaiku i quajtur thesar maqedonas folklorik. Rëndësia e paradës u



theksua edhe nga të pranishmit, kryetari i LSHPM **Dragi Argirovski**, kryetari i komunës Shkup **Koce Trajanovski** dhe zëvendës-ministri i kulturës **Dragan Nedelković**. Me kujdes dhe respekt për interpretuesit dhe organizatorin LSHPM, parada u ndoq edhe nga ministri i punës dhe politikës sociale Dime Spasov. Ambienti i këndshëm, pas përfundimit të manifestimit u përçua edhe në shoqërimi në përbashkët në hotelin "NEW STAR" në Vizbeg, ku kryetari i LSHPM Dragi Argirovski i ndau pjesëmarrësve mirënjohje.

Këshilli organizativ dhe Komisioni i JKZ kontribuan në përzgjedhjen e shoqatave të pensionistëve që morën pjesë në Festivalin e 15-të të moshës së tretë, që u mbajt 29 dhe 30 shtator 2015 në Lubjana - Slloveni. Në manifestimin ndërkombëtar të **SHP Radovish dhe Konçe** dhe **SHP Makedonska Kamenica** me dinjitet u prezantuan Republikën e Maqedonisë dhe kontribuan në afirmimin e LSHPM në dimensione më të gjera.

1.14. PARADA E KËTRMBËSHJETË E KËNGËVE, MUZIKËS DHE VALLEVE

Prill - qershor 2016

Në nder të shënimit jubilar të 70-vjetorit të organizimit të pensionistëve dhe 25 vjetorin e pavarësim-it të Republikës së Maqedonisë në vitin 2016 morën pjesë 50 shoqata të pensionistëve- anëtare të LSHPM, përveç Dojran, Vevçanit dhe Labunishtës, me mbi 1.000 përfaqësues të tyre nga tetë rajone:

Shtip dhe Karbinci - 27 prill 2016 - Në Shtëpinë e kulturës "Aco Shopov" në Shtip performuan shoqëritë nga: Shtip dhe Karbinci, Strumica, Llozovë, Novo Sellë, Ziletovë, Shën Nikollë, Radovish dhe Konçe dhe Probishtip. Pjesëmarrësve dhe të ftuarve iu drejtuan: kryetari i SHP Shtip dhe Karbinci **Mihail**

Vasilev, kryetari i komunës Shtip **Ilčo Zahariev** dhe nënkryetari i KE të LSHPM **Saltir Karovski**. Pjesëmarrësve iu ndanë mirënjohje nga Milevka Zdravkovska, anëtare nga Komisioni i JKZ pranë LSHPM.

Kriva Pallanka - 4 maj 2016 - Në këtë paradë në Shtëpinë e kulturës në Kriva Pallanka morën pjesë shoqata të pensionistëve nga komunat : Kriva Palanka, Kratovë, Kumanovë dhe Qendër, Solidariteti - Aerodrom dhe Çair od Shkupi. Fjalë rasti mbajtën: kryetari i SHP Kriva Pallanka **Slavko Stojanovski**, kryetari i LSHPM **Dragi Argirovski** i kryetari i komunës na Kriva Pallanka **Arsenço Aleksovski**. Parada u ndoq edhe nga kryetari i komunës Rankovce Momçilo Aleksovski dhe nënkryetari i KE të LSHPM Saltir Karovski. Mirënjohje të pranishmëve iu ndau Slavica Lambasha, anëtare nga Komisioni i JKZ pranë LSHPM.

Veles - 5 maj 2016 - Në manifestimin rajonal folklorik në Veles u takuan shoqatat e pensionistëve nga rajoni i nën Vardarit: Kavadari, Bogdanci, Negotino, Gjevgjeli, Vallandovë, Demir Kapija si edhe mikpritësi SHP Veles. Pjesëmarrësve i foli kryetari i SHP **Veles Vele Aleksoski** dhe kryetari i LSHPM **Dragi Argirovski**. Pjesëmarrësve iu ndanë mirënjohje nga Leonid Mançev, anëtar nga Komisioni i JKZ pranë LSHPM.

Pehçevo - 9 maj 2016 - Në Shtëpinë e kulturës "Jane Sandanski" performuan shoqatat nga: Pehçevë, Vinica, Koçan, Dellçevë, Berovë dhe Makedonska Kamenica. Fjalë rasti mbajtën: kryetari i SHP Pehçevë **Boris Zarinski**, kryetari i komunës Pehçevo, **Igor Popovski** dhe nënkryetari i KE të LSHPM **Saltir Karovski**. Mirënjohje të pranishmëve iu ndau Gjorgji Serafimov, anëtar i KE të LSHPM.



Gazi Baba - 10 maj 2016 - Në shtëpinë e ARM Shkup performuan shoqatat e pensionistëve: Saraj, Pensionistët e luftës, Kisella Vodë, Solidariteti pensionistët - Ilinden, OVR Shkup dhe mikpritësi SHP Gazi Baba. Folën: kryetari i KE të SHP Gazi Baba **Gjorge Andonov**, kryetari i komunës Gazi Baba **Toni Trajkovski** dhe sekretari i KE i LSHPM **Stanka Trajkova**. Mirënjohje pjesëmarrësve i ndau kryetari i komisionit për JKZ Mendo Dimovski.

Manastir - 11 maj 2016 - Në sallën e Teatrit Popullor pranë Qendrës së kulturës në qytetin e konsujve takimi rajonal folklorik i shoqatave të pensionistëve nga Manastir, Prilep, Krushevë, Demir Hisar dhe për herë të parë SHP Resnjë. Pjesëmarrësve i foli: kryetari i KE të SHP Manastir, **Tome Ilioski**, përfaqësuesi nga Këshilli i komunës Manastir **Sonja Tërpezanova** dhe kryetari i LSHPM **Dragi Argirovski**. Mirënjohje të pranishmëve iu ndau Cvetanka Angelkovska, anëtare nga Komisioni i JKZ pranë LSHPM.

Butel - 17 maj 2016 - Në sallën e sporti në lagjen Radishani, Shkup në Paradën rajonale morën pjesë shoqëritë nga: Tetovë, Shuto Orizari, Taftalixhe, Karposh, Gjorçe Petrov dhe mikpritësi - SHP Butel. Takimi u përshëndet nga: kryetari i SHP Butel, **Lupço Dimovski**, kryetari i komunës Butel, **Petre Latinovski** dhe kryetari i Kuvendit të LSHPM **Besnik Pocesta**, që foli në gjuhët maqedonisht dhe shqip. Mirënjohje të pranishmëve iu ndau Nurie Kadriu, anëtare nga Komisioni i JKZ pranë LSHPM.

Kërçovë - 19 maj 2016 - Mbi 200 pjesëmarrës nga SHP: Kërçovë, Makedonski Brod, Ohër dhe Debërca, Gostivar, Struga, Dibër i Qendër Zhupa, në Shtëpinë e kulturës "Koço Racin" në Kërçovë u prezantuan në Paradën rajonale të këngës, muzikës dhe valleve. Në hapjen e këtij manifestimi kulturor të pranishëmve iu foli: kryetari i KE të SHP Kërçovë **Lubomir Lukarovski** dhe kryetari i Kuvendit **Memet Mehmeti**, që foli në gjuhën shqipe. Po ashtu në gjuhët shqip e maqedonisht folën edhe kryetari i Kuvendit të LSHPM **Besnik Pocesta**. Pjesëmarrësve iu ndanë mirënjohje nga ne emër të LSHPM nga Dushan Risteski, anëtar i KE të LSHPM.

PARADA E GJASHTË REPUBLIKANE E KËNGËVE, MUZIKËS DHE VALLEVE

Shkup, 7 qershor 2016

Më 7 qershor 2016 në Shtëpinë e ARM në Shkup u mbajt paraeda e gjashtë folklorike republikane. Përfaqësuesit e zgjedhur nga 27 shoqata të pensionistëve (661 pjesëmarrës të drejt-përdrejtë) performuan me prezantime interesante dhe të ndryshme, mes të cilave u tregua në formën më të mirë të mundshme pasuria kulturore dhe traditat tona folklorike, që u bënë aktivitet i patë-jkalueshëm në jetesën e pensionistëve. Pensionistët e hareshëm që këndonin në kërcim shkaktuan vëmendje sidomos me melosin burimor dhe prezantimin e koloritit të pasur të trashëgimisë sonë kulturore, si shprehje e identitetit dhe gërshetimit tek diversiteti, që na ka mbajtur ndër shekuj.

Në paradë folën edhe kryetari i LSHPM **Dragi Argirovski**, ministrija e kulturës Elizabeta Kançeska - Milevska dhe kryetari i komunës Shkup dhe kryetar i BNJVL Koce Trajanovski. Ky manifestim i madh kulturor i pensionistëve u ndoq me kujdes dhe respekt të madh edhe nga ministri i punës dhe politikës sociale Dime Spasov. Shoqërimi i



përbashkët ishte në hotelin "NEW STAR" në Vizbeg, ku u ndanë edhe mirënjohjet pjesëmarrësve dhe ishte njëherazi edhe një kontribut në përhapjen e miqësisë dhe krijimin e momenteve të këndshme që fisnikërojnë jetën dhe plakjen aktive.

Parada republikane e këngëve, muzikës dhe valleve, sipas të gjitha kriterëve këtë vit u mbajt në organizmin më të mirë dhe me cilësi të dukshme të të gjithë pjesëmarrësve. Parada u mbulua plotësisht nga mediat. Këshilli organizativ nga Komisioni i JKZ si pjesëmarrës në Festivalin ndërkombëtar për moshën e tretë të jetës në Lubjana - Slloveni, me propozim të selektorit Tomçe Stojkov, zgjodhi SHP Manastir dhe SHP Demir Hisar, që kishin prezantim tepër të suksesshëm.

Parada - tabela 2003 - 2016

Parada	Viti	Shoqata	Pjesëmarrës	Vizitorë
E para rajonale	2003	9	196	500
E dyta rajonale	2004	24	500	900
E treta rajonale	2005	32	700	1.500
E para republikane	2005	5	300	2.000
E katërta rajonale	2006	28	650	1.600
Ndërrajonale	2006	2	300	1.500
E pesta rajonale	2007	28	620	2.050
E gjashta rajonale	2008	30	516	2.000
E shtata rajonale	2009	37	250	2.500
E teta rajonale	2010	39	40	1.980
E nënta rajonale	2011	43	900	2.800
E dhjeta rajonale	2012	45	1.050	2.500
E dyta republikane	2012	33	600	1.600
E njëmbëdhjeta rajonale	2013	47	1.100	2.300
E treta republikane	2013	31	800	1.600
E dymbëdhjeta rajonale	2014	45	1.000	2.000
E karta republikane	2014	33	850	1.600
E trembëdhjeta rajonale	2015	43	1.300	2.600
E pesta republikane	2015	25	600	1.200
E katërmëdhjeta rajonale	2016	50	1.000	2.700
E pesta republikane	2016	27	661	1.200

2. AKTIVITETE TË TJERA TË SHOQATAVE NË SFERËN E KULTURËS

Eksitojnë shumë ngjarje dhe aktivitete kulturore të shoqatave të pensionistëve-anëtare të Lidhjes që janë jashtë Programit të LSHPM dhe të Komisionit të jetës kulturore-zbavitëse, por që janë shumë



aktuale dhe të rëndësishme në kultivimin dhe përçimin e traditave dhe jetës kulturore të pensionistëve. Këto aktivitete praktikohen gjatë shënimit të ngjarjeve kulturore, jubileve, festave shtetërore dhe fetare dhe shumë manifestimeve të tjera me raste të ndryshme, në të cilat pensionistët si organizatorë ose pjesëmarrës konfirmohen si gardianë të vërtetë, vazhdues dhe përçues të traditave dhe pasurisë kulturore në Maqedoni. Një pjesë e këtyre aktiviteteve janë ekskurSIONE edukative - informative, vizita të organizuara në vende historike dhe kulturore ndjekja e shfaqjeve dramatike, Koncerteve muzikore dhe përfshirjes aktive të pensionistëve në manifestime të tilla.

Viteve të fundit u rrit shumë interesi tek pensionistët për të vizituar Teatrin e ri në Shkup, Muzeun e luftës maqedonase dhe Muzeun arkeologjik. Nga spektri i gjerë i aktiviteteve më karakteristike dhe më të rëndësishme dhe më të përfaqësuara në jetën kulturore të pensionistëve janë ato si më poshtë:

2.1. TRADICIONALE KULTURORE-TAKIME ZBAVITËSE DHE MANIFESTIME

Krahas paradave të këngëve, muzikës dhe valleve, që organizohen nga LSHPM, manifestime të ngjashme janë realizuar nga shoqatat e pensionistëve në mbarë republikën. Aktivitete të tilla tradicionale nga sfera e kulturës, kryesisht janë organizuar nga shoqatat e rajonit të nën Vardarit, duke filluar nga Veles, Kavadar, Negotino, Vallandovë, Bogdanci, Gjevgjeli, Dojran dhe shoqatave nga Maqedonia perëndimore - Prilep dhe Manastir. Ato për vite më radhë e zhvillojnë manifestimin "Pensionistët këndojnë". Takimet mbahen me nga katër herë në vit, që do të thotë se çdo shoqatë, pjesëmarrës në manifestim është mikpritës çdo dy vjet. Në repertor kryesisht janë interpretimet korintike, me këngë tradicionale popullore dhe këngë të vjetra qytetare, të shoqëruara me instrumente muzikore burimore, karakteristike për rajonet nga të cilat vijnë interpretuesit. Këto takime mbyllen me shoqërime të përbashkëta, ku sërish kënga, vallja dhe muzika e gërshetojnë unitetin dhe e forcojnë miqësinë e përbashkët, duke respektuar identitetin e pjesëmarrësve dhe përfaqësuesve të bashkësive multietnike.



Po ashtu, shoqatat e pensionistëve janë pjesëmarrës, por edhe iniciatorë dhe organizatorë të takimeve tradicionale rajonale, që i ngjajnë manifestimeve kulturore dhe zhvillohen në zona dhe periudha të ndryshme, por edhe lidhen me data të caktuara, ngjarje dhe festa popullore dhe fetare. Manifestime të tilla janë: Takimet tradicionale kulturore të shoqatave nga rajoni Perëndimor, Takimet në Prilep me rastin e Ditës së Kryengritjes, Takimet multietnike në Tetovë, takime masovike të pensionistëve dhe shoqërime në Star Dojran, Elenec - Makedonska Kamenica, Oraovica - Radovish, Takime tek manastiri Pantelej - Koçan, Eko-hepening në Pelince - Kumanovë, Shoqërimet tradicionale në Lesnovë - Probishtip, Takimet në Saraj - Shkup, Takimi tradicional i pensionistëve nga Struga, pjesëmarrje në manifestimet Vera kulturore e Ohrit dhe Shtipit, "Java e Tominit" në Vinicë, "Shën Trifun" - rregullimi i vreshtave në Kavadar, e të tjera.

Me përfaqësuesit e tyre shoqëritë morën pjesë edhe në Festivalin Folklorik të instrumenteve popullore dhe këngëve "Pece Atanasovski" në Prilep dhe në Dollneni, Festivali i këngëve dhe valleve popullore "Ditët e Ilindenit" në Manastir, Festivali ndërkombëtar "Todorica" në Shën Nikollë, Festivali i këngëve vllahe në Ponikva - Koçan dhe në festivale dhe manifestime të tjera kulturore në vend dhe jashtë tij.

2.2 MANIFESTIMET QË PROMOVOJNË USHQIMET TRADICIONALE

Në disa qytete, shoqatat e pensionistëve në bashkëpunim edhe me vetëqeverisjen lokale organizojnë manifestime përmes të cilave krahas pjesës muzikore-zbavitëse promovojnë edhe ushqimet tona tradicionale. Në Veles prej më shumë se 22 vitesh mbahet "Ëmbëlsirat e gjyshes", në Probishtip "Turshia e gjyshes" dhe "Hepening për Pashkë", në Makedonska Kamenica "Banica në mal", në SHP Kisella Vodë "Korijada" dhe manifestime të ngjashme, të tilla si: pastërmalijada, pitijada, somunijada dhe ushqime të tjera, që janë specifike për zona të caktuara dhe rajone në Maqedoni. Në këto manifestime krahas shprehjes së traditës dhe aftësisë të gruas të aftë maqedonase, specialitetet e përgatitura shiten për të pranishmit, pensionistët dhe qytetarët, ndërsa të hollat e mbledhura donohen për qëllime humanitare. Tradicionale dhe karakteristike janë edhe



veshjet shumëngjyrëshe dhe kostumet e pjesëmarrësve në manifestime, ndërsa takimet kryesisht mbylleen me këngë, valle, muzikë dhe me shoqëri të përbashkët dhe me hare.

2.3 NXITJA DHE KULTIVIMI I KRIJIMTARISË LETRARE

Ka edhe takime nga sfera e poezisë, në të cilat pensionistët tregojnë aftësisë e tyre për fjalën e shkruar, lexojnë krijime dhe poezi nga autorë të njohur dhe të tyre. Kështu SHP Kumanovë për vite me radhë organizon Koncerte dhe mbledhje poetike-muzikore, ashtu si janë manifestimet "Të majit dhe përshëndetjet" dhe "Pensionistët për qytetin e tyre", ndërsa punësoria e dramës pranë SHKA "Gjoko Simonovski" e kësaj shoqate tradicionalisht arrin që të përgatisë shfaqje dhe kabare, me të cilat në raste të ndryshme performon rregullisht përpara pensionistëve dhe publiku më të gjerë në Kumanovë, por



edhe në qytete të tjera. Afirmimi i veçantë i Punëtorisë së dramës ishte me dramën "Kumanovarja Lençe" nga Vasil Ilovski dhe "Mërgimtarët" nga Anton Panov, si edhe shfaqja humoristike skenike "Tek kafeneja përballë shtëpisë" në dialekt kumanovar. Punësoria pati sukses edhe me shfaqjet dramatike "Të verdhë dhe me brirë", në dialekt kumanovar, "Fytyra e dyshimtë" nga Branislav Nushiq, drama "R" nga Jordan Plevnesh (çmimi i parë për rolin mashkull në FDA Koçan), ndërsa merr pjesë tradicionalisht edhe në "Kartolina hokatare" me rastin e 1 prillit, Ditës së shakasë.

Kontribut të rëndësishëm në kultivimin e krijimtarisë letrare jep edhe "Klubi i adhuruesve të librit", i cili prej shumë kohësh funksionon me sukses pranë SHP Solidariteti - Aerodrom në Shkup. Në Klub organizohen takime dhe promovohen libra kryesisht nga autorë - pensionistët, por edhe nga shkrimtarë të tjerë tanët, me qëllim që të nxitet leximi tek pensionistët dhe të ndiqet krijimtaria letrare.

2.4 EKSPOZITA ME VEPRA ARTISTIKE DHE ARTIZANALE

Shoqatat organizojnë edhe aktivitete shoqëruese në manifestimet kulturore-zbavitëse nga artistë amatorë. Ekspozita me piktura, punime dore, punime me qëndisje dhe thurje, por edhe eksponate të tjera, thuajse rregullisht organizohen në kuadër të takimeve revyale kulturore-zbavitëse në nivel rajonal dhe republikan, ndërsa një përfaqësim më të madh vërehet tek shoqatat organizatore dhe mikpritëse të



manifestimeve të tilla. Ekspozitat e tilla rregullisht i organizon SHP Kumanovë, por praktikohen edhe në SHP Kriva Pallanka, Shtip dhe Karbinci, Probishtip, Strumica, Kisella Vodë, Pensionistët e luftës, Solidariteti - Aerodrom, Gazi Baba, Kërçovë, Ohër dhe De-



bërca, Veles dhe në shoqëri të tjera. Krahës tyre, në SHP Veles, me sukses krijohet dhe realizohen vepra unike artistike me kokra orizi nga artistja pensioniste Snezhana Lazarova - Luna, që ka realizuar disa ekspozita të suksesshme në qytetin e saj të lindjes, por edhe në qytete të tjera.

PJESA VII



SPORTI DHE SHOQËRIMI PËR SHPIRT TË SHËNDOSHË NË TRUP TË SHËNDETSHËM

SPORTI DHE SHOQËRIMI PËR SHPIRT TË SHËNDOSHË NË TRUP TË SHËNDETSHËM

Para 21 vitesh, me rastin e Ditës së pensionistëve të Maqedonisë, më 20 shtator të vitit 1996, me iniciativën e një pjese të Kryesisë së Lidhjes dhe disa shoqatave, filloi realizimi i një ideje të bukur: organizimi i garave sportive masive të pensionistëve të Maqedonisë. Realizimi i kësaj ideje bazohet në faktin se sporti në moshën më të thyer të jetës mundëson të mirëmbahet funksioni fizik dhe intelektual i organizmit të njeriut dhe shpirt i shëndoshë në trup të shëndetshëm. Iniciativa iu dorëzua 34 shoqatave të pensionistëve, të cilat dhanë mendime dhe propozime të ndryshme. Me këtë rast shumë individë dyshuan se pensionistët do të interesohen për sportin dhe nëse do të sigurohen mjetet e nevojshme materiale për qëllimin në fjalë. Pas analizës përkatëse u konstatua se në përgjigjet e dhëna dominoi optimizmi dhe përfitimet e organizimit sportiv sepse krahas përfitimeve në aspektin e shëndetit, sporti do të ndihmonte edhe për përhapjen e miqësisë dhe për tejkalimin e monotonisë në jetën e pensionistëve.

1996

Në Garat e Para Sportive Republikane të Pensionistëve (GPSRP) që u mbajtën në Ohër, më **28 gusht 1996**, morën pjesë vetëm 13 shoqatat me seli në Ohër, Kumanovë, Tetovë, Strumicë, Radovish, Gostivar, Resnjë, Kërçovë, Veles, Negotino, Koçanë, Probishtip dhe OPB Shkup, me gjithsej 150 pjesëmarrës, 45 nga të cilat garuan në shah, qitje dhe pikado. Në shah fitoi ekipi i OPB - Shkup, në qitje fitoi ekipi i Tetovës, ndërsa në pikado fituan femrat e SHP Kumanovë. Garat e para republikane të pensionistëve, të hapura i shpalli **z. Andon Markovski**, nënkryetari i atëhershëm i Lidhjes së pensionistëve të Maqedonisë. Megjithëse u arritën rezultate modeste, duke theksuar se në vendet e Ballkanit këto lojëra ishin lojërat e para sportive të pensionistëve.

Me kalimin e viteve u rrit cilësia e lojërave dhe të njëjtat u bënë më masive, ndërsa konfirmimi për këtë gjë vjen me të dhënat e garave sportive republikane të pensionistëve që u mbajtën sivjet, me rastin e jubileut 70-vjeçar të organizimit të pensionistëve në Maqedoni. Në këtë garë, e cila ishte gara e 21-të, morën pjesë mbi 1.200 pensionistë. Në 11 disiplina garuan 500 pensionistë dhe pensioniste ose mbi 11 herë më shumë se garat e para.



1997

Në vitin **1997**, në Garat e Dyta Sportive Republikane të Pensionistëve (GDSRP) në **Dojran**, morën pjesë 80 garues dhe 270 tifozë dhe të ftuar nga 19 shoqatat me seli në: Berovë, Manastir, Gostivar, Gjevgjeli, Kavadar, Kërçovë, Koçanë, Kriva Pallankë, Kumanovë, Ohër, Prilep, Radovish, Shën Nikollë, Strumicë, Tetovë, Shtip, OPB, Kisella Vodë dhe Gazi Babë nga Shkupi. Nikoqir i këtij takimi ishte SHP Gjevgjeli, ndërsa pensionistët garuan në 6 disiplina: shah, domino, qitje, vrap, pikado tërheqje litari. Më parë gara sportive rajonale janë organizuar në: Shkup, Strumicë, Kavadar dhe Kratovë. Duhet theksuar se për dy garat e para republikane nuk janë publikuar buletine informative dhe për këtë arsye nuk kemi të dhëna më të plota.

1998

Në vitin **1998** Lidhja realizoi aktivitete më të gjera për organizimin më gjithëpërfshirës, më të plotë dhe më cilësor të kohës së lirë të pensionistëve, sidomos në fushën e sportit. Më 20 shtator, në terrenet sportive tek Banja e Kumanovës në **Kumanovë** u mbajtën Garat e Treta Sportive Republikane të Pensionistëve (GTSRP), ku morën pjesë 500 pjesëmarrës, 100 prej të cilëve kanë qenë garues në 6 disiplina. Gjatë hapjes solemne fjalime kanë mbajtur **Çedo Georgievski**, kryetari i Këshillit organizativ komunal dhe **Boris Protiq**, Kryetari i atëhershëm i Komunës së Kumanovës, ndërsa me një fjalim solemn takimet i hapi **z. Vite Isjanovski**, Kryetari i atëhershëm i Lidhjes së pensionistëve të Maqedonisë.

Sipas buletinit informativ, në kategorinë e parë në shah fitoi ekipi i SHP Manastir, ndërsa në kategorinë e femrave fitoi SHP Gazi Babë. Në garën e tërheqjes së litarit për meshkujt më i mirë ka qenë ekipi i SHP Berovë, ndërsa në kategorinë e femrave ai i SHP Tetovë. Në pikado për meshkujt më i mirë ka qenë ekipi i SHP Dellçevë, ndërsa në kategorinë e femrave ai i SHP Kavadar. Në qitje më të mirë kanë qenë qitësit e SHP Tetovë, ndërsa në kategorinë e femrave qitëset e SHP të OPB - Shkup. Në konkurrencën individuale të hedhjes së gjyles fitoi Dimitrija Kuzmanovski, anëtar i SHP Tetovë, ndërsa në kategorinë e femrave fitoi Lubica Kuzmanovska anëtare e SHP Kumanovë. Në garën e vrapit më i shpejtë ishte Jovan Dupkarski, anëtar i SHP Berovë, ndërsa në kategorinë e femrave më e shpejtë ishte Lubica Kuzmanovska, anëtare e SHP Kumanovë.



1999

Garat e Katërta Sportive Republikane të Pensionistëve (GKSRP) u mbajtën në **Vinice**, më **18 shtator 1999**. Në këto gara morën pjesë 550 pensionistë dhe mbi 100 garues, të cilët garuan në 7 disiplina. Në shah për meshkujt fitoi ekipi i SHP Manastir, nën udhëheqjen e Borçe Ilievski, ndërsa në kategorinë e femrave më i mirë ishte ekipi i SHP Shtip, i kryesuar nga Vera Ognjanova. Në pikado për meshkujt fitoi ekipi i SHP Radovish, individit më i mirë i të cilës ishte Marinko Todorov, ndërsa në kategorinë e femrave ishte ekipi i SHP Koçanë, i kryesuar nga Borislava Dimitrova. Në qitje fitoi ekipi i SHP Tetovë, individit më i mirë i të cilës ishte Jordan Paunovski, ndërsa në kategorinë e femrave, falë Lençe Mitanskës, fitoi ekipi i SHP të OPB - Shkup. Në disiplinën e atletikës, në vrap, fitoi Jovan Dupkarski, anëtar i SHP Berovë, ndërsa në kategorinë e femrave fitoi përfaqësuesja e SHP Tetovë. Në hedhjen e gjyles fituan përfaqësuesit e SHP Tetovë dhe SHP Dellçevë, ndërsa në disiplinën e re të kërcimit fitoi përfaqësuesi i SHP Ohër, Gjorgji Trpçeski. Në garën e tërheqjes së litarit për meshkujt fitoi ekipi i SHP Kisella Voda, ndërsa në kategorinë e femrave fitoi ekipi i SHP Tetovë. Nikoqir i këtyre lojërave ishte SHP Vinice, megjithatë edhe për këto gara sportive nuk është publikuar buletin informativ.

2000

Më **2 shtator 2000** u mbajtën Garat e Pesta Sportive Republikane të Pensionistëve (GPSRP), në **Krani** - në bregun e Liqenit të Prespës, me pjesëmarrjen e rreth 800 pensionistëve të 29 shoqatave. Nikoqir i këtyre garave ishte SHP Resnjë, ndërsa në hapjen solemne fjalime mbajtën **Dorço Krstevski**, kryetar i Shoqatës së pensionistëve të Resnjës, **Dr. Arso Gosharevski**, Kryetari i Komunës së Resnjës, Vite Isjanovski, kryetari i LSHPM-së dhe Bedredin Ibraimi, zëvendëskryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe ministri i punës dhe politikës sociale.



së gjyles tek meshkujt fitoi ekipi i SHP Kumanovë, i përfaqësuar nga fituesi Malko Amdovski, ndërsa në konkurrencën e femrave fitoi SHP Tetovë, përfaqësuesja më e mirë e të cilës ishte Ratka Milevska. Në garën e vrapit fituan ekipet e SHP Gostivar tek meshkujt dhe SHP Kumanovë tek femrat, ndërsa më i mirë gjatë garës së kërcimit ishte Gjorgji Trpçeski anëtar i SHP Ohër. Rezultate më të mira në këtë garë arriti SHP Kumanovë, e cila fitoi edhe kupën e LSHPM-së.

Në formën e një dokumenti të veçantë dhe afatgjatë për këtë manifestim sportiv me rëndësi të pensionistëve, LSHPM nga viti 2000 filloi të përgatis dhe publikojë një buletin informativ special me 40 faqe me ngjyrë. Me tekste dhe fotografi, por edhe me paraqitje dhe grafikë të ndryshëm, sigurohen gjurmë afatgjate për pjesëmarrësit dhe organizatorët e këtyre garave masive, të cilat nga viti në vit, jo vetëm që bëhen më masive, por bëhen edhe më cilësore.



SHA Stopanska banka - nën patronazhin e të cilës u mbajt gara dhe **Vite Isjanovski**, kryetari i LSHPM-së.

Në këtë garë morën pjesë 600 pensionistë, ndërsa 182 garues garuan në 7 disiplina. Më saktësisht 105 meshkuj dhe 77 femra të 22 shoqatave. Në shah për meshkujt vendin e parë e fitoi ekipi i SHP Manastir, ndërsa në konkurrencën e femrave fitoi SHP Vinicë. Në qitje, më të mirë ishin qitësit e SHP Kumanovë, ndërsa rezultate më të mira arriti Lube Dimitriev. Në konkurrencën e femrave fitoi SHP Gazi Baba, ndërsa anëtarja më e mirë e kësaj gare ishte Leposava Xhambazova, anëtare e SHP Shtip. Në pikado për meshkujt fitoi SHP Tetovë, me garuesin

Në këtë garë morën pjesë 221 garues, të cilët garuan në 7 disiplina. Në shah për meshkujt fitoi ekipi i SHP Manastir, ndërsa në konkurrencën e femrave fitoi SHP Gostivar. Në qitje me pushkë mësimore fitoi ekipi i SHP Tetovë, qitës më i mirë i të cilës ishte Jordan Naumovski, ndërsa në konkurrencën e femrave fitoi ekipi i SHP të OPB, me anëtarin më të mirë Lençe Altanoska. Në pikado për meshkujt dhe femrat fituan ekipet e SHP Radovish dhe SHP Kumanovë, të kryesuara nga anëtarët më të mirë, Marinko Todorov dhe Nadezhda Janevska. Në garën e tërheqjes së litarit tek meshkujt fitoi SHP Strumicë ndërsa në konkurrencën e femrave SHP Tetovë. Në garën e hedhjes

2001

Garat e Gjashta Sportive Republikane të Pensionistëve (GGJSRP) u mbajtën më **16 shtator 2001**, në Liqenin e Velesit "Mlladost", ndërsa nikoqir ishte SHP Karposh nga Shkupi. Në hapjen solemne fjalime mbajtën **Nedelko Trajanovski**, nënkryetari i Këshillit ekzekutiv të SHP Karposh, **Stevka Bogoevska**, kryesuese e Këshillit të Komunës së Velesit, **Kiro Zrmanovski**, sekretari i



Vuka Periq, ndërsa në konkurrencën e femrave fitoi SHP Kumanovë me anëtarën Nadica Janevska si garuese më e mirë. Në garën e tërheqjes së litarit për meshkujt fitoi SHP Gostivar, ndërsa në konkurrencën e femrave fitoi SHP Tetovë. Garuesit nga Tetova ishin më të mirë në garën e vrapit, në të dy konkurrencat, ndërsa garues më të mirë u shpallën Vinko Smilevski dhe Bozha Tasevska. Në garën e hedhjes së gjyles fitoi SHP Tetovë tek meshkujt, me anëtarin Vinko Smilevski, ndërsa në konkurrencën e femrave fitoi SHP Kumanovë me anëtarën Elena Apostolova. Në garën e kërcimit në ekip fitoi SHP Tetovë, ndërsa vendin e parë e fitoi Vinko Smilevski, i cili njëkohësisht e fitoi medaljen e tretë të artë.

Ekipi me rezultate më të mira ishte ai i SHP Tetovë, i cili fitoi edhe kupën e rastit.



2002

Garat e Shtata Sportive Republikane të Pensionistëve (GSHSRP) u mbajtën më **14 shtator 2002**, në kompleksin Gorica në **Ohër**, me pjesëmarrjen e rreth 860 pensionistëve, 235 nga të cilët ishin garues, më saktësisht 138 meshkuj dhe 97 femra. Në hapjen e lojërave fjalime në emër të nikoqirit mbajtën **Krste Sprostranovski**, kryetari i SHP Ohër, **Mr. Vite Isjanovski**, kryetari i LSHPM dhe **Lupço Meshkov**, Drejtori i Fondit të SPIM.

Garuesit garuan në 7 disiplina. Në shah për meshkujt më i mirë ishte ekipi i SHP Struga, ndërsa në konkurrencën e femrave më i mirë ishte ekipi i SHP Shtip. Në

garën e qitjes fituan ekipet e SHP Tetovë, ndërsa medalje ari fituan Jordan Paunovski dhe Menka Florçeska. Në garën e pikados fitoi SHP Dellçevë në kategorinë e meshkujve, ndërsa garuesi më i mirë ishte Branko Nalbatovski anëtar i SHP Karposh. Në konkurrencën e femrave në këtë disiplinë ishte Dobrica Lazarova. Në garën e tërheqjes së litarit për meshkujt fitoi ekipi i SHP Strumicë, ndërsa në kategorinë e femrave fitoi SHP Kumanovë. Në hedhjen e gjyles për meshkujt medalje ari fitoi Vinko Smilevski, anëtar i SHP Tetovë, ndërsa në kategorinë e femrave fitoi Elena Apostolova, anëtare e SHP Kumanovë. Në garën e vrapit medalje ari sërisht fituan Vinko Smilevski dhe Bozhana Tasevska, të dy anëtarë të SHP Tetovë. Në garën e kërcimit vendin e parë e fitoi Vllado Trajanovski, anëtar i SHP Probishtip.

Ekipi me rezultate më të mira ishte ai i SHP Tetovë, i cili fitoi edhe kupën e rastit.

Kryetari i Komunës së Ohrit, **Dr. Nikolla Naumov**, me këtë rast për Kryesinë e LSHPM dhe të ftuarit organizoi një pranim. Gjatë takimit në fjalë u theksua se bëhen përpjekje të vazhdueshme që pensionistët të zëvendësojnë vetminë, pesimizmin dhe depresionin me shoqërimin dhe dëshirën për sport, rekreacion, argëtim dhe për plotësimin e kohës së lirë me edukime. Në këtë mënyrë pensionistët nuk do të jenë barë e familjes dhe shoqërisë, por një faktor i jetës së tyre.

2003

Garat e Teta Sportive Republikane të Pensionistëve (GTSRP) u mbajtën më **13 shtator 2003**, në **Kavadar**. Me fjalime rasti u drejtuan kryetari i ri i LSHPM, **z. Dushko Shurbanovski** dhe Kryetari i Kuvendit të SHP Kavadar, **z. Pançe Grkov**, ndërsa lojërat të hapura i shpalli **z. Gjorgji Trpçeski**, kryetari i Komisionit të sportit pranë LSHPM. Me përkrahjen e 1.050 tifozëve dhe të ftuarve, 276 garues, 155 meshkuj dhe 121 femra garuan në 9 disiplina, ndërsa si disiplina të





reja u përfshinë ecja e shpejtë dhe dominoja. Në garën e shahut në ekip për meshkujt, më i mirë ishte ekipi i SHP Qendër, ndërsa në konkurrencën e femrave ai i SHP Shtip. Në garën e pikados në ekip për meshkujt fitoi SHP Prilep, ndërsa në kategorinë e femrave fitoi SHP Radovish. Në garën e qitjes për meshkujt fitoi ekipi i SHP Tetovë, ndërsa në konkurrencën e femrave fitoi SHP Shtip. Në garën e tërheqjes së litarit, në konkurrencën e meshkujve dhe femrave, fitoi SHP Gostivar. Në hedhjen e gjyles medalje ari sërish fituan Branko Poçuçi, anëtar i SHP Kumanovë dhe Jablanka Veselinovska, anëtare e SHP Tetovë. Në disiplinën e re të ecjes së shpejtë medalje ari fituan Sllavko Trajkovski, anëtar i SHP Tetovë dhe Gjurgja Josifova, anëtare e SHP Shtip.

Në garën e kërcimit, medalje ari fitoi Vladimir Trajanov, anëtar i SHP Probishtip. Në garën e dominosë medalje ari fituan Petre Zafirov, anëtar i SHP Veles dhe Ollga Popovska, anëtare e SHP Gostivar. Fitues i kësaj gare u shpall rajoni i dytë, të cilin e përbëjnë shoqatat e Karposhit dhe OPB nga Shkupi, Tetovës dhe Gostivarit. Kupën për herë të parë dhe për të vetmen herë në historinë e garave e fitoi një rajon, megjithëse sukses më të madh arriti SHP Tetovë. Me këtë rast, një pranim për mysafirët organizoi Kryetari i Komunës së Kavadarit, z. Pançe Minov.

2004

Garat e Nënta Sportive Republikane të Pensionistëve (GNSRP) u mbajtën më **11 shtator 2004**, afër Eurotel në **Strugë**, ndërsa nikoqirë të kësaj gare ishin shoqatat e pensionistëve Qendër - Shkup dhe Strugë. Në këtë garë morën pjesë 1.070 pjesëmarrës, 289 nga të cilët ishin garues ose 160 pensionistë dhe 129 pensioniste. Në hapjen solemne fjalime mbajtën **z. Pavle Spasov**, kryetari i SHP Qendër dhe



Dushko Shurbanovski, kryetari i LSHPM-së, të cilët e shpallën garën të hapur. Fjalime rasti mbajtën edhe **Dr. Lubo Sekuliq**, kryetari i LSHP të Malit të Zi, **Sava Garbuzanov**, kryetari Lidhjes së bashkuar të pensionistëve të Bullgarisë, **Dr. Isa Gorica**, kryetari i pensionistëve të Shqipërisë dhe **Irfan Jengjingjui**, përfaqësuesi i Fondit të pensionistëve të shërbimeve publike të Turqisë.

Në garën e shahut për meshkujt fitoi ekipi i SHP Tetovë, ndërsa në konkurrencën e femrave fitoi ekipi i SHP Kumanovë. Shahiste më i mirë u shpall Ollga Spirovska, anëtare e SHP Qendër, ndërsa shahist më i mirë u shpall Mladen Simjanovski, anëtar i SHP Tetovë. Në garën e pikados fitoi ekipi i SHP Veles, me qitësin më të mirë Ilija Dimovski, ndërsa në konkurrencën e femrave fitoi ekipi i SHP Krushevë, me qitësen Marija Dimçevska. Në qitje në ekip për meshkujt fitoi SHP Ohër, ndërsa në konkurrencën e femrave fitoi ekipi i SHP Kavadar. Individë më të mirë në qitje u shpallën Miodrag Jovanovski, anëtar i SHP Gazi Babë dhe Cveta Dimova, anëtare e SHP Kavadar. Në garën e tërheqjes së litarit për meshkujt dhe femrat rezultate më të mira arritën ekipet e SHP Tetovë. Në garën e hedhjes së gjyles edhe këtë herë



medalje ari fitoi Branko Poçuça, anëtar i SHP Kumanovë dhe Jabllanka Veselinovska, anëtare e SHP Tetovë. Në garën e vrapit medalje ari fitoi Ilija Jaqimov, anëtar i SHP Veles dhe Bozhana Tasevska, anëtare e SHP Tetovë, ndërsa në garën e ecjes së shpejtë fituan Simeon Ilievski, anëtar i SHP Ohër dhe Lubica Kuzmanovska, anëtare e SHP Kumanovë. Në garën e kërcimit fitoi Tomislav Popovski, anëtar i SHP Kumanovë, ndërsa në disiplinën e dominosë fituan Borçe Bozhinov, anëtar i SHP Radovish dhe Ratka Spasovska, anëtare e SHP Probishtip. Fituese e kësaj gare ishte SHP Tetovë.

Prania e të ftuarve në garën e nëntë u shfrytëzua për organizimin e një takimi të veçantë në nivel ndërkombëtar, në të cilin u bisedua për bashkëpunimin e pensionistëve të vendeve të Ballkanit dhe njëkohësisht u ngrit një iniciativë për formimin e Asociacionit ballkanik të pensionistëve.

2005

Garat e radhës Sportive Republikane të Pensionistëve (GSRP) me rastin e jubileut 10-vjeçar u mbajtën më **10 shtator 2005**, në Liqenin e Velesit "Mlladost", ndërsa nikoqir ishte SHP Veles. Në këtë garë morën pjesë mbi 900 pensionistë, para të cilëve fjalime mbajtën **z. Dushko Shurbanovski**, kryetari i LSHPM, Kryetari i Velesit **z. Ace Kocovski** dhe kryeministri i atëhershëm i Qeverisë së RM, **z. Vllado**



Buçkovski, i cili theksoi se çdo vend duhet të respektojë dhe çmojë rezultatet, punën dhe energjinë e gjeneratave më të vjetra, duke kërkuar zgjidhje për të gjitha çështjet e hapura të jetës dhe veprimit të pensionistëve. Në nëntë disiplinat garuan 299 garues ose 166 meshkuj dhe 133 femra, anëtarë të 33 shoqatave. Në disiplinën e shahut vendin e parë e fitoi ekipi i SHP Qendër, ndërsa shahist më i mirë u shpall Stevan Veskov, anëtar i SHP Karposh. Në konkurrencën e femrave fitoi ekipi i SHP Shtip, ndërsa shahiste më e mirë u shpall banorja e Shtipit Elica Manaskova. Në qitje fitoi ekipi i SHP Tetovë, ndërsa individ më i mirë ishte Miodrag Jovanović, anëtar i SHP Gazi Babë. Në konkurrencën e femrave vendin e parë e fitoi ekipi i SHP të OPB Shkup, ndërsa qitëse më e mirë u shpall Efka Josheva, anëtare e SHP Kavadar. Në disiplinën e pikados për meshkujt fitoi ekipi i SHP Demir Hisar, me garuesin më të mirë Boris Rutevski, ndërsa në konkurrencën e femrave fitoi SHP Karposh. Garuesja më e mirë e kësaj discipline ishte Mare Nenkoviq, anëtare e SHP Shtip. Në disiplinën e tërheqjes së litarit medalje ari fituan ekipet e SHP Gostivar në konkurrencën e meshkujve dhe SHP Tetovë në konkurrencën e femrave. Branko Poçuça, anëtar i SHP Kumanovë dhe Jabllanka Veselinovska, anëtare e SHP Tetovë edhe këtë herë ishin më të mirë në disiplinën e hedhjes së gjyles. Në disiplinën e ecjes së shpejtë medalje ari fituan Sllavko Trajkovski, anëtar i SHP Tetovë dhe Naumka Penezic, anëtare e SHP Ohër dhe Lubica Kuzmanovska, anëtare e SHP Kumanovë. Në disiplinën e vrapit në konkurrencën e meshkujve gjithashtu kishte dy fitues, Ilija Jaqimov anëtar i SHP Veles dhe Sllavko Pekevski, anëtar i SHP Berovë, ndërsa në konkurrencën e femrave medalje ari fitoi Bllagica Markullovski, anëtare e SHP Ohër. Në disiplinën e kërcimit medalje ari fitoi Tomislav Panovski, anëtar i SHP Kumanovë. Në disiplinën e dominosë medalje ari fituan Petar Zafirov, anëtar i SHP Veles dhe Lençe Tanovska, anëtare e SHP Resnjë. Fitues i garës së dhjetë ishte SHP Kumanovë.





2006

Më 9 shtator 2006, në autokampin **Krani**, në bregun e Liqenit të Pre-spës u mbajtën Garat e **11-ta** Sportive Republikane të Pensionistëve (**GNJS-RP**), në të cilat për herë të parë morën pjesë mbi një mijë pjesëmarrës, me saktësisht 1.114, 351 nga të cilët ishin garues ose 192 pensionistë dhe 159 pensioniste. Gjatë hapjes solemne fjalime mbajtën **z. Dushko Shurbanovski**, Kryetari i Komunës së Resnjës, **z. Di-**

mitar Buzlevski, **z. Naziv Daljani**, Kryetari i Sindikatës së pensionistëve të Pogradecit - Republika e Shqipërisë dhe **Tatjana Kalajxhieva**, në emër të Stopanska Banka SHA Shkup, nën patronazhin e të cilës u zhvillua gara.

Në disiplinën e shahut fitoi ekipi i SHP të OPB Shkup, me shahistin më të mirë **Dimitar Ilievski**, ndërsa në konkurrencën e femrave fitoi SHP **Kumanovë**, me shahisten më të mirë **Vera Trajkovska**. Në disiplinën e qitjes në kategorinë e meshkujve fitoi SHP Shtip me qitësin më të mirë **Vanço Denkov**, ndërsa në konkurrencën e femrave fitoi SHP Ohër me qitësen më të mirë **Nevena Kostovska**. Në disi-



plinën e tërheqjes së litarit, në kategorinë e meshkujve fitoi SHP Tetovë, ndërsa në konkurrencën e femrave fitoi SHP **Gazi Babë**. Në disiplinën e pikados fitoi ekipi i meshkujve të SHP Ohër, pikadisti më i mirë u shpall **Dimitar Tutkovski**, anëtar i SHP Resnjë, ndërsa në konkurrencën e femrave fitoi ekipi i SHP **Kriva Pallankë**. Në këtë kategori pikadiste më e mirë u zgjodh **Katica Borizovska**. Në disiplinën e vrapit medalje ari fituan **Bllagoja Stanojkov**, anëtar i SHP **Kumanovë** dhe **Lençe Mitevska**, anëtare e SHP **Kratovë**. Në disiplinën e hedhjes së gjyles medalje ari sërish fituan **Branko Poçuça**, anëtar i SHP **Kumanovë** dhe **Jabllanka Vese-**

linovska, anëtare e SHP **Tetovë**. Në disiplinën e kërcimit medalje ari fitoi **Nikolla Danev**, anëtar i SHP **Negotinë**. Në disiplinën e dominosë fituan **Dimitar Stamenov**, anëtar i SHP **Novo Sellë** dhe **Angelina Cureva**, anëtare e SHP **Dellçevë**. Në disiplinën e tabllës medalje ari fituan **Pavle Shlakov**, anëtar i SHP **Resnjë** dhe **Todorka Saveva**, anëtare e SHP **Vallandovë**. Rezultate më të mira fituan sportistët e SHP Ohër .

2007

Më 15 shtator 2007, për herë të tretë në Liqenin e Velesit "Mlladost" u mbajtën Garat e **12-ta** Sportive Republikane të Pensionistëve (**GDSRP**), në praninë e 760 pjesëmarrësve, nga të cilët 364 ishin garues ose 172 meshkuj dhe 122 femrat. Në këtë manifestim sportiv masiv të pensionistëve u drejtuan **z. Dushko Shurbanovski** dhe Kryetari i Komunës së Velesit, **z. Ace Kocovski**. Në këtë manifestim fjalim mbajti edhe Kryeministri, **z. Nikolla Gruevski**, i cili theksoi se pensionistët janë grupi i qytetarëve i cili gjatë gjithë jetës ka punuar, krijuar dhe ka dhënë kontribut në zhvillimin e shtetit dhe shoqërisë. Për këtë arsye vendi ka për detyrë të shpërblejë këto qytetarë, duke u kujdesur për to dhe duke punuar



për sigurimin e kushteve që do t'u mundësojnë jetë të qetë dhe me dinjitet, për të kaluar ditët e pensionit.

Në disiplinën e qitjes fitoi ekipi i SHP Ohër, me qitësin më të mirë Toshe Jankulovski, ndërsa në konkurrencën e femrave fitoi SHP Qendër me qitësen më të mirë Marija Janevska. Në disiplinën e shahut fitoi ekipi i SHP Shtip, me shahistin më të mirë Vasko Krstev, ndërsa në konkurrencën e femrave fitoi SHP Kumanovë, me shahisten më të mirë Janika Kostadinovska. Në disiplinën e pikados, në të dy konkurrencat, fitoi ekipi i SHP Dellçevë, ndërsa pikadistë më të mirë u shpallën Nikolla Kamçev, anëtar i SHP Kavadar dhe Nevena Ivanova, anëtare e SHP Strumicë. Në disiplinën e tërheqjes së litarit medalje ari në të dy konkurrencat fituan ekipet e SHP Tetovë. Në disiplinën e hedhjes së



gjyles medalje ari fituan Branko Poçuça, anëtar i SHP Kumanovë dhe Jablanka Veselinovska, anëtare e SHP Tetovë. Në disiplinën e vrapit medalje ari fituan Vllado Stanojkov, anëtar i SHP Kumanovë dhe Lençe Mitevska, anëtare e SHP Kratovë. Në disiplinën e kërcimit medalje ari fitoi Nikolla Danev, anëtar i SHP Negotinë, ndërsa në domino Cvetko Zavorovski, anëtar i SHP Prilep dhe Ratka Spasovska, anëtare e SHP Probishtip. Në disiplinën e tabllës medalje fituan Petre Petrov, anëtar i SHP Kratovë dhe Milevka Zdravkovska, anëtare e SHP Probishtip. Rezultate më të mira arritën sportistët e SHP Tetovë.

2008

Në Qendrën sportive Champion në Radovish, më datën **6 shtator 2008**, i mbajtën Garat e **13-ta** Sportive Republikane të Pensionistëve (**GTSRP**), me 800 pjesëmarrës, 192 meshkuj dhe 172 femra të 34 shoqatave të pensionistëve. Me këtë rast fjalime mbajtën **z. Dushko Shurbanovski**, kryetari i LSHPM, Kryetari i Radovishit, **Dr. Robert Vellkov** dhe **Valentina Topleva**, menaxhere e Tutunska Banka Shkup, e cila e shpalli garën të hapur.

Në disiplinën e qitjes, në konkurrencën e meshkujve fitoi ekipi i SHP Prilep, ndërsa në konkurrencën e femrave fitoi SHP e OPB Shkup. Qitës më i mirë u shpall Boris Grnçaroski, anëtar i SHP Prilep, ndërsa qitëse më e mirë u shpall Bozhana Miloshevska, anëtare e SHP Kërçovë. Në disiplinën e shahut fitoi ekipi i SHP Ohër, ndërsa në konkurrencën e femrave fitoi ekipi i SHP Shtip. Shahist më i mirë u shpall Vllado Todorovski, anëtar i SHP Qendër, ndërsa në konkurrencën e femrave fitoi Vera Ognjanova, anëtare e SHP Shtip. Në disiplinën e tërheqjes së litarit medalje ari fituan ekipet e SHP Probishtip në konkurrencën e meshkujve dhe ekipi i SHP Tetovë në konkurrencën e femrave. Në disiplinën e pikados fituan anëtarët e SHP Dojran në konkurrencën e meshkujve, me pikadistin më të mirë Niko Poptomov, ndërsa në konkurrencën e femrave fitoi SHP Koçanë, me pikadisten më të mirë Pavlina Bogdanova. Në disiplinën e vrapit medalje ari fituan Blazho Stanojkov, anëtar i





SHP Kumanovë dhe Lençe Miteva, anëtare e SHP Kratovë, ndërsa në disiplinën e hedhjes së gjyles fituan Branko Poçuça dhe Elena Apostolovska, anëtarë të SHP Kumanovë. Në disiplinën e kërcimit medalje ari sërish fitoi Nikolla Danev, anëtar i SHP Negotinë, ndërsa në domino Nikola Poçu, anëtar i SHP Krushevë dhe Cvetanka Ristevska, anëtare e SHP Prilep. Në disiplinën e tabllës vendin e parë e fituan Adli Bellçishta, anëtar i SHP Dibër dhe Qendër Zhupë dhe Stojanka Atanasova, anëtare e SHP Dellçevë. Këtë herë rezultate më të mira arritën sportistët e SHP Kumanovë. Me këtë rast pranim për kryesitë e organizatave të pensionistëve organizuan kryetarët e Komunave të Radovishit dhe Konçes, Dr. Robert Vellkov dhe Stojan L Lazarov.

2009

Më 26 shtator 2009, në "Eurotel" Strugë, në bregun e Ligenit të Ohrit, u mbajtën Garat e 14-ta Sportive Republikane të Pensionistëve (GKSRP), nikoqir i të cilave ishte SHP Qendër - Shkup, nën patronazhin e **z. Koce Trajanovski**, kryetari i BNJLV dhe kryetar i Qytetit të Shkupit. Në hapjen solemne fjalime mbajtën **Pavle Spasev**, kryetari i Këshillit ekzekutiv të SHP Qendër dhe **Dushko Shurbanovski** kryetari i LSHPM.

Në garat morën pjesë rreth 860 pjesëmarrës nga të cilët 376 ishin garues ose 198 meshkuj dhe 178 femra. Garat për herë të parë u zhvilluan në 11 disiplina, më saktësisht u përfshinë tre disiplina të reja: tabllë, dyluftim dhe treluftim dhe njëkohësisht u hoq disiplina e ecjes së shpejtë. Në disiplinën e qitjes fitoi ekipi i SHP Ohër në konkurrencën e meshkujve, ndërsa në konkurrencën e femrave fitoi ekipi i SHP Kavadar. Qitës më i mirë u shpall Kostadin Stojanov, anëtar i SHP Koçanë, ndërsa qitëse më e mirë u shpall Efka Josheva, anëtare e SHP Kavadar. Në disiplinën e shahut fitoi ekipi i SHP Resnjë në kategorinë e meshkujve, ndërsa në konkurrencën e femrave fitoi ekipi i SHP Shtip. Shahist më i mirë u shpall Todor Gollomeov, ndërsa shahiste më e mirë u shpall Vera Ognjanova, të dy anëtarë të SHP Shtip. Në disiplinën e tërheqjes së litarit fitoi ekipi i SHP Probishtip në konkurrencën e meshkujve, ndërsa në konkurrencën e femrave fitoi ekipi i SHP Tetovë. Në disiplinën e pikados për meshkujt fitoi ekipi i SHP Prilep, me anëtarin Bozhin Taleski, ndërsa në konkurrencën e femrave fitoi ekipi i SHP Strumicë. Megjithatë, pikadiste më e mirë u shpall Sllavka Vellkovska, anëtare e SHP Kisella Voda. Në disiplinën e vrapit medalje ari fituan Goce Angellov, anëtar i SHP Kumanovë



dhe Pavlina Kamçeva, anëtare e SHP Strumicë. Në disiplinën e hedhjes së gjyles fituan Branko Poçuça dhe Branka Veselinovska, anëtarë të SHP Kumanovë. Në dyluftim për femrat dhe treluftim për meshkujt medalje ari fituan Sllavica Lambasha dhe Bllazho Stanojkov, anëtarë të SHP Kumanovë. Në disiplinën e kërcimit edhe këtë herë fitoi Nikolla Danev, anëtar i SHP Negotinë. Në disiplinën e dominosë medalje ari fituan Gjorgji Sokolovski, anëtar i SHP Dellçevë dhe Dobrilla Gjoleva, anëtare e SHP Strumicë, ndërsa në disiplinën e tabllës fituan Angjell Shutev, anëtar i SHP Shtip dhe Sllavica Jovanova, anëtare e SHP Prilep. Rezultate më të mira arritën sportistët e SHP Kumanovë.



Me qëllim që garat sportive të jenë plotësisht të rregullt, Komisioni i sportit pranë LSHPM përgatiti një Rregullore, e cila u plotësua me kalimin e viteve. Kjo rregullore parasheh nevojën për t'i kushtuar më shumë vëmendje dhe të rritet cilësia e tetë garave sportive rajonale.

Në rajonin e **parë** folën Pavle Spasev, kryetari i Këshillit ekzekutiv të SHP Qendër, Kryetari i Shkupit, z. Koce Trajanovski, Kryetari i Kuvendit të SHP Qendër, z. Krste Angellovski dhe Kryetari i Komunës Qendër, z. Vladimir Todoroviq. Rezultate më të mira arriti ekipi i SHP Qendër. Në rajonin e dytë, që u mbajt në terrenet sportive në Liqenin Treska në Shkup fjalime mbajtën Dr. Jovan Tasevski, kryetari i Kuvendit të SHP Gjorçe Petrov, Dushko Shurbanovski, kryetari i LSHPM, Blerim Bexheti, Kryetari i Komunës së Sarajit dhe Sokol Mitrevski, Kryetari i Komunës Gjorçe Petrov. Rezultate më të mira arritën sportistët e SHP Tetovë. Në rajonin e tretë garat u zhvilluan në Krushevë. Në emër të nikoqirëve të takimit folën Krsto Stojanovski, kryetari i SHP Krushevë dhe Dushko Shurbanovski, kryetari i LSHPM. Rezultate më të mira arritën garuesit e SHP Prilep. Në rajonin e katërt, në Qendrën sportive "Biljanini Izvori" fitoi nikoqiri SHP Ohër. Në solemnitetin e rastit fjalime mbajtën Gjorgji Trpçeski, kryetari i Këshillit ekzekutiv të SHP Ohër dhe Debërcë, Dushko Shurbanovski, Kryetari i LSHPM, Mitre Veljanovski, anëtar i Kuvendit të Ohrit dhe Kryetari i Debërcës, z. Lupço Koçinoski. Në rajonin e pestë në Kavadar rezultate më të mira arritën nikoqirët. Fjalim me rastin mbajtën Ilija Pemov, Kryetari i Këshillit ekzekutiv të SHP Kavadar, Kryetari Aleksandar Panov dhe Çedo Georgievski, Nënkryetari i LSHPM. Garat e rajonit të gjashtë u mbajtën në Zletovë. Në emër të nikoqirit fjalime mbajtën Danka Josifovska, Kryetare e SHP dhe Kryetari i Komunës së Probishtipit, z. Toni Tonevski. Rezultate më të mira arritën garuesit e SHP Kumanovë. Në rajonin e shtatë, në Novo Sellë, fjalime rasti mbajtën Çedo Georgievski, Nënkryetari i LSHPM, z. Petar Spasov, Kryetari i Komunës Novo Sellë dhe Nikolla Kallpaçki, Kryetar i SHP nikoqire. Rezultate më të mira arritën sportistët e SHP Shtip. Në Vinicë, në rajonin e tetë, rezultate më të mira arritën garuesit e SHP Koçanë. Në solemnitetin e rastit fjalime mbajtën Mlladen Petrov, Kryetari i SHP Vinicë, Dragi Argirovski, Sekretari i Këshillit ekzekutiv i LSHPM dhe Emill Donçev, Kryetar komune.

2010

Më **18 shtator 2010**, u mbajtën Garat e 15-ta Sportive Republikane të Pensionistëve (**GPSRP**), në Qendrën sportive "Shampion" në **Radovish**, me pjesëmarrjen e 380 garuesve të 35 shoqatave, më saktë-



sisht 200 meshkuj dhe 180 femra. Në praninë e rreth 900 pjesëmarrësve, ky manifestim sportiv republikan u hap nga zëvendësministri i punës dhe politikës sociale, **z. Spiro Ristevski**. Gjatë hapjes solemne fjalime rasti mbajtën Kryetari i Radovishit, **Dr. Robert Vellkov, Jovan Eftimov**, Kryetari i SHP Radovish dhe Konçe dhe **Lençe Tashkova**, në emër të Komercijalna Banka Shkup, nën patronazhin e të cilës u mbajt gara.

Në disiplinën e qitjes fitoi ekipi i SHP Ohër, me qitësin më të mirë Cvetko Popovski, ndërsa në konkurrencën e femrave fitoi SHP Qendër, me qitësen më të mirë Angelina Temellkova. Në disiplinën e shahut fitoi ekipi i SHP Shtip, ndërsa shahist më i mirë u shpall Lubomir Haxhimanov, anëtar i SHP Kisella Voda. Në konkurrencën e femrave fitoi ekipi i SHP Shtip, ndërsa shahiste më e mirë u shpall Vera Ognjanova. Në disiplinën e pikados vendin e parë e fitoi ekipi i SHP Kratovë, me garuesin më të mirë Jove Jovanov, ndërsa në konkurrencën e femrave fitoi ekipi i SHP Probishtip dhe Liljana Jaqimovska. Në disiplinën e tërheqjes së litarit fitoi ekipi i SHP Gazi Babë në konkurrencën e meshkujve dhe SHP Tetovë në konkurrencën e femrave. Në disiplinën e vrapit medalje ari fituan Mico Micoski, anëtar i SHP Prilep dhe Pavlina Kamçeva, anëtare e SHP Strumicë. Në disiplinën e hedhjes së gjyles edhe këtë herë medalje ari fituan rekorderët Branko Poçuça, anëtar i SHP Kumanovë dhe Jabllanka Veselinovska, anëtare e SHP Tetovë. Në disiplinën e kërcimit tradicionalisht medalje ari fitoi Nikolla Dinev, anëtar i SHP Negotinë. Në disiplinën e dyluftimit në konkurrencën e femrave fitoi Sofka Jovanova, anëtare e SHP Veles, ndërsa në disiplinën e treluftimit për meshkuj fitoi Mitko Bogdanovski, anëtar i SHP Tetovë. Në disiplinën e dominosë fituan Borko Minovski, anëtar i SHP Kisella Vodë dhe Dobrilla Gjoleva, anëtare e SHP Strumicë. Në disiplinën e tabllës medalje ari fituan Vanço Bojaxhiev, anëtar i SHP Negotinë dhe Snezhana Atanasova, anëtare e SHP Shën Nikollë. Këtë herë rezultate më të mira arritën garuesit e SHP Tetovë.



Me sukses u organizuan edhe garat sportive rajonale të sportistëve me rastin e jubileut. Në rajonin e **parë** rezultate më të mira arritën pensionistët e SHP Qendër. Garat u zhvilluan në terrenet sportive të SHP Gazi Babë. Në solemnitetin e rastit fjalime mbajtën Dushan Pereski, Kryetari i Këshillit ekzekutiv të SHP Gazi Babë, Dushko Shurbanovski, Kryetari i LSHPM dhe Vukashin Spasovski, Kryetari i Kuvendit të SHP Gazi Babë. Në terrenet sportive në Liqenin e Treskës garuan sportistët e rajonit të **dytë**, ndërsa rezultate më të mira arritën sportistët e SHP Tetovë. Në emër të nikoqirit fjalim mbajti Kryetari i SHP Saraj, z. Rufat Ramadani, por edhe Dragi Argirovski, sekretari i Këshillit ekzekutiv të LSHPM dhe Kryetari i Komunës së Sarajit, z. Blërim Bexheti. Në rajonin e **tretë** në Prilep rezultate më të mira arritën nikoqirët. Pjesëmarrësit i përshëndeti Kryetari i SHP Prilep, z. Kirill Gjorgioski, ndërsa lojërat i shpalli të hapura Dushko Shurbanovski, Kryetari i LSHPM. Në rajonin e **katërt** në Kërçovë solemnitetin e rastit e hapi Mehmed Mehmedi, Kryetari i Kuvendit të SHP Kërçovë, ndërsa fjalime rasti mbajtën edhe Dragi Argirovski, Sekretari i Këshillit ekzekutiv të LSHPM dhe Naziv Dalani, Kryetari i organizatës së pensionistëve të Pogradecit, Republika e Shqipërisë. Rezultate më të mira arriti SHP Ohër dhe Debërcë. Në rajonin e **pestë** pensionistët garuan në Liqenin e Velesit "Mlladost" dhe rezultate më të mira arritën sportistët e SHP Kavadar. Në hapjen e garave fjalime mbajtën Momçillo Markovski, Kryetari i SHP Veles, Kryetari i Komunës, z. Goran Petrov dhe Dushko Shurbanovski, Kryetari i LSHPM. Në rajonin e **gjashtë** në Kriva Pallankë, tradicionalisht rezultate më të mira arritën pensionistët sportistë të SHP Kumanovë. Në solemnitetin e rastit fjalime mbajtën Arsen Ilievski, Nën-kryetari i Shoqatës komunale, Dushko Shurbanovski, Kryetari i LSHPM dhe Arsenço Aleksovski, Kryetari i Komunës. Në rajonin e **shtatë** në Lozovë rezultate më të mira arritën garuesit e Shtipit. Në solemnitetin e rastit fjalime mbajtën Tozo Mançev, Kryetari i SHP, Orce Cvetkovski, Kryetari i Komunës dhe Dragi Argirovski, Sekretari i Këshillit ekzekutiv të LSHPM. Në terrenet sportive në Dellçevë garuan pensionistët e rajonit të **tetë**. Garat me një solemnitet i shpalli të hapura Luba Angellovska, Kryetarja e SHP Dellçevë, ndërsa rezultate më të mira arritën pensionistët e Koçanit.



2011

Më 10 shtator 2011, në Kompleksin Livadishte në Strugë u mbajtën Garat e 16-ta Sportive Republikane të Pensionistëve (GGJSRP). Në këto gara morën pjesë 1.100 pensionistë, ndërsa garuan 384 pensionistë, 200 meshkuj dhe 184 femrat. Në emër të nikoqirit SHP Strugë pjesëmarrësve mirëseardhje u dëshiroi **z. Liman Pollozhani**, Kryetari i SHP. Fjalimin kryesor e mbajti Kryetari i ri i LSHPM, **z. Dragi Argirovski**, i cili i shpalli garat e hapura, ndërsa në pjesën e mbylljes ndau edhe kupën e rastit për SHP Ohër dhe Debërcë, shoqatë kjo që arriti rezultate më të mira. Në disiplinën e qitjes, në të dy konkurrencat vendin e parë e fitoi SHP Ohër dhe Debërcë, me qitësin më të mirë Cvetko Popovski dhe qitësen më të mirë Snezhana Milloshevska. Në disiplinën e shahut për meshkuj fitoi SHP Shtip, ndërsa në kategorinë e femrave fitoi SHP Qendër. Shahistël më të mirë u shpallën Gjorgji Quka, anëtar i SHP Ohër dhe Debërcë dhe Lidija Kizova, anëtare e SHP Qendër. Në disiplinën e pikados rezultate më të mira arriti ekipi i SHP Prilep dhe anëtar i saj Bozhin Taleski, ndërsa në konkurrencën e femrave fitoi SHP Tetovë, me anëtares Dushka Ivanovska. Në disiplinën e tërheqjes së litarit fituan SHP Koçanë në konkurrencën e meshkujve dhe SHP Tetovë në atë të femrave. Në disiplinën e vrapit medalje ari fituan Micko Mickovski, anëtar i SHP Prilep dhe Bllagica Markuleska, anëtare e SHP Ohër dhe Debërcë. Në disiplinën e hedhjes së gjyles fitoi Branko Poçuça, anëtar i SHP Dojran, ndërsa për herë të parë në konkurrencën e femrave fitoi Marija Karakamisheva, anëtare e SHP Bogdancë. Në disiplinën e kërcimit fitoi Nikolla Donev, anëtar i SHP Negotinë. Në disiplinën e dyluftimit për femrat fitoi Sofka Jovanova, anëtare e SHP Veles, ndërsa në disiplinën e treluftimit fitoi Sime Cvetanoski, anëtar i SHP Prilep. Në disiplinën e dominosë medalje ari fituan Bllagoja Bogoevski, anëtar i SHP Demir Hisar dhe Nadica Gjurovska, anëtare e SHP Gjorçe Petrov. Në disiplinën e tabllës fituan Ilija Risteski anëtar i SHP Krushevë dhe Stanojka Atanasova, anëtare e SHP Dellçevë.



ri i Kuvendit të LSHPM. Ndërkaq, garat i shpalli të hapura Kryetari i Komunës, **z. Stevçe Jakimovski**. Në rajonin e **tretë** rezultate më të mira arritën pensionistët e Prilepit. Garat u mbajtën në Demir Hisar, ndërsa në solemnitetin e rastit fjalime mbajtën Kryetari i SHP Dragan Angeleski, Kryetari Toni Angeleski dhe Kryetari i LSHPM Dragi Argirovski. Në rajonin e **katërt** edhe këtë herë rezultate më të mira arritën sportistët e SHP Ohër i Debërcë. Garat u zhvilluan në Dibër, ndërsa fjalime rasti mbajtën Besnik Pocesta, Kryetari i SHP Dibër dhe Qendër Zhupë, Kryetari i Komunës së Dibrës, Dr. Argëtim Fida dhe Dragi Argirovski,

Kryetari i LSHPM. Në rajonin e **pestë**, në terrenet sportive në Banjat e Negorcit, fjalime rasti mbajtën Risto Tanellov, Kryetari i Këshillit ekzekutiv të SHP Gjevgjeli, në cilësinë e nikoqirit, Ivan Frangov, Kryetari i Komunës dhe Dragi Argirovski, Kryetari i LSHPM.



Në këtë garë rezultate më të mira arritën garuesit e SHP Veles. Në rajonin e **gjashtë** nikoqirë ishin pensionistët e Kumanovës, të cilët arritën edhe rezultate më të mira. Në solemnitetin e rastit fjalime mbajtën Spirko Nikollovski, Kryetari i SHP, ndërsa lojërat i shpalli të hapura z. Dragi Argirovski, Kryetari i LSHPM. Në rajonin e **shtatë**, në garat e zhvilluara në Shtip, rezultate më të mira arritën nikoqirët. Në solemnitetin e rastit fjalime mbajtën Kryetari i SHP Shtip dhe Karbincë, z. Mile Vasilev, Kryetari i Komunës së Shtipit, Dr. Zoran Alekov dhe Metodija Toshevski, Nënkryetari i Këshillit ekzekutiv të LSHPM.

Në rajonin e **tetë** triumfuan pensionistët e Koçanit, ndërsa garat u zhvilluan në Makedonska Kamenica. Në solemnitetin e rastit fjalime mbajtën Vidan Konevski, Kryetari i SHP, Kryetari i Komunës z. Darko Mitevski dhe Stanka Trajkova, Sekretare e Këshillit ekzekutiv të LSHPM.

2012

Më **11 shtator 2012**, për herë të parë në historinë e organizimit të këtyre garave, në Shkup u mbajtën Garat e **17-ta** Sportive Republikane të Pensionistëve (**GSHSRP**), në kompleksin e hotelit "NEW STAR", nën patronazhin e Kryeministrit të Republikës së Maqedonisë, z. Nikolla Gruevski, i cili mbajti edhe një fjalim rasti. Me këtë rast Kryeministri në veçanti theksoi se forcimi i standardit, respekti dhe dashuria, kalimi me dinjitet i viteve të pleqërisë dhe sigurimi i qetësisë gjatë ditëve të pensionit janë nevojat kryesore por edhe detyrimet e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë. Fjalime rasti mbajtën edhe Ministri i punës dhe politikës sociale, z. **Spiro Ristovski**, Kryetari i LSHPM, z. **Dragi Argirovski**, Kryetari i Komunës Gjorçe Petrov, z. **Sokol Mitrovski** dhe z. **Metodija Novkovski**, Kryetari i Këshillit ekzekutiv të SHP, në cilësinë e nikoqirit.



Në praninë e 1.150 pensionistëve, 395 nga të cilët ishin garues të 38 shoqatave, rezultate më të mira në 11 disiplinat arriti SHP Ohër dhe Debërcë, e cila fitoi edhe kupën e rastit. Në disiplinën e qitjes, në konkurrencën e meshkujve dhe femrave fitoi ekipi i SHP Ohër dhe Debërcë, ndërsa qitës më i mirë u shpall Kosta Stojanov, anëtar i SHP Koçanë. Në konkurrencën e femrave qitëse më i mirë u shpall Mara Iliq, anëtare e SHP e OPB Shkup. Në disiplinën e shahut për meshkujt vendin e parë e fitoi SHP Kumanovë, me shahistin më të mirë Srgjan Hristovski, ndërsa në konkurrencën e femrave fitoi SHP Ohër dhe Debërcë, me shahisten më të mirë Menka Jovanovska. Në disiplinën e pikados për meshkujt fitoi ekipi i SHP Shën Nikollë, ndërsa në konkurrencën e femrave fitoi SHP Dellçevë. Në disiplinën e pikados, në konkurrencën e meshkujve fitoi Lube Petrushevski,





anëtar i SHP Pensionistët e Solidarizuar Ilinden, ndërsa në konkurrencën e femrave fitoi Snezhana Spasevska, anëtare e SHP Dellçevë. Në disiplinën e tërheqjes së litarit për meshkujt fitoi SHP Gazi Babë, ndërsa në konkurrencën e femrave fitoi SHP Tetovë. Në disiplinën e vrapit për meshkujt deri në moshën 65 vjeçe medalje ari fitoi Mome Cvetanovski, anëtar i SHP Kumanovë, ndërsa në konkurrencën e meshkujve mbi 65 vjet fitoi Blazhe Srbnovski, anëtar i SHP Ohër dhe Debërcë. Në konkurrencën e femrave deri në moshën 65-vjeçe më e shpejtë ishte Bllagica Markuleska, anëtare e SHP Ohër dhe Debërcë, ndërsa në kategorinë e femrave mbi 65 vjet fitoi Pavlina

Kamçeva, anëtare e SHP Strumicë. Në disiplinën e dyluftimit për femrat medalje ari fitoi Lupka Trifunovska, anëtare e SHP Ohër dhe Debërcë, ndërsa në disiplinën e treluftimit për meshkujt fitoi Sime Cvetanovski, anëtar i SHP Prilep. Në disiplinën e hedhjes së gjyles fituan Bllazho Stanojkov, anëtar i SHP Kumanovë dhe Marija Karakamisheva, anëtare e SHP Bogdancë. Medalje ari në disiplinën e kërcimit fitoi Miroslav Kuzmanoski, anëtar i SHP Prilep. Në disiplinën e dominosë fituan Nikolla Manasiev, anëtar i SHP Zletovë dhe Danica Popzaharieva, anëtare e SHP Koçanë. Në disiplinën e tabllës fituan Ivan Haxhiev, anëtar i SHP Strugë dhe Millanka Pandelevska, anëtare e SHP Ohër dhe Debërcë.

Në garat rajonale në rajonin e **parë** rezultate më të mira arriti SHP Gazi Babë. Nikoqir i garës ishte SHP Kisella Voda. Fjalime rasti mbajtën Kryetari i Kuvendit të SHP, z. Done Todorovski dhe Nënkryetari i Këshillit ekzekutiv të LSHPM, z. Metodija Toshevski. Në rajonin e **dytë** në Gostivar rezultate më të mira arritën pensionistët e SHP Tetovë. Fjalim rasti mbajti Kryetari i SHP Gostivar, z. Nijazi Xhelili, por edhe Nënkryetari i Kuvendit të LSHPM, z. Besnik Pocesta. Nikoqir i rajonit të **tretë** ishte SHP Resnjë, ndërsa rezultate më të mira arritën sportistët e SHP Prilep. Lidhur me rëndësinë e këtyre garave folën Kostadina Barandovska, Kryetare e SHP, Kryetari i Komunës, z. Mishko Vollkanovski dhe Metodija Toshevski, Nën-



kryetari i Këshillit ekzekutiv të LSHPM. Në rajonin e **katërt** nikoqirët, SHP Ohër dhe Debërcë, arritën rezultate më të mira. Në solemnitetin e hapjes fjalime mbajtën Kryetari i Këshillit ekzekutiv të SHP, z. Gjorgji Trpçevski, Kryetari i Komunës së Ohrit, z. Aleksandar Petreski dhe Nënkryetari i Kuvendit të LSHPM, z. Besnik Pocesta. Garat e rajonit të **pestë** u zhvilluan në Vallandovë, ndërsa rezultate më të mira arritën sportistët e SHP Negotinë. Në solemnitetin e rastit fjalime mbajtën Tome Iliev, Kryetari i SHP

dhe Stanka Trajkova, Sekretare e Këshillit ekzekutiv të LSHPM. Në rajonin e **gjashtë** në Probishtip fjalime mbajtën Gruica Manasijev, Kryetari i SHP, Kryetari i Komunës Toni Tonevski dhe Stanka Trajkova, Sekretare e Këshillit ekzekutiv të LSHPM. Rezultate më të mira arritën sportistët e SHP Kumanovë. Në Strumicë u zhvilluan garat e rajonit të **shtatë**, ndërsa rezultate më të mira arritën garuesit e SHP Rado-vish dhe Konçe. Në solemnitetin e rastit fjalime mbajtën Dançe Daskalovska, Kryetare e Këshillit ekzekutiv të SHP, Kryetari i Komunës Zoran Zaev dhe Dragi Argirovski, Kryetari i LSHPM. Në Koçanë u zhvilluan garat e rajonit të **tetë**, ndërsa rezultate më të mira arritën nikoqirët. Pjesëmarrësit i përshëndeti Gjorgji Serafimov, Kryetari i SHP, Kryetari i Komunës Ratko Dimitrovski dhe Kryetarii i LSHPM Dragi Argirovski.

2013

Garat e **18-ta** Sportive Republikane të Pensionistëve (GTSRP) u mbajtën në Shtip më **7 shtator 2013**, në kompleksin "Makedonka". Numrin rekord të të pranishmëve dhe mirëseardhje të pranishmëve u dëshiruan Ministri i punës dhe politikës sociale, **z. Dime Spasov** dhe **Dragi Argirovski**, Kryetari i LSHPM. Fjalime rasti mbajtën edhe Kryetarët e Komunave të Shtipit dhe Karbincit, **Mr. Illço Zahariev** dhe **Zoran Minov**, si dhe **Mihail Vasilev**, Kryetari i SHP Shtip dhe Karbincë. Në këtë Olimpiadë sportive të pensionistëve në Shtip morën pjesë dhe u shoqëruan 1.380 pensionistë nga e gjithë Maqedonia, ndërsa garuan 396 pensionistë të 38 shoqatave. Në disiplinën e tabllës medalje ari fituan Ivan Toshev, anëtar i SHP Ne-

gotinë dhe Mirjana Çallova, anëtare e SHP Demir Kapi. Në disiplinën e qitjes fitoi ekipi i SHP e OPB Shkup, me qitësin më të mirë Zoran Sazdov, ndërsa në konkurrencën e femrave fitoi SHP Ohër dhe Debërcë. Qitëse më e mirë u shpall Mirosllava Boshnjakovska, anëtare e SHP e OPB. Në disiplinën e shahut fitoi SHP Tetovë me shahistin më të mirë Jakup Lika, ndërsa në konkurrencën e femrave fitoi SHP Shtip, me shahisten më të mirë Shenka Balltovska, anëtare e SHP Tetovë. Në disiplinën e pikados fitoi SHP Kumanovë në kategorinë e meshkujve dhe SHP Gazi Babë në kategorinë e femrave. Në këtë disiplinë rezultate më të mira arritën Mitko Mitevski dhe Sevdia Dimitrova, anëtarë të SHP Kavadar. Në disiplinën e tërheqjes së litarit për meshkujt fitoi SHP Gazi Babë, ndërsa në konkurrencën e femrave fitoi SHP Probishtip. Në disiplinën e vrapit për meshkujt deri në moshën 60 vjeçe medalje ari fitoi Mome Cvetanovski, anëtar i SHP Kumanovë, ndërsa në kategorinë mbi moshën 60 vjeçe fitoi Gjorgji Jovanov, anëtar i SHP Radovish dhe Konçe. Në konkurrencën e femrave deri në moshën 60 vjeçe medalje ari fitoi Bllagica Markuleska, anëtare e SHP Ohër dhe Debërcë, ndërsa në konkurrencën e femrave mbi 60 vjet fitoi Bllaga Mihova, anëtare e SHP Koçanë. Në disiplinën e hedhjes së gjyles vendin e parë e fituan Glase Simovski, anëtar i SHP Negotinë dhe Mara Karakamisheva, anëtare e SHP Bogdancë. Në disiplinën e kërcimit, medalje ari fitoi Marjan Nikollovski, anëtar i SHP Ohër dhe Debërcë. Në disiplinën e dominosë fituan Stoillko Krajnin, anëtar i SHP Gjorçe Petrov dhe Carka Doklevska, anëtare e SHP Taftalixhe. Në disiplinën e dyluftimit për femrat fitoi Lupka Trifunovska, anëtare e SHP Ohër dhe Debërcë, ndërsa në disiplinën e treluftimit për meshkujt fitoi Vllatko Spasovski, anëtar i SHP Kumanovë. Rezultate më të mira arritën sportistët e SHP Ohër dhe Debërcë, të cilët për të tretën herë me radhë fituan mirënjohjen e rastit dhe kupën, të cilën e mbajtën përgjithmonë.

Në garat rajonale të rajonit të **parë**, që u mbajtën në Gazi Babë, fjalime rasti mbajtën Gjorge Andonov, Kryetari i Këshillit ekzekutiv të SHP, z. Besnik Pocesta, Nënkryetari i Kuvendit të LSHPM dhe Toni Trajkovski, Kryetari i Komunës së Gazi Babës. Rezultate më të mira arritën sportistët e Gazi Babës. Në rajonin e **dytë** përsëri fituan sportistët e Tetovës. Në garat që u zhvilluan në Liqenin e Treskës në Shkup, fjalime rasti në emër të nikoqirit mbajtën Jovan Ginovski, Kryetari i Kuvendit të SHP Karposh, Stanka Trajkova, Sekretare e Këshillit ekzekutiv të LSHPM dhe Stevçe Jakimovski, Kryetari i Komunës së Karposhit. Në rajonin e tretë garat u zhvilluan në Manastir, ku rezultate më të mira arritën pensionistët e Prilepit. Fjalime rasti mbajtën Tome





Ilioski, Kryetari i Këshillit ekzekutiv të SHP, Kryetari i Komunës Vladimir Taleski dhe Kryetari i LSHPM Dragi Argirovski. Sportistët e Ohrit fituan garat e rajonit të **katërt** në Strugë. Fjalime rasti mbajtën Liman Pollozhani, Kryetari i SHP Strugë dhe Besnik Pocesta, Nënkrjetari i Kuvendit të LSHPM. Në rajonin e **pestë** garat u zhvilluan në Negotinë, ndërsa fjalime rasti mbajtën Petar Zaharçev, Kryetari i SHP dhe Metodija Toshevski, Nënkrjetari i Këshillit ekzekutiv të LSHPM. Rezultate më të mira arritën pensionistët e SHP Kavadar. Garat e rajonit të **gjashtë** u zhvilluan në Kratovë, ndërsa rezultate më të mira arritën sportistët e SHP Kumanovë. Fjalime rasti mbajtën Lupço Angelovski, Kryetari i SHP, Kryetari i Komunës Mite Andonovski dhe Stanka Trajkova, Sekretare e LSHPM. Në rajonin e **shtatë** në Radovish fituan pensionistët e Shtipit, ndërsa fjalime rasti mbajtën Jordan Kostadinov, Kryetari i SHP Radovish dhe Konçe, Kryetari i Komunës së Radovishit, z. Sako Nikollov, Kryetari i Komunës së Konçes, z. Bllagoj Jovanov dhe Dragi Argirovski, Kryetari i LSHPM. Në rajonin e **tetë** në Vinicë rezultate më të mira arritën sportistët e SHP Koçanë. Në solemnitetin e rastit fjalime mbajtën Mlladen Petrov, Kryetari i SHP, Emill Donçev, Kryetari i Komunës dhe Metodija Toshevski, Nënkrjetari i Këshillit ekzekutiv të LSHPM.

2014

Garat e 19-ta Sportive Republikane të Pensionistëve (**GNSRP**) u mbajtën më **6 shtator 2014**, në kompleksin "Teteks" në **Tetovë**, nën patronazhin e Ministrisë të punës dhe politikës sociale, **z. Dime Spasov**, i cili para rreth 1.000 të pranishmëve mbajti një fjalim rasti. Po ashtu, fjalim rasti mbajti edhe **Dragi Argirovski**, Kryetari i LSHPM. Fjalime rasti mbajtën edhe **Ahmed Qazimi**, Drejtuesi i Sektorit të aktiviteteve publike në Komunën e Tetovës, **Gojko Eftoski**, Kryetari i Kuvendit dhe **Shaban Azizi**, Kryetari i Këshillit ekzekutiv të SHP Tetovë.

Në këtë garë garuan 400 sportistët më të mirë të 46 shoqatave, 208 meshkuj dhe 192 femra. Garat u mbajtën në 11 disiplinat tradicionale. Në disiplinën e qitjes për meshkujt fitoi ekipi i SHP Koçanë, ndërsa në konkurrencën e femrave fitoi SHP Prilep. Qitës më i mirë u shpall Toshe Jankuloski, anëtar i SHP Ohër dhe Debërcë, ndërsa qitëse më e mirë u shpall Vera Dimitrioska, anëtare e SHP Prilep. Në disiplinën e shahut, në konkurrencën e meshkujve fitoi SHP Gjorçe Petrov, ndërsa në konkurrencën e femrave fitoi SHP Qendër. Risto Krstev, anëtar i SHP Tetovë u shpall shahisti më i mirë, ndërsa shahiste më e mirë u shpall Liljana Sllavevska, anëtare e SHP Qendër. Në disiplinën e pikados fitoi SHP



Gazi Babë, me anëtarin më të mirë Naste Ignjatovski, ndërsa në konkurrencën e femrave fitoi SHP Shën Nikollë, me anëtarin më të mirë Tana Mihajlova. Në disiplinën e tërheqjes së litarit, në të dy konkurrencat, fitoi SHP Gazi Babë. Në disiplinën e vrapit për meshkujt deri në moshën 60 vjeçe medalje ari fitoi Risto Netkov, anëtar i SHP Shtip dhe Karbincë, ndërsa në konkurrencën e meshkujve mbi 60 vjet fitoi Blazhe Sribnovski, anëtar i SHP Ohër dhe Debërcë. Në konkurrencën e femrave deri në moshën 60 vjeçe medalje ari fitoi Lupka Trifunovska, anëtare e SHP Ohër dhe Debërcë, ndërsa në kategorinë e femrave mbi 60 vjet fitoi Pavlina Kamçeva, anëtare e SHP Strumicë. Në disiplinën e kërcimit medalje ari fitoi Marjan Nikollovski, anëtar i SHP Ohër dhe Debërcë, ndërsa në disiplinën e hedhjes së gjyles fitoi Blazho Stanojkov, anëtar i SHP Kumanovë. Marija Karakamisheva, anëtare e SHP Bogdancë fitoi në kategorinë e femrave të kësaj discipline. Në disiplinën e dyluftimit për femrat fituese u shpall Verica Puleska, anëtare e SHP Ohër dhe Debërcë, ndërsa në disiplinën e treluftimit për meshkujt fitues u shpall Gjoko Janevski. Në disiplinën e tabllës medalje ari fituan Nikolla Atanasovski, anëtar i SHP Krushevë dhe Todorka Saveva, anëtare e SHP Solidariteti - Aerodrom. Në disiplinën e dominosë medalje ari fituan Fejzi Rustemi, anëtar i SHP Tetovë dhe Lubica Nastoska, anëtare e SHP Strugë. Rezultate më të mira edhe këtë herë arritën sportistët e SHP Ohër dhe Debërcë, të cilët fituan edhe kupën.

Në rajonin e **parë** garat u zhvilluan në terrenet e SHP Butell, ndërsa fitues u shpall ekipi i SHP Gazi Babë. Në solemnitetin e rastit fjalime mbajtën Lupço Dimovski, Kryetari i SHP, Petre Llatinovski, Kryetari i Komunës së Butelit dhe Dragi Argirovski, Kryetari i LSHPM. Në rajonin e **dytë** pensionistët e Tetovës përsëri ishin më të mirët, garat u zhvilluan në terrenet e Ligenit të Treskës, ndërsa nikoqir ishte SHP e OPB Shkup. Fjalime rasti mbajtën Spirko Nikollovski, Kryetari i SHP dhe Besnik Pocesta, Nënkryetari i Kuvendit të LSHPM. Pensionistët e Prilepit arritën rezultate më të mira në garat e rajonit të **tretë** që u



mbajtën në Krushevë. Fjalime rasti mbajtën Nikolla Nikollovski, Kryetari i Këshillit ekzekutiv të SHP, Metodija Toshevski, Nënkryetari i Këshillit ekzekutiv të LSHPM dhe Dr. Gjorgji Damçevski, Kryetari i Komunës së Krushevës. Në rajonin e **katërt** garat u zhvilluan në Samokov, afër qytetit Makedonski Brod, ndërsa fjalime rasti mbajtën Ilija Llazeski, Kryetari i SHP, Besnik Pocesta, Nënkryetari i Kuvendit të LSHPM dhe Millosim Vojneski, Kryetari i Komunës Makedonski Brod. Rezultate më të mira arritën sportistët e SHP Ohër dhe Debërcë. Në Bogdancë u zhvilluan garat e rajonit të **pestë**, ndërsa fjalime rasti mbajtën Sllavčo Uzunov, Kryetari i SHP, Kryetari i Komunës Anastasija Ollumçeva dhe Stanka Trajkova, Sekretare e Këshillit ekzekutiv të LSHPM. Rezultate më të mira arritën pensionistët e SHP Kavadar. Në rajonin e gjashtë në Zletovë, rezultate më të mira arritën sportistët e SHP Kumanovë. Në solemnitetin e rastit fjalime mbajtën Trajan Pecov, Kryetari i SHP Zletovë, Kryetari i Komunës së Probishtipit Toni Tonevski dhe Stanka Trajkova, Sekretare e Këshillit ekzekutiv të LSHPM. Pensionistët e SHP Radovish dhe Konçe arritën rezultate më të mira në garën e rajonit të shtatë që u mbajt në Shën Nikollë. Fjalime rasti mbajtën Mirko Danaillov, Kryetari i SHP, Kryetari i Komunës Zoran Tasev dhe Stanka Trajkova, Sekretare e Këshillit ekzekutiv të LSHPM. Në rajonin e tetë fituan pensionistët e Koçanit, ndërsa gara u zhvillua në Berovë. Fjalime rasti mbajtën Dragi Naxhinski, Kryetari i Komunës dhe Metodija Toshevski, Nënkryetari i Këshillit ekzekutiv të LSHPM.

2015

Më 4 shtator 2015, në kompleksin e hotelit "NEW STAR" në **Shkup** u mbajtën garat e **20-ta Sportive Republikane të Pensionistëve**, gara jubileu. Gara e manifestimit sportiv të jubileut, që u shndërrua në një Olimpiadë të vërtetë sportive për pensionistët, përsëri u zhvillua nën patronazhin e z. Dime Spasov, Ministri i punës dhe politikës sociale të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, i cili me këtë rast mbajti një fjalim. Në hapjen solemne, para 1.200 pjesëmarrësve fjalime mbajtën edhe **Dragi Argirovski**, Kryetari i LSHPM, Koce Trajanovski, Kryetari i Shkupit dhe Kryetari i BNJLV, Kryetari i Komunës së Butelit **Petre Llatinovski**, ndërsa në emër të nikoqirit foli **Lupço Dimovski**, Kryetari i SHP Butel.





Në 11 disiplinat tradicionale garuan 397 pensionistë, 208 meshkuj dhe 198 femra, anëtarë të 41 shoqatave. Në disiplinën e qitjes për meshkujt fitoi ekipi i SHP Koçanë, me anëtarin më të mirë Kostadin Stojanov, ndërsa në konkurrencën e femrave fitoi SHP Kumanovë, me anëtarën më të mirë Bogica Dimitrievska. Në disiplinën e shahut për meshkujt fitoi ekipi i SHP Tetovë, ndërsa shahist më i mirë i shpall Pançe Zahariev, anëtar i SHP Shtip. Në konkurrencën e femrave në këtë disiplinë fitoi SHP Qendër, me shahisten më të mirë Liljana Sllavevska. Në disiplinën e pikados për meshkujt fitoi ekipi i SHP Taftalixhe, me pikadistin më të mirë Sllave Simovski, ndërsa në konkurrencën e femrave fitoi SHP Dellçevë, me pikadisten më të mirë Cveta Xhabirska. Në disiplinën e tërheqjes së litarit vendin e parë tek meshkujt e fitoi ekipi i SHP Gjevgjeli, ndërsa në konkurrencën e femrave ai i SHP Tetovë. Në disiplinën e vrapit për meshkujt deri në moshën 60 vjeçe, medalje ari fitoi Mome Cvetanovski, anëtar i SHP



Kumanovë, ndërsa në kategorinë e meshkujve mbi 60 vjet fitoi Bllazhe Srbinovski, anëtar i SHP Ohër dhe Debërcë. Në konkurrencën e femrave deri në moshën 60 vjeçe fitoi Gallaba Georgieva, anëtare e SHP Shtip dhe Karbincë, ndërsa në kategorinë e femrave mbi 60 vjet fitoi Bllagica Markuleska, anëtare e SHP Ohër dhe Debërcë. Në disiplinën e hedhjes së gjyles medalje ari fituan Gjorgji Mehanxhiski, anëtar i SHP Dojran dhe Marija Karakamisheva, anëtare e SHP Bogdancë. Në disiplinën e kërcimit fitoi Marjan Nikollovski, anëtar i SHP Ohër dhe Debërcë, ndërsa kolegja e tij Verica Puleska fitoi medaljen e artë në disiplinën e dyluftimit për femrat. Në disiplinën e treluftimit për meshkujt fitoi Sime Cvetanovski, anëtar i SHP Prilep. Në disiplinën e tabllës fituan Mustafa Efatoski, anëtar i SHP Kërçovë dhe Sofija Arsova, anëtare e SHP Gjorçe Petrov. Në domino medalje ari fituan Hajro Kurtoviq, anëtar i SHP Makedonska Kamenica dhe Bllaga Velanovska, anëtare e SHP Kumanovë. Rezultate më të mira arritën sportistët e SHP Ohër dhe Debërcë.



Edhe garat sportive rajonale të pensionistëve kaluan me një organizim të shkëlqyer dhe u arritën rezultate solide. Në rajonin e parë nikoqir ishte SHP Pensionistët e Solidarizuar - Ilinden. Rezultate më të mira arritën sportistët e SHP Qendër. Në hapjen solemne fjalime mbajtën Bllagoja Atanasovski, Kryetari

i Këshillit ekzekutiv të SHP, Kryetari i Komunës Zhika Stojanovski dhe Dragi Argirovski, Kryetari i LSHPM. Në rajonin e **dytë** tradicionalisht rezultate më të mira arritën pensionistët e Tetovës, të cilët ishin edhe nikoqirë. Në solemnitetin e rastit fjalime mbajtën Stojan Sokolovski dhe Shaban Azizi, Kryetarët e Kuvendit dhe Këshillit ekzekutiv të SHP Tetovë, ndërsa në emër të LSHPM fjalim mbajti Nënkryetari i Kuvendit, z. Besnik Pocesta. Në rajonin e **tretë** më shumë vende të para fituan pensionistët e Prilepit, të cilët ishin edhe nikoqirë. Në solemnitetin e rastit fjalime mbajtën Kirill Gjorgieski, Kryetari i SHP, Kryetari i Komunës së Prilepit, z. Marjan Risteski dhe Dragi Argirovski, Kryetari i LSHPM. Nikoqir i garave të rajonit të **katërt** ishte SHP Kërçovë, ndërsa fitues absolutë u shpallën sportistët e SHP Ohër dhe Debërcë. Fjalime rasti mbajtën Lubomir Llukarowski, Kryetari i SHP dhe Besnik Pocesta, Nënkryetari i Kuvendit të LSHPM. Në rajonin e **pestë** takimet u zhvilluan në Dojran. Fjalime rasti mbajtën Borivoje Bojxhiev, Kryetari i SHP, Kryetari i Komunës, z. Borçe Stamov dhe Sekretari i Këshillit ekzekutiv të LSHPM Stanka Trajkova. Më shumë vende të para fituan pensionistët e Kavadarit. Në rajonin e **gjashtë** nikoqir i garës ishte SHP Kriva



Pallankë, ndërsa gara u zhvillua në kompleksin sportivo - rekreativ "Park" në Ginovci, Komuna Rankovcë. Në hapjen solemne fjalime mbajtën Ivan Jakimovski, Kryetari i SHP Kriva Pallankë, Kryetarët e Komunave Kriva Pallankë dhe Rankovcë, z. Arsenço Aleksovski dhe Momçillo Aleksovski dhe Kryetari i LSHPM, z. Dragi Argirovski. Rezultate më të mira arritën sportistët e SHP Kumanovë. Në rajonin e **shtatë** garat u zhvilluan në Novo Sellë, ku triumfuan pensionistët e SHP Shtip dhe Karbincë. Fjalime rasti mbajtën Ilija Kovačev, Kryetari i SHP, Blazho Vellkov, Kryetari i Komunës Novo Sellë dhe Dragi Argirovski, Kryetari i LSHPM. Në rajonin e **tetë** lojërat sportive u zhvilluan në Makedonska Kamenica, ku fjalime rasti mbajtën Vidan Ko-

nevski, Kryetari i SHP dhe Dragi Argirovski, Kryetari i LSHPM. Tradicionalisht rezultate më të mira arritën pensionistët e Koçanit.

2016

Garat e 21-ta Sportive Republikane të Pensionistëve u mbajtën më 3 shtator 2016, në Qendrën sportive "Shampion" në Radovish. Ky manifestim tradicional sportiv u mbajt për nder të 70-vjetorit të organizimit të pensionistëve në vendin tonë dhe 25 viteve të pavarësisë së Republikës së Maqedonisë. Fjalimin kryesor e mbajti **z. Dime Spasov**, zëvendësministri i punës dhe politikës sociale, i cili në veçanti theksoi se me një nder dhe kënaqësi e veçantë gjatë viteve të kaluara Ministria e ka përkrahur financiarisht realizimin e suksesshëm të këtyre lojërave sportive të pensionistëve, të cilat paraqesin një shembull i vërtetë se si pensionistët mund të jenë aktivë edhe në erës së tretë. Mbi 1.200 të pranishmit, mysafirët dhe pjesëmarrësit i përshëndeti edhe njeriu i parë i organizatës më të madhe joqeveritare, apolitike dhe multietnike, Kryetari i LSHPM, **z. Dragi Argirovski**, i cili gjatë fjalimit të tij i uroi të dy jubiletë dhe theksoi rëndësinë e madhe të sportit për shëndetin psiko-fizik të pensionistëve. Në emër të nikoqirëve të pranishmit i përshëndeti edhe Kryetari i Komunës së Radovishit, **z. Sashko Nikollov**, si dhe **Jordan Kostadinov**, Kryetari i SHP Radovish dhe Konçe.



Në Olimpiadën e 21-të të pensionistëve garuan një numër rekord garuesish, më saktësisht 501 garues, prej të cilëve 264 meshkuj dhe 237 femrat. Garat u zhvilluan në 11 disiplina dhe për herë të parë

në vend të dyluftimit dhe treluftimit u zhvilluan dy disiplina të reja: basketboll - gjuajtje të lira dhe futboll - penalti në porta të vogla. Në disiplinën e qitjes për meshkujt fitoi SHP Koçanë me qitësin më të mirë Dragi Gacev, ndërsa në konkurrencën e femrave fituan SHP Ohër dhe Debërcë. Qitëse më e mirë në këtë kategori u shpall Snezhana Miloshevska. Në disiplinën e shahut në të dy konkurrencat fituan ekipet e SHP Qendër, ndërsa shahist më i mirë u shpall Aleksandar Stepanovski, anëtar i SHP Manastir. Shahiste më e mirë u shpall Liljana Sllavevska, anëtare e SHP Qendër. Në disiplinën e pikados, në konkurrencën e meshkujve fitoi ekipi i SHP e OPB Shkup, ndërsa në atë të femrave fitoi ekipi i SHP Dellçevë. Pikadistë më të mirë u shpallën Cvetan Eftimovski, anëtar i SHP Dellçevë dhe Marija Stankoviq, anëtare e SHP



Pensionistët e Solidarizuar Ilinden - Shkup. Ekipi i SHP Koçanë në konkurrencën e meshkujve fitoi në disiplinën e tërheqjes së litarit, ndërsa në atë të femrave tradicionalisht fitoi SHP Tetovë. Në disiplinën e vrapit për meshkujt deri në moshën 60 medalje ari fitoi Mojso Balevski, anëtar i SHP Manastir, ndërsa në kategorinë e meshkujve mbi 60 vjet fitoi Bllazhe Srbinoski, anëtar i SHP Ohër dhe Debërcë. Medalje ari në disiplinën e femrave deri në moshën 60 vjeçe fitoi Sllavica Timosievska, anëtare e SHP Tetovë, ndërsa në kategorinë e femrave mbi 60 vjet fitoi Bllagica Markuleska, anëtare e SHP Ohër dhe Debërcë. Në disiplinën e hedhjes së gjyles medalje ari fituan Bllazho Stanojkov, anëtar i SHP Kumanovë dhe Marika Karakamisheva, anëtare e SHP Bogdancë. Në disiplinën e kërcimit fitoi Gjorgji Nikollov, anëtar i SHP Koçanë. Në disiplinën e dominosë medalje ari fituan Dimitar Stamenov, anëtar i SHP Novo Sellë dhe Sllobodanka Talevska, anëtare e SHP Resnjë. Në disiplinën e tabllës fituan Kirill Stojanov, anëtar i SHP Taftalixhe dhe Natasha Misheva, anëtare e SHP Çair. Në futboll - penalti në porta të vogla, në konkurrencën e meshkujve fitoi ekipi i SHP Krushevë, ndërsa në konkurrencën e femrave fitoi ekipi i SHP Prilep. Në disiplinën e basketbollit - gjuajtje të lira fituan ekipi i SHP Koçanë - tek meshkujt dhe SHP Kriva Pallankë - tek femrat.



Rezultate më të mira arritën sportistët e SHP Ohër dhe Debërcë, të cilët për herë të gjashtë fituan kupën e LSHPM.

Në garat sportive rajonale të pensionistëve, që u mbajtën në vitin 2016, në rajonin e **parë** rezultate më të mira arritën sportistët e SHP Gazi Babë. Nikoqiri i këtyre garave ishte SHP Çair, ndërsa fjalime rasti mbajtën Mentor Qoku - Kryetari i SHP, Besnik Pocesta, Kryetari i Kuvendit të LSHPM dhe Zahir Bektashi, Kryetar i Këshillit të Komunës së Çairit. Edhe këtë herë në rajonin e **dytë** rezultate më të mira arritën garuesit nga Tetova. Në Qendrën sportive-rekreative "Treska" në Shkup nikoqir ishte SHP Gjorçe Petrov, ndërsa në hapjen solemne fjalime rasti mbajtën Metodija Novkovski, Kryetari i Këshillit Ekzekutiv të SHP dhe Dragi Argirovski, Kryetari i LSHPM. Në rajonin e **tretë** garuesit nga Prilepi përsëri arritën rezultate më të mira. Nikoqiri i këtyre garave ishte SHP Demir Hisar. Fjalime rasti mbajtën Pere Petreski, Kryetari i SHP, Lupço Bllazhevski, Kryetari i Komunës, Stanka Trajkova, Sekretari i Këshillit ekzekutiv të LSHPM. Tradicionalisht në rajonin e **katërt** triumfuan pensionistët e Ohrit. Nikoqiri i garave ishte SHP Dibër dhe Qendër Zhupë, ndërsa fjalime rasti mbajtën Xhavid Karpuzi, Kryetari i SHP, Kryetari i Komunës së Dibrës, Ruzhdi Lapa dhe Dragi Argirovski, Kryetari i LSHPM. Në rajonin e **pestë** garat u zhvilluan në Kavadar, ndërsa nikoqirët arritën rezultate më të mira. Fjalime rasti mbajtën Risto Angjushev, Kryetari i SHP dhe Saltir Karovski, Nënkryetari i Këshillit ekzekutiv të LSHPM. Në rajonin e **gjashtë** nikoqir ishte SHP Ku-



tate më të mira arritën garuesit e Koçanit, ndërsa fjalime rasti mbajtën Mone Georgievski, Kryetari i SHP, Kryetari Darko Shahtanski dhe Dragi Argirovski, Kryetari i LSHPM.

Pasqyra e Garave Sportive Republikane të Pensionistëve gjatë 21 vitet e kaluara:

1996	Ohër	150 pjesëmarrës
1997	Gjevgjeli (Liqeni i Dojranit)	350 pjesëmarrës
1998	Kumanovë (Banja e Kumanovës)	500 pjesëmarrës
1999	Vinice	550 pjesëmarrës
2000	Resnjë - Krani (Liqeni i Prespës)	800 pjesëmarrës
2001	Veles (Liqeni "Mlladost")	600 pjesëmarrës
2002	Ohër - "Gorica" (Liqeni i Ohrit)	857 pjesëmarrës
2003	Kavadar (Hoteli "FENI")	1.050 pjesëmarrës
2004	Struga "Eurotel"	1.070 pjesëmarrës
2005	Veles (Liqeni "Mlladost")	920 pjesëmarrës
2006	Resnjë - Krani (Liqeni i Prespës)	1.114 pjesëmarrës
2007	Veles (Liqeni "Mlladost")	760 pjesëmarrës
2008	Radovish (SRC "Shampion")	800 pjesëmarrës
2009	Strugë ("Eurotel")	858 pjesëmarrës
2010	Radovish (SRC "Shampion")	900 pjesëmarrës
2011	Strugë (Livadishta)	1.100 pjesëmarrës
2012	Shkup (kompleksi " NEW STAR")	1.150 pjesëmarrës
2013	Shtip (kompleksi "Makedonka")	1.380 pjesëmarrës
2014	Tetovë (kompleksi "Teteks")	1.008 pjesëmarrës
2015	Shkup (kompleksi "NEW STAR")	1.205 pjesëmarrës
2016	Radovish (SRC "Shampion")	1.241 pjesëmarrës

Vlen të theksohet se paralelisht me Garat rajonale dhe republikane sportive të pensionistëve janë zhvilluar edhe gara midis shoqatave - anëtare të LSHPM. Më shumë vite me radhë janë zhvilluar takime sportive midis SHP Kratovë, SHP Kriva Pallankë, SHP Probishtip dhe SHP Shën Nikollë. Një kohë të gjatë vazhdojnë të zhvillohen garat midis shoqatave të pensionistëve nga Gazi Baba, Kumanova dhe Strumica, ndërsa kohëve të fundit janë zhvilluar edhe gara midis SHP Qendër dhe SHP Koçanë, SHP Kavadar dhe SHP Koçanë, SHP Ohër dhe Debërcë dhe SHP Solidariteti - Aerodrom. Tradicionalisht zhvillohet turniri i shahut me rastin e Ditës së çlirimit të Shkupit, në të cilin marrin pjesë të gjithë shoqatat e pensionistëve të Qytetit të Shkupit. Me organizimin e SHP Çair filloi të mbahet edhe turniri i shahut, në të cilin përveç nikoqirëve marrin pjesë edhe SHP Butel, SHP Shuto Orizarë, SHP Solidariteti - Aerodrom dhe SHP Kisella Vodë.

E gjithë kjo tregon qartë se tek pensionistët forcohet vetëdija lidhur me rëndësinë e sportit për plakje të shëndetshme dhe aktive, por edhe kujdesi i LSHPM për shëndetin e anëtarëve të saj. Gjithashtu, gjithnjë e më e dukshme dhe pozitive është mbështetja e shtetit dhe vetëqeverisjes lokale për popullatën vendase më të moshuar dhe më të madhe, në çdo plan.

PJESA VIII



INFORMIMI SI NJË PRIORITET I PENZIONISTËVE

INFORMIMI SI NJË PRIORITET I PENZIONISTËVE

1. HISTORIA E INFORMIMIT

Informimi është një nga prioritetet e Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë. Lidhja informimin gjithmonë e ka konsideruar si një element me rëndësi i jetës së pensionistëve sepse pa një informim të saktë dhe në kohë është njësoj sikur nuk ndodh asgjë, ndërsa vetëm pensionisti i informuar është i mirë për Lidhjen, Shoqatën, vetveten dhe shoqërinë.

Informimi në fillim ka qenë modest dhe në përputhje me kohën dhe zhvillimin e ngjarjeve informatike në nivel global. Gjithashtu, në informimin kanë ndikuar edhe faktori subjektiv dhe energjia, të cilën në këtë segment e ka investuar udhëheqja e Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë dhe ato të shoqatave anëtare të Lidhjes.

Fillimet e informimit kryesisht kanë qenë në formën e takimeve, procesverbaleve, shpalljeve dhe formave të tjera informative të shkruara. Kohë pas kohe, tekste për pensionistët, problematikën dhe jetën e tyre, janë publikuar në gazetën sindikale "Trudbenik" dhe në gazetën "Nova Makedonija".

Pas regjistrimit dhe mbajtjes së Kuvendit konstitutiv të Shoqatës së pensionistëve të Republikës Popullore të Maqedonisë u krijuan kushtet që edhe kjo shoqatë të ketë gazetën e saj informative. Në pamundësi për të pasur gazetën e saj, Shoqata e pensionistëve të Republikës Popullore të Maqedonisë arriti marrëveshje për të pasur një faqe në gazetën e pensionistëve serbë. Në këtë mënyrë, duke filluar nga korriku i vitit 1952, pas më shumë se një vit nga formimi, në numrin 7 të gazetës serbe "Penzionerski GLASNIK", u botua faqja në gjuhën maqedonase, të cilën e redaktonte shoqata maqedonase, ndërsa redaktori i saj ishte Gjorgje Ristiç.



Bashkëpunimi me gazetën serbe vazhdoi për 16 vjet. Kur u krijuan kushte, pensionistët maqedonas morën vendim për të botuar gazetën e tyre, në formën e një shtojce të gazetës ditore "Večer". Numri i parë me titullin "FJALA Jonë" u botua më 31 mars 1967.



Numri i tretë, që u botua në 3 gusht 1967, u botua me një emër të ri, me emrin "PENSIONISTI".



Gazetën e redaktonte një Këshill redaktues, ndërsa kryeredaktor ishte Milosh Konstantinov.

Në fillimet e tranzicionit në vendin tonë u shuan më shumë gazeta informative, midis të cilave u gjet edhe "Trudbenik". Analiza komparative, me të cilën është zbatuar metoda analitike dhe paqitja e materialeve burimore të dokumentacionit

të Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë të periudhës 10-vjeçare ose viteve 1991-2001, ka vërtetuar se informimi i pensionistëve gjatë periudhës në fjalë nuk ka pasur nivelin e dëshiruar dhe në fushën konkrete pothuajse ka pasur terr informativ. Vetëm në vitin 1997 u publikua Monografia "Lidhja e pensionistëve të Maqedonisë 1946-1996", të cilën e përgatiti gazetari Dimçe Apostolski.

Në 1996 u mbajtën Garat e para sportive republikane të pensionistëve në Ohër. Me këtë rast u konstatua nevoja e informimit më të mirë lidhur me garat sportive të pensionistëve, me të cilin pensionistët jo vetëm që do të afirmohen më mirë, por do të mundësohet karakteri garues i pensionistëve dhe do të rritet numri i pensionistëve të interesuar për garat, që do të rezultojë me rritjen e nivelit të cilësisë.

Në vitin 1998 u botua Buletini i parë për Garat e treta sportive republikane që u mbajtën në Kumanovë. Viteve në vazhdim vazhdoi publikimi i buletineve, por me një cilësi më të mirë. Buletini i parë u publikua me rastin e garave sportive republikane të 21-ta, që u mbajtën në vitin 2016, në Radovich. Në vitin 2013 filloi publikimi i Buletinit për sfilatat e këngës, muzikës dhe lojërave, që botohet rregullisht për 14 vjet.

Në aspektin historik, kur bëhet fjalë për informimin, është me rëndësi fakti që më 28 janar 2005, me iniciativën e gazetarit në pension, z. Dragi Argirovski, në bashkëpunim me udhëheqjen e Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë dhe Kryeredaktorin e gazetës "Nova Makedonija", z. Aleksandar Dimkovski, u publikua numri i parë i revistës **"Pikëpamjet e pensionistëve"**. Sezoni i parë i këtij feltoni vazhdon deri më

Me iniciativën e Kryetarit Argirovski dhe Kryeredaktorit të "Nova Makedonija", z. Dimkovski, më



datën 16.02.2012 filloi sezoni i dytë i feltonit "Pikëpamjet e pensionistëve" në gazetën "Nova Make-



24 prill 2008 dhe gjatë periudhës përkatëse u botuan 40 numra, të përgatitura dhe redaktuara nga z. Dragi Argirovski. Revista dhe emisioni "Moshë e tretë", që transmetohej në TVM, dhanë kontribut të madh për prishjen e territ informativ të asaj kohe për problematikën e pensionistëve në vendin tonë.


donia". Më 10 mars 2016 u botua numri i 50-të i kësaj reviste.

Me rastin e botimit të numrit të 50-të të revistës "Pikëpamjet e pensionistëve", në LSHPM u mbajt një takim me drejtorin e gazetës "Nova Makedonija", z. Ratko S. Lazarevski dhe kryeredaktorin e gazetës dhe redaktorin e revistës, z. Aleksandar Dimkovski, në të cilën mori pjesë kryesia e Lidhjes, kryetari i LSHPM, z. Dragi Argirovski, nënkryetari dhe sekretari i Këshillit ekzekutiv, z. Saltir Karovski dhe Stanka Trajkova, dhe redaktorët e revistës, znj. Kalina Slivovska - Andonova dhe Men-do Dimovski.



Përveç kënaqësisë së shprehur nga të dy anët lidhur me bashkëpunimin e shkëlqyer, u konstatua se është mirë këtë shembull ta ndjekin edhe mediat e tjera dhe njëkohësisht u konstatua se gazeta "Nova Makedonija" e boton revistën "Pikëpamjet e gazetarëve" sepse ekziston 72 vite dhe në aspektin e gjeneratave është në të njëjtën moshë me një numër të madh të individëve të moshës së tretë, gjë që nuk vlen për asnjë gazetë tjetër vendase. Gjatë takimit në fjalë u konstatua se gazeta "Nova Makedonija" blihet dhe lexohet edhe pa revistën "Pikëpamjet e gazetarëve", për shkak të përmbajtjeve, komenteve dhe kolumnave të saj, por gjithashtu u theksua se revista e pensionistëve mundëson që aktivitetet e shoqatave dhe Lidhjes të mësohen dhe lexohen jo vetëm brenda vendit, por edhe më gjerë. Gjithashtu u theksua se revista e pensionistëve në të ardhmen do të jetë akoma më e pasur, ndërsa bashkëpunimi akoma më i mirë.

Në vitin 2004, Kryetari i atëhershëm i Lidhjes së pensionistëve të Maqedonisë, z. Vite Isjanovski, publikoi librin me titullin "Pensionistët e Maqedonisë sot". Në aktivitetin e publicistikës, me problematikën e pensionistëve në veçanti dallohet Dragi Argirovski me veprat "Lartësia e tij pensionisti", e publikuar në vitin 2006, "Saga e pensionistit" dhe



"Në stuhinë e moshës së tretë", e botuar në vitin 2007, "Emri im është pensionist", e botuar në vitin 2010, "Kohët tona të pensionit" e botuar në vitin 2012, "Studimi mbi organizimin e pensionistëve" (bashkëautor Ilija Gligorov) dhe "Argumentet zbardhin të vërtetën", e botuar në vitin 2016.

Kryetari i tanishëm i LSHPM, gazetari dhe publicisti Dragi Argirovski është autori i vetëm me shumë vepra të botuara për pensionistët dhe e konsiderojnë si ideatorin e informimit të drejtë në LSHPM, për pensionistët dhe të moshuarit vendas dhe më gjerë dhe për këtë arsye ai është shpallur ekspert i moshës së tretë nga ana e Institutit Evropian "Hevrekka" në Republikën e Sllovenisë.

Hulumtimet e Argirovskit zbardhin se një numër i madh pensionistësh në kuadër të LSHPM dhe Lidhjeve të pensionistëve nga viti në vit, gjithnjë e më shumë, përfshihen në aktivitetet e shoqë-

risë, sportet amatore të pensionistëve, sfilatat folklorike etj., si rezultat të ndikimit të informimit në të gjitha nivelet e Lidhjes.

Për të arritur qëllimin e dëshiruar dhe të mirën e dëshiruar ose për të pasur një informim të saktë dhe në kohë, një kontribut të veçantë ka edhe zhvillimi i mjeteve të informimit masiv, duke filluar nga mediat e shtypura, radio-televizionet dhe format më moderne të informimit, përfshirë Internetin, me ndihmën e të cilave informatat e parapara për afirmimin e ngjarjeve të pensionistëve publikohen nga gazetarët profesionistë, por edhe shumë korrespondentë amatorë dhe fotoreporterë - pensionistë. Në këtë mënyrë mundësohet edhe e drejta e informimit të qytetarëve me aktivitetet e pensionistëve, por edhe me inkurajimi i mendimeve dhe ideve të ndryshme.

2. FORMAT E INFORMIMIT NË LSHPM

Viteve të kaluara Lidhja, por edhe shoqatat anëtare të Lidhjes i kanë kushtuar një rëndësi të madhe informimit. Informimi u zhvillua në dy drejtime, që ndihmoi për forcimin e besimit dhe bashkëpunimit midis shoqatave dhe Lidhjes. Shoqatat e pensionistëve u informuan edhe për bashkëpunimin e Lidhjes me Qeverinë dhe ministrinë, veçanërisht me Ministrinë e punës dhe politikës sociale dhe Ministrinë e kulturës. Gjithashtu, një vëmendje të madhe iu kushtua edhe informimit të opinionit të gjerë lidhur me aktivitetet e LSHPM.

Transparenca e punës ndihmoi që disa kritika të pabaza drejtuar Lidhjes të dallohen si të tilla ose si spekulime dhe të pavërteta.

Për sa u përket formave, mund të themi se informimi është zhvilluar në të gjitha mënyrat e mundshme dhe para së gjithash me ndihmën e gazetës "Pensionisti plus", revistës në gazetën "Nova Makedonija" me titullin "Pikëpamjet e pensionistëve" dhe faqes në gazetën në gjuhën shqipe "Koha", ndërsa kohë pas kohe informimi është realizuar edhe me ndihmën e gazetave dhe revistave të tjera dhe me ndihmën e shumë radio dhe televizioneve në nivel lokal dhe nacional. Informimi u zhvillua edhe me ndihmën e përmbajtjeve të publikuara në ueb faqen e LSHPM, në të cilën rregullisht publikohet gazeta "Pensionisti plus", dy buletinet e sportit dhe sfilatave dhe njëkohësisht në ueb faqen e LSHPM janë publikuar informatat më interesante

dhe më të rëndësishme të publikuara në ueb faqet e tjera ose revistat e tjera. Gjithashtu, u përgatitën edhe 28 nënfaqe të 28 shoqatave, me informata për shoqatat, programet, strukturën organizative dhe të dhëna kontakti. Shoqata e parë që dha të dhëna për formimin e nënfaqeve ishte SHP Karposh nga Shkup, ndërsa në këtë mënyrë u forcua bashkëpunimi midis shoqatave dhe u mundësua informimi më i mirë lidhur me aktivitetet e tyre.

Përveç formave të informimit të përmendura më sipër, "Pikëpamjet e pensionistëve", "Pensionisti plus" dhe faqja e pensionistëve në gazetën në gjuhën shqipe "Koha", Lidhja boton edhe fletushka, posterë dhe forma të tjera informimi.

Në organizimin e pensionistëve në Maqedoni veçohet viti 2008, kur si rezultat të një projekti të z. Dragi Argirovski, u publikua gazeta e parë informative e pavarur dhe falas e LSHPM me titullin "Pensionisti plus", që në fakt ishte një paralajmërim i një mënyre të re të informimit të pensionistëve.

Me shkrimin e numrit të parë të gazetës "Pensionisti plus", Kryeredaktori **Çedo Georgievski** ka theksuar se gazeta dhe ueb faqja kanë qenë një hap i madh në informimin dhe se LSHPM me rreth 250.000 anëtarë ka nevojë për një sistem informimi që duhet të plotësojë qëllimet dhe detyrat kryesore të fushës përkatëse. Përse bëhet fjalë në fakt? Brenda Lidhjes një kohë më të gjatë është

ПЕНЗИОНЕР

Титул на СЗПМ БЕСПЛАТЕН МЕСЕЧЕН
+ 30 СЕГАШИТЕ И ИДНИТЕ ПЕНЗИОНЕРИ

Издание: август 2008 г.
Редовен член: 02 321 327
e-mail: kontakt@szpm.org.mk
www.szpm.org.mk

Кои правот број?

Крупен истражувач во информирањето



Скопје. Тоа е првата година откако на 1 јули 2008 г. "Пензионер" е издаван како месечен весник. До денеска, во својот тираж имаа околу 7.000 примероци, што значи дека сега во секој дом во Скопје постои барем еден примерок од весникот. Иако е бесплатен, "Пензионер" е многу ценет од своите читатели. Тоа е благодарност за тоа што весникот не само информира, туку и зајакнува соработката меѓу пензионистите и државата.

Во Скопје постојат и други весници, но ниту еден од нив не е посветен на пензионистите. "Пензионер" е првиот весник во Македонија кој е посветен на пензионистите. Тоа е и првиот весник во Македонија кој е бесплатен. Тоа е и првиот весник во Македонија кој е издаван месечно.

Во Скопје постојат и други весници, но ниту еден од нив не е посветен на пензионистите. "Пензионер" е првиот весник во Македонија кој е посветен на пензионистите. Тоа е и првиот весник во Македонија кој е бесплатен. Тоа е и првиот весник во Македонија кој е издаван месечно.

Скопје. Тоа е првата година откако на 1 јули 2008 г. "Пензионер" е издаван како месечен весник. До денеска, во својот тираж имаа околу 7.000 примероци, што значи дека сега во секој дом во Скопје постои барем еден примерок од весникот. Иако е бесплатен, "Пензионер" е многу ценет од своите читатели. Тоа е благодарност за тоа што весникот не само информира, туку и зајакнува соработката меѓу пензионистите и државата.

Во Скопје постојат и други весници, но ниту еден од нив не е посветен на пензионистите. "Пензионер" е првиот весник во Македонија кој е посветен на пензионистите. Тоа е и првиот весник во Македонија кој е бесплатен. Тоа е и првиот весник во Македонија кој е издаван месечно.

ПЕНЗИОНЕР

Титул на СЗПМ БЕСПЛАТЕН МЕСЕЧЕН
+ 30 СЕГАШИТЕ И ИДНИТЕ ПЕНЗИОНЕРИ

Издание: август 2008 г.
Редовен член: 02 321 327
e-mail: kontakt@szpm.org.mk
www.szpm.org.mk

Редакциски одбор:

Главен и одговорен уредник:
Драги Аргировски

Членови:

Димче Апостолски,
Иванчо Кузмановски,
Калина Сливоска Андонова,
Костадинка Кајмаковска,
Цветанка Илиева,
Хисен Шакири

Адреса:
СЗПМ, 12 ударна бригада
бр. 2, зграда на ССМ - Скопје
Телефон: 02 3223 710
тел-факс: 02 3128 390
Web: www.szpm.org.mk
E-mail: kontakt@szpm.org.mk

Дизајн и компјутерна обработка:
www.koma.com.mk

Печати:
Графички центар Скопје

Ракописите и фотографиите не се враќаат.

Според Законот, за весникот се плаќа данок според посебна намалена даночна стапка.

kërkuar një mënyrë më efikase informimi. Deri më tani janë përdorur forma të ndryshme. Gjatë tre e gjysmë viteve të fundit me sukses u botua revista në gazetën "Nova Makedonija", me titullin "Pikëpamjet e pensionistëve". Kjo revistë botohej një herë në muaj, në katër faqe, me cilësi të mirë dhe plotësonte nevojat e lexuesit. Revista ishte një hap i madh përpara në fushën e informimit, por nuk mjaftonte.

Në MTV paralelisht transmetohej emisioni "Moshë e tretë", një emision që vlerësohet shumë nga anëtarësia dhe bashkë me revistën "Pikëpamjet", kompletoi sistemin e informimit të pensionistëve në nivel republike.

- Pensionistët tani e tutje do ta kenë gazetën e tyre! Treguam një fjalë me rëndësi të madhe. Të kesh një gazetë të pavarur është një arritje e madhe. Ne pensionistët kemi gazetën tonë, të cilën e quajmë "Pensionisti plus".

Kjo gazetë do të publikohet një herë në muaj dhe për dallim nga "Pikëpamjet", do të ketë katër herë më shumë faqe ose gjithsej gjashtëmbëdhjetë faqe. Ky është dallimi i parë i madh në raport me "Pikëpamjet". Dallimi i dytë është tirazhi më i madh prej 7.000 kopje, që do të thotë se mund ta fitojnë më shumë pensionistë nëse do t'u ndahet vetëm tyre, kuptohet falas. Ndarja falas e gazetës është dallimi i tretë i madh. Dallimi iu katërt është numri shumë i më i madh i informatave lidhur me shoqatat, me ndihmën e numrit më të madh të korrespondentëve. E gjithë kjo flet për një cilësi të re dhe jo vetëm kuantitet, më shumë shkrime për jetën e përditshme, aktivitetet dhe zhvillimet në degat, shoqatat, klubet, seksionet dhe shumë të tjera. Me ndihmën e shkrimeve dhe fotografive do ta gjejnë veten shumë pensionistë, do të verifikohet kontributi i tyre për ngritjen e cilësisë së aktiviteteve në ambientin ku veprojnë, një përmbajtje e re dhe më e mirë në jetën e pensionistëve. Me informatat do të kemi një ndikim pozitiv dhe do të kemi synime të reja për vetveten dhe të tjerët.

Për numrin e parë të gazetës "Pensionisti plus", zëvendës kryeredaktori i gazetës, z. Dragi Argirovski përkatiti një intervistë me z. **Dushko Shurbanovski**, kryetar i Kuvendit dhe Këshillit ekzekutiv të LSHPM. Me këtë intervistë theksi u vendos në informimin si një interes i drejtpërdrejtë i pensionistëve. Me këtë rast Shurbanovski theksoi si më poshtë vijon:

- Për pensionistët, botimi i gazetës "Pensionisti plus" do të mundësojë më shumë informata për çështjet me interes për pensionistët dhe çështjet që kanë të bëjnë me nevojat e tyre. Gazeta do të mundësojë edhe informimin e opinionit më të gjerë me gjendjen e kësaj kategorie dhe me nevojat e tyre, por edhe me informimin e organeve kompetente lidhur me nevojat e pensionistëve, rritjen e ndjenjës së solidaritetit të gjeneratave më të reja për prindërit, gjyshërit dhe gjyshet e tyre. Gazeta do të ndihmojë që të rinjtë të njihen me kontributin

e pensionistëve, jo vetëm në formimin e shtetit maqedonas me pjesëmarrjen në Luftën Nacional Çlirimtare, por edhe me ndërtimet pas luftës dhe ndërtimin e bazës materiale të vendit.

Pritet të hapet edhe një **ueb-faqe për LSHPM** sepse kjo formë prezantimi dhe komunikimi është e nevojshme me anëtarët - 48 shoqatat e pensionistëve, por edhe me shtetasit tanë që jetojnë jashtë vendit.

Gazeta informative e LSHPM "Pensionisti plus" me përmbajtjet e saj për pensionistët e sotëm dhe të ardhshëm botohet në 6.000 kopje dhe është një nga gazetatat më të lexuara në Republikën e Maqedonisë sepse publikohet edhe në formë elektronike dhe shpërndahet në 400 klubet e pensionistëve në Maqedoni, ku brenda javës qëndrojnë dhe shoqërohen rreth 150.000 pensionistë dhe qytetarë të tjerë.

Që nga viti 2011 në gazetën "Pensionisti plus" botohet një faqe në gjuhën shqipe, ndërsa në gazetën në gjuhën shqipe "Koha", disa vite me radhë botohet një faqe e paraparë për pensionistët.

Nga viti 2016 gazeta publikohet në ueb faqen e LSHPM.



Në vitin 2011 u pasurua ueb-faqja e LSHPM, e cila deri më sot është një faktor me rëndësi i informimit të pensionistëve dhe të moshuarve që jetojnë jashtë vendit, në mbarë botën.

Në televizion transmetohet emisionet speciale "Moshë e tretë" në TVM dhe "Ktheje kohën" në TV Alfa, "Vitet e arta" në radion maqedonase dhe shumë kronika në kuadër të emisioneve dhe programeve të ndryshme televizive.

2.1. 2.1. KOMISIONI I INFORMIMIT DHE VEPRIMTARISË BOTUESE TË KE TË LSHPM

Informimi në fillim zhvillohej me ndihmën e Komisionit të jetës kulturore-argëtuese. Komisioni i informimit dhe aktivitetit botues i Këshillit ekzekutiv të LSHPM u formua në vitin 2008. Kryetar i parë i Komisionit ishte Dragi Argirovski. Komisioni ka programin dhe planin e punës që miratohet çdo vit dhe sipas të cilit zhvillohen aktivitetet dhe qëllimet e tij të mëposhtme:

- Informimi i saktë dhe në kohë;
- Sigurimi i informatave mbi punën e Lidhjes së shoqatave të pensionistëve drejtuar anëtarëve dhe anasjelltas;

NDARJA SOLEMNE E MIRËNJOHJEVE PËR MË TË MIRËT

Më 21 dhjetor 2016, Komisioni i informimit dhe veprimtarisë botuese të LSHPM mbajti një seancë në të cilën përveç anëtarëve morën pjesë edhe kryetari i LSHPM, z. Dragi Argirovski, nënkryetari i Kë-

shillit ekzekutiv të LSHPM, z. Salltir Karovski, sekretari i Këshillit ekzekutiv të LSHPM, znj. Stanka Trajkova dhe nënkryetari i Komisionit të jetës kulturore-argëtuese të LSHPM, z. Mendo Dimovski.

● Sigurimi i informatave mbi punën e Lidhjes së shoqatave të pensionistëve drejtuar opinionit të gjerë dhe anasjelltas;

● Sigurimi i informatave mbi punën e të gjitha institucioneve qeveritare dhe joqeveritare, organizatave lidhur me problematikën e pensionistëve, drejtuar Lidhjes së shoqatave të pensionistëve dhe anëtarëve të saj;

● Inkurajimi i krijimit dhe aktivitetit botues të personave të moshës së tretë.

Në vitin 2011 në detyrën e Kryetarit të Komisionit u zgjodh znj. Kalina S. Andonova.



Me solemnitetin e rastit mirënjohje fituan mediat për kontributin e tyre në zhvillimin e organizimit të pensionistëve në Maqedoni gjatë 70 viteve të kaluara, media këto me të cilat bashkëpunon Lidhja dhe të cilat kanë pasuruar informimin lidhur me problematikën e pensionistëve në vendin tonë. Me këtë rast mirënjohje fituan: gazeta "Nova Makedonija", GCS, gazetata "Dnevnik", "Večer" dhe "KOHA", MTV, Radioja e Maqedonisë, TV ALFA dhe MTM. Gjithashtu mirënjohje fituan edhe 10 korrespondentët e gazetës "Pensionisti plus", korrespondentët më të mirë dhe me përvojë pune më të gjatë, të cilët me tekstet e tyre nga numri në numër rritën cilësinë e gazetës. Mirënjohje fituan: Milevka Zdravkovska, Gojko Eftoski, Cveta Spasikova, Krste Spaseski, Dobro Todorovski, Vjollca Sadiku, Snezhana Kutuzovska, Vasil Paçemski, Vukica Petrusheva dhe Kiril Risteski.



ПЕНЗИОНЕР <i>plus</i> Весник за сегашните и за идните пензионери Издавач: СЗПМ Година IX – број 100 ноември 2016 год. БЕСПЛАТЕН МЕСЕЧЕН ВЕСНИК	Издавачки совет: Драги Аргировски (претседател) Бесник Поцеста Салтир Каровски Станка Трајкова Гидо Бојчевски Лена Семеновска Павле Спасов Д-р Веле Алексоски Груица Манасиев E-mail: argirovski@szpm.org.mk	Редакциски одбор: Калина Сливовска - Андонова главен и одговорен уредник; Мендо Димовски, заменик главен и одговорен уредник; Членови: Цветанка Илиева Баки Бакиу, Спиро Николовски, Вадије Зендџи Димитар Чавдаров	Лектор: Верица Тоциновска Адреса: СЗПМ Бул. „Кочо Рацин“ бр. 14 – Скопје П.факс. 440 Телефон: 02 3223 710 тел-факс: 02 3128 390 Web: www.szpm.org.mk E-mail: vesnik@szpm.org.mk	Компјутерска обработка: Томе Ангеловски Печати: Графички центар Скопје Раколисите и фотографиите не се враќаат. Според Законот, за весникот се плаќа данок според посебна намалена даночна стапка.
---	---	--	---	---

2.2. PUNËTORI PËR KORRESPONDENTËT

Informimi, si deri më sot, është një nga prioritetet e SHPM sepse pa një informim të saktë dhe në kohë nuk mund të kemi asgjë.

Me qëllim që ky prioritet të organizohet më mirë, u formua një rrjet korrespondentësh që furnizon gazetën "Pensionisti plus", "Pikëpamjet e pensionistëve" dhe "KOHA". Për edukimin e këtyre kuadrove deri më sot janë zhvilluar 4 punëtori.

Punëtorja e parë në vitin 2012

Informimi i saktë dhe në kohë

Me fillimin e mileniumit të ri, pensionistët në Maqedoni kishin gjithnjë e më shumë mundësi të fitojnë informata më cilësore dhe më interesante të karakterit të përgjithshëm, me theks të veçantë në infor-



matat lidhur me standardin e pensionistëve, nivelin e pensioneve, harmonizimin e tyre me rritjen e shpenzimeve të jetës, kushtet e mjekimit në ambulancë dhe spitalor dhe çmimet e barnave, rehabilitacioni dhe rekreacioni në banja - klimatik, ndërtimi i shtëpive të reja për të moshuarit etj.

Gazeta "Pensionisti plus" - gazetë mujore e LSHPM, revista "Pikëpamjet e pensionistëve" e cila një herë në muaj botohet në gazetën ditore "Nova Makedonija" dhe faqja në gazetën "KOHA", publikojnë më shumë informata lidhur me çështjen më sipër.



Për të realizuar qëllimin e paraparë, revistat të jenë më të pasura me përmbajtje me tema të ndryshme dhe të jenë më interesante për pensionistët, më 15 nëntor 2012, në Liqenin e Velesit u zhvillua punëtorja e parë me korrespondentët dhe bashkëpunëtorët nga Republika e Maqedonisë.

- Falë pluralizmit të mediave dhe zhvillimit të tregut medial në Republikën e Maqedonisë, vazhdimisht inkurajohet aktivizimi i organizatës së pensionistëve, sidomos në aspektin e informimit për arritjen e rezultateve dhe mënjanimin e problemeve të sigurimit pensional dhe invalidor, mbrojtjen shëndetësore, sigurimin e standardeve dhe kushteve më të mira për të gjithë pensionistët, tha në fillim të kësaj punëtorie Kryetari i LSHPM, z. Dragi Argirovski.

- Pensionistët duhet të informohen saktë dhe me kohë me të gjitha zhvillimet, ndërsa opinioni duhet të fitojë pamjen e plotë lidhur me jetën e pensionistëve dhe problemet e tyre, tha Metodija Toshevski, Kryeredaktori i gazetës "Pensionisti plus".

Gjatë pjesës së punës takimi u nda në dy sesione:

- Përgatitje tekstesh në aspektin gazetaresk dhe
- Përkufizimet kryesore për kompjuterët dhe Internetin.

Pjesëmarrësit e punëtorisë fituan manual për përgatitjen e teksteve, të cilin e përgatitën znj. Kalina Slivovska - Andonova, për pjesën kompjuterike dhe informatike dhe Mendo Dimovski, për pjesën e gazetarisë.

Në debatet morën pjesë: Dobre Todorovski, Pero Milenkovski, Vele Aleksovski, Taska Gavrovska, Mihail Vasilev, Bozhana Qullafkova, Jordan Kostadinov, Cveta Spasikova etj.

Punëtorja e dytë në vitin 2014

Informimi dhe edukimi

Më 29 janar 2014 u zhvillua punëtorja e dytë në të cilën morën pjesë korrespondentë të shumë shoqatave, Këshilli redaktues, Këshilli botues dhe Komisioni i informimit të LSHPM. Mediator i punëtorisë ishte Kryeredaktori i gazetës "Pensionisti plus" ishte Metodija Toshevski. Ai në fillim përshëndeti të pranishmit dhe theksoi si më poshtë vijon:

- Në vitin 2012 u mbajt punëtorja e parë me korrespondentët e revistave tona informative. Rezultatet e fituara treguan se punëtorja arriti qëllimin e saj.

Punëtorja e dytë është një vazhdim i punës dhe njësoj si punëtorja e parë ka pjesë teorike dhe pjesë praktike. Korrespondentët përveç anatomisë së informacionit do të njihen edhe me përdorimin e avancuar të Internetit, për pranimin dhe dërgimin e teksteve dhe fotografive, tha Metodija Toshevski gjatë hapjes



së punëtorisë.

Sekretari i Këshillit ekzekutiv të LSHPM, znj. Stanka Trajkova, i njoftoi të pranishmit me programin e Lidhjes të vitit 2014, duke vënë theksin në Projektin "Karta sociale" dhe aktivitetet që do të realizohen në vitin 2014, vit ky i cili nga ana e Lidhjes u shpall viti i solidaritetit.

Sipas agjendës së punëtorisë, Kryetari i LSHPM dhe Kryetari i Këshillit botues, z. Dragi Argirovski, në bazë të përvojës së tij gazetareske 50-vjeçare, foli mbi përgatitjen e një informacioni të mirë, duke theksuar si më poshtë vijon:

- Gjatë përgatitjes së një teksti ose një informacioni, analizoni të gjitha aspektet dhe gjithmonë kujdesuni për të vërtetën. Në këtë mënyrë mund të kemi objektivitet.

Pas pjesës teorike, znj. Kalina Slivovska - Andonova të pranishmëve u prezantoi mënyrën e përdorimit të Internetit për pranimin dhe dërgimin e teksteve dhe fotografive. Ajo informoi të pranishmit

edhe për ueb faqen e LSHPM, e cila vitin e kaluar u pasurua me arkivin e të gjitha gazetave dhe buletinëve. Ueb faqja këtë vit u pasurua edhe me arkivin e risive dhe ngjarjeve të reja.

Lidhur me përfitimet dhe rezultatet e punëtorisë së parë foli Mendo Dimovski, ndërsa Taska Gavrovska foli mbi përdorimin e drejtë të gjuhës dhe gabimet e zakonshme që i bëjnë korrespondentët.

Në debatin konkret morën pjesë: Milevka Zdravkovska, Pero Milenkovski, Dobro Todorovski, Krste Spaseski, Cvetanka Ilievska, Gojko Eftovski, Sevastija Sotirovska, Sonja Smilevska, Svetlana Petkovska, Spirko Nikolovski dhe Cveta Spasikova. Në kuadër të punëtorisë u arrit në konkluzionin se punëtoritë e këtij lloji janë të dobishme në shumë aspekte sepse ofrojnë edukime, shkëmbim përvojash dhe shoqërim.

Punëtorija e tretë në vitin 2015

Lidhja ka një rrjet korrespondentësh që mund ta dëshirojë çdo medie

Në Shkup, më datën 20.02.2015, u mbajt punëtorija e korrespondentëve të LSHPM. Në sallën e plotë, në të cilën ishin të pranishëm mbi pesëdhjetë korrespondentë nga të gjitha shoqatat anëtare të Lidhjes, me kënaqësi u konstatua se informimi i pensionistëve dhe opinionit më të gjerë, brenda dhe jashtë vendit, lidhur me pensionistët, problemet dhe sukseset e tyre, është një detyrë e përfaqësuesve të moshës së tretë.

Bashkëpunëtori më i vjetër midis tyre, i cili vizaton ilustrime për faqen e argëtimit të gazetës "Pensionisti plus" ishte Mile Topuz, i cili futet në dekadën e nëntë të jetës, por bashkëpunon pa rezervë dhe dërgon vizatime, përdor dhe njeh teknologjinë informatike, për të qenë efikas dhe i pavarur nga djali i tij dhe nipërit.

Korrespondenti me stazh pune më të gjatë ishte Gojko Eftovski, gazetar nga Tetova, ndërsa midis të pranishmëve, shqiptari i vetëm ishte Baki Bakiu, redaktori i faqes në gjuhën shqipe të gazetës "Pensionisti plus" i cili shkruan dhe përkthen tekste në gjuhën maqedonase dhe shqipe.





Në rrjetin e korrespondentëve, të cilin mund ta dëshirojnë shumë media më serioze kishte edhe gazetarë me përvojë të pasur gazetareske, shkrimtarë, poetë, por edhe gazetarë amatorë të profesioneve të ndryshme, të cilët me shumë punë dhe dashuri e mësojnë këtë zanat të vështirë dhe me përgjegjësi. Ato jo vetëm që shkruajnë, por dërgojnë edhe fotografi për tekstet e tyre, që të jenë më të mira dhe më të besueshme.

Punësoria filloi me fjalën e Kryetarit të LSHPM, z. Dragi Argirovski. Gjatë fjalimit, ai ndër të tjera theksoi se, për të qenë një gazetar i mirë duhet hulumtuar dhe gjithmonë duhet pozicionuar në anën e objektivitetit dhe të vërtetës, duhet kritikuar dhe anashkaluar kritikizmin, por edhe të theksohet e mira. Si gjithmonë fjalimi i tij u ndoq me kujdes dhe respekt nga të pranishmit.

Për projektet e reja të Lidhjes foli Stanka Trajkova, sekretarja e Këshillit ekzekutiv të LSHPM. Pas shtjellimit të Programit të LSHPM të vitit 2015, prezantimit të disa aspekteve, por edhe gabimeve që bëhen zakonisht në tekstet që i dërgojnë korrespondentët, fjalën e mori Mendo Dimovski, zëvendëskryeredaktori i gazetës "Pensionisti plus", i cili në fjalimin e tij kishte për qëllim eliminimin e gabimeve dhe rritjen e cilësisë së gazetave informative: gazetës falas të LSHPM "Pensionisti plus", revistës "Pikëpamjet e pensionistëve", që botohet në gazetën "Nova Makedonija", faqes së pensionistëve në gazetën në gjuhën shqipe "KOHA" dhe ueb faqes së Lidhjes, që ato të jenë në një nivel sa më të lartë.

Në këtë punëtori u diskutua edhe përdorimi i teknologjisë informatike dhe përsosja e njohurive informatike të korrespondentëve, elemente këto për të cilat Kalina S. Andonova, Kryetare e Komisionit të informimit të Këshillit ekzekutiv të LSHPM dhe Kryeredaktori i gazetës "Pensionisti plus". Gjatë fjalës së saj ajo theksoi se në këtë aspekt regjistrohet një përparim i dukshëm sepse vetëm tre shoqata dërgojnë tekste, lajme dhe fotografi me postën standarde, ndërsa të tjerat përdorin postën elektronike. Në këtë kontekst, nëse do të merret parasysh se mosha e korrespondentëve është 70-75 vjet, puna e tyre meriton respekt dhe mirënjohje! Në fillim puna ka qenë shumë më ndryshe, tha Andonova.

Gjithashtu, në kuadër të punëtorisë u diskutua edhe për ueb faqen e LSHPM, e cila gjithnjë e më shumë lexohet në të gjitha vendet, por edhe jashtë Maqedonisë. Me hapjen e nënfaqeve për çdo shoqatë anëtare të LSHPM, u përmirësua kontakti midis shoqatave dhe shkëmbimi i përvojave u bë më cilësor.

Në pjesën finale u zhvillua një debat, në kuadër të të cilit të pranishmit konstatuan se informimi brenda Lidhjes funksionon mirë dhe ndihmon që aktivitetet, rezultatet dhe sukseset e shoqatave dhe Lidhjes në përgjithësi të ngrihen në një nivel më të lartë, pensionistët të mos jenë në margjinat e shoqërisë dhe të kenë jetë më cilësore dhe të plaken në mënyrë aktive. Gjithashtu, u theksua se konstatimet përkatëse nuk nënkuptojnë pushimin e aktiviteteve të mëtejshme, por përkundrazi, mundet dhe duhet të jetë akoma më mirë sepse potenciali intelektual ekziston dhe duhet të shfrytëzohet.

Punësoria e katërt në vitin 2016

Në fokus: Jubileu 70-vjeçar i LSHPM

Me rastin e shënimit të jubileut 70-vjeçar të organizimit të pensionistëve në Maqedoni, me organizimin e LSHPM, më 12 prill 2016, në restorantin "Panini" në Liqenin e Velesit, u zhvillua punësoria e katërt me korrespondentët e gazetës "Pensionisti plus", revistës në gazetën "Nova Makedonija" "Pikëpamjet e pensionistëve" dhe faqes së pensionistëve në gazetën në gjuhën shqipe "Koha". Përveç korrespondentëve të shoqatave të pensionistëve anëtare të Lidhjes, në punëtori morën pjesë anëtarë të Këshillit botues dhe Këshillit redaktues të gazetës "Pensionisti plus" dhe Komisionit të informimit pranë LSHPM. Në emër të organizatorit të pranishmit fillimisht i përshëndeti dhe takimin e shpalli të hapur Kalina Slivovska -



Andonova, Kryeredaktore e gazetës "Pensionisti plus" dhe redaktore e revistës "Pikëpamjet e pensionistëve", si dhe të faqes në gjuhën shqipe në gazetën "KOHA", e cila theksoi rëndësinë e punëtorisë në aspektin e konfirmimit të rezultateve të punës dhe shkëmbimit të përvojave, me qëllim përmirësimin e cilësisë së informimit.

Pas saj korrespondentëve iu drejtua Kryetari i LSHPM, z. Dragi Argirovski, i cili është edhe Kryetar i Këshillit botues të gazetës "Pensionisti plus". Gjatë fjalës së tij ai theksoi efektet e informimit të drejtë dhe në kohë, të cilat në vitin e jubileut ose shënimit të 70-vjetorit të organizimit



të pensionistëve duhet të jenë akoma më të mira dhe më të dukshme, që është veçanërisht me rëndësi për shkak të përpjekjeve të disa elementeve destruktive që përpiqen të dobësojnë rëndësinë e organizimit të pensionistëve dhe të krijojnë kushte për të realizuar qëllime dhe interesa

personale. Për këtë arsye, duhet të tregohet dhe të dihet e vërteta e Lidhjes, vazhdimisht të prezantohen qëllimet dhe aktivitetet e LSHPM, me qëllim që akoma më shumë të afirmohet dhe forcohet rejtingu i Lidhjes. Me fuqinë e argumenteve dhe penës së gazetarit mund të vepohet në drejtim të informimit më të shpejtë dhe më real të pensionistëve, që ato të jenë në gjendje vetë të përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat e tyre.

Kryeredaktori i gazetës, znj. Kalina S. Andonova foli mbi rëndësinë e përsosjes së njohurive informatike të korrespondentëve, ndërsa Zëvendëskryeredaktori dhe redaktori përgjegjës Mendo Dimovski, bëri një krahasim midis punëtorisë së parë dhe të katërt, në aspektin e përsosjes së korrespondentëve për përgatitjen e teksteve. Sekretari i Këshillit ekzekutiv të LSHPM, znj. Stanka Trajkova, theksoi qëllimet e organizimit të pensionistëve në aspektin e realizimit të formave të ndryshme të veprimit në kuadër të shoqatave, duke pasur parasysh aktivitetet dhe zhvillimet momentale me interes për pensionistët. Nën kryetari i Këshillit ekzekutiv të LSHPM, z. Saltir Karovski foli mbi rëndësinë e fjalës së shkruar, duke marrë parasysh edhe mediat elektronike, si një lloj linku me opinionin, për prezantim transparent dhe publikim të rezultateve të shoqatave të pensionistëve dhe Lidhjes. Mbledhjen e gazetarëve e përshëndeti edhe Kryetari i Kuvendit të LSHPM, z. Besnik Pocesta, i cili theksoi rezultatet e informimit dhe shprehu dëshirën që në të ardhmen të jenë akoma më të mira. Në debat morën pjesë: Vele Aleksoski, Cveta Spasikova, Dobro Todorovski, Nada Aleksoska, Spirko Nikolovski, Elica Danilovska, Krste Spaseski dhe korrespondentë të tjerë, të cilët punëtorinë e konsideruan si një nevojë të mëtejshme për orientimin e punës dhe shkëmbimin e përvojave dhe si një inkurajim për arritje akoma më të mëdha në segmentin e informimit të pensionistëve.

2.3. UEB-FAQJA E LIDHJES SË SHOQATAVE TË PENSIONISTËVE TË MAQEDONISË

Lidhja e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë i kushton shumë rëndësi informimit të anëtarësisë, por edhe informimit lidhur me zhvillimet

brenda Lidhjes dhe shoqatave për nevojat e opinionit të gjerë. Ky trend vazhdon me një ritëm të theksuar, kuptohet nëpërmjet gazetës "Pensionisti



plus", revistës "Pikëpamjet e pensionistëve" që botohet me gazetën "Nova Makedonija" dhe faqes për pensionistët që botohet në gazetën "KOHA" në gjuhën shqipe. Informimi i anëtarësisë dhe opinionit zhvillohet edhe me shtypin dhe mediat elektronike në nivel nacional dhe lokal.

Për sa i përket ueb faqes së LSHPM, ajo ndryshon vazhdimisht pamjen dhe përmbajtjen e saj. Në ueb faqe vazhdon të publikohet gazeta "Pensionisti plus", ndërsa nga fillimi i vitit 2014 është mundësuar arkiv me të gjitha risitë, njësoj si arkivi i të gjitha gazetave, që është mundësuar në vitin 2013. Në ueb faqen e LSHPM publikohen edhe buletinet e sportit dhe sfilatat folklorike. Një risi e mirë, kur bëhet fjalë për ueb faqen e LSHPM, është edhe publikimi i nënfaqeve të shoqatave anëtare të Lidhjes.

Nënfaqet e tyre i kanë shoqatat në vashdim: SHP Gazi Babë, SHP Gjorçe Petrov, SHP Dojran, SHP Karposh, SHP Kisella Voda, SHP Taftalixhe DDD, SHP Krushevë, SHP Ohër dhe Debërcë, SHP Radovish dhe Konçe, SHP Solidariteti - Aero-drom dhe SHP Butel. Gjatë periudhës në vijim pritet të përgatiten nënfaqe edhe për shoqatat e tjera. Në këtë mënyrë afirmimi i shoqatave dhe Lidhjes në përgjithësi do të jetë më i plotë, ndërsa komunikimi midis tyre shumë më i mirë.

Kur bëhet fjalë për ueb faqen, mund të lavdërohem se ajo nga dita në ditë vizitohet gjithnjë e më shumë. Për shembull, nga data 11 mars deri në 10 prill të vitit 2014 numri i vizitorëve ishte 573, që do të thotë se në raport me muajin dhjetor të vitit 2013 u rrit për 40 %, sepse të njëjtin muaj faqja ka pasur 335 vizita. Vizitat e realizuara pas kësaj shifre kanë qenë të vizitorëve të rinj. Ueb faqja më shumë vizitohet nga vizitorë nga Republika e Maqedonisë 53%, 19 % prej të cilëve janë nga Shkupi.

Të dhënat tregojnë se shumica e vizitorëve janë të moshës 25 - 34 vjeçe, ndërsa 23,5% janë vizitorë mbi moshën 45-vjeçe. Shifrat janë një provë se faqen e vizitojnë pothuajse të gjitha gjeneratat, ndërsa në aspektin e gjinisë e kanë vizituar 45.84% femra dhe 54.16% meshkuj. Midis vizitorëve mund të gjenden organizata qeveritare dhe jo-qeveritare, punonjës turistikë, informaticientë, sociologë, sportistë, folkloristë, instruktorë që merren me ushqime të shëndetshme etj.

Për sa u përket shteteve dhe rajoneve gjuhësore, pjesa më e madhe e vizitorëve flasin gjuhën angleze ose vendeve që përdorin gjuhën angleze, ndërsa gjatë periudhës përkatëse përqindja ka arritur në 80.28%.

Me përmbajtjet që publikohen në ueb faqen www.szpm.org.mk është siguruar informimi i plotë dhe transparent i punës së Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, brenda dhe jashtë vendit.

Treguesit janë të ngjashëm edhe për vitin 2016, me rritje prej 5-10% të numrit të vizitorëve.

2.4. VEPRIMTARIA BOTUESE QË FINANCOHET NGA LSHPM

Inkurajimi i krijimtarisë dhe veprimtarisë botuese të individëve të moshës së tretë është një nga detyrat por edhe dëshirat e Lidhjes. Për këtë arsye pesë vite me radhë, me planin financiar të Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë parashihen mjete për këtë qëllim. Mjetet në fjalë i ndan një komision treanëtarësh, të cilin e përbëjnë: Dr. Vasil Tocinovski, Tamara Arsova dhe Tome Stojkov.

Në vitin 2004 me mbështetjen e LSHPM u botua libri me titullin "Pensionistët e Maqedonisë sot", me autor Vite Isjanovski.

Në vitin 2006 LSHPM botoi Monografinë e saj me rastin e 50-vjetorit të organizimit të pensionistëve, të cilën e përgatiti Dimçe Apostollovski.

Në vitin 2013 LSHPM mbështeti projektet dhe botimet e pensionistëve më poshtë:

1. Baki Bakiu - "Anekdota nga e gjithë bota"
2. Shoqata e pensionistëve të Komunës Shën Nikollë - Monografia e SHP Shën Nikollë
3. Trajko Stojkovski dhe Jovan Gjurovski - Monografia: Kaleshanginata staravina - Mariove
4. Sanda Ignjatovska - libri me poezi me titullin "Shpirti"
5. Milevka Zdravkovska - libri poetik "Këngë nga damarët"
6. Mice Pashoevski - përralla fëmijërore "Princesha e sëmurë" dhe "Baba Dimri me nipërit tek ne"
7. Shoqata Kulturore- Artistike Kumanovë - Projekti i dramës - për "R"
8. Mendo Dimovski - libri publicistik "Hapat gjatë jetës"

Në vitin 2014 u mbështetën projektet dhe botimet e autorëve pensionistë në vazhdim:



1. Stojan Kukuneshoski - poezi
2. Snezhana Lazarovska - ekspozitë me piktura me oriz
3. Punëtorja teatrale Kumanovë
4. Bozhana Cuculovska - poezi
5. Blagojka Filipçeva dhe Lidija Simovska - ekspozita "Guri ka shpirt"
6. Jovan Mazganski - libër me poezi
7. Lidija Jeremij - libër me poezi
8. Svetlana Petkovska - projekti "Razbojot na baba mi Veta"
9. Stojan Stefanovski - Monografi
10. Nenad Batkovski - Monografi për shahistin Dimitar Ilievski
11. Dushan Ristoski - Monografia "Përmendoret"
12. Aleksandar Stojanov - Katastrofat natyrore
13. Boris Shuminovski - "Ruaj fjalën" - libër
14. Bllagorotka Stojçevska - "Këngë për dashurinë" (poezi)
15. Ivan Rusjakov - "Kokrra" (aforizma)

Në vitin 2015 u mbështetën projektet dhe botimet e autorëve pensionistë më poshtë:

- Nada Aleksoska - "Këngë për yjet"
- Ivan Gligorovski - "Ilindenasi i fundit" - libër
- Anastas Qushkov - "Lumi i shurdhër"
- Petar Shallamanov - "Poezi"
- Baki Bakiu - "Përralla"
- Lidija Jeremij - "Djepi i shpirtit" - poezi
- Bllagoj Arsov - Monografi
- Lenka Gogovska - "Tregime"
- Mihail Beldedovski - "Makedonski Maleenja" - libër
- Kalina S. Andonova - "Fate" - tregime
- Dushko Josifovski - "Grozdana" - roman
- Sava Takovska - "Jehona e mbrëmjes" - poezi
- Bllagoja Aleksoski - "Xhunxhule"
- Stojan Nasevski - "Rajoni i Kratovës" - libër
- SHP Kumanovë - 10 vjet jetë kulturore
- Shfaqja teatrale "Personi i dyshimtë" - SHP Kumanovë

Në vitin 2016 u mbështetën projektet dhe botimet e autorëve pensionistë më poshtë:
Ilija Gligorov dhe Dragi Argirovski - Studim për organizimin e pensionistëve
Dragi Argirovski - "Argumentet zbardhin të vërtetën" (libër publicistik për erën e tretë)
Dr. Vasil Drvoshanov - "Spevot Jaska nga Metodija St. Toshevski" - libër
Mendo Dimovski - "UNË" - libër

Lidhja gjithashtu ka botuar edhe:
Rregullore




Manual për kontabilistët (3),
Manualë për korrespondentët për përgatitjen e teksteve
Manual për punë me kompjuter (2)
Buletine për garat sportive (18)
Buletine për sfilatat e këngës, muzikës dhe lojërave (14).

Monografi kanë botuar shoqatat në vazhdim: SHP Ohër dhe Debërcë, SHP Koçanë, SHP Probishtip, SHP Tetovë, SHP qendër, SHP Gjorçe Petrov, SHP Karposh, SHP Pensionistët e luftës, SHP Butel, SHP Kumanovë. Informator publikon SHP Kumanovë, në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe.

Me të dhënat më sipër lidhur me informimin brenda LSHPM dhe shoqatave anëtare të pensionistëve dhe me ndihmën e mediave të shtypura dhe elektronike vendase, mund të konstatohet se informimi brenda Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë është në një nivel të lartë dhe shembull për shumë asociacione pensionistësh të rajonit dhe më gjerë, në vendet e Ballkanit dhe Evropë.

Botime jubileu të buletineve të sportit u publikuan në vitet 2000, 2005, 2010 dhe 2015.



Buletini i parë i këngës, muzikës dhe lojërave u publikua në vitin 2003 dhe vazhdon të publikohet çdo vit.



Nga shumë botimet që janë mbështetur financiarisht nga ana e LSHPM, veçojmë promocionin e librit "Argumentet zbardhin të vërtetën", që u publikua me rastin e 70-vjetorit të organizimit të pensionistëve të Maqedonisë, me autor z. Dragi Argirovski.

Më 26 gusht 2016, në sallën e plotë të Lidhjes së Sindikatave të Maqedonisë, para më shumë se 200 adhuresve të fjalës së shkruar, midis të cilëve u gjetën Ministri i punës dhe politikës sociale, z. Dime Spasov, Kryetari i Komunës Gjorçe Petrov, z. Sokol Mitrovski, Lupço Ajdinski, Kryetar nderi i organizatës civile "Shkupjania Nënë Tereza" dhe të ftuar të tjerë, u promovua libri "Argumentet zbardhin të vërtetën", me autor z. Dragi Argirovski, gazetar dhe publicist i njohur. Për librin dhe autorin në fillim foli promotori Aleksandar Dimkovski, Kryeredaktori i gazetës "Nova Makedonija".

- Tek pensionistët frymëzon dhe duhet të jetë shembull për të gjithë ndjenja e bashkimit. Unitetit dhe përkatësisë në shtetin dhe patriotizmi i tyre në moshën e tretë, kundrejt shumë shembujve të ndarjes në aspektin social, politik ose partiak me të cilat ballafaqohemi shpesh. Në ngjarjet e shumta

që i organizojnë pensionistët marrin pjesë masive Maqedonasit, Shqiptarët, Serbët, Turqit, Vllehet, Romët e të tjerë. Ato shoqërohen, garojnë dhe bëjnë shaka. Me një fjalë, ato i gëzohen jetës. Për këtë arsye befasojnë të dhënat e librit me titullin "Argumentet zbardhin të vërtetën", sipas të cilave në aspektin e pasurisë së përbajtjeve informative, të kapshme për anëtarësinë, por edhe për të gjithë qytetarët e tjerë, sot LSHPM është shembulli i vetëm në Ballkan. Libri me titullin "Argumentet zbardhin të vërtetën", i autorit të respektuar, kryetarit të LSHPM, z. Dragi Argirovski, gazetar dhe publicist i respektuar, është i pasur me fakte dhe argumente që mbështeten me të dhëna relevante. E vërteta është përkufizim me rëndësi elementare në jetë dhe për këtë arsye të gjithë ne çdo ditë kërkojmë të vërtetën. Libri i z. Argirovski është i pasur me indikatorë për të vërtetën, që janë sistemuar dhe

prezantuar me analiza krahasuese. Në një mënyrë të kuptueshme, figurative dhe inspirative, me stil të formuat dhe të njohur gazetaresk, autori trajton problematikën, duke mbajtur në nivel të lartë vëmendjen e lexuesit. Sipas rëndësisë edhe ky libër, njësoj si nëntëmbëdhjetë veprat paraprake, pa dyshim do të bëhet pjesë e antologjisë së veprimtarisë vendase të publicistikës, sidomos kur bëhet fjalë për problematikën e pensionistëve. Në këtë aspekt edhe vepra "Argu-



mentet zbardhin të vërtetën", është prova më e mirë, vula e ditëve të sotme, por edhe një përmendore e qartë për të gjitha gjeneratat, që ofron përgjigje për të gjitha temat dhe dilemat aktuale lidhur me jetën e pensionistëve.

Pas tij, para të pranishmëve foli **Kalina S. Andonova**, Kryeredaktore e gazetës "Pensionisti plus", recensuese e librit dhe një nga promotorët e tij. Ajo ndër të tjera tha:

- Libri "Argumentet zbardhin të vërtetën", i autorit Dragi Argirovski, siç mund të shihet edhe me titullin i përkushtohet të vërtetës dhe kërkimit të së vërtetës. Publicisti dhe gazetari Dragi Argirovski, me përvojën e tij të pasur ka për të treguar shumë dhe prandaj shkruan. Provë për këtë gjë janë 20 librat e tij! Argirovski është një autor i mençur dhe i guximshëm, me pikëpamje vizionare. Ai me mendimet, fjalën dhe komentet e tij, nëpërmjet analizave, me sukses zbardh të vërtetën, duke prezantuar një sërë argumentesh dhe faktesh. Në këtë mënyrë ai, me ndihmën e librave të tij, shndërrohet nga një vëzhgues në pjesëmarrës aktiv dhe mbrojtës i të vërtetës, në kuadër të mundësive të veta. Libri "Argumentet zbardhin të vërtetën", i autorit Dragi Argirovski është një vepër me të cilën janë prezantuar shumë nga pikëpamjet e tij, por edhe analizat lidhur me jetën e pensionistëve. Libri

ka analiza dhe hulumtime lidhur me plakjen aktive dhe përmirësimin e standardit të jetës në vitet e vona të jetës, shkrime me të cilat janë përshkruar përpjekje intensive që e gjithë kjo të shndërrohet në një bashkëpunim konstruktiv me të gjitha institucionet kompetente në të gjitha nivelet. Libri "Argumentet zbardhin të vërtetën", është një kontribut personal i Kryetarit Dragi Argirovski me rastin e 70-vjetorit të organizimit të pensionistëve në Maqedoni, si njeriu i parë i organizatës më të madhe joqeveritare dhe multietnike të pensionistëve. Me ndihmën e librit shumë vetë do ta mësojnë të vërtetën dhe do të informohen me shumë gjëra. Me këtë rast, dikush do të jetë i lumtur, ndërsa të tjerët jo, por në çdo rast, të gjithë do të jenë më të pasur me njohuri, të cilat si dritë do të depërtojnë në mendjen dhe zemrën e tyre sepse e vërteta mund të dallohet vetëm në këtë mënyrë.

Në kuadër të promocionit u prezantua edhe mendimi për librin, autorin dhe krijimtarinë e tij, nga ana e regjisorit dhe dramaturgut të njohur **Branko Stavrev**:

- Me lumin e informatave që mund të gjenden në 20 librat, Dragi Argirovski, siguroi një studim sociologjik që ndjek komplet dhe në mënyrë komplekse jetën e njeriut. Filozofia e "plakjes aktive" bëhet një ide bazike e Argirovskit dhe ka të bëjë me


angazhimin e tij të madh që edhe më tej të tregojë dhe provojë se njeriu duhet të krijojë deri sa të jetë gjallë ose deri në frymën e tij të fundit. Dragi Argirovski bën përpjekje të mëdha për të analizuar idetë pozitive, por njëkohësisht, në formën e paralelizmit të veprimeve të përgjithshme, lidhur me betejat për një jetë më të mirë të individëve të moshës së tretë, në mënyrë permanente mbështet edhe një aksion dytësor, të regjistrohet gjithçka, të regjistrohet edhe lajmi më i shkurtër për çfarëdo lloj ngjarjeje, të polemizohet me ato që mendojnë më ndryshe, të përgatitet parathënie për libër, të informojë për aktivitetet kulturore, politike dhe sportive dhe gjithçka që është zbardhur me gazetën, radion dhe televizionin, ndërsa kohëve të fundit edhe me rrjete sociale dhe të gjitha të përmbledhen në një libër - dokument për kohën e sotme, e cila nesër, sipas zakoneve metafizike, do të bëhet e kaluar. Me saktësinë e stenodaktilografit qytetari Dragi Argirovski angazhon gazetarin Dragi Argirovski, i cili regjistron çdo pjesë, qoftë edhe pjesën më të

vogël dhe jetëson, me qëllim që elementet e kalueshme t'i shndërrojë në diçka të qëndrueshme, me shpresë se do të shërbejë për të ardhmen. Në fund, mund të themi se brenda Dragi Argirovskit jetojnë dy personalitete. Ai i zhurnalistit dhe qytetarit, që bashkohen në një, për të mbështetur provën se plakja është e pashmangshme, por mund të jetë aktive. Me veprat e tij mësojmë se që para se të dal në skenën e jetës, ai ka ditur kush dhe çfarë rol do të luaj dhe në këtë mënyrë do të deklarojë kuptimin e pranisë së tij krijuese para babait dhe atdheut.

Mendimet dhe lavdërimet e tyre për autorin dhe krijimtarinë e tij i shprehën edhe Mendo Dimovski, Metodija Novkovski dhe Nijazi Xhelili, të cilët theksuan se vepra më e re e autorit është një libër nga i cili mund të lexohet dhe mësohet për gazetarinë hulumtuese, por edhe për zhvillimet në LSHPM dhe më gjerë.

Në fund, autori i librit Dragi Argirovski, falënderoi sinqerisht të gjithë të pranishmit.

IX ДЕЛ



PLAKATE, MIRËNJONJE DHE FLETË FALENDERIMI

PLAKATE, MIRËNJOHJE DHE FLETË FALENDERIMI

1. PLAKATE DHE MIRËNJOHJE

Me rastin e 70-vjetorit të organizimit të pensionistëve në Maqedoni, Lidhja e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë ndau 97 pllakate dhe 162 mirënjohje për persona dhe institucione eminente, aktivistë të shquar, kryetarë komunash dhe organizata të shquara që kanë dhënë kontributin e vet për zhvillimin e organizmit të pensionistëve në vendin tonë.



PLAKATE PËR PERSONA DHE INSTITUCIONE EMINENTE

1. Presidenti i Republikës së Maqedonisë Gjorge Ivanov
2. Kuvendi i i Republikës së Maqedonisë
3. Qeveria e Republikës së Maqedonisë
4. Ministria e punës dhe politikës sociale
5. Ministria e kulturës
6. Ministria e shëndetësisë
7. Ministria e financave
8. Ministria e mbrojtjes
9. Lidhja e sindikatave të Maqedonisë
10. Lidhja e luftëtarëve të Maqedonisë
11. Kryqi i Kuq i Maqedonisë
12. Fondi i Sigurimeve Pensionale dhe Invalidore të Maqedonisë (FSPIM);
13. Fondi i Sigurimit Shëndetësor të Maqedonisë (FSSHM)
14. Dime Spasov, Ministri i punës dhe politikës sociale
15. Elizabeta Kançeska Milevska, Ministra e kulturës
16. Spiro Ristovski, zëvendësministri i arsimit
17. Koce Trajanovski, kryetari i Qytetit të Shkupit
18. Andrej Jus, Hevrika Lubjanë
19. Anton Donko, ZDUS Slloveni;
20. ZDUS Sloveni
21. Marjan Shiftar - ZDUS Slloveni
22. Konfederata e sindikatave të Shqipërisë
23. Koll Nikolaj, kryetari i KSA
24. Nazif Daljani, kryetari i KS Pogradec - Shqipëri.

PLAKATE PËR AKTIVISTËT E SHQUAR

- | | |
|---|------------------------|
| 1. Dragi Argirovski, kryetari i LSHPM | 6. Dushko Shurbanovski |
| 2. Besnik Pocesta, kryetari i Kuvendit të LSHPM | 7. Andon Markovski |
| 3. Saltir Karovski | 8. Krste Angelovski |
| 4. Stanka Trajkova | 9. Gjorgji Serafimov |
| 5. Ilija Adamovski | 10. Gjorge Andonov |
| | 11. Dançe Daskalovska |

- | | |
|--------------------------------------|--------------------------|
| 12. Tome Ilioski | 32. Mirko Makreshanski |
| 13. Dimitrija Bogatinoski | 33. Zdravko Petkovski |
| 14. Gjorgji Trpçeski | 34. Risto Anxuxhev |
| 15. Kiril Gjorgjioski | 35. Vele Aleksoski |
| 16. Spirko Nikolovski - SHP Kumanovë | 36. Nijazi Xhelili |
| 17. Pavle Spasev | 37. Lena Semenakova |
| 18. Aleksandar Zahariev | 38. Risto Trajkoski |
| 19. Jordan Kostadinov | 39. Stanko Sipkovski |
| 20. Shaban Sabriu | 40. Mihail Vasilev |
| 21. Dushan Risteski | 41. Mentor Shoku |
| 22. Fidanço Stoev | 42. Gruica Manasiev |
| 23. Sllavko Stojanovski | 43. Kalina S. Andonova |
| 24. Petar Zaharçev | 44. Mendo Dimovski |
| 25. Jovan Ginovski | 45. Ilija Gligorov |
| 26. Metodija Novkovski | 46. Olga Novaçeva |
| 27. Shaban Azizi | 47. Mitre Stojanovski |
| 28. Lupço Dimovski | 48. Milevka Zdravkovska |
| 29. Ramiz Qazimovski | 49. Lubica Kuzmanovska |
| 30. Aleksandar Dimkovski | 50. Stojançe Stefanovski |
| 31. Risto Frangov | 51. Ziko Zikov |

PLAKATE PËR KRYETARËT E KOMUNAVE

1. Ratko Dimitrovski, Kryetari i Komunës Koçanë
2. Sokol Mitrovski, Kryetari i Komunës Gjoçe Petrov
3. Petre Latinovski, Kryetari i Komunës Butel
4. Stevçe Jakimovski, Kryetari i Komunës Karposh
5. Zoran Damjanovski, Kryetari i Komunës Kumanovë
6. Ilčo Zahariev, Kryetari i Komunës Shtip
7. Marjan Risteski, Kryetari i Komunës Prilep
8. Vlladimir Talevski, Kryetari i Komunës Manastir
9. Sllavço Çadiev, Kryetari i Komunës Veles
10. Zoran Zaev, Kryetari i Komunës Strumicë
11. Sashko Nikollov, Kryetari i Komunës Radovish
12. Ivan Frangov, Kryetari i Komunës Gjevgjeli
13. Darko Mitrovski, Kryetari i Komunës Makedonska Kamenica
14. Toni Tonevski, Kryetari i Komunës Probishtip
15. Izet Mexhiti, Kryetari i Komunës Çair
16. Arsenço Aleksovski, Kryetari i Komunës Kriva Pallanka
17. Zhika Stojanovski, Kryetari i Komunës Ilinden
18. Toni Trajkovski, Kryetari i Komunës Gazi Babë
19. Trajçe Dimitriev, Kryetari i Komunës Demir Kapi
20. Lupço Bllazhevski, Kryetari i Komunës Demir Hisar
21. Borçe Mitevski, Kryetari i Komunës Petrovec
22. Bekim Murati, Kryetari i Komunës Saraj

MIRËNJOHJE PËR ORGANIZATAT E SHQUARA

- | | |
|----------------------------------|---|
| 1. Shtëpia e ARM Shkup | 6. Komercijalna banka Shkup |
| 2. Drejtoria e "Nova Makedonija" | 7. Qendra grafike Shkup |
| 3. NLB Banka Shkup | 8. Shtypshkronja RI-grafika Shkup |
| 4. Sava osiguruvanje Shkup | 9. Televizioni i Maqedonisë - Mosha e tretë |
| 5. ZEGIN | 10. Radioja maqedonase Radio Shkup |

- | | |
|--|---|
| 11. Redaksia e gazetës KOHA | 24. SHKA e SHP Tetovë |
| 12. Redaksia e gazetës Dnevnik | 25. SHKA "Pensionist" dhe "Penka Koteska" e SHP Prilep |
| 13. Redaksia e gazetës Veçer | 26. SHKA e SHP Radovish |
| 14. Televizioni Kanal 5 | 27. SHKA e SHP Makedonska Kamenica |
| 15. Televizioni MTM | 28. Klubi i adhuresve të librit "Solidariteti - Aerodrom" - Shkup |
| 16. Televizioni K-3 Kumanovë | 29. HAK- BUS |
| 17. Banja e Katllanovës | 30. GAZMEND TURIST Dibër |
| 18. Banjat e Dibrës "Capa" | 31. NEW STAR Shkup |
| 19. Banjat e Negorës | 32. SHAMPION Radovish |
| 20. Organizata shëndetësore - Qendra e shërimit natyral Banja Bansko | 33. Redaksia e "Pensionisti plus" e LSHPM |
| 21. SHKA "Gjoko Simonovski" SHP Kumanovë | 34. Teatri Popullor i Maqedonisë |
| 22. SHKA "Pensionistë të lumtur" - SHP Probishtip | |
| 23. SHKA e SHP Koçanë | |

MIRËNJOHJE PËR AKTIVISTËT E SHQUAR

- | | | |
|-------------------------|--------------------------------|----------------------------|
| 1. Trajko Savevski | 26. Sofija Simovska | 51. Lubinko Ristov |
| 2. Risto Prentovski | 27. Sveto Dimovski | 52. Kiro Gerasimov |
| 3. Gjorgji Zarinski | 28. Cvetanka Ilieva | 53. Branko Poçuça |
| 4. Mladen Petrov | 29. Baki Bakiu | 54. Jabllanka Veselinovska |
| 5. Dragan Petkov | 30. Fruska Kostadinovska | 55. Bllagica Markuleska |
| 6. Borivoe Bojaxhiev | 31. Lubomir Georgiev | 56. Nikolla Donev |
| 7. Trajan Pecov | 32. Spirko Nikollovski - Shkup | 57. Bllazho Stanojkov |
| 8. Lupço Lukarski | 33. Millorad Ristevski | 58. Marija Karakamisheva |
| 9. Liman Pollozhani | 34. Zhaklina Muçeva | 59. Bozhana Tasevska |
| 10. Vidan Koneski | 35. Gojko Eftoski | 60. Pavlina Kamçeva |
| 11. Nikolla Atanasov | 36. Arsen Ilievski | 61. Sime Cvetanoski |
| 12. Mirko Danaillov | 37. Vadije Zendeli | 62. Mome Cvetanovski |
| 13. Mirko Trpevski | 38. Mirko Janakiev | 63. Elena Apostollova |
| 14. Dimitrija Dimovski | 39. Cvetanka Angellovska | 64. Toshe Jankulovski |
| 15. Arif Bekir | 40. Vera Buzharovska | 65. Kostadin Stojanov |
| 16. Nurie Kadriu | 41. Nikollajço Nikollov | 66. Vjollca Sadiku |
| 17. Vangelica Markovska | 42. Marija Gjorgieva | 67. Kenan Mimidinovski |
| 18. Nadezhda Davçeva | 43. Liljana Mlladenovska | 68. Verica Tocinovska |
| 19. Done Todorovski | 44. Dragan Georgiev | 69. Tomçe Stojkov |
| 20. Stojan Nasteovski | 45. Jordan Arsovski | 70. Pero Andreevski |
| 21. Jovan Eftimov | 46. Lidija Jeremiq | 71. Najdo Eftovski |
| 22. Adem Osmanfari | 47. Sllavica Lambasha | 72. Liljana Trajanovska |
| 23. Zore Mickovski | 48. Novko Petrushevski | 73. Zoran Andreeski |
| 24. Stevo Bojaxhiev | 49. Faik Jashari | 74. Tome Angelovski |
| 25. Stamen Filipov | 50. Kirill Dameski | |

MIRËNJOHJE PËR SHOQATAT E PENSIONISTËVE ANËTARE TË LSHPM

- | | |
|--|---|
| 1. Shoqata e pensionistëve Berovë | 10. Shoqata e pensionistëve Gazi Babë - Shkup |
| 2. Shoqata e pensionistëve Manastir | 11. Shoqata e pensionistëve Gjevgjeli |
| 3. Shoqata e pensionistëve Bogdancë | 12. Shoqata e pensionistëve Gostivar |
| 4. Shoqata e pensionistëve Butel - Shkup | 13. Shoqata e pensionistëve Dibër dhe Qendrës Zhupë |
| 5. Shoqata e pensionistëve Vallandovë | 14. Shoqata e pensionistëve Dellçevë |
| 6. Shoqata e pensionistëve Vevçanë | 15. Shoqata e pensionistëve Demir Kapi |
| 7. Shoqata e pensionistëve Veles | 16. Shoqata e pensionistëve Demir Hisar |
| 8. Shoqata e pensionistëve Vinicë | |
| 9. Shoqata e pensionistëve të luftës Shkup | |

- | | |
|--|---|
| 17. Shoqata e pensionistëve Dojran | 37. Shoqata e pensionistëve Pehçevë |
| 18. Shoqata e pensionistëve
Gjorçe Petrov - Shkup | 38. Shoqata e pensionistëve Prilep |
| 19. Shoqata e pensionistëve Zletovë | 39. Shoqata e pensionistëve Probishtip |
| 20. Shoqata e pensionistëve Kavadarçë | 40. Shoqata e pensionistëve
Radovich dhe Konçe |
| 21. Shoqata e pensionistëve Karposh - Shkup | 41. Shoqata e pensionistëve Resnjë |
| 22. Shoqata e pensionistëve
Kisella Vodë - Shkup | 42. Shoqata e pensionistëve
Solidariteti - Aerodrom, Shkup |
| 23. Shoqata e pensionistëve Kërçovë | 43. Shoqata e pensionistëve Strugë |
| 24. Shoqata e pensionistëve Koçanë | 44. Shoqata e pensionistëve Strumicë |
| 25. Shoqata e pensionistëve Kratovë | 45. Shoqata e pensionistëve
Taftalixhe DDD Shkup |
| 26. Shoqata e pensionistëve Kriva Pallankë | 46. Shoqata e pensionistëve Tetovë |
| 27. Shoqata e pensionistëve Krushevë | 47. Shoqata e pensionistëve Qendër - Shkup |
| 28. Shoqata e pensionistëve Kumanovë | 48. Shoqata e pensionistëve Çair - Shkup |
| 29. Shoqata e pensionistëve Labunishtë | 49. Shoqata e pensionistëve
Shtip dhe Karbincë |
| 30. Shoqata e pensionistëve Llozovë | 50. Shoqata e pensionistëve
Shuto Orizarë - Shkup |
| 31. Shoqata e pensionistëve
Makedonska Kamenica | 51. Shoqata e pensionistëve Shën Nikollë |
| 32. Shoqata e pensionistëve
Makedonski Brod | 52. Shoqata e pensionistëve solidarë
Ilinden - Shkup |
| 33. Shoqata e pensionistëve Negotinë | 53. Shoqata e pensionistëve Saraj - Shkup |
| 34. Shoqata e pensionistëve Novo Sellë | 54. LSHP të Qytetit të Shkupit |
| 35. Shoqata e pensionistëve OPB Shkup | |
| 36. Shoqata e pensionistëve
Ohër dhe Debërcë | |

Çdo vit, Shoqata e pensionistëve të Maqedonisë dhe shoqatat - anëtare të së njëjtës ndajnë fletë-falenderimi për pjesëmarrjen në garat sportive dhe sfilatat e këngës, muzikës dhe lojëra dhe manifestime të tjera të ndryshme, ndërsa Lidhja dhe shoqatat fitojnë fletëlavdërime nga institucione dhe organizata të ndryshme lidhur me problematikën e pensionistëve.

KËSHILLI ORGANIZATIV I SHËNIMIT TË 70-VJETORIT TË ORGANIZIMIT TË PENSIONISTËVE NË MAQEDONI

- | | |
|---|-----------------------------------|
| 1. Dragi Argirovski,
Kryetar i Këshillit | 20. Mentor Qoku |
| 2. Besnik Pocesta | 21. Risto Frangov |
| 3. Saltir Karovski | 22. Stanko Sipkovski |
| 4. Stanka Trajkova | 23. Tome Ilioski |
| 5. Dushko Shurbanovski | 24. Vele Aleksoski |
| 6. Andon Markovski | 25. Metodija Novkovski |
| 7. Ilija Adamoski | 26. Vasill Zimbakov |
| 8. Gjorge Andonov | 27. Spirko Nikollovski - Kumanovë |
| 9. Gjorgji Serafimov | 28. Gjorgji Trpçeski |
| 10. Dançe Daskallovska | 29. Kirill Gjorgjioski |
| 11. Aleksandar Zahariev | 30. Shaban Azizi |
| 12. Shaban Sabriu | 31. Pavle Spasov |
| 13. Dushan Risteski | 32. Mitre Stojanovski |
| 14. Jordan Kostadinov | 33. Ziko Zikov |
| 15. Krste Angellovski | 34. Fidanço Stoev |
| 16. Mirko Makreshanski | 35. Mendo Dimovski |
| 17. Dimitrija Bogatinoski | 36. Zdravko Petkovski |
| 18. Ollga Novaçeva | 37. Stojançe Stefanovski |
| 19. Risto Trajkoski | 38. Kalina S. Andonova |
| | 39. Andreja Naumovski |



- 1. Komisioni për përgatitjen e propozimit për shpërblimin e LSHPM me rastin e jubileut:**
Dragi Argirovski, Kalina Andonova, Tome Ilioski, Shaban Azizi, Metodija Novkovski, Ilija Adamoski dhe Risto Trajkoski.
- 2. Komisioni për mirënjohjet për anëtarët e shquar të LSHPM:**
Saltir Karovski, Gjorgji Serafimov, Risto Frangov, Gjorgji Trpçeski, Zdravko Petkovski.
- 3. Komisioni i protokollit dhe koktelit:**
Dimçe Bogatinoski, Mentor Qoku, Kiril Gjorgjioski dhe Mitre Stojanovski.
- 4. Komisioni i përgatitjes së Akademisë së Akademië së solemne dhe bashkëpunimit ndërkombëtar:**
Dragi Argirovski, Besnik Pocesta, Saltir Karovski, Stanka Trajkova, Dançe Daskalovska, Gjorgji Serafimov, Aleksandar Zahariev, Andreja Naumovski dhe Ilija Gligorov.
- 5. Komisioni i informimit:**
Kalina Andonova, Mendo Dimovski, Cvetanka Ilieva, Baki Bakiu dhe Zoran Andreeski.
- 6. Përkrahja profesionale - sekretariati:**
Pero Antreevski, Lile Trajanovska, Najdo Eftovski, Mara Iliq, Tomçe Stojkov dhe Tome Angelovski.

**MONOGRAFIA E JUBILEUT
"70 VJET TË ORGANIZIMIT TË PENSIONISTËVE NË MAQEDONI
1946-2016"**

Korniza: periudha e përfshirë 1946 - 2016

Gjuha: Në gjuhën maqedonase dhe një pjesë e tirazhit në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze

Formati: A-4 kolor

Numri i përafërt i faqeve: 200

Këshilli botues: Besnik Pocesta, Saltir Karovski, Ilija Adamoski, Gjorge Andonov, Dushan Ristoski, Spirko Nikollovski, Vele Aleksoski, Krsto Angelovski dhe Baki Bakiu.

REDAKSIONI:

Autorët: Dragi Argirovski (kryeredaktor), Kalina S. Andonova (redaktor), Stanka Trajkova, Mendo Dimovski dhe Ilija Gligorov.


Përgatitja dhe rregullimi grafik: Tome Angelovski

Lektor dhe korrigjues: Verica Tocinovska

Fotografi: Zoran Andreeski dhe Mendo Dimovski (të gjitha fotografitë janë pronë e LSHPM)

Recensues: Aleksandar Dimkovski, kryeredaktori i "Nova Makedonija"

Këshilli organizativ
Kryetari Dragi Argirovski



X ДЕЛ

KUVENDI

KËSHILLI
EKZEKUTIV

KËSHILLI
MBIKËQYRËS

KOMISIONI
STATUTAR

KOMISIONI I
BASHKËPUNIMIT
NDËRKOMBËTAR

KOMISIONI
I
BASHKËJETESËS

FORUMI
EKONOMIKO-
LIGJOR

KOMISIONI
I
SHËNDETËSISË

KËSHILLI I ORGANIZATËS
SË REGJISTRUAR PËR
FONDIN E SOLIDARITETIT
DHE SHUMËS SË
ANËTARËSIMIT

KOMISIONI I
JETËS KULTURORE-
ARGËTUESE

KOMISIONI I
MENAXHIMIT
TË PROJEKTEVE

KOMISIONI I
SPORTIT DHE
REKREACIONIT

KOMISIONI I INFORMIMIT
DHE VEPRIMTARISË
BOTUESE

STRUKTURA ORGANIZATIVE E LSHPM

STRUKTURA ORGANIZATIVE E LSHPM

KËSHILLI EKZEKUTIV I LSHPM NË VITIN 2006



KËSHILLI EKZEKUTIV I LSHPM NË VITIN 2009



KËSHILLI EKZEKUTIV I LSHPM NË VITIN 2011



ORGANET DHE TRUPAT E LSHPM NË VITIN 2015



DRAGI ARGIROVSKI
Kryetari
i LSHPM



BESNIK POCESTA
Kryetari i
Kuvendit të LSHPM



SALLTIR KAROVSKI
Nënkryetari i Këshillit
ekzekutiv të LSHPM



STANKA TRAJKOVA
Sekretare e Këshillit
ekzekutiv të LSHPM

ANËTARËT E KUVENDIT TË LSHPM



Dragi Argirovski
Dimitrija Bogatinoski
Stojançe Stefanovski
Dimitar Bogdanovski
Stanko Sipkovski
Pece Geshtarov
Krum Stamenkov
Todor Vasilev
Svetolik Nikollov
Sllavko Stojanovski
Vesna Popova
Gruica Manasijev
Dimitar Mollosov

Petar Zaharçev
Vele Aleksoski
Olga Novaçeva
Lupço Dimovski
Arif Bekir
Jordan Kostadinov
Gjorgji Serafimov
Aleksandar Zahariev
Ramiz Qazimovski
Risto Angjushev
Jovan Ginovski
Krstel Angellovski
Salltir Karovski

Dimitrije Dimovski
Risto Frangov
Mentor Qoku
Gjorgje Andonov
Sllavko Simonov
Baki Bakiu
Mendo Dimovski
Zdravko Petkovski
Cane Antovski
Ilija Adamoski
Kirill Gjorgjioski
Naum Çoçorovski
Adem Osmanfari
Irfan Ushtelenca
Ivan Korunovski
Llazar Angellov
Shaban Sabriu
Sofija Simoska
Mirko Makreshanski
Hulusi Salii
Branko Maksimovski
Ilija Kovaçev

Risto Trajkovski
Ristana Mojsoska
Refat Jaoski
Dushan Ristovski
Dançe Daskallovska
Mitko Spasov
Marija Manevska
Todor Sllamkov
Borivoj Bojaxhiev
Vasill Zimbakov
Jovan Kirkoviq
Mustafa Qamuroski
Bllagoj Ajdarski
Jovan Noçevski
Jovan Çiçakovski
Jovan Popov
Stanka Trajkova
Besnik Pocesta
Ziko Zikov
Mare Iliq
Kalina Andonova

ANËTARË TË KËSHILLIT EKZEKUTIV PËR PERIUDHËN E VITEVE 2015-2019



Dragi Argirovski - Kryetar
Salltir Karovski - Nënkryetar
Stanka Trajkova - Sekretare
Dushan Ristoski
Ollga Novaçeva
Gjorgje Andonov
Risto Frangov
Dançe Daskallovska
Risto Trajkoski
Shaban Sabriu
Dr. Krste Angellovski

Dimitrija Bogatinoski
Stanko Sipkoski
Mr. Ilija Adamoski
Gjorgji Serafimov
Dr. Mirko Makreshanski
Jordan Kostadinov
Mentor Qoku
Aleksandar Zahariev
Jovan Kirkoviq
Kalina S. Andonova

KËSHILLI MBIKËQYRËS

Mitre Stojanovski - Kryetar
Nijazi Xhelili
Snezhana Andova
Mirko Danaillov
Bllagoj Arsov

KOMISIONI I BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR

Dragi Argirovski - Kryetar
Besnik Pocesta
Saltir Karovski
Stanka Trajkova
Dançe Daskallovski
Dr. Andreja Naumovski
Dr. Ilija Gligorov
Gjorgji Serafimov
Aleksandar Zahariev

FORUMI EKONOMIKO-LIGJOR

Dr. Fidanço Stoev - Kryetar
Mr. Ilija Adamoski
Mentor Qoku
Stevan Bojaxhiev
Svetolik Nikollov
Risto Prentovski
Mr. Riste Netkov
Stefan Vlladimirov
Manojllo Dameski

KËSHILLI I ORGANIZATËS SË REGJISTRUAR PËR FONDIN E SOLIDARITETIT DHE PEGESËN E ANËTARËSIMIT

Saltir Karovski - Kryetar
Kiril Gjorgjieski
Gjorgje Andonov
Jovan Ginovski
Gido Bojçevski
Krsto Canev
Lubomir Janev

KOMISIONI STATUTAR I KUVENDIT TË LSHPM

Ziko Zikov - Kryetar
Nikolla Markovski
Pece Gashtarov
Bekir Nexhipi
Vesna Popovska

KOMISIONI I BASHKËPINIMIT NDËRKOMBËTAR DHE BASHKËJETESËS

Shaban Azizi - Kryetar
Liljana Istoçka
Hulusi Saliu
Adem Osmanfari
Bllagoja Arsiq
Petar Zaharçev
Ramiz Qazimovski
Liljana Atanasovska
Arif Bekir

KOMISIONI I JETËS KULTURORE-ARGËTUESE

Mendo Dimovski - Kryetar
Lenka Zdravkovska
Cvetanka Angellovska
Vangelica Markovska
Sllavica Lambasha
Nurie Kadriu
Vangja Peneva
Boris Grkovski
Leonid Mançev

KOMISIONI I MENAXHIMIT TË PROJEKTEVE

Dr. Andreja Naumovski - Kryetar
Mr. Vasill Vangellovski
Dr. Ilija Gligorov
Kalina Slivovska - Andonova
Georgi Haxhi Vaskov
Cvetko Kolçakoski
Emilija Stojanoska

KOMISIONI I SPORTIT DHE REKREACIONIT

Zdravko Petkovski - Kryetar
Lubica Kuzmanovska
Risto Trajkoski
Ivan Cvetanovski
Gale Bobarovski
Liljana Mladenovska
Bllagoja Klekaçkoski
Harallampi Ampov
Dimçe Mitrev

KOMISIONI I SHËNDETËSISË DHE POLITIKËS SOCIALE

Dr. Stojançe Stefanovski - Kryetar
Dr. Dimitar Dimitrievski
Dr. Ilija Gligorov
Dr. Mirko Anakiev
Dr. Dimitar Spasevski
Jordan Arsovski
Cveta Stamenova
Marija Gjorgjieva
Ibrahim Osmani

KOMISIONI I INFORMIMIT DHE VEPRIMTARISË BOTUESE

Kalina Slivovska - Andonova - Kryetare
Cvetanka Ilieva
Gojko Eftovski
Izeir Mustafai
Dimitar Dimovski
Fruska Kostadinovska
Bllagoja Spirkoski
Baki Bakiu
Arsen Ilievski

KËSHILLI BOTUES I "PENSIONISTI PLUS"

Dragi Argirovski - Kryetar
Besnik Pocesta
Salltir Karovski
Stanka Trajkova
Gido Bojçevski
Lena Semenikova
Pavle Spasov
Dr. Vele Aleksoski
Gruica Manasijev

KËSHILLI REDAKTUES I "PENSIONISTI PLUS"

Kalina Slivovska - Andonova - Kryeredaktore
Mendo Dimovski - Zëvendëskryeredaktor
Cvetanka Ilieva
Spirko Nikollovski
Baki Bakiu
Dimitar Çavdarov
Vadije Zendeli

SHOQATAT E PENSIONISTËVE NË LSHPM

SHP MANASTIR

Shoqata e pensionistëve Manastir është një prej shoqatave më të vjetra në Republikën e Maqedonisë, e formuar në vitin e largët 1946. Si ditë të themelimit shoqata e shënon 15 tetorin. Shoqata e pensionistëve e komunës Manastir është një organizatë vullnetare joqeveritare, e organizuar në 30 bashkësi urbanë, kryesisht degë në disa zona urbane dhe më shumë në ato rurale.

Shoqata në radhët e saj numëron edhe pensionistët nga komunat Novaci dhe Mogila. SHP Manastir me numrin e madh të anëtarëve të saj, mbi 17.500 anëtarë, përfaqëson shoqatën më të madhe në Lidhjen e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë. Të drejtat dhe kompetencat e anëtarëve realizohen mbi bazën e normave ligjore dhe Statutit të Shoqatës së pensionistëve Manastir. Për t'u cekur është fakti se shoqata ndan një sasi të konsiderueshme mjeteve financiare për të ndihmuar anëtarët e saj, por ndihmon po ashtu edhe një numër të madh aksionesh humanitare dhe institucionesh.



Krahas aktiviteteve të rregullta në fazën e përpilimit në shoqatë është edhe studimi për angazhimin vullnetar të pensionistëve. Shoqata është tepër aktive edhe në bashkëpunimin me shoqata që janë jashtë vendit. Bashkëpunimi realizohet me shoqatat e

pensionistëve nga Vranja dhe Pozharevac, Republika e Serbisë.

SHP Manastir ka një bashkëpunim të shkëlqyer me LSHPM ku merr pjesë aktive dhe jep kontribut në punën e organizatës më të madhe joqeveritare multi-etnike, ashtu si edhe me organizata të tjera që merren me problematikën që lidhet me pjesën e pensionistëve.



Merr pjesë rregullisht në të gjitha paradat rajonale dhe republikane të këngës, muzikës dhe valleve, si prezantues i thesarit kulturor maqedonas. Në vitin 2016 e prezantoi me sukses Lidhjen e Shoqatave të Pensionistëve të Maqedonisë Festivalin e 16-të të moshës së 3 të jetës Lubjanë, së bashku me SHP Demir Hisar.

Edhe para shumë vitesh SHP Manastir, është përfshirë në shënimin e festës së 4 nëntorit, ditës së çlirimit të qytetit të Manastirit, duke u përfshirë në një sërë aktiviteteve me atë rast, të cilat i organizonte komuna. Në këto festa gjithmonë interpreton grupi "Duka Sirma". Në vitin 2016 përpara një publiku të shumtë në numër grupi i këngëtarëve "Sirma Vojvoda" performoi një kolazh këngësh popullore. Krahas këtyre kjo shoqatë me aktivitetin e saj si organizatë joqeveritare ka marrë disa mirënjohje, si edhe mirënjohjen më të lartë, "4 Nëntori" çmimi ky i qytetit Manastir.

Kryetar i Këshillit ekzekutiv të shoqatës është Tome Ilioski, kryetar i Kuvendit është Stevan Bojaxhiev, nënkryetar i Këshillit ekzekutiv është Cvetanka Angelkovska, ndërsa sekretar është Aneta Petkovska.

SHP VELES

Shoqata e pensionistëve Veles është formuar në vitin 1957. Atëherë Shoqata numëronte rreth 650, ndërsa sot mbi 8.800 anëtarë me mbi 600 bashkëshorte që nuk janë pensionistë, por janë anëtarë të Shoqatës. Shoqata është e organizuar me 14 bashkësi vendore dhe urbane. Me mjetet e veta financiare shoqata ka ndërtuar Shtëpinë e pensionistëve që ka në dispozicion 24 apartamente banimi për pensionistët me qira, kundrejt një shume jashtëzakonisht simbolike, kryesisht që i dedikohet pensionistëve që kanë pension të vogël. Për nevojat e pensionistëve dhe rinisë SHP Veles ka në dispozicion edhe dy banesa të tjera në lagjen Otovica dhe në fshatin Bogomillë. Shtëpia e pushimit në Bogomillë ka



në dispozicion 30 krevate për bujtje, sala sportive, kuzhinë dhe në të mund të qëndrojnë dhe të pushojnë të gjithë pensionistët por edhe qytetarët e tjerë. Shoqata në punën e saj i kushton një kujdes të veçantë masivizimit dhe zhvillimit të aktiviteteve sportive dhe kulturore-artistike. Në sport pensionistët e SHP Veles shpesh fitojnë vendet e para në Lojërat sportive republikane, si ato në vitin 2001, 2005 dhe 2007. Anëtarët e Shoqatës janë vizitorë të rregullt të shfaqjeve teatrale, të promovi-

meve të librave dhe ekspozitave të artit figurativ, si edhe nëpër ekskursionet që organizohen brenda dhe jashtë vendit. SHP Veles, së bashku me komunat Veles, Gradsko dhe Çashka kanë nënshkruar memorandum disa vjeçar - Strategjia e kujdesit për të moshuarit dhe invalidët.

Në festën e madhe fetare për Shën Mërinë, në oborrin e kishës në vendbanimin Çashka në Veles,



gjithmonë është shumë i vogël për të zënë mbi dy mijë pensionistë dhe të ftuar të tjerë që vijnë nga më shumë zona të Maqedonisë, me vetiniciativë, por edhe të organizuar përmes shoqatave të tyre të pensionistëve.

Kjo festë do të shënohet tradicionalisht si festë e Komunës Çashka.

Punon aktivisht edhe Aktivi i vullnetarëve pensionistë dhe të tjerë, të cilët janë të përfshirë në aktivitetet e Kryqit të Kuq dhe të organizatave të tjera humanitare. Shoqata çdo vit participon për pushimin dhe rekreacionin e pensionistëve, për kurimin në Ilixa, si edhe për të mbuluar shpenzimet e udhëtimit për ekskursione një apo dy ditore. SHP Veles ka formuar Fondin e solidaritetit që ka karakter

humanitar dhe përmes tij paguhen mjetet financiare për varrimet e bashkëshortëve të anëtarëve pensionistë. Shoqata bashkëpunon edhe me FSPIM, FSSHM, Ministria e punës dhe politikës sociale, Kryqi i kuq dhe të tjerë.

Kryetar i shoqatës së KE është Dr.Vele Aleksoski, kryetar i kuvendit Olga Gjorgjievska, ndërsa sekretar është Nada Aleksoska.

SHP KUMANOVË

Shoqata na pensionistë "Kumanovë" - Kumanovë konsiderohet si një prej anëtareve më të vjetra të Lidhjes së shoqatave të pensionistë të Maqedonisë. Sipas kujtimeve të anëtarëve më të vjetër, Shoqata fillimet e saj i shënon që nga shtatori i vitit 1946, kur një grup pensionistësh u mbledhën në ambientet e Këshillit të sindikatave në Kumanovë dhe formuan një shoqëri pensionistësh. Krahas





zgjedhjes së drejtuesve, janë zgjedhur edhe delegatët të cilët do t'i përfaqësonin në Kuvendin themelues të pensionistëve të Maqedonisë. Për ekzistencën dhe funksionimin e Shoqatës është gjetur edhe një tekst i publikuar në gazetën "Nova Makedonija" në të cilin shkruhet se më 2 gusht të vitit 1950 ka zhvilluar punimet Kuvendi i shoqatës së pensionistëve në Kumanovë. Kjo e dhënë tregon se shoqëria ka vepruar edhe përpara kësaj. Në vitin 1952 Kuvendi i atëhershëm i komunës Kumanovë miratoi vendimin me të cilin e

autorizon shoqatën e pensionistëve që të administrojë pishinën e notimit në parkun e poshtëm dhe paratë e mbledhura nga pagesat e biletave t'i përdorë për financimin e aktiviteteve të veta. Me ndarjen e degës në vitin 1966, nga Shoqata e atëhershme rajonale e pensionistëve të Kumanovës, Kratovës dhe Kriva Pallankës, formohet një Shoqatë e veçantë e pensionistëve të moshuar në Kumanovë, ku bënin pjesë edhe pensionistë nga Likova dhe Staro Nagoriçane. Me kalimin e viteve normalisht që edhe numri i pensionistëve në SHP Kumanovë u rrit dhe sot ka arritur në mbi 13.850 të siguruar të moshuar, ushtarakë, familjarë, policë dhe bashkëshortë. Ata janë të organizuar në 34 degë në komunat Kumanovë, Likovë dhe Staro Nagoriçane. Në Shoqata ka edhe maqedonas, shqiptarë, turq, serbë, romë dhe vllah.

Shoqata angazhohet në formë permanente për të mbrojtur dhe avancuar të drejtat dhe sigurimin invalidor dhe pensional, përmirësimin e standardit të jetës, e të tjera. SHP Kumanovë njihet edhe me SHKA "Gjoko Simonovski", që në vit organizon 30-35 shfaqje publike në vend, por edhe në vendet e Ballkanit. Një atraksion i veçantë është edhe punëtoria e dramës, aktorët e të cilës kanë vënë në skenë mbi 60 shfaqje teatrale. Po ashtu aktive janë edhe koret e këngëtarëve, seksioni folklorik me orkestrën me instrumente popullore.

Më shumë se qindra pensionistë janë fitues të medaljeve të floririt, argjendit dhe bronzit. Në të gjitha garat e deritanishme sportistët renditen mes atyre më të suksesshëm në vend. Historia e arritjeve bëhet më e plotë edhe me arritjet në sferat e veprimtarisë informuese dhe botuese. Prej më shumë se 16 vitesh



Shoqata boton revistën "Informatori i pensionistit" në gjuhët maqedonisht dhe shqip. Janë botuar edhe 3 monografi jubilarë, dy prej të cilave në sferën e sportit dhe një në krijimtarinë kulturore-artistike të pensionistëve. Për aktivitetet e saj të shumta, Shoqata ka fituar një numër të madh mirënjohesh, mes të cilave edhe Çmimi i Nëntorit i qytetit Kumanovë për Shoqatën dhe veçanërisht për SHKA "Gjoko Simonovski". SHP Kumanovë është shoqata e parë që ka marrë pjesë në Festivalin ndërkombëtar të moshës së tretë të jetës në Lubjana R. Sllovenisë dhe e prezantoi me sukses LSHPM thesarin kulturor të Maqedonisë.

SHP Kumanovë 14 vjet me radhë organizon takimin ndëretnik dhe ndërkombëtar në Pelincen legjendare në të cilin marrin pjesë shumë shoqata anëtare të LSHPM, të ftuar si edhe pensionistë nga Serbia fqinje.

Kryetar i shoqatës dhe i KE është Spirko Nikolovski, nënkryetar është Lubica Kuzmanovska, dhe sekretar.

SHP TETOVË

Pas ekzistimit prej shtatë dekadash, SHP Tetovë gjithmonë ka lënë përshtypjen e një prej shoqatave më të mira dhe më të suksesshme. Edhe një konstatim: kjo shoqatë funksionon në zonën e gjashtë të komunave në Pollogun e poshtëm (Tetovë, Bogovinjë, Bërvenica, Zhelinë, Jegunovcë dhe Tearcë), në të cilën marrin pjesë mbi 12.000 pensionistë, gjë që e rendit edhe në shoqatën më të madhe



në Maqedoni. Përmajtje dominante të aktiviteteve të SHP Tetovë kanë qenë dhe janë forcimi organizativ, organizimi i manifestimeve me pjesëmarrje gjithnjë edhe më të madhe të pensionistëve. Fryt i aktiviteteve janë edhe mirënjohjet e shumta dhe çmimet që Shoqata i ka marrë nga asosacione të ndryshme. Në kuadër të Shoqatës funksionojnë 21 degë dhe 5 klube të pensionistëve, dy prej të cilëve në Tetovë, si edhe nga një në Tearcë, Bogovinjë dhe në Saraqinë.

Në vitin 2012 Shoqata botoi një monografi për 65 vjetorin e themelimit dhe të punës. Monografia u botua si një e tërë në dy gjuhë, maqedonasit dhe shqip. SHP Tetovë është iniciator për organizimin dhe zhvillimin e garës sportive republikane. Deri tani ka marrë pjesë në të gjitha garat republikane dhe rajonale në nivel rajonal gjithmonë me plasman në vendin e parë, ndërsa ato që i organizon LSHPM, tetë herë me radhë kanë qenë më të mirët. Në vitin 2014 SHP Tetovë ishte mikpritës i garave republikane, që u mbajtën në rrethin e kombinatit "Teteks".

SHP Tetovë shfaqet edhe në rolin e organizatorit të paradave folklorike të këngës, muzikës dhe valleve, që në zhvillimin e paradave të para rajonale përpara 14 viteve këngëtarët dhe valltarët tetovarë arritën të bëni shfaqje të suksesshme, po ashtu edhe në paradat e gjashta republikane. SHP Tetovë, në vitin 2013 e përfaqësoi organizatën e pensionistëve të Maqedonisë në Festivalin e Lubjanës (Slloveni), që u mbajt me moton "Të gjithë i takojmë një gjeneratë", referat mbajti kryetar i atëhershëm i Kuvendit Gojko Eftoski, në fjalimin me temë: "Realizimi i detyrave programore të pensionistëve në mjedisin multietnik". Një herë në vit të paktën 700

pensionistë marrin pjesë në ekskursione të ndryshme në vend dhe jashtë tij si në: Serbi, Shqipëri, Bullgari, Turqi, Kosovë dhe Greqi. Është e gjatë lista e aktiviteteve që i realizojnë pensionistët tetovarë. Gjithsesi veçojmë takimin multietnik që është miratuar edhe nga LSHPM si një manifestim republikan në të cilin vallja dhe kënga buçet në të gjitha gjuhët në vend.

Në këtë mandat, kryetar i Shoqatës dhe njëherazi edhe i KE është Shaban Azizi, i Kuvendit është Stojan Sokoloski, ndërsa sekretar është Svetozar Dimovski.

SHP SOLIDARITETI - AERODROM

Shoqata e pensionistëve "Solidariteti - Aerodrom" - Shkup, është një shoqatë relativisht e re. Është formuar pas ndarjes nga SHP "Kisella Vodë" - Shkup, pas mbylljes së bilancit të ndarjes në kënaqësinë e të dy shoqatave, më saktë para gjashtë vitesh, ndërsa është regjistruar në Regjistrin qendror më 14 prill të viti 2009, ditë në të cilën shoqata e shënon me solemnitet çdo vit.

Krahas organeve dhe trupave të zakonshëm, Shoqata ka 5 degë, të tilla si: Vardar, Aerodrom, Jane Sandanski, Novo Lisiçe dhe Lisiç dhe numëron rreth 11.500 pensionistë. Degët i mbulojnë në aspekt territorial të gjitha bashkësitë urbane dhe vendore të zonës së komunës Aerodrom në Shkup. Në kuadër të Shoqatës punojnë edhe 7 klube pensionistësh në të cilat zhvillohen të gjitha aktivitetet e degëve. Shoqata arin rezultate të mira edhe falë potencialit organizativ dhe intelektual që i posedon udhëheqësia dhe anëtarësia. Mund të thuhet lirisht se shoqata bën pjesë në kategorinë e shoqatave -anëtare më aktive të LSHP të qytetit Shkup dhe më gjerë në vend, si anëtare e LSHPM.

Më 15 tetor të vitit 2014 SHP Solidariteti - Aerodrom u binjakëzua edhe me SHP "Ohri dhe Deberca". Është formuar edhe Trupi koordinativ i shoqatave, që realizon Program vjetor me aktivitete, konform mjeteve financiare të akorduara sipas planeve financiare të të dy shoqatave. Shoqata gjatë gjashtë viteve të kaluara arriti rezultate të shkëlqyera në të gjitha fushat duke arritur që mjetet financiare t'ia kthejë anëtarëve në të gjitha bazat, duke përfshirë këtu edhe punën e klubeve, pushimit dhe rekreacionit, ndarjen e ndihmës financiare, kurimin në llixa, aktivitetet sportive, si edhe paradat folklorike të këngës, muzikës dhe valleve, gjë që i atribuohet punës kolektive të organeve dhe trupave të Shoqatës.

Në shoqatë funksionojnë edhe Seksion i muzikës, seksioni i historisë të cilat sipas programeve të veta i orientojnë aktivitetet e tyre. Aktivë janë edhe Klubi i adhuresve të librit dhe Aktiv i pensionistëve. Klubi i adhuresve të librit është një prej atyre më aktivëve në LSHPM, rregullisht fton poetë e shkrimtarë dhe në ato takime të gjithë shijojnë fjalën e bukur të shkruara. Shoqata bashkëpunon shumë mirë edhe me anëtarët e tjera të Lidhjes, si edhe me vetëqeverisjen lokale dhe kryetarin e komunës.

Kryetar i KE dhe i shoqatës është Dimitrija Bogatinoski, kryetar i Kuvendit është Stamen Filipov, ndërsa sekretar është Milorad Ristoski.



SHP RADOVISH DHE KONÇE

Shoqata e pensionistëve në komunat Radovish dhe Konçe është formuar në vitin 1961. Që nga formimi e deri më sot Shoqata në kontinuitet zhvillohet dhe realizon rezultate evidente. Çdo gjenaratë e ka dhënë kontributin e vet në ndërtimin e organizatës dhe pasurimin e aktiviteteve programore. Në shoqatë sot bëjnë pjesë rreth 4.000 pensionistë, të organizuar në 9 degë, 5 prej të cilave në qytet dhe 4 në vendbanime rurale. Në shoqatë janë të anëtarësuar përdorues të pensioneve të pleqërisë, familjare, invalidësh, ushtarakësh dhe bujqësore, të cilët janë anëtare për shkak të mbrojtjes dhe avancimit të qëllimeve dhe interesave të përbashkëta, realizimi i të drejtave për sigurimin pensional dhe invalidor.



Shoqata bashkëpunon aktivisht me Lidhjen, me të gjitha shoqatat komunale, vetëqeverisjen lokale në komunat Radovish dhe Konçe, Qendra e kulturës "Aco Karamanov", FSPIM, FSSHM, Organizata komunale e Kryqit të kuq dhe të tjerë institucione që kanë pika takimi në realizimin e programit të SHP Radovish dhe Konçe.

Në përbërje të shoqatës funksionojnë 4 klube pensionistësh. Shoqata ka në dispozicion një buxhet modest financiar, por me punën mikpritëse dhe angazhimin më të

madh të organeve dhe trupave arrin që me sukses të realizojë aktivitetet e tyre programore. Karakteristikë bazë e shoqatës është shoqërimi masiv në ambiente të mbyllura dhe të hapura, si edhe transparencës dhe llogaridhënie për punën e saj në përgjithësi.

Shoqata e pensionistëve në komunat Radovish dhe Konçe është person juridik dhe më 18.03.2008 është regjistruar edhe në Regjistrin qendror të RM dhe prej tre herësh ka qenë mikpritëse e Olimpiadës sportive të pensionistëve, ndërsa në vitin 2015 e prezantoi me sukses Lidhjen në Festivalin e tretë të moshës së 3 të jetës Lubjanë, bashkë me shoqata nga Makedonska Kamenica.

SHP Radovish dhe Konçe është organizator dhe mikpritës i takimit më të madh që mbahet në kompleksin kishtar, manastirin Shën Gjorgjija, në fshatin Oraovicë, rrëzë malit Pllaçkovicë, aty ku edhe natyra e ka mbuluar me një petk magjik dhe luksoz. Në takime morën pjesë kryetari i komunës Radovish, Sashko Nikolov, si edhe Nikolajço Nikolov, i cili me paratë e veta e ka ndërtuar nga themeli kishën Shën Gjorgjija, i cili, ashtu si thuhet është be-



fasuar nga vitaliteti i pensionistëve dhe nga mënyra e tyre e organizimit dhe me kënaqësi u shpreh se derisa të ketë mundësi do ta ndihmojë organizatën e pensionistëve.

Për kënaqësinë e të gjithë të pranishmëve, sapo dëgjohen tingujt e gëzuar të muzikës askush nuk mundej që t'i bënte ballë, që të mos kërcejë në vallet e bukura maqedonase dhe të mos këndojë. Në këto takime piknik merrnin pjesë mbi 9000 pensionistë nga e gjithë

Maqedonia. SHP Radovish ishte mikpritës i dalluar i Olimpiadës së 21 të pensionistëve, në të cilën morën pjesë mbi 1.200 pensionistë dhe rreth 500 garues në 11 disiplina.

Kryetari i Shoqatës dhe i KE është Jordan Kostadinov, ndërsa sekretar Petre Petrov.

SHP PRILEP

Shoqata e pensionistëve Prilep numëron rreth 13.500 pensionistë të moshuar dhe familjarë dhe është një prej shoqatave më të mëdha në Maqedoni.

Tek shoqata janë të anëtarësuar pensionistë nga tre komuna: Komuna Prilep, Komuna Krivogash-tani dhe Komuna Dollneni dhe 19 degë. Para dhjetë vitesh shoqata kishte vetëm 2 klube, ndërsa tani numëron 10 klube. Në të tëra aktivitetet pensionisti është në fokus të aktivitetit dhe është një prej shoqatave më aktive të Lidhjes. Çdo vit shoqata akordon mbi një milionë denarë për anëtarë me pensione të vogla.

Tek shoqata kanë funksion aktiv edhe dy shoqata kulturore-artistike, ato janë: "Penka Kotevska" dhe "Pensionisti", me të cilat shoqata çdo vit merr pjesë në paradat rajonale dhe republikave të këngës, muzikës dhe valleve, por edhe në manifestime të tjera me raste të ndryshme, në qytet dhe më gjerë. Në vitin 2014 e përfaqësonte me sukses LSHPM në festivalin e moshës së tretë të jetës në Lubjanë, Republika e Sllovenisë.

Bashkëpunon shumë mirë edhe me Vetëqeverisjen lokale dhe kryetarin e komunës Marjan Ristoski. Nga komunat Prilep 7 pensionistë dhe SHP Prilep kanë fituar çmimin me rastin e 40 vjetorit të çlirimit të Prilepit. Në qytet për vitin e katërt me radhë nënshkruhet marrëveshja me kryetarin e komunës për projektin "Super Mario", për t'i ndihmuar të moshuarve nëpër shtëpi, në të cilat janë angazhuar 20 vullnetarë.

SHP Prilep është shembull i aktiviteteve humanitare, dhe çdo vit, në nder të Ditës së kryengritjes maqedonase, "11 Tetor" zhvillohet takimi republikan pensionist.

SHP Prilep është forcë edhe në planin sportiv. Merr pjesë rregullisht në të gjitha garat sportive dhe arrin rezultate të shkëlqyera në të gjitha nivelet.

Veçanërisht spikat në akordimin e të hollave financiare për qëllime humanitare dhe për anëtarësinë e saj. Shoqata ka edhe nënfaqen e saj në faqen e LSHPM, korrespondenti Kiril Risteski është një prej korrespondentëve më të mirë në LSHPM.

Kryetar është Kiril Gjorgjioski, ndërsa sekretar Stevanka Nikoloska.



SHP GAZI BABA

Shoqata e pensionistëve Gazi Baba është një prej shoqatave me më shumë anëtarë në Lidhjen e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, ndërsa është formuar në vitin 1972. Dyzet e pesë vite punë dëshmojnë se në të gjitha vitet e mëparshme është akumuluar shumë entuziazëm, pjekuri dhe qëndrueshmëri. Gjatë ekzistencës së saj, shoqata ka kaluar edhe nëpër një periudhë shumë të vështirë, por gjithsesi ka mbijetuar, falë dëshirës, miqësisë dhe ambicieve. Nga ditë në ditë rritet numri i aktiviteteve të shoqatës, që ato të kulmonin në dhjetë vjeçarin e fundit kur edhe janë arritur rezultate evidente. Shoqata mbulon në aspekt territorial tre komuna, ato të: Gazi Babë, Petrovec dhe Aračinë dhe numëron



rreth 12.000 pensionistë nga vendbanime rurale dhe urbane dhe përbehej të ndryshme etnike. Në SHP Gazi Baba funksionojnë 14 nëndegë dhe po aq klube pensionistësh, në të cilat zhvillohen të gjitha aktivitetet në planin kulturor-argëtues dhe sportiv-rekreativ, ku shoqata ka arritur rezultate të dukshme në raport me masivitetin dhe kualitetin që ka sjellë në nivel rajonal, republikan. Suksese të dukshme arrin gjithmonë edhe me korin, që është pjesë e SHKA "Pensionisti". SHP Gazi Baba ishte mikpritës i paradës së 14-të të

këngës, muzikës dhe valleve në vitin 2016. Në fushën e sportit, kanë arritur rezultate kulmore dhe për disa vite rresht kanë fituar vendet e para në disa disiplina. Në vitin 2013 ishin mikpritës të garave sportive të 18-ta rajonale të pensionistëve, rajonin i parë. Aktivitete mbresëlënëse Shoqata realizon edhe në fushën e kujdesit për pensionistët me pensione të vogla, të cilëve iu akordon ndihmë financiare, ndërsa i çon për kurim pensionistët edhe në pushime klimatike dhe në Ilixa. Gjatë periudhës së vërshimeve në



vitin 2016, ku u prekën edhe disa persona nga anëtarësia Shoqata, iu akordoi ndihmë materiale dhe financiare. Aktiviteti i pensionistëve është nxitësi kryesor edhe i më shumë aksioneve. Shoqata bashkëpunon me pensionistë nga R. Bullgaria dhe R. Serbia dhe para disa kohësh ishte edhe për të prezantuar ushqimin edhe në rajone të tjera në Pernik, R. e Bullgarisë. Bashkëpunimi me LSHPM është në nivel të lartë dhe gjithmonë vepron sipas vendimeve të Lidhjes. Nuk mbetet pas edhe bashkëpunimi me vetë-

qeverisjen lokale, ndërsa kryetari i komunës Toni Trajkovski ka vendosur një mirëkuptim të plotë me këtë pjesë të popullsisë.

Në restorantin "Hanibal" në Gazi Babë tradicionalisht mbahen takime pensionistësh në nivel rajonale dhe republikane.

Kryetar i KE dhe i shoqatës është Gjorge Andonov, kryetar i Kuvendit është Ana Gjorgjieva, ndërsa sekretar është Mitko Karçev.

SHP OHRI DHE DEBËRCË

Shoqata e pensionistëve Ohri dhe Debërca Kuvendin e parë vjetor e ka mbajtur më 20 qershor të vitit 1950, ndërsa vendimin për formimin e ka miratuar Lidhja e sindikatave. Shoqata ka pasur si detyrë që ta ndihmojë anëtarësinë lidhur me realizmin e të drejtave të saj, që rrjedhin nga ZSPI, pjesëmarrje kolektive në aktivitetet shoqërore të komunitetit (kulturore, sociale, shëndetësore e të tjera), të anëtarësisë në rast vdekje, ndihmë për anëtarët me pensione të vogla dhe të tjera. Struktura drejtuese e Shoqatës ka në përbërje kryetarin, sekretarin dhe arkëtarin. Kryetari i parë i SHP Ohër është Kipro Ilioski, i cili ka qenë një personave të rrallë të arsimuar në atë kohë. Sot, shoqata numëron rreth 9.800 pensionistë, që janë të organizuar në 30 Degë vendore. Çdo degë vendore ka Këshillin e vet vendor me në krye një kryetar.

Në këtë botim të Monografisë për 70 vjetorin e themelimit të LSHPM dhe 66 vjetorin e SHP Ohri dhe Debërca nuk guxon që të neglizhohet edhe një prej sukseseve më të mëdha të shoqatës ohridase në të gjitha vitet e saj të ekzistencës. Më 3 shator të vitit 2016 në Radovish, në garat sportive e 21-ta republikane të pensionistëve. SHP Ohri dhe Debërca merite pjesë me 63 pensionistë, 50 prej të cilëve sportistë dhe 13 përgjegjës të ekipeve. Sportistët ohridas të shoqatës ishin më të mirët për të gjashtin vit me radhë. Me një rekord të tillë nuk mund që të lavdërohet asnjë shoqatë tjetër në LSHPM.

Po ashtu, Shoqata është pjesëmarrës i rregullt edhe në paradat e këngës, muzikës dhe valleve, si edhe në një sërë manifestimesh të tjera me karakter humanitar dhe nder gjeneratash.

Me rastin e shënimit të 65 vjetorit të ekzistimit SHP Ohri dhe Debërca, në ceremoninë festive në qershor të vitit 2015 promovoi edhe botimin e Monografisë "Pensionistët ohridas nëpër vite, kulturë, sport dhe rekreacion" i autorit Gjorgji Trpçeski.

Festa e jubileut të 65-vjetorit, në sallën e stolisur solemnisht të komunës Ohër filloi me himnin e Maqedonisë, që u ekzekutua nga SHKA pranë SHP Ohri dhe Debërca, "Dallga".

SHP Ohri dhe Debërca është vëllazëruar edhe me shoqatën SHP Solidaritëti - Aerodrom, Shkup. Bashkëpunimi mes këtyre dy margaritarëve, Ohri i njohur për trashëgiminë e vet kulturore dhe komuna Aerodrom si një prej komunave urbane të rregulluara më mirë është shumë i mirë dhe ecën sipas Programit që hartohet çdo vit.

Kryetar i shoqatës së KE është Gjorgji Trpçeski, nënkryetar i KE është Dobrinka Taleva, kryetar i Kuvendit është Dimitar Spaseski, nënkryetar i Kuvendit është Krste Binbiloski, ndërsa sekretar është Stefan Vladimirov.



SHP GJORÇE PETROV

Shoqata e pensionistëve të Komunës Gjorçe Petrov është formuar në vitin 2001, por aktiviteti i saj i vërtetë ka filluar në vitin 2006. Në fillim kjo ka qenë një shoqatë e vogël, që numëronte rreth



5.000 pensionistë. Me kalimin e kohës numri i pensionistëve është rritur dhe sot ka arritur në mbi 6.500 anëtarë. Me rritjen e numrit të pensionistëve pashmangshmërisht vjen edhe nevoja e formimit të degëve, që sot janë gjithsej 7 në numër. Në çdo nëndegë ka Klub të pensionistëve, por ekziston edhe Klubi i qëndrimit ditor, në të cilin pensionistëve u bëhen kontrole tensioni, i gliceminës e të tjera.

Sa për aktivitetet dhe punën e shoqatës në fillimet e veta tentativat e para ishin në sferën e sportit dhe më pas u radhitën edhe në të tjera aktivitete, të tilla si: pjesëmarrje në parada rajonale dhe republikane dhe gara sportive, organizimi i ekskursioneve, realizmi i aksioneve humanitare, rritja e standardit të pensionistëve, bashkëpunim me shoqata të tjera dhe institucione, bashkëpunim me vetëqeverisjen lokale dhe të tjera. Sipas programit shoqata çdo vit jep ndihmë humanitare për më shumë se

200 anëtarë që kanë pensione të vogla dhe persona invalidë dhe të sëmurë, si edhe viziton Qendrën Gerijatrike "13 Nëntori" dhe shtëpinë e të mosshuarve "Nënë Tereza", duke denarë ndihma humanitare dhe duke mbajtur programe kulturor-artistik. Shoqata është shumë aktive në plan sportiv dhe kulturor. Disa herë ka qenë mikpritës e paradeve rajonale të këngës, muzikës dhe valleve dhe të garave sportive, ndërsa në vitin 2015 si bashkëorganizator i suksesshëm dhe mikpritës i Olimpiadës jubilarë të 20-të sportive të pensionistëve në Shkup.


Shoqata bashkëpunon shumë mirë edhe me vetëqeverisjen lokale, ndërsa kryetari i komunës

Sokol Mitrovski e mbështet shoqatën në të gjitha aktivitetet.

Si një prej shoqatave më aktive shkupjane ajo u zgjodh për të realizuar Pilot projektin "Karta sociale e pensionistit", që po ashtu e kreu me sukses.

Pensionistët e kësaj shoqate çdo vit marrin pjesë në një numër të madh takime pensionistësh dhe ekskursione. SHP Gjorçe Petrov është një prej organizatorëve të takimit të ri ndëretnik të pensionistëve në Saraj.

Kryetar i Shoqatës dhe i KE është Metodija Novkovski. Kryetar i Kuvendit është Snezhana Mirçeska, ndërsa sekretar është Lubinko Ristov. Shoqata Gjorçe Petrov është një



prej shoqatave të rralla në të cilat në një post drejtues qëndron një femër.

SHP KOÇAN

Shoqata e pensionistëve nga Koçan është formuar më 16 nëntor 1972, me vendimin me numër 03-857/1-72 dhe po ashtu është regjistruar nga ana e Sekretariatit të punëve të brendshme në Koçan. Gjatë 45 viteve të kaluara organizata pensioniste ka realizuar rezultate të rëndësishme në të gjitha fushat, duke filluar nga standardi i pensionistëve, mbrojtja shëndetësore dhe sociale, pushimet dhe rekreacioni, jeta kulturore-zbavitëse dhe sporti. Shoqata vepron në zonat e komunave: Koçan, Zërnovci dhe Çeshinovo Obleshevë me rreth 6.500 anëtarë, me gjithsej 15 degë, prej të cilave 8 në qytet dhe 3 në vendbanimet e komunës Koçan, një në komunën Zërnovci dhe tre degë në komunën Çeshinovo Obleshevo.

Në kohët e fundit në bashkëpunim me vetëqeverisjen lokale janë hapur disa klube të reja për pensionistë dhe janë siguruar ambiente pune bashkëkohore në SHP Koçan.

Sot në përbërje të Shoqatës së pensionistëve Koçan punojnë me sukses komisionet e shëndetit dhe standardit, për rekreacione dhe ekskursione, për jetën kulturore-argëtuese, për sport, si edhe komisioni për aktivitetet pensioniste. Po ashtu punojnë me sukses edhe Komisioni statusor dhe Këshilli mbikëqyrës.

SHP Koçan në suaza të aktivitetit të saj me sukses bashkëpunon me SHP e qyteteve fqinje dhe të rajonit, ku është lider, por gjithsesi bashkëpunim më të suksesshëm realizon me SHP e Kumanovës, SHP Kavadarit, SHP Qendër - Shkup dhe SHP Prilep, me të cilat shkëmbejnë turne me ekipe sportive dhe ngjarjesh kulturore-artistike. I rëndësishëm për SHP Koçan është bashkëpunimi që ka me Këshillin e komunës Koçan dhe kryetarin e komunës Ratko Dimitrovski. Ky bashkëpunim rezultonte me sigurimin e lokacionit për ndërtimin e Shtëpisë për të moshuar që do të ketë karakter rajonal dhe që do ta përdorin pensionistët nga komunat e Maqedonisë lindore.

SHP Koçan me buxhetin e vet dhe me ndihmën e Komunës ka përpiluar një projekt për Shtëpinë e ardhshme për të moshuar, që u prezantua në publik. Komunitet bashku me SHP Koçan pret që me ndihmën e partneriteti publik privat gjatë periudhës së ardhshme të ndërtojë këtë shtëpi e cila do t'u shërbejë pensionistëve të rajonit.

SHP Koçan edhe më tej i mbështet aktivitetet e LSHPM në sferën e sportit dhe rekreacionit, me pjesëmarrjen në lojërat e pensionistëve në pjesën e prezantimit të pasurisë folklorike, me pjesëmarrje në paradën rajonale dhe republikane të këngës, muzikës dhe valleve, si edhe në pjesën e aktiviteteve të tjera, për një jetë më interesante dhe më cilësore të pensionistëve. SHKA Koçan si përfaqësues i LSHPM mori pjesë në Festivalin e Lubjanës.

Kryetar i KE dhe i shoqatës është Gjorgji Serafimov, ndërsa sekretar i KE është Gjorgji Manasiev.



SHP KARPOSH

Shoqata e pensionistëve Karposh është formuar më 5 janar të vitit 1978 dhe është një prej shoqatave më të njohura në Republikën e Maqedonisë. Në atë kohë të largët shoqata numëronte 18.445 anëtarë. Me kalimin e viteve shoqata ka pasur momente të bukura, por edhe të vështira. Për shkak të disa ndodhjeve shoqata disa herë është regjistruar dhe reregjistruar (12 herë), duke kërkuar të drejtën nëpër më shumë institucione dhe në shumë nivele. Rezultate ishte pozitiv, pasi drejtësia vjen



gjithmonë dhe këmbëngulja e atyre që e kërkojnë shpërblehet. Në shoqata ekzistojnë 7 degë, që janë: Kozle, Vllae (Zllokuqan, Bardovcë), Nerez, Karposh 1 dhe 2, Karposh 3 dhe 4, Taftalixhe 1 dhe 2.

SHP Karposh merr pjesë aktive në paradat rajonale dhe republikane të këngëve, muzikës dhe valleve, ku veçanërisht e ruan nga harresa me losin qytetar, si shoqatë urbane. Merr pjesë edhe në gara sportive të të gjitha niveleve. Është veçanërisht aktiv Aktiv i pensionistëve që është nxitës



i shumë ekskursioneve dhe aksioneve humanitare. Bashkëpunimi i shoqatës me vetëqeverisjen lokale dhe kryetarin e komunës Stevço Jakimovski është në nivelin e dëshiruar, po ashtu edhe me institucione të tjera që janë të lidhura me pensionistët.

Më 11 janar të vitit 2013 në sallën e tejmbushur të Kinotekës së Maqedonisë u mbajt seanca solemne me rastin e jubileut të 35-të të shoqatës së pensionistëve SHP Karposh Shkup. Në seancë merrnin pjesë përfaqësues të Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, të vetëqeverisjes lokale, kryetari Lidhjes së qytetit të shoqatave të pensionistëve të Shkupit, kryetarë të

më shumë shoqatave me të cilat bashkëpunon shoqata dhe të tjerë të ftuar.

Seanca filloi me ekzekutimin e himnit të Republikës së Maqedonisë, nën interpretimin e korit të pensionistëve të shoqatës. Për historikun dhe për rezultatet dhe sukseset e Shoqatës foli edhe kryetari i Kuvendit të SHP "Karposh" Jovan Ginovski. Më tej të pranishmëve iu drejtua edhe kryetari i komunës Karposh, Stevço Jakimovski, që theksoi se bashkëpunimi mes pensionistëve dhe komunës ka qenë në nivelin më të lartë dhe kështu do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Të ftuarit prezent dhe pensionistët i përshëndeti edhe kryetari i lidhjes së shoqatave të pensionistëve, Dragi Argirovski. Më pas u promovua monografia "TË MOS HARROHET" nga autorët - pensionistë Kalina Slivovska - Andonova dhe Mendo Dimovski. Monografia u promovua nga Lidija Jeremiq, kryetare e Komisionit të jetës kulturore - zbavitëse në Shoqatën e pensionistëve "Karposh", që theksoi se ajo përbën një shenjë të shkruar dhe të pashlyeshme për ekzistencën dhe veprimtarinë e shoqatës, gjurmë për të kaluarën

dhe udhërrëfyes për në të ardhmen. Në fund kryetari i LSHPM, kryetari të komunës si edhe institucionet e tjera dhe individëve që kanë kontribuar për shoqatën që të ekzistojë dhe të ecë përpara iu ndau mirënjohje. Sot shoqata numëron 5.200 pensionistë.

Kryetar i Kuvendit është Jovan Ginovski, kryetar i Këshillit ekzekutiv të SHP Karposh është Trajko Saveski, dhe sekretar është Mirjana Gushevska.



SHP QENDËR

Shoqata e pensionistëve Qendër në Shkup është një ndër shoqatat më të vjetra të Lidhjes së pensionistëve të Maqedonisë dhe shoqata më e vjetër në zonën e qytetit Shkup. Është formuar më 22 janar të vitit 1954. Në Kuvendin themelues është miratuar Rregullorja e punës, ndërsa Statuti i parë i shoqatës është miratuar në vitin 1956, deri në vitin 2010 janë miratuar 7 ndryshime dhe plotësime në Statutin me të cilin ka punuar shoqata. Shoqata për 20 vjet, deri në vitin 1974 ka mbajtur emrin Shoqatë komunale e pensionistëve dhe invalidëve të punës, ku ka pasur tre degë: Idadija, Kisella Vodë dhe Kala.

Më 16 dhjetor të vitit 1977 është miratuar vendimi për mbylljen e veprimtarisë së kësaj shoqate dhe është formuar shoqata e pensionistëve dhe invalidëve të punës së komunës Qendër, në të cilën kanë hyrë bashkësitë vendore: Mile Arsovski, Park, Goce Delçev, Rade Jovčevski - Korçagin, Robert Gajdiq dhe Mito Haxivasilev - Jasmin, ndërsa shoqata numëronte 7.642 anëtarë. Kështu shoqata e formuar ka funksionuar përmes organeve dhe trupave të saj: Konferenca, Kryetari, Këshilli mbikëqyrës, Komisione dhe Seksioni i invalidëve. Shoqata kishte fondet e veta: afa-rist, rezervë, për shpenzime të përbashkëta dhe ndihmë sociale dhe reciproke. Sot shoqata ka rreth 9.800 anëtarë.

Pas regjistrimit zyrtar në vitin 1999 në seancën konstitutive si kryetar u zgjodh Dr. Vllado Stamenkov. Në vitin 2006 si kryetar u zgjodh Dr. Kërste Angelovski që është edhe sot në funksion. Nga viti 2002 kryetar i Këshillit ekzekutiv është Pavle Spasev. Në vitin 2009 me rastin e 55 vjetorit të themelimit shoqata mbajti një seancë solemne dhe në të cilën u ndanë disa mirënjohje individëve të spikatur dhe institucioneve. Sot në shoqatë funksionojnë 9 degë, që janë: Mirçe Acev, Goce Delçev, Dane Krapčev, Robert Gajdiq, Mito Haxivasilev-Jasmin. Nevena Georgieva - Dunja, Mile Arsovski, Rade Jovčevski - Korçagin dhe Punonjësit e pensionuar të arsimit.

Shoqata bashkëpunon me më shumë shoqata dhe institucione, dhe posaçërisht ka një bashkëpunim të mirë me vetëqeverisjen lokale dhe Kryqin e kuq. Në shoqatë funksionon edhe Fondi Solidar. Pensionistët e SHP Qendër marrin pjesë në ekskursionet të ndryshme dhe manifestime dhe sidomos janë aktivë në planin kulturor dhe sportiv. Merr pjesë edhe në paradat e këngës, muzikës, valleve dhe garave sportive. Disa herë radhazi kanë qenë mikpritës i turneut tradicional të shahut, me rastin e 13 nëntorit, Ditës së çlirimit të Shkupit.

Me rastin e 60 vjetorit të themelimit të vet shoqata botoi edhe një Monografi si edhe Infomatorin e Pensionistit. Shoqata për aktivitetet e veta ka fituar shumë mirënjohje dhe falënderime.

Kryetar i shoqatës dhe i KE është Pavle Spasev, i Kuvendit Krsto Angelovski, ndërsa sekretar Trajko Trajanovski.



SHP STRUMICË

ZdrShoqata e pensionistëve Strumicë është formuar në vitin e largët 1953, nga një grup entuziastësh pensionistë, me emrin Shoqatë komunale e pensionistëve Strumicë.

Në vitin 1969 Këshilli i atëhershëm drejtues i shoqatës me iniciativën e Marika Gjorgjievës mori vendim që të ndërtohet Shtëpia e pensionistëve Strumicë dhe po në të njëjtin vit është vendosur edhe gur themeli i shtëpisë. Në tetor të vitit 1971 Shoqata komunale e pensionistëve Strumicë u bë me shtëpi të saponduar në rrugën Leninova nr. 97 Strumicë.



Në dhjetor të vitit 1998 me vendimin e Kuvendit të shoqatës komunale të pensionistëve Strumicë u emërtua në Shoqata e pensionistëve Strumicë. Shoqata e pensionistëve Strumicë tani ka rreth 10.400 anëtarë, të organizuar në 26 degë.



Në territorin e shoqatës së pensionistëve në Strumicë funksionojnë 18 klube pensionistësh. Pensionistët nga kjo shoqatë organizojnë ekskursione nëpër vende atraktive dhe manastire. Shoqata merr pjesë aktive në gara sporti dhe në parada të këngëve, muzikës dhe valleve në të gjitha nivelet, ndërsa në disa prej tyre ka qenë edhe mikpritës i suksesshëm. Bashkëpunon me shoqata të tjera - anëtare të LSHPM, si edhe me institucione që janë të lidhura me popullsinë pensioniste, të tilla si



organizata komunale e Kryqit të kuq dhe Qendra e kujdesit social. Veçanërisht bashkëpunon me SHP Dojran, me të cilën bashkë kanë organizuar piknik - takim pensionist në të cilin marrin pjesë mbi 5.500 pensionistë nga më shumë shoqata të Republikës. Me rastin e festës fetare "Trimeri" për herë të 24 shoqata organizonte takim ku marrin pjesë një numër i madh pensionistësh nga më shumë shoqata

anëtare të LSHPM. Në këto takime kanë performuar rregullisht grupe këngëtarësh të përziera dhe orkestra e shoqatës, të cilët krahas këngëve përpara të pranishmëve prezantuan edhe zakone trimërie tradicionale. Po ashtu, shoqata i kushton një kujdes të veçantë strehimit të anëtarëve të saj për të cilin ka përgatitur një projekt për zgjerimin e shtëpisë së pensionistëve me tridhjetë garsoniera .

Kryetar i shoqatës dhe i KE është Dançe Daskalovska, ndërsa kryetar i Kuvendit është Atanas Kostov.

SHP BUTEL

Shoqata e pensionistëve të Komunë Butel është formuar në vitin 2011. Në fillimet e veta ka qenë një shoqatë e vogël, ndërsa sot numëron rreth 5.600 pensionistë. Me rritjen e numrit të pensionistëve pashmangshmërisht vjen edhe tek nevoja për të formuar degë, të cilat sot kanë arritur në gjithsej 8, Shkup Sever, Butel 2, Zhivko Brajkovski, Radishan, Lubotenski pat, Lubanci dhe Klimeni i Ohrit dhe në 5 prej tyre ka edhe klub pensionistësh, falë bashkëpunimit të shkëlqyer me kryetarin e komunës Butel, Petre Latinovski.

Interesante është e dhëna se kjo shoqatë e pensionistëve në komunën më të re të Shkupit, Butel, tregoi rezultate të rëndësishme me organizimin e ekskursioneve dhe të tjera aktivitete dhe krijoi kushte tejet të volitshme për përmbushjen e aktiviteteve të planifikuara dhe shoqërimin e pensionistëve në vendbanimet dhe degët që në shtrirjen e tyre përkrijnë me komunitetet urbane.

Krahas shumë pensionistëve dhe qytetarëve të zonës, në hapjen solemne të klubeve merrte pjesë edhe kryetari i LSHPM, Dragi Argirovski, kryetari i Komunës Butel, Petre Latinovski, drejtuesit e Shoqatës dhe përfaqësues të më shumë mediumeve. Hapja e klubeve është rezultat bashkëpunimit të vazhdueshëm të Shoqatës së pensionistëve me Komunën Butel, me vetëqeverisjen lokale.

Për bashkëpunimin e suksesshëm Shoqata ka fituar edhe një pllakat nga komuna. Sot SHP Butel ka zënë një vend masiv dhe cilësor si në nivel lokal ashtu edhe në atë republikan në suaza të LSHPM, aty ku edhe është anëtare aktive.

Në vitin 2016, me rastin e jubileut të madh pensionist, 70 vjetorit të organizimit të pensionistëve në Maqedoni dhe shënimit të përvjetorit të shoqatës u botua Monografia, për një periudhë nga viti 2011 deri në vitin 2016. Në Shoqatë është aktiv dhe punon me sukses edhe Aktivi i pensionistëve, anëtarët e së cilit marrin pjesë rregullisht në manifestimin "Turshia e gjyshes" në Probishtip, ku kanë fituar edhe vendin e parë.

Shoqata ishte mikpritës edhe në jubileun e 20-të të Garave sportive republikane të pensionistëve që u mbajtën në kompleksin "NEW STAR" në Shkup.

Lupço Dimovski është kryetar i shoqatë dhe i KE, ndërsa sekretar është Marija Trifunovska.



SHP GOSTIVAR

Shoqata e pensionistëve Gostivar është themeluar dhe funksionon që nga viti 1946, si një shoqatë qytetare e pensionistëve dhe që nga viti 1970 është emërtuar si Shoqatë e pensionistëve dhe invalidëve të punës. Që nga 25.02.1993 është regjistruar në Regjistrin qendror të R. Maqedonisë si Shoqatë e pensionistëve "Gostivar", me seli në rrugën "Major Çede Filiposki" nr. 17 Gostivar. Shoqata e pensionistëve Gostivar punon me Statutin e miratuar më 12.03.2011, si një organizatë joqeveritare dhe



apolitike shoqërore. Më 25.02.2015 është zhvilluar kuvendi zgjedhor për një periudhë mandati prej katër vitesh, deri në muajin mars të vitit 2019, me muajin e 11-të të vitit 2016 numëron 6.581 pensionistë. SHP Gostivar përbëhet nga 23 degë nga tre komuna që janë: Gostivar, Mavrovo - Rostushe dhe Vrapçisht. Në komunën Gostivar ekzistojnë 16 degë, që janë: nëntë në qytet (Lagjja e Sahatit, Lagja maqedonase, Dutlok, lagjja Xamixit, Lagjja e beut, lagja e re, Mara Ugrinova, Pitar-nica dhe Ciglana) dhe shtatë në vendbanimet përreth (Banica e poshtme, Vrutok, Simnicë, Belovishtë, Sërbinovë, Çegran dhe Balildol).



Komuna Mavrovë - Rostushë përbëhet nga katër degë që janë: Hanet e Mavrovës, Zhirovnica, Rostusha dhe Shkarinjë, ndërsa në Komunën Vrap-



çisht ekzistojnë tre degë që janë: Negotinë, Vrapçisht dhe Zubovë. Çdo degë ka Kryetar, Sekretar, arkëtar dhe dy anëtarë. Kuvendi i Shoqatës së pensionistëve Gostivar numëron 33 delegatë që janë: 29 të zgjedhur nga degët dhe 4 nga Këshilli ekzekutiv i Shoqatës. Këshilli ekzekutiv numëron 11 anëtarë që janë: Kryetari dhe 10 anëtarë. Këshilli mbikëqyrës numëron 5 anëtarë, Kryetar dhe katër anëtarë. Po ashtu ka edhe 1 delegat në LSHPM - Shkup. Në SHP Gostivar punojnë 4 komisione dhe Aktiv i pensionistëve që është shumë aktiv, falë angazhimit të kryetares së Aktivit Vadie Zendeli, që është shembull

për shoqërimin dhe bashkëjetesës dhe është një prej organizatorëve kryesorë të takimit tradicional ndërretnik, ku marrin pjesë një numër i madh anëtarësh, thuajse nga të gjitha shoqatat-anëtare të LSHPM.

Kryetar i shoqatës dhe i KE të Kuvendit është Nijazi Xhelili, ndërsa sekretar është Voislav Llazarevski.

SHP ÇAIR

Para më shumë se tre dekadash një grup aktivistësh inicoi idenë për të themeluar një shoqatë pensionistësh që i vunë emrin "Çair dhe Butel". Me formimin e komunave të reja, Butel dhe Shuto Orizare, pensionistët u ndanë sipas principit territorial dhe Shoqata e ndryshoi emërtesën në Shoqatë e pensionistëve "Çair". Sot numëron rreth 7.845 pensionistë dhe në të punojnë pesë nëndegë, prej të cilave vetëm një nëndegë ka klub, ndërsa tek të tjerët është problem sigurimi i ambienteve. Gjatë viteve



të kaluar Shoqata krijoi traditë pune, por njëherazi u ndikua edhe në thellimin e lidhjeve miqësore, shoqërimi dhe bashkëjetesën, pasi që mjedisi është multi-etnik. Rezultatet e arritura viteve të fundit gjithsesi që nënkuptojnë sukses, që veçmë është konfirmuar edhe me një sërë rezultatesh pozitive. Anëtarët e Aktivit të pensionistëve, që është formuar para shumë vitesh, janë angazhuar kryesisht në aksione humanitare. Pensionistëve me pen-



sione të vogla dhe të sëmure çdo vit u akordohen fonde pa të drejtë kthimi, me çka tregohet se kujdesi për to është i përditshëm. Në shoqatë është formuar edhe një grup muzikor edhe kori, të cilat me sukses marrin pjesë në paradat rajonale dhe republikane si edhe në shumë manifestime komunale dhe të tjera. Shoqata është aktive edhe në sferën e sportit. Merr pjesë në të gjitha garat sportive rajonale dhe republikane të pensionistëve dhe arrin rezultate të mira, por edhe ka fituar edhe vende të para. SHP Çair në vitin 2016 në Lojërat e 21-ta rajonale sportive të



rajonit të parë u tregua mikpritës i suksesshëm. Në përputhje me aktivitetet e vazhdueshme dhe rekreacionin organizohen edhe ekskursione, në vend dhe jashtë shtetit, në të cilat marrin pjesë më shumë se 1500 pensionistë, ndërsa shumica e ekskursioneve mbështeten financiarisht nga Shoqata. Bashkëpunimi me LSHPM, është tashmë tradicional. Bashkëpunimi me vetëqeverisjen lokale është i mirë, por punohet që të jetë akoma edhe më i mirë.

Kryetar i KE dhe i shoqatës është Mentor Qoku, kryetar i Kuvendit është Isen Zekiri, ndërsa sekretar është Ivanka Seckovska.

SHP KAVADAR

Shoqata e pensionistëve Kavadar është themeluar në vitin 1964. Në vitin 1997 invalidët dhe invalidët e punës u ndanë si një subjekt i veçantë juridik, ndërsa Shoqata e pensionistëve Kavadar funksionon si një shoqatë e pavarur. Në fillim është zgjedhur kuvendi në shtator të vitit 1998, menjëherë pas miratimit të Ligjit për shoqata dhe fondacione në Republikën e Maqedonisë dhe miratimin e Statutit të shoqatës së RM,



ndërsa nga viti 2002 filloi të funksionojë Këshilli i ekzekutiv.

SHP Kavadar numëron mbi 5.800 pensionistë që janë përfshirë në një numër të madh aktivitetesh të Shoqatës nga sfera e jetës kulturore-zbavitëse, sportit, pushimit dhe rekreacionit, e të



tjera. Në kuadër të Shoqatës funksionon SHKA "Vreshti" me grup këngëtarësh dhe valltarësh, që performojnë rregullisht në të gjitha zonat më të rëndësishme të Republikës, rajonit dhe zonave komunale. Shoqata kavadariane ishte një prej iniciatorëve për zhvillimin e manifestimit "Pensionistët këndojnë" për rajonet e Nën Vardarit dhe Pellagonisë.

Çdo vit, më 14 shkurt mbahet takimi i pensionistëve të Maqedonisë, ndërsa nga viti 2016 edhe jashtë vendit, me rastin e Shën Trifunit. Në

vitin 2016 morën pjesë 21 shoqata.

Nga sporti Shoqata e pensionistëve Kavadar është lider në rajon, sipas rezultateve të arritura dhe mirënjohjeve të marra, ndërsa ishte mikpritës i garave sportive rajonale dhe në vitin 2003 republikane.

Rreth 2.000 pensionistë në vit janë të angazhuar me më shumë se 20 ekskursione në vend dhe jashtë vendit, si edhe pushime në Ohër dhe Shqipëri.

Në disa klube që janë nën ombrellën e SHP Kavadar në ditë qëndrojnë një numër i madh pensionistësh nga Kavadar, Rosoman, Marena dhe të tjera vendbanime.

Para 10 vitesh SHP Kavadar ka botuar Buletin Informativ për aktivitetet e veta dhe rezultatet gjatë viteve. Në rrjedhë është edhe përgatitja e shtëpisë së pushimit për anëtarët e saj në fshatin Çemersko, si edhe iniciativa për ndërtimin e Shtëpisë së të moshuarve për të cilën është gjetur investitori.

SHP Kavadar bashkëpunon me thuajse të gjitha shoqatat në Maqedoni, ndërsa është vëllazëruar edhe me ato të Koçan, Leskovac, R. e Serbisë dhe Pernik, R. e Bullgarisë.

Kryetar i KE dhe i Shoqatës është Risto Angjushev, kryetar i Kuvendit është Violeta Andova dhe sekretar Fruska Kostadinovska.



SHP KISELLA VODË

Shoqata e pensionistëve Kisella Vodë - Shkup është një prej shoqatave më të vjetra të Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë. Shoqata numëron rreth 13.000 anëtar nga komunat në vijim: Kisella Vodë, Zelenikovë, Sopishtë dhe Studeniçan. Shoqata mund të shërbejë si shembull



edhe për shoqatat e tjera, sipas aktiviteteve të shumta në të gjitha fushat e veprimtarisë. Aktivitetet zhvillohen përmes 12 degëve, si edhe në Klubet e pensionistëve që janë nëpër të gjitha degët. Klubi i pensionistëve nuk është vetëm në degën Studeniçan, por në degën Kisella Vodë ka dy Klube pensionistësh. Një numër kaq i madh i Degëve dhe Klubeve nuk është në asnjë prej shoqatave - anëtare të Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë. Në shoqatë është aktiv edhe Aktivi i pensionistëve që ka organizuar manifestimin humanitar "Korijada". Shoqata e pensionistëve Kisella Vodë - Shkup merr pjesë aktive në të gjitha manifestimet kulturore sportive, që nga niveli i degëve dhe deri në manifestime në nivel të shtetit ku ka arritur edhe rezultate evidente sipas numrit të pensionistëve që marrin pjesë në paradat e këngës, muzikës dhe valleve. SHP Kisella Vodë është një prej shoqatave më masovike.

Informimi i anëtarësisë është në nivel, ndërsa masiviteti po ashtu. Në rrjed-



ha është përgatitja e kartës sociale.

Aktiviteti i tillë i shoqatës është në kontinuitet që nga formimi e deri më sot dhe kështu do të jetë edhe në të ardhmen, falë angazhimit të drejtuesve, anëtarësisë, bashkëpunimit me vetqëverisjen lokale dhe Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë.

Kryetar i shoqatës dhe i KE është Vasil Zimbakov, kryetar i Kuvendit është Jovan Kirkoviq dhe sekretar është Aleksandar Shterjovski.

SHP KËRÇOVË

Shoqata e pensionistëve Kërçovë është një organizatë apartiake, multietnike, joqeveritare dhe punon mbi principe demokratike, me të drejta të barabarta për të gjithë anëtarët dhe përfaqësim proporcional në organe, trupa dhe komisionet e Shoqatës, pa dallim gjinie, feje, përkatësie etnike. Shoqata është formuar në vitin 1962 me emërtesën Shoqata komunale e pensionistëve - Kërçovë, me seli në



një shtëpi private. Më 29.05.1968 është ngritur procedura për ndërtimin e Shtëpisë së pensionistëve me ambiente strehimi për Shoqatën dhe 10 apartamente për vendosjen e pensionistëve me gjendje të keqe ekonomike. Shtëpia është ndërtuar me buxhetin e vet dhe me donacione nga institucione të tjera. Si një ditë të rëndësishme Shoqata e shënon 11 Shtatorin, Ditën e çlirimit të Kërçovës, ditë kur është hapur në



mënyrë solemne edhe Shtëpia e pensionistëve në rrugën Janko Mihajloski p.n. - Kërçovë. SHP Kërçovë punon në Shtëpi që prej vitit 1972 dhe shtëpia është në pronësi të shoqatës. Në Shoqatë janë të anëtarësuar rreth 4.500 pensionistë, që marrin pension familjar dhe pleqërie nga Kërçova, të ndara në 11 degë vendore. Anëtarët e SHP Kërçovë të drejtat e tyre i realizojnë mbi bazën e normave ligjore, Statusin e LSHPM dhe Statutin e SHP Kërçovë. Në shoqatë janë veçanërisht aktive edhe pensionistet. Në Kërçovë mbahet takimi i pensionistëve, që i kush-

tohet solidaritetit. Mbi 400 pensioniste dhe pensionistë të shoqatave Ohri dhe Deberca, Struga, Manastir, Resen, Demir Hisar, Krushevë, Prilep, Veles, Negotinë, Shtip, Strumicë, Karposh, Gazi Baba - Shkup dhe Tetovë, si edhe shoqata e Kërçovës, që ishte mikpritëse e takimit. Në këtë takim të madh humanitar të pensionistëve merre pjesë edhe kryetari i Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, Dragi Argirovski, i cili në fjalën përshëndetëse, krahas përshëndetjeve të përzemërta, theksoi se takimet e tilla të solidaritetit duhet që të zhvillohen më shpesh, pasi që pensionistët njihen dhe janë të dëshmuar si qytetarë solidarë dhe humanë.

Në takim krahas asaj se pensionistët e treguan solidaritetin dhe humanitetin e tyre, ato u shoqëruan dhe u argëtuan. Ndryshe, qëndrimi në Kërçovë u shërbeu pensionistëve për të vizituar edhe manastiret "Shën Mëria e papërlyer" dhe "Shën Gjorgji" në fshatin Knezhinë, si edhe Shtëpinë e artit e cila gjendet në afërsi me manastirin.

Kryetar i SHP Kërçovë dhe i KE është Lupço Llukarowski, kryetar i Kuvendit është Mehmed Mehmedi, ndërsa sekretar është Dobrivoj Llazareski.

SHP PROBISHTIP

Shoqata e pensionistëve nga Probishtipi, sipas numrit të anëtarësisë renditet mes shoqatave më të vogla, anëtare të LSHPM, por me aktivitete në sfera të ndryshme insiston të jetë në një nivel ose të ngjashëm me atë të shoqatave më të mëdha.

Veprimtaria e parë e organizuar e pensionistëve në Probishtip fillon më vitin 1960, me 571 pensionistë. Si kryetari parë u zgjodh Ugrin Kotevski, ndërsa sekretar Petar Golubjatnik. Sot Shoqata e pensionistëve të moshuar dhe familjarë numëron 1.950 anëtarë dhe ka aktet e veta për funksionimin normal. Organi më i lartë është Kuvendi, që numëron 19 anëtarë, Këshilli ekzekutiv 9, ndërsa komisionet janë të kulturës, sportit, shëndetësisë dhe të tjera.

Me ekzistencën e saj 57 vjeçare shoqata shënon një sërë arritjesh të numërta dhe çmime në kulturë, sport dhe rekreacion, shëndetësi dhe rekreacion klimatik dhe në llixha.

Për t'u shënuar është që pikërisht kjo shoqatë e vogël e luan rolin nxitësit në ngjarjet kulturore dhe sportive në LSHPM. SHKA "Pensionistët e lumtur" që për 42 vjet punon në përbërje të SHP ka vërejtur rezultate evidente në festivalet në Maqedoni dhe jashtë vendit tonë, ku ka fituar edhe një sërë vendesh të para për kultivimin e folklorit tradicional për traditën më të suksesshme të vendosur "Lupenje klasje". Në vitin 2011 SHP Probishtip ishte përfaqësuesi i dytë i LSHPM në Festivali ndërkombëtar të moshës së tretë të jetës në Lubjana, ndërsa është pjesëmarrës edhe në Festivalin Ballkanik në Kosovë dhe Samokov në Bullgari, nga ku u kthye me marrjen e vendeve të para. Vitrinat e shoqatës janë të mbushura me diploma, çmime, mirënjohje, falënderime dhe pllakate. Pikërisht ishte SHP Probishtip organizatori i parë i paradave folklorike të këngës, muzikës dhe valleve në vitin 2003.

Në pjesën e sportit, SHP Probishtip garat e para sportive rajonale i organizonte në vitin 1996 dhe deri më sot është pjesëmarrës i rregullt i garave sportive republikane të LSHPM. Dhe në pjesën e sportit Shoqata ka arritur rezultate të larta. Përndryshe SHP Probishtip për më shumë se 30 vjet e kultivon sportin dhe mban gara sportive që janë me karakter ndërkomunal, dhe pjesëmarrës të rregullt janë edhe Kriva Pallankë, Kratova, Probishtip dhe Shën Nikolla. Në pjesën e shëndetësisë mban ligjërata edukative me institucionet e shëndetit, dërgon pensionistë në rekreacion llixha-klimatik, dhe një pjesë prej tyre i shfrytëzojnë edhe masat përmes Qeverisë së RM. Interes të madh pensionistët tregojnë edhe për ekskursionet ditore në ambiente të hapura, që gjatë vitit i organizon shoqata, dhe numërohen mbi dhjetë, por po ashtu janë edhe organizatorë edhe të takimeve masovike piknik në Lesnovë.

Nga puna e SHP Probishtip me një kënaqësi të veçantë duhet të përmendet edhe bashkëpunimi mes gjeneratash në më shumë sfera, si edhe bashkëpunimi me vetëqeverisjen lokale, kryetarët e komunave, Shtëpinë e shëndetit dhe OK të Kryqit të kuq.

Kryetar i Shoqatës dhe i Këshillit ekzekutiv është Gruica Manasijev, ndërsa sekretar Angel Kocев.



SHP SHTIP

Shoqata e pensionistëve të komunës Shtip është formuar në vitin e largët 1946, me seli në Shtip. Gjatë zhvillimit të saj vazhdimisht e ka rritur numrin e vet, ashtu që për momentin numëron rreth 8.500 anëtarë. Ajo vepron në zonën e komunës Shtip dhe që nga viti 2010 edhe në zonën e komunës Karbinci. Në territorin e zonës së vet të komunave Shtip dhe Karbinca, Shoqata funksionon përmes 13 degëve që në përbërjen e tyre kanë me nga 5 anëtarë. Shoqata po ashtu ka formuar dhe hapur edhe 7 klube për pensionistë, dhe ajo një qendror i vendosur në Shtëpinë e pensionistëve, dhe 6 të ndarë në degë. Në vitin 1975 është vendosur që me buxhetin e vet financiar të ndërtohet një Shtëpi e re për pensionistë.



Gjatë vitit 2011 është arritur tek përfundimi se ka nevojë për ndërtimin e një shtëpie të re për pensionistë, sërish me buxhetin e vet që i ka kursyer Shoqata me harxhime racionale dhe mikpritjen e të hollave nga anëtarësia. Pas disa ofertave, nga ana e vetëqeverisjes lokale në Shtip, që drejtohet nga kryetari i komunës m-r Illço Zahariev, është propozuar që shtëpia të ndërtohet në objektin ekzistues, që nga pronësia e ARM iu dha në pronësi vetëqeverisjes lokale Shtip, dhe ajo në interes të pensionistëve e akordon në shfrytëzim të gjatë të SHP Shtip dhe Karbincë. Po aty planifikohet që të strehohen rreth 100 pensionistë. Që nga vetë themelimi i Shoqatës është formuar grupi që me këngë qytetare të vjetra merr pjesë në të gjitha manifestimet

folklorike rajonale dhe republikane. Prej pak kohësh është formuar edhe grupi i këngëtarëve që do të përmbushë edhe folklor burimor. Shoqata çdo vit merr pjesë në lojërat sportive, si në ato rajonale, ashtu edhe në ato republikane dhe ka arritur rezultate solide. Për anëtarët e saj gjatë vitit realizon më shumë lloje aktivitete të planifikuara - ekskursione dhe festa. Çdo vit sipas Statutit dhe rekomandimeve nga Lidhja, shumica e pensionistëve shkojnë në kurim klimatik dhe në llixha. SHP Shtip dhe Karbinci ishte mikpritës i Garave të 18-ta sportive republikane të pensionistëve në vitin 2013, të cilat i realizoi me sukses.

Kryetar i shoqatës është Aleksandar Zahariev, që është njëherazi edhe kryetar i Këshillit ekzekutiv, nënkryetar i Këshillit ekzekutiv është Kosta Shteriev, ndërsa sekretar Riste Netkov.

SHP KRIVA PALLANKË

Shoqata e pensionistëve "Kriva Pallankë" - Kriva Pallankë funksionon si e pavarur prej 48 vitesh. Duke shfletuar arkivin e Shoqatës mund të konstatohet si vijon: se pensionisti i parë i Komunës ka qenë Stojan Veliçkovski nga fshati German, i dalë në pension në vitin 1957. Sot shoqata numëron 3.100 pensionistë. Deri në vitin 1969 pensionistëve nga komunat Kriva Pallankë dhe Rankovcë, ishin



anëtarë të SHP Kumanovë. Në vitin 1969 në muajin tetor, pensionistët e këtyre dy komunave ndahen dhe formojnë shoqatën komunale të pensionistëve në komunën Kriva Pallankë, në të cilën përveç pensionistëve të moshuar dhe familjarë ishin të anëtarësuar edhe ato invalidë. Kryetari i parë i shoqatës komunale ishte Filip Filipovski. Shoqata e formuar kështu ka vepruar deri në vitet e tetëdhjeta të shekullit të kaluar, kur u ndanë pensionistët invalidë dhe formuan një Shoqatë të veçantë. Në vitet shtatëdhjetë të shekullit të kaluar, në bashkëpunim me Komunën dhe Fondin SPI është ndërtuar edhe



Shtëpia e pensionistëve. Më vonë në vitet e tetëdhjeta të shekullit të njëzetë brenda ndërtesës së njësisë së zonës së Fondit të SPI është ndërtuar një klub i ri i qëndrimit ditor të pensionistëve. Në SHP Kriva Pallankë ka 6 degë që janë: fsh. Rankovcë me fshatrat përreth, fsh. Petralica, fsh. Mozhdivnjak, Kriva pallankë, fsh. Zhidillovë dhe fsh. Dubrovica. Shoqata ka një bashkëpunim të madh gjithëpërfshirës me LSHPM, numri më i madh i shoqatave të pensionistëve në Republikë, vetëqeverisjet lokale, me ndërmarrje publike dhe subjekte shtetërore.



i KE është Arsenie Ilievski, sekretar Bllagoja Nikollovski.

Me rastin e Ditës së çlirimit të Kriva Pallankës - 8 Tetori në seancën solemne të Këshillit të komunës çmimi më i lartë, "8 Tetori", iu akordua Shoqatës së pensionistëve Kriva Pallankë, si rezultat i aktivitetit të suksesshëm për vite me radhë si një organizatë joqeveritare.

Gjithsesi që çmimi është merit, pasi që Shoqata me aktivitetet e veta dhe arritjet del në pah në suaza të komunës dhe veçanërisht në Lidhjen e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë dhe më gjerë. Bashkëpunimi me komunat është tradicional dhe me të vërtetët për t'u marrë si shembull. Kryetar i Shoqatës dhe i KE është Sllavko Stojanovski, nënkryetar

SHOQATA E PENSIONISTËVE TË LUFTËS

Shoqata e pensionistëve të luftës së RM (SHPL e RM) është formuar më 10 dhjetor 1992. Në cilësinë e personit juridik është regjistruar më 23.03.1993 dhe për shkak të harmonizimit me ligjet e reja dhe ndryshimet në Statut është reregjistruar në vitin 1999, 2008, 2011 dhe 2016 që nga formimi e deri në vitin 2010 Shoqata ishte e organizuar dhe vepronte në të gjithë territorin e Republikës dhe që nga viti



2011 vepron e organizuar vetëm në territorin e Shkupit, në fillime me 7 degë dhe me rreth 1600 anëtarë, ndërsa sot me 3 degë dhe rreth 1.300 anëtarë. Kryetarë të deritanishëm të KE ishin: gjenerali në pension Dimitrije Savevski (i ndjerë) dhe kolonelët në pension Trajçe Postollovski, Jordan Jordano-



nov, Dragan Bozarevski dhe Gjorgji Zarinski (aktual). SHPL është anëtare e LSHPM që nga viti 1998 dhe anëtare e LSHP e qytetit të Shkupit që nga viti 2013, ku realizon rezultate evidente, që nga muaji mars i vitit 2012 është binjakëzuar me SHP Kumanovë dhe ka bashkëpunim të suksesshëm me më shumë shoqata në qytet dhe në Republikë. Në funksionimin e tërë të shoqatës vend qendror ka kujdesi për pensionistin, përkatësisht sigurimi i kushteve për jetë pensioniste të shëndetshëm dhe dinjitoze. SHPL në formë të ndryshme është kujdesur për ruajtjen e të drejtave të fituara nga SPI dhe për përmirësimin e pozicionit social, mbrojtjes shëndetësore, për informimin e anëtarësisë dhe të tjera. Organizon edhe aksione humanitare dhe solidarë të çdo lloji dhe aktivitete sportive-rekreative. Suksese evidente arrin në shumë fusha dhe sidomos në pjesëmarrjen në paradat rajonale dhe republikane të këngës, muzikës dhe valleve, gjatë 3-4 viteve të fundit. Po ashtu organizon me sukses ekskursione, piknikë, shëtitje, vizita dhe pjesëmarrje në takimet e pensionistëve dhe në manifestime të tjera me karakter rekreativ në qytet dhe në Republikë. Në vitin 2013 dhe 2014 është zbatuar informimi individual i anëtarëve për qëllimet, detyrat dhe aktivitetet e SHPL dhe anketimi i pozicionit social-shëndetësor, interesi, nevojat, aftësitë dhe afinitetet për përfshirjen në aktivitetet e organizuara të Shoqatës.

Më 10-të dhjetor 2007 dhe në vitin 2012 në formë dinjitoze është shënuar 15 dhe 20-vjetori i formimit të SHPL, me ç'rast është botuar edhe Monografia e Shoqatës. SHPL me shumë sukses i realizonte detyrat nga ana e KE e LSHPM, në rolin e mikpritësit në paradat rajonale dhe republikane të këngëve, muzikës dhe valleve dhe në ceremoni jubilarë dhe manifestime me një interes dhe rëndësi më të gjerë, me çka fitoi edhe mirënjohje.

Mbijetesa e Shoqatës dhe sukseset e arritura janë rezultat i drejtimit me zgjuars, këmbënguljes së madhe dhe adaptimit të entuziastëve të SHPL, si edhe në mirëkuptimin dhe ndihmën e LSHPM dhe organeve të MO dhe GSH të ARM, e cila mund të ishte edhe më e mirë.

Kryetar i Shoqatës dhe i KE është Gjorgji Zarinski, ndërsa sekretar është Eftim Mishevski.

SHP DIBËR DHE QENDËR ZHUPA

Shoqata është formuar në 18.10.1973 dhe që prej atëherë është anëtare e LSHPM. SHP Dibër dhe Qendër Zhupa funksionon përmes organeve, trupave dhe komisioneve si vijojnë: Kuvendi i Shoqatës së pensionistëve i komunave Dibër dhe Qendër Zhupa, që numëron 27 anëtarë dhe 12 zëvendës ose në total 39 anëtarë, Këshilli ekzekutiv që numëron 18 anëtarë, Këshilli mbikëqyrës 3 anëtarë dhe 1 zëvendës. Në shoqatë punojnë 5 komisione. Shoqata ka 8 degë që janë: Bajram Beg, Inqar, Dervish Mustafa, lagja Venec 1 dhe 2 në Dibër, Qendër Zhupa, fshatrat Otishani dhe Xhephishtë, Kosovrasti i poshtëm dhe dega në fshatin Mogorçë. Në Shoqatë punon edhe Aktivi i pensionistëve dhe kryetare është Marionka Ushtelenci. Për vite me



radhë kryetar i SHP Debar ishte Besnik Pocesta, kryetar i tanishëm i Kuvendit të LSHPM. SHP Dibër dhe Qendër Zhupa posedon me një Shtëpi për pensionistë, e ndërtuar në vitin 1973 me 10 dhoma, dy prej të cilave përdoren për funksionimin e shoqatës dhe ambiente për qëndrim ditor të pensionistëve, me dimensione prej 100 m². Po ashtu, shoqata performon në të gjitha paradat rajonale

të këngës, muzikës, valleve. Në shoqata mbahen leksione mbi tema që janë në interes të anëtarëve dhe organizohen edhe ekskursione. Është interesante që në Dibër disa hotele i hapën dyert e tyre dhe i ofruan kapacitete të tyre për qëndrimin e pensionistëve të vetmuar me çmime të volitshme dhe për ata që kanë pensione të vogla. SHP Dibër dhe Qendër Zhupa ka Klub pensionistësh në Zhupë që punon shumë. Në seancën e nderit të Kuvendit ku merrnin pjesë dhe përfaqësues nga të gjitha degët e Shoqatës një falënderim i veçantë u shpreh edhe për bashkëpunimin e suksesshëm me "Banjat e Dibrës - Capa".

Edhe në sferën e sportit pensionistë dibranë kanë sukses në garat rajonale dhe ato republikane sportive të lojërave dhe shqërimin.

Shoqata numëron rreth 2.200 pensionistë të moshuar dhe familjarë dhe bashkëpunon veçanërisht me pensionistët nga Shqipëria.

Kryetar i KE dhe i Shoqatës së pensionistëve të komunës Dibër dhe Qendër Zhupa është Xhavid Karpuzi, sekretar është Muhamed Hisa.

SHP OPB e R.M. - Shkup

Shoqata e punonjësve të pensionuar nga organet e punëve të brendshme të Republikës së Maqedonisë - Shkup është formuar me iniciativën e punonjësve të pensionuar të OPB të RM me një Vendim të miratuar në Kuvendin themelues, e mbajtur më 09.05.1969, ku merrni pjesë mbi 250 pensionistë. Shoqata është regjistruar me Vendimin e ish RSVR (tani MPB), me të drejtë veprimi në zonën e RSM dhe më 16.05.1969 është regjistruar në regjistër (që mbahej pranë RSVR) e shoqatave republikane dhe që atëherë ka marrë statusin e subjektit juridik. Qëllimi bazë i themelimit të Shoqatës ishte që të gjendej forma e angazhimit shoqëror të punonjësve të pensionuar të OPB (persona të autorizuar zyrtarë), që për shkak të proceseve shoqërore dhe mbi bazën e akteve të veçanta (leh specialis) e drejta e pensionit realizohej shpesh para kohe dhe në një moshë rel-



ativisht të re për angazhimin e tyre pas pensionimit, në suaza në shoqatës janë realizuar aktivitete mes të cilave ishin: trajnimi dhe dhënia e patentës, ku për këtë arsye ishte regjistruar Auto shkolla "Milicioner", më pas kryhej siguri i objekteve të ndërmarrjeve dhe organizatave, në panairë, manifestime të ndryshme e kështu me radhë dhe në bashkëpunim me MPB. Me ndryshimet që erdhën pas normativës ligjore, Shoqata, me Vendimin e Gjykatës themelore Shkup 1, Shkup më 07.04.1999 u reregjistruar dhe është evidentuar në Regjistrin e shoqatës së qytetarëve dhe fondacioneve.



anëtarësisë, për një pleqëri aktive dhe të shëndetshme. Shoqata numëron mbi 1.600 anëtarë. Edhe pse Shoqata është regjistruar me veprimtari në territorin e Republikës, ajo sot vepron në territorin e Shkupit në kuadër të Shoqatës në vitin 2014 punon me sukses dhe është aktiv Aktivi i pensionisteve.

Kryetar i shoqatës, i KE të Kuvendit është Spirko Nikolovski, ndërsa sekretar Fenço Atanasov.

Për realizimin e këtyre qëllimeve gjithmonë duke u përballur me sfidat, Shoqata ka arritur suksese jashtëzakonisht të mira dhe ka zgjidhur shumë çështje të rëndësishme, sidomos në planin e mbrojtjes së të drejtave nga sfera e SPI, harmonizimin e pensioneve të punonjësve të pensionuar të OPB, përmirësimin e pozicionit material dhe social të anëtarësisë dhe familjeve të tyre, ndërsa suksese të dukshme ka edhe në sferën e sportit, në planin e kulturës, si edhe në pjesën e jetës zbavitëse të

SHP SHËN NIKOLLË

Në vitin e largët 1960 pensionistë entuziastë formuan Shoqatën e pensionistëve dhe kjo është forma e parë e një aktiviteti të organizuar të qytetarëve më të moshuar në Shën Nikollë. Kryetari i parë i kësaj Shoqate ishte Stoimir Pavlov. Për ndërtimin e Shtëpisë së pensionistëve, në të cilën gjenden edhe zyrat e shoqatës, është meritë kryetari i ardhshëm, Llazo Mishev.

Për vite të tëra kryetar i suksesshëm i SHP ishte Mirko Danaillov. Sot shoqata numëron mbi 2.800 anëtarë. Në shoqatë funksionojnë 8 degë, 3 prej të cilave në qytet dhe 5 në vendbanimet rurale. SHP Shën Nikollë ka organet dhe trupat e veta dhe Statutin e saj që është i harmonizuar me të gjitha ligjet relevante, si edhe me Statutin e LSHPM, anëtare e të cilit është. Në përbërje të Shoqatës punojnë edhe dy klube pensionistësh, si edhe Aktivi i pensionistëve. SHP Shën Nikollë në vitin 2010 ishte mikpritës i suksesshëm i paradës së tetë rajonale të këngës, muzikës dhe valleve dhe i garës së 15-të rajonale sportive, në të cilat Snezhana Atanasova, mori vendin e parë dhe u stolis me medalje ari në disiplinën tabelë. Shoqata në vitin 2014 u tregua një mikpritës i suksesshëm i paradës së 12-të rajonale të këngës, muzikës, valleve dhe lojërave, por edhe, organizator i mirë i Garave sportive rajonale dhe po atë vit, në Garat e 19-ta republikane sportive, ekipi i SHP Shën Nikollë në disiplinën pikado mori vendin e parë. Si shigjetar më i mirë u shpall Tana Mihajlova. Në vitin 2015 formohet seksioni kreativ-artistik "Ovçepolska Zunica" e artit figurativ, mjeshhtërisë për të bërë makrame dhe piktura me lule të thata për vite me radhë. SHP Kratovë, SHP Kriva Pallankë, SHP Probishtip dhe SHP Shën Nikollë në vazhdim takohen në gara sportive ndërkomunale. Shoqata, çdo vit e shënon patronatin e qytetit, Shën Nikollajin.

Me rastin e numrit të 100-të të gazetës "Pensionisti plus" dhe 70 vjetorit të organizimit pensionist në Maqedoni, Vukica Petrusheva mori Mirënjohje si një prej dhjetë korrespondentëve më të mirë të LSHPM.

Kryetar i shoqatës dhe i KE është Nikolla Atanasov, ndërsa sekretar është Trajçe Sandev.



SHP STRUGA

Sipas të dhënave arkivore dhe Regjistrat qendror, SHP Struga funksionon që nga viti 1960. Në vitet e para të formimit shoqata vepronte konform Ligjit për sigurimin pensional-invalidor shëndetësor dhe social. Më pas u miratua edhe Statuti i parë i shoqatës dhe të tjerave akte ligjore, ndërsa në vitin 2010 shoqata u reregjistruar konform Ligjit për shoqata dhe fondacione. Sot SHP Struga numëron 4.109



anëtarë, prej të cilëve 700 janë shqiptarë. Kjo shoqatë është një prej atyre me përkatësi të përzier etnike, pasi që në të janë anëtarë edhe maqedonas, shqiptarë, vllleh, romë dhe komunitete të tjera etnike dhe është shembullore sesi ato veprojnë së bashku të depolitizuar në të gjitha sferat e jetës dhe punës. SHP Struga që nga muaji nëntor i vitit 2012 vepron e pavarur, pasi që në atë periudhë rreth 400 pensionistë nga komuna e Vevçanit u ndanë

nga shoqata strugave dhe formuan shoqatën e vet të pensionistëve Vevçan. SHP Struga është organizuar sipas principit territorial, me 14 Degë vendore. Në shoqatë funksionon edhe Aktivi i pensionistëve dhe më shumë komisione. Shoqata strugave është mes atyre të rrallave që e kanë zgjidhur çështjen administrative - strehimi dhe ka në dispozicion edhe Klubin e pensionistëve, në të cili gjatë ditës me qindra pensionistë e kalojnë kohën e lirë. SHP Struga ka bashkëpunim të frytshëm me



LSHM, si edhe me më shumë SHP nga rajoni jugperëndimor dhe me institucione të tjera, ndërmarrje publike, fondacione dhe organizata joqeveritare. Në vitin 2014 SHP Struga u binjakëzua me SHP Krushevë, ndërsa me degën komunale të Kryqit të kuq të Strugës kanë nënshkruar Memorandum bashkëpunimi. Në 57 vjetorin e themelimit SHP Struga ka arritur rezultate, të mira, sidomos në dhjetë vitet e shkuara, si rezultat i drejtuesve aktualë. Për punën e saj të suksesshme SHP Struga ka marrë Mirënjohje të shumta, falënderime, lavdërime, ndërsa në planin sportiv ka fituar medalje ari, argjendi dhe bronzi.

Shoqata e pensionistëve nga Struga në vitin 2004 dhe në vitin 2009, në "Eurotel" dhe në vitin 2011 në kompleksin Livadhishte, ishte mikpritës i suksesshëm i Garave sportive republikane të pensionistëve.

Kryetar i Shoqatës dhe i KE është Millorad Tërposki, ndërsa sekretar Izeir Mustafai.

SHP PENSIONISTË SOLIDARË - ILINDEN

Shoqata e pensionistëve, Pensionistë solidarë - Ilinden - Shkup, është shoqatë relativisht e re. Është formuar në fundin e vitit 2010, pas ndarjes nga SHP Gazi Baba, me bilanc ndarës. Shoqata ka pesë degë dhe ato në Ilinden, Kadino, Milladinovci, Bujkovci dhe Marino, dhe bashkë me to funksionojnë edhe klube, ku pensionistët mund të shoqërohen. Aktivitetet kryesore të Shoqatës janë të orientuara gjithmonë drejt realizimit të programit vjetor dhe kujdesit për cilësinë e jetës dhe standardit të pensionistëve. Shoqata ka rreth 2.000 anëtarë.



SHP Pensionistë solidarë - Ilinden - Shkup angazhohet që sa më shumë pensionistë të marrin pjesë në manifestimet muzikore dhe sportive, të organizuara në të gjitha nivelet, ku ata arrijnë rezultate të lartë në shumë disiplina angazhimit të vetë dhe të treguar në Garat e 20-ta sportive rajonale të pensionistëve, si mikpritësi të mirë të rajonit të parë. Pensionistët e kësaj shoqate marrin pjesë

në thuajse të gjitha shoqërimet pensioniste, por edhe në ekskursione e deri në vende për piknik dhe manastire.

Përmirësimi i punës dhe zgjerimi i aktiviteteve është edhe formimi i grupit këngëtar folklorik, me të cilin kjo shoqatë do të njihet. Aktiviteti i pensionistëve pranë Shoqatës gjatë viteve të kaluara një theks të veçantë i ka vënë edhe organizimit të aksioneve humanitare, shoqërimeve dhe ekskursioneve, por organizohen edhe leksione mbi tema nga sfera e shëndetësisë. Shoqata Pensionistëve solidarë është anëtare e LSHPM. Bashkëpunimi i tyre është i mirë dhe për realizimin e më shumë programeve. Me vetëqeverisjen lokale, dhe kryetarin e komunës Zhika Stojanovski, bashkëpunimi është në nivel shumë të mirë dhe kryetari është gjithmonë me ta.

Kryetar i KE dhe i shoqatës Blagoja Atanasovski, kryetar i Kuvendi të Vase Gjorgjievski, ndërsa sekretar është Strasho Stojanovski.



SHP TAFTALIXHE DDD

Shoqata e pensionistëve Taftalixhe DDD është regjistruar më 13.02.2008. që nga formimi e deri më sot Shoqata zhvillohet dhe realizon rezultate evidente, falë drejtuesve, por edhe të gjithë anëtarëve. Në shoqatën e pensionistëve të Taftalixhe DDD sot anëtarësojnë 6.700 pensionistë të orga-



nizuar në 6 degë që janë: Karposh 1 dhe 2, Karposh 3 dhe 4, Vllae me Zllokuqan dhe Bardovci, Taftalixhe 1 dhe 2, Vllado Tasevski dhe Kozle. Në shoqatë funksionojnë 3 Klube pensionistësh në të cilët pensionistët shoqërohen dhe argëtohen. Në shoqatë është aktive Aktivi i pensionisteve. Shoqata mundohet që të mbrojë dhe të avancojë qëllimet e përbashkëta dhe interesat e anëtarëve. Aktivisht bashkëpunon me Lidhjen e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, me Lidhjen e shoqatave të pensionistë të Qytetit të Shkupit, por edhe me shoqata të tjera komunale, vetëqeverisjen lokale në komunat Kar-

posh, Fondin e SPIM, Fondin e LSHM, kuq, dhe të tjera organizata dhe institucione që kanë pika të përbashkëta në realizimin e programit të Shoqatës.

Kryetar i shoqatës, por edhe i KE është Dimitar Dimovski, kryetar i Kuvendit është Slobodanka Isijanova, ndërsa sekretar është Pavle Vasileski.

SHP SARAJ

Shoqata e pensionistëve e komunës Saraj, si një shoqatë e pavarur është formuar më 08.10.2007 konform Ligjit për Shoqata të qytetarëve dhe fondacioneve të Republikës së Maqedonisë, Statutin e LSHPM dhe Statutin e vet - Shoqatë e pensionistë së komunës Saraj, regjistruar në Regjistrin qendror në Shkup. Iniciator për formimin e Shoqatës së pensionistëve të komunës ishin: Rufat Ramadani, Gani Ismaili, Abedin Krosi, Bajram Ebibi dhe të tjerë.



Si një Shoqatë e pavarur e pensionistëve në komunën Saraj, sipas të dhënave të fundit të LSHPM, numëron rreth 1.900 pensionistë të moshuar dhe familjarë. Shoqata ka tre degë: Saraj, Kondovë dhe Bukoviq. Ka Kuvend me 13 anëtarë, Këshilli ekzekutiv me 5 anëtarë, Këshill mbikëqyrës me 3 anëtarë dhe 4 Komisione. Në shoqatë ekziston edhe Aktivi i pensionisteve. Në praninë e një numri të madh të pensionistëve në SHP Saraj, me ndihmën e Kryqit të kuq të Maqedonisë dhe Lidhjen e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, u hap një

Qendër e qëndrimit ditor të personave të moshës së tretë. Në ceremoni ishin prezent: kryetari i komunës Saraj, Bekim Murati, sekretari gjeneral i Kryqit të kuq të Maqedonisë, Sait Saiti, kryetari i Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, Dragi Argirovski, sekretari nga Kryqi i kuq i Qytetit Shkup, Suzana Tuneva - Paunovska, si edhe donatorët Xemail Dauti nga "Fondacioni Albiz" - Saraj dhe Igor Gievski nga "EVN Maqedoni". Qendra ditore është e hapur me mbështetjen financiare të "Fondacionit Albiz".

Kryetar i Kuvendit është Baki Bakiu, dhe i KE është Mahir Duraku, ndërsa sekretar është Imer Jakupi.

SHP VEVÇANI

Shoqata komunale e pensionistëve nga Vevçani, është formuar më 29 nëntor 2012 g dhe kjo datë konsiderohet si dita e shoqatës. Më parë, pensionistët e Vevçanit ishin anëtarë të SHP Struga.



Iniciatorë për formimin e SHP Vevçani janë Vitomir Kostojçinoski, Jovan Avramoski, Sandre Ruseski dhe të tjerë. Me ndarjen e shoqatës strugane, SHP Vevçani, sipas të dhënave më të fundit të LSHPM numëron rreth 400 pensionistë të moshuar, familjarë, invalidorë, të punës dhe të tjera kategori pensionistësh dhe është një prej shoqatave të rralla në Republikë në të cilën së bashku janë anëtarë të gjitha kategoritë e pensionistëve. Shoqata është aktive në më shumë fusha dhe sidomos në ruajtjen e thesarit dhe traditës kulturore. Falë bashkëpunimit të

suksesshëm, komuna e ka zgjidhur edhe çështjen e strehimit të shoqatës, pajisjen dhe të gjitha kushtet e tjera të nevojshme për punë normale, si edhe pajisjen e klubit të pensionistëve në Shtëpinë e kulturës, ku edhe është vendosur Vetëqeverisja lokale. Kryetar i KE dhe i shoqatës është Vitomir Kostojçinoski, Naum Çoçoroski është kryetar i Kuvendit, ndërsa Slobodan Gogoski është sekretar.

SHP VINICA

Fillimi i organizmit pensionit dhe shoqërimit të pensionistëve në komunën Vinica është që në vitin 1946, në kuadër të organizatës së krijuar në komunën Koçan. SHP Vinica si një shoqatë e formuar është më 27.05.1967, me numrin e anëtarëve pensionistë rreth 70.

Në periudhën e kaluar Shoqata vë veprimtarinë e saj i ka dhënë një aksent të veçantë sigurimit të kushteve më të mira për jetën dhe standardin e pensionistëve. Me ndërtimin e Shtëpisë së Pensionistëve



në vitin 1975-76 janë krijuar kushte më të mira për aktivitete pensioniste dhe për relaksim të tyre. Në Shoqatë bëjnë pjesë pensionistë me pension moshe, familjar dhe invalidor. Për t'u venduar është menaxhimi i Fondit Solidar, përmes të cilit jepet ndihma e nevojshme pensionistëve me paga të vogla, të sëmurëve dhe për pajisje. Në vitin 2017 Shoqata shënoi 70 vjetorin jubilar me anëtarësi prej mbi 2.600 pensionistë. Shoqata çdo vit organizon takim me rastin e "Javës së Tomit" në të cilën

marrin pjesë 700-800 pensionistë, si edhe takimet tek manastiri i Shën Spasit në fshatin Dragobrashte (13 shtatori), në të cilin marrin pjesë mbi 2.000 pjesëmarrës nga më shumë shoqata. Takimi organizohet me ndihmën e Komunës dhe Këshillit kishtar të Manastirit "Voznesenie Hristovo" nga fshati. Takimi tek manastiri mbyllet me valle dhe këngë popullore dhe hare. SHP Vinica merr pjesë aktive edhe në pjesëmarrjen në Garat Sportive të pensionistëve dhe në Paradat e këngës, muzikës dhe valleve, ku shënon rezultate të mira.

Kryetar i SHP Vinica dhe i KE është Dragan Petkov, ndërsa sekretar Petrush Danilov.

SHP VALLANDOVË

Shoqata e pensionistëve Vallandovë ka në përbërje pensionistë moshe, invalidë dhe familjarë nga komuna. Shoqata është formuar me Vendimin nën emrin e Lidhjes së pensionistëve Vallandovë, më 04.03.1984.



Me statusin e personit juridik ka fituar Regjistrin qendror pranë Gjykatës ekonomike të rrethit Shkup, me vendimin me nr. regj. 726/87 më 12.11.1987, konform Ligjit për shoqata dhe fondacioneve. SHP Vallandovë është anëtare e LSHPM. Në kohën e formimit shoqata kishte 763 anëtarë. Në vitin 1997 numri i pensionistëve arriti në 1.250 anëtarë. Në vitin 2002 ajo shifër ishte 1.381, dhe në vitin 2015 numri i pensionistëve - anëtarë u rrit deri në 1.800 përdorues në pension. Si kryetar i Shoqatës në periudhën e kaluar shfaqen: Dinka Lazov, Gjorgje Sapunxhi-ev, Aleksandar Stojçev, Manço Shirtovski, Vanço Marshkaov, Leonid Mançev dhe kryetari i tanishëm, i shtati me radhë Kiril Goshev. Shoqata ka 4 degë sipas vendosjes gjeografike të vendbanimeve. Shoqata ka në dispozicion dhe është pronar i Shtëpisë së pensionistëve, aty ku edhe vendosur Klubi pensionistëve, si edhe 4 apartamente në të cilat jetojnë pensionistë. Kryetar i shoqatës së KE është Kiril Goshev, nënkryetar është Mile Shuntov, ndërsa sekretar është Gorica Mihajlova.

SHP NEGOTINË

Shoqata e pensionistëve - Negotinë është formuar në vitin e largët 1954. Ajo ishte organizata e parë pensioniste në rajon, ndërsa themelues ishin: Pano Maliminov - kryetar, Atanas Ivanov - sekretar i Vasil Tefov - arkëtar. Edhe pse numri i pensionistëve atëherë nuk ka qenë i madh, ishin pesëdhjetë, gjithsesi formimi i organizatës kishte edhe rëndësi të madhe, pasi që përmes saj mbrohen interesat dhe të drejtat e kësaj kategorie qytetarësh.



Tani në SHP Negotinë bëjnë pjesë mbi 3.000 pensionistë moshe, familjarë dhe invalidë, si edhe invalidë pune. Shoqata posedon me një shtëpi pensioniste. Në të tre klubet e pensionistëve Negotinë, Krivollak dhe Disan, pensionistët takohen, komunikojnë dhe argëtohen dhe relaksohen.

Në SHP Negotinë funksionojnë 12 degë dhe ato 5 në Negotinë dhe në 7 mjedise rurale, në fshatra. Duhet veçanërisht që të theksohet ekzistimi i Klubit pensionist "Negotinijana". Për zhvillimin dhe avancimin e jetës kulturore - zbavitëse në një masë të madhe ka kontribuar edhe grupi vokale-instrumental "Pensionistë të hareshëm", që ka kënduar shumë këngë dhe ka realizuar një numër të madh shfaqjesh në komunë dhe Republika.

Shoqata ka bashkëpunim të mirë me vetëqeverisjen lokale.

Kryetar i shoqatës dhe i KE është Petar Zaharçev, nënkryetar i Kuvendit Stojan Atanasovski dhe sekretar Simeon Hristovski.

SHP DELLÇEVË

Shoqata SHP Dellçevë është formuar në vitin 1997 dhe prej disa vitesh funksionon si një subjekt i pavarur juridik përmes Kuvendit të vet me 31 anëtarë, Këshillit ekzekutiv me 11 anëtarë, Këshillit mbikëqyrës me 3 anëtarë dhe disa komisioneve. Në shoqatë është aktiv edhe Aktivi i pensionistëve.



Pensionistët në SHP Dellçevë janë të organizuar në 14 degë dhe një klub pensionistësh. Shoqata merr pjesë në paradat e këngës, muzikës dhe valleve si edhe të garave sportive të organizuara nga LSHPM. Në vitin 2015 ishte mikpritës i garave rajonale të 21-ta të rajonit lindor. Bashkëpunon shumë mirë me vetëqeverisjen lokale dhe me institucione të tjera që lidhen me popullsinë e pensionistëve.

Po ashtu, SHP Dellçevë ka bashkëpunim ndërkombëtar ndërkufitar me pensionistë të Bllagoevgrad, me të cilët ka nënshkruar Memorandum bashkëpunimi.

Shoqata ka rreth 3.200 anëtarë.

Kryetar i SHP i dhe i KE është Mone Gjorgjievski, ndërsa sekretar është Boris Mucunski.

SHP LABUNISHTË

SHP Labunishta është formuar në vitin 1998. Më përpara pensionistët e kësaj shoqate ishin anëtarë në SHP Struga. Iniciatorë për formimin e shoqatës, sipas kujtimeve të pensionistëve më të vjetër ishin aktivistët:



Naziv Imeroski, Ramiz Qazimoski, Dilaver Shaqiroski, Bilal Maksudoski, Nihad Saloski, Nevzad Mustafovski, Shevrit Demiroski, Safet Saloski, Fejzulla Fejzulloski, Spase Marinovski, Esad Avmedoski, Said Sefidanoski dhe të tjerë. SHP Labunishta është orga-

nizuar dhe i përfshin fshatrat: Boroec, Podgorci dhe Labunishta dhe numëron rreth 700 anëtarë nga nacionalitet të ndryshme.

SHP Labunishta është mes shoqatave të rralla në Republikë që ka Shtëpinë e saj të pensionistëve, e ndërtuar me aksione dhe me buxhetin e vet financiar dhe ndihmën e pensionistëve dhe banorëve të fshatit, të punësuar jashtë vendit. Gjithsesi që donacioni më i madh për ndërtimin e Shtëpisë së pensionistëve është dhënë nga LSHPM, në një vlerë prej 120.000 denarë. Shtëpia është e pajisur me mjete bashkëkohore. SHP Labunishtë ka vendosur bashkëpunim të mirë me shoqatat: Struga, Vevçani, Dibër dhe Qendër Zhupa, Ohër dhe Debarca dhe të tjera shoqata nga pjesa perëndimore e Republikës. Është shumë i rëndësishëm bashkëpunimi me LSHPM nga ku merr edhe mbështetje të madhe. Me rastin e jubileut të 70 vjetorit të organizmit pensionist në Maqedoni, anëtari i Kuvendit të LSHPM Ramiz Qazimoski, që është edhe kryetari i parë e shoqatës mori një pllakatë.

Kryetar i shoqatës dhe i KE është Lutvi Qazimoski, ndërsa sekretar Lutvija Salloski.

SHP LLOZOVË

Shoqata komunale e pensionistë Llozovë është shoqatë e vogël. Në të janë të anëtarësuar rreth 450 pensionistë nga 9 fshatra të komunës Llozovë, prej të cilëve 40 invalidë pune. Deri më 27.12.1997 pensionistët e Llozovës ishin anëtarë në përbërje të SHP Shën Nikollë. Më 28.12.1997 pensionistët nga Llozova formuan një shoqatë të vetën si Lidhja e pensionistëve të komunës Llozovë, me seli në Llozovë. Që nga 22.03.2011 me ndryshimin e Statutit Lidhja e pensionistëve nga komuna Llozovë u transformua në Shoqatë pensionistësh Llozovë. Aktivitetet e veta i realizon në formë vullnetare, pasi që gjendja financiare është shumë e keqe. Shoqata ka shumë aktivitete, mes të cilave ekskursione dhe vizata në shtetet fqinje si: Shqipëri, Bullgari dhe Serbi. Sipas mundësive të shoqatës disa prej pensionistëve me pensione të vogla i ndihmon edhe financiarisht. Shoqata merr pjesë aktive në shënimin e jubileve,



përvjetorëve dhe festave të tjera në qytet dhe më gjerë. Çdo vit shënohet Dita e drurit. SHP Llozovë merr pjesë në paradat e këngës, muzikës dhe valleve që i organizon LSHPM. Në vitin 2016 ishte mikpritëse e Garave rajonale sportive të 21-ta në rajonin VII. Për momentin punon në përgatitjen e kartës sociale të pensionistëve të shoqatës.

Kryetar i shoqatës dhe i KE është Marija Manevska, kryetar i Kuvendit Grozdan Tasevski, ndërsa sekretar Cveta Klinçareva.

SHP PEHÇEVË

Shoqata e pensionistëve Pehçevë renditet mes dhjetë shoqatave më të vogla sipas numrit të anëtarëve në LSHPM, me rreth 1.000 pensionistë. Angazhohet në mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të pensionistëve, pas përmirësimit të mbrojtjes shëndetësore dhe krijimit të kushteve për shoqërimin e tyre dhe bashkëpunim.



Anëtarët marrin pjesë në Gara sportive rajonale dhe republikane pensioniste dhe kohëve të fundit edhe në parada rajonale dhe republikane të këngës, muzikës dhe valleve. Në organizimin e shoqatës dhe në bashkëpunim me kryetarin e komunës Igor Popovski në pikën turistike "Ramna reka" filluan që të mbahen piknik takime me pjesëmarrjen e mbi 1.500 pensionistëve nga më shumë qytete dhe nga vendi ynë. Insistohet që manifestimi të bëhet tradicional dhe të kontribuojë në zhvillimin turistik të kësaj pjese të Maleshevisë. Si fryt i këtyre takimeve ishte takimi i "Ramna reka", pesë vjet më parë mes pensionistëve nga Pehçeva dhe SHP Gazi Baba Shkup. Pensionistët i vizituan ujëvarat që përbëjnë një atraksion turistik në takim mes dy drejtuesve u bë edhe binjakëzimi, sipas marrëveshjes për aktivitete të mëtejshme të përbashkëta.

Kryetar i shoqatës dhe i KE është Boris Zarinski, kryetar i Kuvendit është Branko Haxhiski, ndërsa sekretar është Stojan Haxhi Ivanov.

SHP KRUSHEVË

Shoqata e pensionistëve - Krushevë është e pavarur, joqeveritare apartiake dhe organizatë multi-etnike e shfrytëzuesve të lirë të shoqatave (moshe, familjarë dhe invalidë) pensionistë nga komuna Krushevë. Shoqata vepron në interes të realizimit dhe avancimit të qëllimeve të përbashkëta dhe interesave të gjithë shfrytëzuesve të pensionit në Komunë, i mbron të drejtat nga sigurimi pensional dhe invalidor dhe angazhohet edhe për një mbrojtje më të mirë shëndetësore. Shoqata i avancojnë aktivitete kulturore, sportive dhe humanitare të pensionistëve dhe merr pjesë në garat sportive të organizuara në nivel Rajonal dhe në nivel të Lidhjes, si edhe në manifestimin e këngës, muzikës dhe valleve dhe bashkëpunon edhe me



shoqata të tjera dhe organizata joqeveritare në Komunë dhe më gjerë. Shoqata është person juridik që nga 20.10.1998 dhe është regjistruar pranë Regjistrimit qendror të RM, konform Ligjit të shoqatave dhe fondacioneve. Është anëtare e LSHPM dhe numëron rreth 1.600 përdorues të pensionit. Ka në dispozicion dhe është pronare e Shtëpisë së pensionistëve, që është e vendosur tek Klubi i pensionistëve. Klube të pensionistëve ka edhe në fshatin Buçin, Vërboec, dhe po përgatitet që të hapet edhe në fshatin Zhitoshe.

Kryetar i shoqatës dhe i KE është Gligor Angeleski, kryetar i Kuvendit është Nikolla Atanasoski dhe sekretar Dimçe Trajkoski.

SHP DOJRAN

Shoqata e pensionistëve nga Komuna Dojran është themeluar më vendimin e Kuvendit të Shoqatës më 05.02.1999, me daljen nga SHP Gjevgjeli. Shoqata është vërtetuar me vendim gjyqi më 06.04.1999. Kryetar i parë i Shoqatës së pensionistëve të Komunës Dojran është Vojo Terziev, ndërsa selia e shoqatës është në ambientet e Komunës Star Dojran, që do të thotë se nuk ka ambiente të veta. Që nga 22 shkurt 2011 si kryetar i Kuvendit të Këshillit ekzekutiv është zgjedhur Borivoj Bojaxhiev. Kryetari i Këshillit ekzekutiv të SHP Dojran deri tani ishte: Petar Topçev, Petar Iliev dhe Elinica Popkoçeva. Shoqata sot numëron rreth 600 anëtarë, por edhe pse janë një numër i vogël, marrin pjesë në të gjitha aktivitetet për të cilat ka mundësi dhe para.

Një prej aktiviteteve më evidente në të cilën rregullisht është bashkëorganizator është hapja e sezonit turistik në Dojran, në të cilin çdo vit marrin pjesë mbi 5.000 pensionistë thuajse nga të gjitha shoqatat anëtare të LSHPM. Në këto takime disa pensionistë duke u shëtitur kënaqen në bukuritë në zonën rreth liqenit të Dojranit, disa pushojnë nën hije të mëdha dhe disa guxojnë që të lahen duke e hapur sezonin.



Kryetar i SHP, i Kuvendit dhe i KE është Borivoj Bojaxhiev, ndërsa sekretar Petar Iliev.

SHP DEMIR KAPI

Shoqata e pensionistëve "Demir Kapija" nga komuna Demir Kapija është formuar më 7 janari i vitit 2010, ndërsa në LSHPM është pranuar në prill të vitit 2010. Gjatë formimit të shoqatës ajo numëronte 600 nga komuna Demir Kapi, ndërsa sot ka rreth 710 pensionistë. Në shoqatë funksionojnë



katër degë. Që në vetë fillimet Shoqata organizonte ekskursione dhe takime në fundjavë. Në vendin turistik Doshnica, tradicionalisht zhvillohet takimi pensionist ku marrin pjesë deri në 1200 dhe 1400 persona nga më shumë shoqata. Në vitin 2016 në takim morrte pjesë edhe kryetari i LSHPM Dragi Argirovski dhe kryetari i ko-

munës Demir Kapi Trajçe Dimitriev, që i mbështet nga të gjitha anët shoqatën në kufijtë e mundësive të komunës. Duke i parë aktivitetet e pensionistëve Këshilli i komunës Demir Kapi, me rastin e festës 7 Nëntor - Ditës së çlirimit të Demir Kapisë, Shoqata i akordoi mirënjohjen e 7 nëntorit, me shpresën dhe dëshirën që edhe më tej pensionistët të vazhdojnë me aktivitetet e tyre dhe të arrijnë suksese të reja.

Shoqata ka formuar edhe ekipin e futbollit ku marrin pjesë në gara të të gjitha niveleve, si edhe në turne të futbollit të vogël "Shën Mëria", që e organizon komuna. Që nga viti 2016 është formuar edhe grupi i këngëtarëve folklorikë që merr pjesë në parada. Pensionistet marrin pjesë edhe në gara të ndryshme, si ajo që bëhet në Probishtip "Turshia e gjyshes". Me rastin e Vitit të ri viziton 20 familje pensionistësh të moshuar dhe të pafuqishëm dhe i jep ndihmë modeste, si edhe viziton edhe kopshtin e fëmijëve "Boris Trajkovski", në Demir Kapi dhe fëmijëve të moshës parashkollore iu dhuron dhurata modeste.

Që nga formimi është kryetar Blagoja Kavazov, ndërsa sekretar Risto Ristovski.

SHP NOVO SELLË

Shoqata është formuar më 18.12.1997. që nga vetë formimi e deri më sot funksionon si një subjekt i pavarur që rregullisht merr pjesë në të gjitha aktivitetet e organizuara nga LSHPM. Shoqata praktikon vizitat tek të sëmurët dhe të pafuqishmit, ekskursione në vende të caktuara, pjesëmarrje në gara sportive dhe parada folklorike e të tjera.



Ka hapur edhe klube pensionistësh Sushica, Mokrievë dhe Smollari. Në lojërat e 20-ta rajonale sportive që u mbajtën në SHP Novo Sellë, në vitin 2015 ato ishin pjesëmarrëse dhe në to po ashtu ishin pjesëmarrës pensionistë nga 7 rajonet e Lindjes. Ceremonia përfundimtare u mbajt në restorantin Sonce, fsh. Borisovë, ku nga SHP Strumicë, SHP Radovish, SHP Konçe, SHP Shtip, SHP Llozovë dhe SHP Shën Nikollë ishin prezent rreth 360 pensionistë. Në SHP Novo Sellë janë anëtarë pensionistë nga Sushica, Zubova, Koleshina, Borisova, Mokrieva, Mokrina, Smollari, Drazheva, Staro Konjareva, Novo Konjareva dhe Samoillova.

Shoqata numëron rreth 1.400 pensionistë. Kryetar i SHP Novo Sellë është Ilija Kovačev, ndërsa sekretar është Kiro Velkov.

ZP BOGDANCI

Shoqata është formuar më 25.07.1998 dhe në po atë ditë është paraqitur dokumenti për regjistrimin në Regjistrin qendror. Shoqata ka katër degë: Bogdanci, Stojakovë, Gjavotë dhe Selemlë. Nga të gjitha degët ka përfaqësues në Kuvend dhe në KE e shoqatës. Kuvendi ka 21 anëtarë, ndërsa



KE numëron 9 anëtarë. Në përbërje të OSHP - Bogdanci ka aktiv të pensionisteve. Shoqata numëron rreth 1.400 anëtarë. Nga sfera e kulturës shoqata merr pjesë rregullisht në paradat rajonale të këngës, muzikës dhe valleve, si edhe në manifestime. Pensionistët këndojnë në rajonin e nën Vardarit dhe qytete Prilep dhe Manastir. Pensionistët janë rregullisht prezent edhe në piknike në natyrë nëpër të gjithë vendin. Po ashtu, çdo vit organizohen ekskursione. Dy ekskursione - pranverës dhe vjeshtës me participimin e shoqatës



organizohen edhe vizita të shfaqjeve teatrale. Humaniteti ndaj më të varfërve është prezent edhe përmes ndarjes së ndihmës financiare dhe paketave me artikuj bazë, në një vlerë sipas të ardhurave të shoqatës. Ajo merr pjesë rregullisht edhe në aktivitete rajonale dhe republikane pensioniste sportive konform me programin e LSHPM. Shoqata nuk ka klubin e vet pensionist. Kancelaria dhe ambienti për aktivitete janë në

pronësi të Fondit të SPIM.

Kryetar i SHP Bogdanci është Dimitar Çavdarov, ndërsa sekretar Sanda Petrusheva.

SHIP DEMIR HISAR

Shoqata e pensionistëve Demir Hisar është organizatë e pavarur, joqeveritare, jopartiake dhe multietnike e pensionistëve të lirë moshe, familjarë dhe invalidë. Është formuar në vitin 1965. Shoqata vepron në interes të realizimit dhe avancimit të qëllimeve dhe interesave të përbashkëta të të gjithë shfrytëzuesve të pensionit në



Komunë, që i mbron të drejtat e fituara nga sigurimi invalidor dhe pensional dhe angazhohet për një mbrojtje më cilësore shëndetësore të pensionistëve. SHP Demir Hisar funksionon përmes organeve, trupave dhe komisioneve në vijim: Kuvendi, Këshilli ekzekutiv dhe Këshilli mbikëqyrës, 5 komisione dhe ato: për kulturë dhe jetë zbavitëse, për sport dhe rekreacion, për shëndet dhe mbrojtje shëndetësore, komisionin e ndihmës, çështjeve sociale dhe vizita në pension-

istë të sëmurë, për furnizimin me mjete financiare. Shoqata posedon Shtëpinë e Pensionistëve të ndërtuar në vitin 1972 me sipërfaqe prej 517,30 m², prej të cilave Shoqata përdor 403 m². Një pjesë e ambienteve i përdor edhe Shërbimi territorial i SPIM. Në vitin 2016 bashkë me SHP Manastir mori pjesë me sukses në Festivalin e 16-të të moshës së tretë në Lubjana. Shoqata numëron rreth 1.590 pensionistë.

Kryetar i shoqatës është Pere Petreski, ndërsa sekretar është Boris Najdovski.

SHP SHUTO ORIZARI

Fillimet e organizimit pensionist të pensionistëve në Shuto Orizarë datojnë që prej para 8 vitesh, kur në vitin 2009 u nda nga SHP Çair dhe Butel. SHP Shuto Orizari është shoqatë relativisht e re. Në të bëjnë pjesë rreth 1.400 pensionistë, prej të cilëve shumica janë të nacionalitetit rom, derisa në



një numër më të vogël janë edhe nga nacionalitete të tjera. Atyre i është dhënë një ambient pune dhe klub me një sipërfaqe prej 130 m², në të cilën punojnë dhe i kryejnë aktivitetet e tyre. Në Shoqatë punon aktivisht në më shumë aksione Aktivi i pensionisteve. Një pjesë e aktiviteteve të tyre janë: vizita tek të sëmurët, ligjërata, pjesëmarrje në manifestime dhe organizim i ekskursioneve në dhe jashtë vendit. Që në fillimet e veta shoqata aktivisht u përfshi edhe në më shumë aktivitete të organizuara nga LSHPM. Në të gjithat paradat rajonale dhe republikane të këngës, muzikës dhe valleve merr pjesë rregullisht edhe është prezent edhe në garat sportive rajonale dhe republikane. SHP Shuto Orizari tregon një kujdes të veçantë për shëndetin dhe standardin e anëtarëve të saj. Pensionistëve me paga të vogla, personave të sëmurë dhe të pafuqishëm i jep ndihmë financiare. Bashkëpunimi me

vetëqeverisjen lokale është në nivelin e nevojshëm. Kryetar është Arif Bekir, ndërsa sekretar është Liljana Hajdar.

SHP GJEVGJELI

Shoqata e pensionistëve nga Komuna Gjevgjeli është themeluar në vitin 1986 me seli në rrugën Marshall Tito nr. 147 Gjevgjeli. Si Shoqatë e pensionistë vepron në të tërë territorin e Komunës Gjevgjeli dhe ka 14 degë që janë: Gjevgjeli 5 degë, Negorci, Miravci me Petrovo Gabrovo dhe Miletkovo, Davidovo, Prdejci, Bogorodica, Mërzenci, Moin me Gorniçet, Smokvica dhe Kovanec, ndërsa numëron rreth 3.900 pensionistë.

Organe në Shoqatë: Kuvendi që numëron 27 anëtarë. Në Shoqatën e pensionistëve Gjevgjeli punon edhe Komisioni i kulturës dhe jetës zbavitëse, në përbërje të të cilit është edhe grupi i këngëtarëve "Sava Mihajlova", Komisioni i sportit, Komisioni i ambientit të banimit dhe afarist, Komisioni i punëve sociale dhe



shëndetësore, Komisioni i ndjekjes së punës së klubeve nëpër vendbanimet dhe ruajtjen e vendbanimit dhe ambientit afarist. Shoqata e pensionistëve ka në dispozicion 21 apartamente në dy Shtëpitë e Pensionistëve në Gjevgjeli, restorante me kopsht veror dhe klub pensionistësh si edhe ambiente afariste, zyra. Shoqata po ashtu ka edhe një vilë në Kozhuv - Smrdilva voda dhe të gjitha këto në pronësi të Shoqatës së pensionistëve Gjevgjeli me fletë pronësie. Klubet e vendbanimeve në ambientet e Komunës Gjevgjeli janë me marrëveshje për bashkëpunim afarist. Këshilli i komunës Gjevgjeli me rastin e 7-të Nëntorit - Dita e çlirimit të qytetit individëve dhe institucioneve që kanë kontribuar në zhvillimin e përgjithshëm të Komunës ndau pllakate. Pllakati i artë i është dhënë SHP Gjevgjeli, si mirënjohje për arritjen e rezultateve në të gjitha segmentet e jetës së pensionistëve.

Kryetar i Shoqatës është Lena Semenakova, ndërsa sekretar është Mirjana Karajnova.

SHP MAKEDONSKI BROD

Në Librin e evidencës pranë Shoqatës së pensionistëve Makedonski Brod, anëtarët e parë të shoqatës janë të evidentuar në janar të vitit 1952. Numri i pensionistëve anëtarë të shoqërisë në Makedonski Brod, në dhjetor të vitit 1959 arriti në 54 anëtarë. Ish kryetari i shoqatës nga viti 1982 ishte



e: Milan Mitkoski, Muzafer Zeqiroski, Vençe Stankoski, Milovan Markoski, ndërsa sekretari Stojan Ginoski, Kostadin Ivanoski dhe Stanojle Stanoeski. Sot SHP Makedonski Brod numëron rreth 1.300 anëtarë (pensionistë të moshuar, familjarë dhe invalidë) të organizuar në më shumë se shtatë degë për komunën Makedonski Brod dhe komuna Pllasnica. SHP Makedonski Brod është e shoqatë e pavarur, joqeveritare, jopartiake, joprofitabile dhe multietnike me së bashku 52 shoqata të tjera të Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë.

SHP Makedonski Brod, si person juridik angazhohej në mbrojtjen dhe avancimin e qëllimeve të përbashkëta dhe interesave të përdoruesve të pensionit. Me aktivitetet e veta SHP Makedonski Brod bashkëpunon me LSHPM, me shoqatat e pensionistëve të rajonin jugperëndimor të R. Maqedoni, vetëqeverisjes lokale, FSSHM, Fondit të SPIM, Kryqi i kuq, Qendra ndërkomunale e punëve sociale dhe të tjerë institucione.

Kryetar i shoqatës është Ilija Lazeski, ndërsa sekretar Vençe Kuzmanoski.

SHP RESNJË

Shoqata vepron prej disa vitesh. Ishte mikpritës i suksesshëm i garave republikane të pensionistëve në vitin 2000 dhe 2006 në terrenet e shtëpisë së pushimit Krani në Liqenin e Prespës. Ku vendi i SHP Resen, konform aktiviteteve të miratuara programore festën "Shën Kirili dhe Metodija", Ditën e shkronjave sllovene, që është njëherazi edhe patroni i Resnjës, më 24 maj shënohet me solemnitete. Me



këtë rast mbi 400 pensionistë nga vendi janë shoqëruar në bregun e Liqeni të Prespës. Në fillimin e festës pas një pritje të përzemërt dhe me ëmbëlsira të pranishmit i përshëndeti kryetarja e SHP Resen, Kostadina Barandovska,

që me fjalën e saj tregoi rëndësinë e kësaj feste të madhe fetare dhe falënderoi për prezencën pensionistëve nga shoqatat: Ohri dhe Debërca, Struga, Manastiri, Vevçani, Demir Hisar, Shtip dhe Karbinci, Gjorçe Petrov dhe të tjerë. Për rëndësinë e festës dhe për bashkëpunimin me komunën dhe SHP Resen, fliste edhe kryetari i komunës Gjoko Strezovski. Takimi i hapur u shpall nga kryetari i LSHPM Dragi Argirovski, duke theksuar rëndësinë e jubileut të 70 vjetorit të organizmit pensionist në Maqedoni. Kënaqësia e shoqërimit dukej edhe në fytyrat e të pranishmëve që në ikje i dëshiruan këtij takimi që të bëhet në traditë, që është edhe qëllim i shoqatës që numëron 2.800 pensionistë.

Kryetar i shoqatës është Kostadina Barandovska, ndërsa sekretar është Goce Butevski.

SHP BEROVË

Jeta e organizuar e pensionistëve nga komuna Berovë fillon në vitin 1965, si një organizatë qytetare e pensionistëve të qytetit Berovë, me rreth 20 anëtarë. Drejtuesi i parë është pensionisti Dimitar Çuqevski, ndërsa klub - kafeneja e parë në vitin 1967 ishte e vendosur tek një objekt privat. Lidhja



komunale e pensionistëve - Berovë filloi me aktivitete në vitin 1969 me rreth 50 anëtarë. Në SHP Berovë veprojnë disa komisione nën kompetenca të Këshillit ekzekutiv, përmes të cilave zhvillohen të gjitha aktivitetet në shoqatë. Komisioni për ndarjen e ndihmës financiare tradicionalisht bën ndarjen e paketave humanitare për Pashkë dhe Krish-tlindje.

Për momentin SHP Berovë numëron rreth 2.250 anëtarë-pensionistë, ndërsa në territorin e komunës Berovë vepron veçmas edhe një Shoqatë e pensionistë invalidë Berovë, me rreth 400 anëtarë, që nga Shoqatë amë është ndarë që në vitin 1994. Deri në fund të vitit 1973 zyra dhe Klubi i pensionistëve ishin të vendosur në ambiente private me qira. Në vitin 1973 është ndërtuar Shtëpia e pensionistëve në Berovë, me kat përdhes dhe ku janë vendosur zyra dhe Klubi i pensionistëve. Shtëpia është rikonstruktuar dhe rinovuar në vitet 1986-87, si edhe në vitin 2008, 2010, 2013 dhe 2016.

Kryetar i SHP është Lupço Gotovski, ndërsa sekretar Nadezhda Sashanska.

SHP KRATOVË

Shoqata kratovare e pensionistëve aktivitetet e saj më të mëdha fillon që t'i realizojë në dhjetë vitet e shekullit të kaluar. Shoqata është një prej iniciatorëve të zhvillimit të garave sportive tradi-



cionale ndërkomunale të pensionistëve nga Probishtip, Kriva Pallankë, Shën Nikollë dhe Kratovë që kanë traditë 25 vjeçare. Me sukses marrin pjesë edhe në gara sportive rajonale dhe republikane, pensioniste dhe në parada folklorike që i organizon Lidhja e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë. Aty një sukses të posaçëm kanë edhe tamburashët e njohur kratovarë pensionistë. Me rastin e festës

Shën Gjorgji Kratovski, patroni i qytetit Kratovë, shoqata organizon takimin tradicional të pensionistëve nga më shumë qytete nga vendi ynë. Çdo vit më shumë pensionistë marrin pjesë edhe në ceremonitë festive të sheshit "Pavel Shatev".

Shoqata numëron rreth 1.700 anëtarë dhe realizon një bashkëpunim shumë të mirë me vetëqeverisjen lokale dhe me kryetarin e komunës Mite Andonovski, si edhe me më shumë shoqata - anëtare të LSHPM.

Kryetar i Shoqatës është Lupço Angelovski, ndërsa sekretar është Manço Antovski.



SHP MAKEDONSKA KAMENICA

Shoqata e pensionistëve së komunës Makedonska Kamenica si një shoqatë e pavarur vepron që nga 28.01.1997. Deri tani ka vepruar si një Degë e SHP Dellçevë me kompetenca të zgjeruara, procedura për formimin e Shoqatës është zbatuar në mënyrë demokratike, ndërsa bilanci i ndarjes së mjeteve është bërë sipas numrit të pensionistëve.



Kryetari i Shoqatës është Simeon Angelov. Shoqata vepron në princip të deleguar prandaj edhe në fshatin Sasa ku ka edhe një numër të madh të pensionistëve ka Degë. Vendbanimet fshatare janë të tipit të lagjeve, që do të thotë të shpërndarë në zonat më të larta të brezit kufitar drejt R. Bullgarisë dhe nuk mundet që të vijë deri tek grupimi në më shumë vendbanime dhe formimin e degës.

Prandaj çdo vendbanim-bashkësi vendore (10 bashkësi vendore) në Kuvendin e Shoqatës përfaqësohet me delegat ose me gjithsej dhjetë delegatë. Në Shoqatë veprojnë edhe Komisioni i kulturës dhe jetës argëtuese, Komisioni i sportit, Komisioni i shëndetit, Komisioni i punës me subjekte juridike, Komisioni rregullativ dhe Komisioni i të ardhurave, si edhe Aktivi i pensionistëve dhe grupit folklorik "Pensionistët e hareshëm", me të cilën në vitin 2015 në 15 F3ZHD në Lubjana bashkë me SHP Radovish dhe Konçe e përfaqëson LSHPM përkatësisht R. Maqedonisë. Makedonska Kamenica në Kuvend ka 11 delegate, ndërsa në Këshillin Ekzekutiv 7. Shoqata e pensionistëve ka klub pensionist me 155m2.

SHP Makedonska Kamenica është organizatori takimit më të madh në të cilin marrin pjesë 5.000 pensionistë vë vendin Elenec, e ndihmuar nga LS me të cilën ka nënshkruar edhe një Memorandum bashkëpunimi. Shoqata numëron rreth 1.300 anëtarë.

Kryetar i Shoqatës është Vidan Konevski, ndërsa sekretar Kirka Atanasovska.

SHP ZLLETOVË

Shoqata e pensionistëve në Ziletovë është formuar në vitin 1998, pas ndarjes nga SHP Probishtip. Kryetari i deritanishëm i shoqatës ishte Radoslav Mihajlov, Danka Josifova dhe Strahil Mijalčov. Shoqata bashkëpunon shumë mirë me SHP Probishtip, SHP Kratovë, SHP Shtip dhe me shoqata të tjera.



Është një prej shoqatave më të vogla-anëtare të LSHPM me rreth 500 anëtarë. Shoqata merr pjesë me sukses edhe në garat sportive rajonale dhe republikane, si edhe në paradat rajonale dhe republikane të këngës, muzikës dhe valleve. Shoqata kujdeset edhe për sigurinë materiale-sociale të pensionistëve dhe për mbrojtjen e tyre shëndetësore dhe organizon edhe pjesëmarrje në piknik, takime dhe ekskursione. Po ashtu një aktivitet të posaçëm ka Aktivi i pensionistëve që kujdesen për aktivitetet humanitare.

Suksesi më i madh i shoqatës ishte që në vitin 2010 ndërtoi një ambient të vetin në qendër të Ziletovës me zyra dhe klub pensionist ku pensionistët shoqërohen dhe luajnë shah, domino, tablla, pikado dhe të tjera... Ajo është

të si shtëpia e dytë. Informohen, dakordohen për aktivitete, ndërsa këtu ushtrojnë anëtarët e shoqatës kulturore-artistike.

Kryetar i Shoqatës është Trajan Pecevski, ndërsa sekretar është Trajko Popov.

LSHP E QYTETIT SHKUP

Ne Lidhjen e shoqatave të pensionistëve të qytetit Shkup janë të përfshirë të gjitha 14 shoqatat e pensionistëve nga kryeqyteti i Republikës së Maqedonisë, me mbi 80.000 anëtarë. Lidhja vepron për një kohë më të gjatë, ndërsa rezultate evidente në aktivitetet e veta realizon pas pavarësimit së Republikës së Maqedonisë, kur në fillim ishte kryetar Vasko Popovski. Periudhë e rëndësishme si kryetar i Lidhjes së qytetit ishte d-r Kërsto Angelovski. Që nga fillimi i vitit 2007 godina në kuadër të Lidhjes



u formua Këshilli koordinativ si një formë e veçantë këshillëdhënëse e veprimt, ndërsa me qëllim të një marrëveshje sa më efektive koordinimin dhe zgjidhjen e çështjeve të caktuara me interes të pensionistëve nga Shkupi. Në fokus të interesimit për standardin e jetës, punës dhe shtëpisë së pensioniste dhe bashkëpunimi me Fondin e SPIM, mbrojtja sociale dhe shëndetësore, pushimi, rekre-

acioni dhe të tjera. Synohet që Qendra Rekreative Katllanovë për më shumë dhe më me efikasitet të përdoret dhe të zgjidhet pronësia.

Në takimet me kryetarin e komunës Shkup Koce Trajanovski në vitin 2009 u nënshkrua edhe marrëveshja për përcaktimin e mjeteve buxhetore për rekonstruktimin QR Katllanovë si edhe për vendosjen e transportit publik qytetar për të moshuar, gra me mbi 62 vjeç dhe burra mbi 64 vjeç, fillimisht çdo të martë dhe të premte dhe më pas edhe e shtuna dhe e diela. Me ndihmën e kryetarit të komunës realizohet bashkëpunimi me pensionistë nga qytetet kryesore të Ballkanit. Me mbështetjen e kryetarit të komunës mbahet edhe turneu tradicional i shahut pensionist "13 Nëntori". Benefitet që i siguron qyteti i Shkupit për popullsinë pensioniste rriten vazhdimisht. Vitet e fundit Lidhja e qytetit të pensionistëve është e suksesshme, si mikpritëse e Paradave republikane të këngës, muzikës, valleve që i organizon LSHPM.

LSHP e qytetit Shkup është mikpritës i takimit pensionist ndëretnik në Saraj, që duhet që të bëhet tradicionale.

Organet e Lidhjes së qytetit janë Kuvendi dhe këshilli ekzekutiv dhe mbikëqyrës, por ka edhe komisione të kulturës dhe sportit. Si kryetar i ri i Kuvendit është Lupço Dimovski, ndërsa i Këshillit ekzekutiv Metodija Novkovski.

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE - DRAGI ARGIROVSKI	
VITI I JUBILEUT 70-VJEÇAR DO TË MBAHET MEND.....	5
RECENSIMI - ALEKSANDAR DIMKOVSKI,	
KRYEREDAKTORI I "NOVA MAKEDONIJA"	
VITE ME PLOTË SHOQËRIM, BASHKËJETESË DHE AKTIVITE.....	8
PJESA I - DRAGI ARGIROVSKI	
"KARTA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË" PËR LSHPM	11
PJESA II - ILIJA GLIGOROV	
DY DEKADAT E PARA TË ZHVILLIMIT.....	21
PJESA III - STANKA TRAJKOVA	
AKTIVITETET DHE REZULTATET ME RËNDËSI	29
(RUBRIKAT 5, 6, 8 DHE 9 I PËRGATITI ILIJA GLIGOROV)	
PJESA IV - ILIJA GLIGOROV	
BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR I LSHPM	53
PJESA V - STANKA TRAJKOVA	
SHOQËRIMI MES GJENERATAVE DHE BASHKËJETESA	65
PJESA VI - MENDO DIMOVSKI	
PENSIONISTËT GARDIANË BESNIKË TË THESARIT KULTUROR	
TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË.....	71
PJESA VII - DRAGI ARGIROVSKI	
SPORTI DHE SHOQËRIMI PËR SHPIRT TË SHËNDOSHË NË TRUP TË SHËNDETSHËM.....	97
PJESA VIII - KALINA S. ANDONOVA	
INFORMIMI SI NJË PRIORITET I PENZIONISTËVE.....	119
(RUBRIKËN 1 E PËRGATITI ILIJA GLIGOROV)	
PJESA IX - KALINA S. ANDONOVA	
PLLAKATE, MIRËNJOHJE DHE FLETË FALENDERIMI.....	137
PJESA X - KALINA S. ANDONOVA	
STRUKTURA ORGANIZATIVE E LSHPM.....	143

NË MONOGRAFINË JANË PËRDORUR TË DHËNA DHE FOTOGRAFI NGA:

- MATERIALET E ARKIVIT
- GAZETAT ZYRTARE
- BILETINET E GARAVE SPORTIVE
- BILETINET E SFILATAVE FOLKLORIKE
- MONOGRAFITË E SHOQATAVE
- INFORMATORË
- GAZETA "PENSIONISTI PLUS"
- REVISTA "PIKËPAMJET E PENSIONISTËVE"
- NË GAZETËN "NOVA MAKEDONIJA"
- GAZETA "KOHA"

FJALËT FLUTUROJNË, SHKRIMI MBETET

NË VEÇANTI FALËNDEROJMË
PËR MBËSHTETJEN
LIDHUR ME MONOGRAFINË:

FONDACIONI "ALBIZ"
POSTA E MAQEDONISË



f o u n d a t i o n



BESIM DHE SIGURI!

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

061.2-057.75(497.7)"1946/2016"

AKTIVITETE të pensionistëve që meritojnë respekt : 70 vjet
1946-2016 / [Dragi Argirovski ... и др.]. - Shkup : Lidhja e
shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, 2017. - 200 стр. :
фотографии ; 30 см

Превод на делото: Пензионерски активности за почит : 70 години
1946-2016 / Драги Аргировски ... [и др.]. - Автори: Dragi
Argirovski, Stanka Trajkova, Kalina Slivovska-Andonova, Ilija
Gligorov, Mendo Dimovski

ISBN 978-608-65788-6-2

1. Argirovski, Dragi [автор]

а) Сојуз на здруженијата на пензионери на Македонија - 1946-2016 -
Јубилеи б) Пензионерски друштва - Македонија - 1946-2016

COBISS.MK-ID 103612170